Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
17

JUSUF GËRVALLA
dhe
L I R I A

LIRIA
I PA INFEKTUAR
L I R I A, Nr. 1, Tetor 1980
KËTO DITË NA RA NË DORË
L I R I A, Nr. 2 Dhjteor 1980
NDOSHTA PIKËRISHT NGA RADHËT E TYRE
JUSUF GËRVALLA PO I JEPTE SHENJAT E PARA TË BASHKIMIT
DY DEGË TË TË NJËJTIT TRUNG
L I R I A Nr. 3, Maj 1981
ATJE KU DUKET SE KA PASUR PASIVITET OSE HARRESË
TITULLI DUHET NDËRRUAR

LIRIA, Nr. 4-5, Gusht 1981
TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR
TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS
QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM
LIRIA, Nr 6, Dhjetor 1981

THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA
KJO MË BRENGOSË EDHE MË SHUMË PËR RRUGËN E TYRE

* * *

Me anën e këtij libri kam dashur të sqaroj edhe në një aspekt tjetër, përmes revistës "LIRIA, relacionin në mes Lëvizjes së Jusuf Gërvallës dhe Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës, OMLK, gjatë vitit 1981. Më konkretisht kontributin e Jusuf Gërvallës dhe ndihmën e tij për revistën LIRIA. Përmes parashtrimit të plotë të kësaj çështje mendoj se do të jetë edhe më lehtë të bëhen analiza të ndryshme qoftë kualitative apo kuantitative.

Numrat 3 (maj 1981) dhe 4-5 (gusht 1981) teknikisht janë përgatitur në shtëpinë e Jusuf Gërvallës në Untergruppenbach. Aspektin teknik e kam shtjelluar në një punim me titull "Stilografat e Jusuf Gërvallës". Organizimi i dërgimit të këtyre tre numrave (3 dhe 4-5) në Kosovë është bërë nga Jusuf Gërvalla, i cili për këtë detyrë e ka ngarkuar Haxhi Berishën, nga Prapaqani.

Përveç këtyre tre numrave, në Shtutgart nga Jusufi është shkruar dhe shpërndarë trakti "TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR" i cili është shpërndarë në mënyrë masovike, në gusht 1981 për t'i bërë jehonë botimit të xhiro-llogarisë Ndihma për Kosovën, e botuar në faqen e fundit të numrit 4-5 të Lirisë. Përveç këtij trakti, në shtëpinë e Jusufit, në shtator 1981, është radhitur dokumenti: TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.

Vëllimi i tekstit të numrave 3 e 4-5 të revistës LIRIA si dhe ai i Tezave dhe traktit "TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR", të gjitha këto të përgatitura në Untergruppenbach, është rreth 61 000 fjalë. Vëllimi i tekstit të numrave 1, 2 dhe 6 të revistës Liria, të gjitha këto të përgatitura teknikisht në Zvicër, është rreth 41 670 fjalë. Në bazë të kësaj rrjedh se 60% e veprimtarisë me shkrim të Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës, gjatë vitit 1981, pos asaj që është ndihmuar me punime origjinale, është përgatitur teknikisht në shtëpinë e Jusuf Gërvallës, është shtypur në Shtutgart, nga shtëpia e tij është dërguar për në Kosovë, dhe sa i përket shpërndarjes në Perëndim, së pari janë shpërnda dhe shfaqur në rrethin e Shtutgartit. Duke qenë i informuar dhe i involvuar në hollësi për këto punë nga vetë Jusufi, mund të kuptohet edhe më lehtë interesimi dhe angazhimi im në këtë çështje, respekti im për këtë veprimtari ashtu si është edhe për çdo shkronjë e fjalë që e ka shkruar apo daktilografuar Jusuf Gërvalla, respekti për çdo punë që e ka bërë, me shokët e tij në Shtutgart.

Me këtë rast dua të falenderoj Faridin Tafallarin, i cili si gjithmonë më ka ofruar ndihmë të pakursyer. Në këtë rasti ai m'i ka siguruar të gjithë numrat e revistës LIRIA. Numrat e revistës Liria qe disa vite, përmes angazhimit të Lëvizjes Vetëvendosje, gjenden

të digjitalizuar (përmes skanimit) në internet, por në disa pjesë më kanë munguar disa fjalë, ndërsa në kopjet e siguruara nga Faridin Tafallari nuk më ka munguar asgjë.

LIRIA

LIRI (anglisht *freedom, liberty*; frengjisht *liberte*; latinisht *libertas*; gjermanisht *Freiheit*). Në kuptimin tonë të përditshëm, në njërën anë, mendojmë se mund të diskutojmë dhe të marrim vendime, dhe në këtë kuptim kemi liri për të zgjedhur (në mes alternativave të ndryshme). Në anën tjetër mendojmë se në natyrë çdo gjë e ka shkakun e vet, është e vendosur nga një shkak dhe mu për këtë pyesim se mos edhe veprimet tona janë të lidhura në zingjirin shkak-pasojë. Në bazë të këtyre dy interpretimeve, në dukje, kundërthënëse mbi realitetin, lind **problemi metafizik** rreth *vullnetit të lirë* dhe atyre përpjekjeve tradicionale për zgjidhjen e tij.

1. Në bazë të **fatalizmit** (nga latinishtja fatalis, "e vendosur që nga krijimi i botës") përjetimi i lirisë për të zgjedhur është një iluzion. Pamvarësisht se çka bëjmë, e ardhmja do të formohet "ashtu siç është shkruar", siç është vendosur nga fati apo siç ka vendosur krijuesi. I ngjashëm me fatalizmin është i ashtuquajturi determinizmi logjik, ku potencohet se; pasi deklarimet tona për të ardhmen qysh tani janë të vërteta apo false, qysh tani, në baza logjike duhet të jetë e vendosur se si do të jetë, si do të duket e ardhmja.

2. Forma tjera të **determinizmit** (latinisht determinare, me e kufizue, përcaktue) pranojnë se zgjedhjet tona apo veprimet tona kanë ndikim në ngjarjet e ardhshme, pasi këto janë të pranishme dhe janë shkaktare të tyre (ngjarjeve të ardhshme). Por njëkohësisht potencohet mendimi se vetë zgjidhjet dhe veprimet tona janë të përcaktuara nga shkaqet e mëparshme (të natyrave fiziologjike, mentale ose sociologjike). Në kundërshtim ndaj fatalizmit pranohet se (a) e ardhmja mundet me qenë ndryshe dhe (b) se e tashmja dhe e ardhmja kishin mund me qenë ndryshe sikur e kaluara të kishte qenë ndryshe, por duke u bazuar në të dhënat faktike të së kaluarës e tashmja dhe e ardhmja janë definitivisht të vendosura, të përcaktuara.

Në bazë të së ashtuquajturit **determinizimit të fortë,** kjo do të thotë, se edhe nëse veprimet tona nuk janë të vendosura nga ndonjë krijues, prapë se prapë është një iluzion të flitet për "*zgjedhje të lira*" në bazë të "*vullnetit të lirë*", kur në rrethanat e dhëna nuk ka kuptim të flitet "se unë kisha mund me veprua ndryshe". Për këtë arsye njeriu nuk është përgjegjës për veprimet e tij, dhe të gjitha gjykimet morale, lavdatat apo kritikat janë të pavend.

Në kundërshtim me këtë **determinizmi i butë** (i quajtur edhe si **kompatibilizëm**, "pikëpamje përbashkuese", nga anglishtja compatible, bashkues, jokundërthënës), potencon se është i mundur bashkimi i përvojës së veprimeve të lira me determinizmin. Liria është një çështje e mungesës së detyrimit të brendshëm apo *të jashtëm.* Një njeri vepron lirisht kur e bën atë që dëshiron, do me thënë vepron në bazë të dëshirave, qëndrimeve, pikëpamjeve, karakterit të tij, etj. Liria dhe shkak-pasoja mund të bashkohen, dhe për këtë nuk ekziston ndonjë problem teorik lidhur me përdorimin e koncepteve morale. Lira e njeriut nuk është një çështje rreth gjithçkafit apo asgjësë, por është çështje shkallësh. Krejt sipas rrethanave, një njeri është më pak apo më tepër i lirë dhe liria duhet gjithmonë të vlerësohet konkretisht. Përkrahës të këtij determinizmi të butë janë pos tjerësh Hobbes, Locke, Hume, J. S. Mill, Ayer dhe përgjithësisht filozof të traditës empiriste dhe liberaliste. Gjatë viteve 1900 filozofia analitike ka përpjekur ta

thelloj determinizmin e butë duke e analizuar edhe konceptin *veprim* dhe janë bërë diskutime se a është fare e mundur që veprimet të shpjegohen si pasoja të një shkaku.

3. Përkrahësit e **indeterminizmit** e mohojnë si fatalizmin ashtu edhe të gjitha format e determinizmit. Ata e pranojnë se veprimet vërtetë kryhen në rrethana të caktuara të llojit fiziologjik, mental apo sociologjik ("trashëgimi dhe mjedis"), por ata e përjashtojnë mendimin se veprimi apo pasojat e tij janë *pasojë* e domosdoshme e *shkaqeve* të mëparshme. Njeriu e ka një vullnet të lirë me ndihmën e të cilit ai mund të bëjë zgjedhje të cilat paraprakisht nuk janë të përcaktuara.

Indeterministët i kanë dy probleme themelore:

a) problemin për ta shpjeguar raportin në mes njeriut si pjesë të asaj natyre të përcaktuar nga shkaku-pasoja. Zgjidhja *moniste* niset nga ajo se njeriu i lirë është një pjesë e botës, por në gjendje ta shkëpusë zingjirin e shkaqeve dhe të ndërhyjë në te. Tek filozofë të tjerë bëhet një zgjidhje *dualiste*, sipas të cilës njeriu është pjesëtar në botëra të ndryshme, në botën e lirisë dhe në atë të domosdoshmërisë, dhe këto dy botë janë dy sfera të pamvarura. Kantit (sigurisht gabimisht) i është mveshur një dualizëm i tillë. Pos të tjerëve D. Davidson ka paraqitur pikëpamje të ngjashme.

b) Pa marrë parasysh bashkimin në njërën apo tjetrën, prej këtyre dy zgjidhjeve (moniste apo dualiste), prapë se prapë do të ndeshet problemi për dallimin në mes zgjidhjes së lirë, të *indeterminuar*, dhe vetëm asaj mungese të shkaqeve dhe *ligjshmërive* (rastësisë). P. sh. si mund të bëhet dallimi në mes një veprimi të lirë të indeterminuar dhe një ngjarje indeterminuese atomike tek Epikuri apo në kuantfizikën moderne?

4. Në bazë të Karl Jaspers (1883-1969) si fatalistët, deterministët dhe indeterministët tradicional e kanë gabim, pasi ata gabimisht e kuptojnë njeriun si një send (objekt) në mesin e sendeve tjera dhe tek pastaj pyesin nëse ky send a është i lidhur në zingjirin shkaqeve apo jo. Por njeriu karakterizohet pikërisht nga ajo se ai nuk është send (objekt), por një subjekt që ekziston, subjekt i lirë i cili tejkalon (transcendon) sendin (send-shmërinë). Pikëpamje të ngjashme gjenden tek Kierkegard, Heidegger dhe Sartre.

Problemi metafizik mbi *vullnetin e lirë* dhe këto katër përpjekje për zgjidhje që janë përmendur më lartë sillen rreth kuptimit të pastër metafizik mbi lirinë. Anash këtij kuptimi rreth lirisë, ekziston gjithashtu një **kuptim normativ rreth lirisë**, sipas të cilit njeriu është i lirë nëse ai vetë-realizohet (self-realization=zhvillim i balancuar i personalitetit njerëzor, ku asnjë pjesë nuk dominon mbi një tjetër.), (liria si vetë-realizim). Diskutimi mbi **kuptimin normativ rreth lirisë** ia prenë shpeshherë udhën diskutimit metafizik mbi vullnetin e lirë.

Në mesin e problemeve kryesore janë:

a) A është qëllimi më i rëndësishëm i njeriut të bëhet pjesë e një tërësie?

b) A janë mjetet më të rëndësishme diçka mbi të cilat ai (njeriu) vetë mund të vendosë – apo ato janë objektivisht të dhëna në një mënyrë apo tjetër?

c) Cilin rol luan vetëdija e njeriut mbi vetveten për zhvillimin e balancuar të personalitetit të tij, ku asnjë pjesë nuk dominon mbi një tjetër (vetë-realizimit)?

1. Për **fatalistin** para së gjithash çështja e vetë-realizimit është përmes;

a) pajtimit me fatin e tij, apo fisit të tij dhe të mos luftoj kundër asaj që është e pashmangshme.

b) Tradicionalisht fatalistët i konsiderojnë qëllimet finale të jetës (fisit apo botës) objektivisht të dhëna qysh atëherë kur është krijuar bota. Mësimet e Niçes "mbi rikthimin e përjetshëm" mund të interpretohen si shembull i mendimit fatalist.

c) Kuptimi i ekzistencës si domosdoshmëri e palakueshme konsiderohet si qendror për jetën e lirë.

2. a) Përgjithësisht **deterministët e fortë** kanë një tendencë ta konsiderojnë individin vetëm si një moment në një tërësi botërore, në atë mënyrë që individi bëhet i lirë përmes nënshtrimit ndaj kërkesave të tërësisë. Në mënyrë të kundërt **deterministët e butë** kanë një tendencë ta konsiderojnë individin si qëllimin më të rëndësishëm, që shihet më së lehti në traditën e liberalizmit (p. sh. Locke), ku liria normative shihet si mungesë e detyrimit të jashtëm dhe të brendshëm. Hegeli mund të interpretohet si determinist i butë, që thotë se individi është i lirë tek atëherë kur dëshirat e tij përputhen me qëllimin e tërësisë.
b) Nuk ekziston unitet në mes deterministëve se lidhur me atë se a ka vlerëshmëri objektive kuptimi i jetës apo jo. P. sh. një utilitarist si J. S. Mill kishte me thënë se po, ndërsa Ayer do ta mohonte këtë, megjithëse që të dy janë determinist dhe liberalistë.
c) Ekziston unitet lidhur me atë se njohja e situatës personale është një kusht i domosdoshëm për të arritur lirinë në kuptimin normativ.

3-4. a) Intederministët e llojeve të ndryshme i konsiderojnë zhvillimet origjinale individuale si synimin më të lartë të lirisë. Kanti dhe filozofët ekzistencialistë (p. sh. Jaspers apo Sartre) janë këtu shembuj të pamohueshëm.
b) Por në anën tjetër ekziston jo-uniteti lidhur me atë se a janë synimet përfundimtare të jetës objektive apo jo. Jaspers dhe Sartre e mohojnë statusin objektiv të synimeve jetësore. Ndërsa Kierkegaard në një pjesë të shkrimeve të tij, si dhe më vonë Scheler, thonë se çdo njeri e ka një detyrë individuale (një ide të personalitetit), të cilën ai duhet ta vetë-realizoj përmes zgjidhjeve të interdeterminuara për të arritur liri të plotë. Sipas Sartrit zgjidhjet themelore të ndonjërit lidhur me synimet jetësore janë indeterminante dhe pa ndonjë njësi matëse objektive. Në disa pjesë tek Kierkegaard dhe tek Scheler, në anën tjetër, thuhet se ne, vërtetë jemi indeterminent kur është çështja të bëjmë zgjidhjet, nëse ne duam ta realizojmë synimin e vërtetë me jetën, por ne nuk mund të vendosim (të zotërojmë situatën) se çka do të duhej të bëjmë këtu në jetë. Kant thotë diçka të ngjashme. Sipas Kantit për ne është e mundur që ta përdorim lirinë tonë zgjedhëse indeterminante në mënyrë të kushtëzuar, por nuk është liri e vërtetë. Liria e vërtetë kërkon që t'u nënshtrohemi ligjeve të pandryshueshme morale, autor i të cilave, në bazë të fuqisë së arsyes, jemi vetë.
c) Ekziston unitet lidhur me atë se liria ka si parakusht ekzistencën e një vetëdije mbi situatën vetjake, pasi zgjidhjet indeterminante të (drejtë) një synimi kanë si parakusht ekzistencën e vetëdijes mbi situatën personale.

I PA INFEKTUAR

1. Nuk kam qenë komunist
2. Kurrsesi kompromis me komunistët
3. I painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar
4. Të gatshëm të bashkëpunojnë me "Ballin Kombëtar"
5. Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti

1. Nuk kam qenë komunist

"Dema-Demaçi**:** *Unë nuk kam qenë as enverist ose komunist.*

A. Duka:- I keni njohur në atë kohë Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën?

Adem Dema-*Demaçi:* ***Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur, ndërsa Kadri Zekën jo."*** *(Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 150-156)*

2. Kurrsesi kompromis me komunistët

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si* ***ideologji ruse*** *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste."* (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.*

Mirëpo, ***kurrsesi*** *nuk gjente fuqi për të bërë* ***çfarëdo kompromisi me komunistët****, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Sabri Novosella (Për diplomatët shqiptarë): "*Këta mua, personalisht, në mënyrë kontinuitive, më sillnin libra të Enver Hoxhës, që unë të gjeja mënyrë për t'i dërguar në Kosovë. Ata, thjeshtë e loznin lojën e tyre, por më duhet t'a pranojë se edhe unë e lozja lojën time. Unë të gjitha ato libra që m'i dhanë i futa në stufë dhe i dogja, që të mos u binin në duar të rinjve kosovarë, ngase prej tyre nuk fitohej asgjë e mirë, sepse atyre që u gjendeshin ato libra, dënoheshin me burg të rëndë dhe të gjatë, e madje edhe akuzoheshin si marksist-leninistë, kështu që, në vend që t'i shërbehej çështjes së Atdheut dhe kombit, në fakt krijoheshin kundërefekte."* (Intervistë në Zëri e ribotuar në Drita nr. 10/1997)

3. I painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar

Shefqet Jashari-Strofci: "*Ta zëmë rastin kur është futur në kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla. Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetarë i mirëfilltë, d.m.th. i painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik." (Drita, Trelleborg, Suedi, nr. 15, 1997, f. 15)*

4. Të gatshëm të bashkëpunojnë me "Ballin Kombëtar"

Kadrush Sylejmani*: "Metush Krasniqi me Jusuf Gërvallën, me atë rast, thanë se ishin të gatshëm të pranonin bashkëpunimin e organizatës së tyre me "Ballin Kombëtar" dhe "Legalitetin" në Gjermani. Ata përgatitën një raport të gjerë mbi situatën aktuale politike në Kosovë, në Serbi dhe përgjithësisht në Jugosllavinë e atëhershme dhe, së bashku me Programin e Statutin e Partisë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë, ia dhanë Saqip Sylejmanit, që ta dërgonte në Gjermani." (Metush Krasniqi, Prishtinë 1999, f.166)*

Kadrush Sylejmani*: "Një vit e gjysmë pas ardhjes dhe qëndrimit të Saqip Sylejmanit në Kosovë, me të njëjtën detyrë dhe me porosinë e Hajrullah e Ahmet Tërpezës dhe të Mefail Emërllahut në emër të "Ballit Kombëtar" dhe të "Legalitetit" erdhi nga Gjermania në Kosovë edhe Avdyl Kikaj, nga Lupçi Ulët i Podujevës. Edhe ky menjëherë u vu në kontakt me Metush Krasniqin, Jusuf Gërvallën e udhëheqës të tjerë të partive politike shqiptare në Kosovë dhe me një raport të shkoqitur mbi gjendjen politike në Kosovë e në trojet e tjera etnike shqiptare në Jugosllavi, u kthye në Gjermani." (Metush Krasniqi, Prishtinë 1999, f.167)*

5. Qëllimet majtiste janë të kthjellëta si loti

"Bota sot: *Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?*

***Hysen Gërvalla**: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Hysen Gërvalla: *"Dhe kur e panë se pak kush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolën mangët dhe u futen të gjallë në zjarrin që përvëlonte. Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar....*

...Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtare, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hydajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Hysen GËRVALLA: "*Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës."* (Bota Sot, 12 mars 2003)

L I R I A

ORGAN I MARKSISTË-LENINISTËVE TË KOSOVËS Tetor 1980, Nr. 1

1-1. "LIRIA"
1-2. ASNJË MASË E REVIZIONISTËVE NUK MUND TA MPOSHTË POPULLIN TONË HEROIK
1-3. ZEMRA JONË LËNGON PËR TA
1-4. GJENDJE E RËNDË NË EKONOMINË E KOSOVËS
1-5. NJË FAQE E LAVDISHME E LUFTËS PËR LIRI E PAVARËSI
1-6. VEPËR ME RËNDËSI TË MADHE TEORIKE DHE PRAKTIKE
1-7. LIBËR I RI I SHOKUT ENVER HOXHA
1-8. POPULLI AFGAN DO TË FITOJË
1-9. DIKTATURA FASHISTE NUK MUND TA MPOSHTË POPULLIN TURK

1-1. "LIRIA"

Nga Mehmet Hajrizi

Liri! Liri thërrasin sot të gjithë popujt e robëruar të botës. Armiqtë imperialistë, socialimperialistë, revizionistë e fashistë kudo në botë dridhen nga kjo thirrje e popujve dhe proletariatit. Të gjithë shtypësit e robëruesit në botë fundin e tyre do ta gjejnë në zjarrin e madh të luftës popullore.

Liri! Liri thirri në shekuj populli shqiptar për Atdheun e tij të dashur. Gjaku lumë u derdh për lirinë e shtrenjtë në tokën e shqipes.

Liri thërret sot Kosova e robëruar, Kosova e shumëvuajtur e martire, Kosova trime. Bijtë e Kosovës luftuan në shekuj për liri, kundër armiqve të shumtë e të egër që lakmonin fushat tona të gjera, malet tona të bukura, pasuritë e shumta që ka në vete toka jonë e dashur. Me këto lakmi të çmendura kralët e Serbisë e Malit të Zi, me ndihmën e imperializmit evropian, me gjithë luftën heroike të popullit shqiptar, arritën të shkëpusin nga trungu i Shqipërisë gati gjysmën e saj dhe ta fusin nën robërinë e tyre të egër.

Të nisur nga këto lakmi kralët revizionistë të Beogradit me tradhti dhe me hekur e zjarr e futën sërish nën një robëri të re po aq të egër popullin e Kosovës dhe viseve shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi.

Por, populli ynë, që në historinë e tij nuk iu nënshtrua kurrë asnjëherë me sunduesit e rinj revizionist e shovinist të tërbuar. Prandaj, populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi ka luftuar vazhdimisht dhe lufton pa pushuar, në forca të ndryshme, kundër pushtuesve të sotëm revizionistë, për çlirim kombëtar e shoqëror. Kjo luftë do të rritet

gjithnjë e më shumë, do të zgjerohet e thellohet çdo ditë, do të marrë zjarr, do t'i djegë në flakën e saj armiqtë dhe tradhtarët dhe do t'i sjellë fitoren e sigurtë popullit tonë, lirinë e ëndërruar në shekuj. Kosovën pa pushtues, pa shtypës e shfrytëzues, të lirë e të bashkuar me Atdheun socialist do ta bëjë vetëm gjaku i pastër i bijve më të mirë të saj.

Organi "Liria" po del me qëllim që ta ndihmojë këtë luftë të popullit tonë për të drejta e liri.

"Liria" në gjithë punën e saj do të frymëzohet nga aspiratat e larta të popullit dhe do të orientohet nga një vijë e drejtë politike e ideologjike marksiste-leniniste.

"Liria" do të jetë një tribunë e vërtetë e popullit që ka për qëllim të ndihmojë bashkimin e gjithë popullit në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve.

"Liria" do të luftojë pa mëshirë kundër armiqve të popullit tonë dhe do të demaskojë propagandën e poshtër demagogjike e mashtruese të tij.

"Liria" do t'i tregojë popullit qartë cilët janë armiqtë e vërtetë të tij, kush i rrëmbeu lirinë, kush e vrau dhe e mashtroi, kush e dëboi nga vatrat e veta, kush e varfëroi dhe e çoi nëpër burgjet e errëta jugosllave bijtë e tij, kush e shtyp dhe e shfrytëzon kaq egërsisht dhe do t'i tregojë cila është rruga e shpëtimit nga robëria e tmerrshme.

"Liria" do t'i mbrojë me guxim interesat e popullit tonë të robëruar para çdo armiku.

"Liria" jonë do të jetë gjithë jetën tribunë e së vërtetës, e drejtësisë dhe zëri i lirisë së vërtetë të popullit tonë.

"Liria" do të punojë e luftojë me vullnet të hekurt për edukimin dhe kalitjen e popullit me një patriotizëm të flaktë e revolucionar.

"Liria" do të ngrejë lart me krenari traditat e shkëlqyera luftarake të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë, përpjekjet e luftërat e tij për liri e bashkim kombëtar.

"Liria" do të pasqyrojë urrejtjen e madhe që ka mbushur gjokset shqiptare kundër regjimit shtypës e shfrytëzues, luftën e popullit që behet në forma të ndryshme kundër këtij regjimi, do t'i sqarojë masat mbi gjendjen brenda dhe jashtë vendit si dhe do t'i orientojë ato në situatat e ndryshme.

"Liria" do të pasqyrojë fitoret madhështore të ndërtimit e të mbrojtjes së socializmit në Shqipërinë nënë, nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës dhe shokut Enver Hoxha.

"Liria" do të karakterizohet nga fryma e lartë e internacionalizmit proletar. Në luftë për çlirim ne nuk jemi vetëm, proletariati dhe popujt e shtypur kudo në botë luftojnë kundër shtypësve e shfrytëzuesve të tyre, me ne janë të gjithë popujt liridashës të botës.

"Liria" do të përkrahë luftën çlirimtare në Jugosllavi e kudo në botë dhe është kundër politikës antipopullore e gjakatare të imperializmit me atë amerikan në krye, të socialimperializmit sovjetik, të atij kinez dhe të reaksionarëve të çdo ngjyre.

Këtë mision ka "Liria" jonë. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 1)

1-2. ASNJË MASË E REVIZIONISTËVE NUK MUND TA MPOSHTË POPULLIN TONË HEROIK

Nga Hydajet Hyseni

Pushtuesit revizionistë jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë, kohëve të fundit, kanë ndërmarrë kundër popullit tonë një varg masash të dhunës e të demagogjisë. Këto masa të revizionistëve nuk janë të panjohura për popullin tonë dhe nuk e çudisin atë. Gjatë gjithë sundimit të tyre të egër revizionistët jugosllavë nuk kanë lënë metodë e mjet pa përdorur me qëllim që ta shtypin e shfrytëzojnë sa më egërsisht popullin tonë dhe të shuajnë çdo aspiratë e përpjekje të tij për çlirim kombëtar e shoqëror.

Menjëherë pas luftës klika gjakatare e Tito-Rankoviçit ndërmori masa të papar4a për ta shfarosur, dëbuar e shkombëtarizuar popullsinë tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe për të realizuar në këtë mënyrë ëndrrat e çmendura të paraardhësve të tyre shovinistë. Zhdukja mizore e dhjetëra mija shqiptarëve gjatë dhe pas luftës, dëbimi me dhunë për në Turqi e vende të tjera i qindra mija të tjerëve, rrahja e poshtërimi i pothuajse të gjithë burrave kosovarë gjatë aksionit famëkeq të armëve, plaçkitja e pamëshirshme e pasurive tona natyrore, grabitja e dhunshme e tokës së bereqetit janë vetëm disa nga masat që xhelatët titistë ushtruan mbi kurrizin e popullit tonë. Por megjithë këto masa të përbindshme ata nuk ia arritën qëllimit të tyre. Populli ynë trim e patriot nuk u shfaros, nuk e lëshoi tokën e tij të dashur, nuk e harroi gjuhën e tij të ëmbël, zakonet e traditat e lashta shqiptare. Ai nuk u frikësua e nënshtrua para dhunës e terrorit fashist të revizionistëve, por, përkundrazi, urrejtja dhe pezmi i tij u shtuan edhe më shumë.

Propaganda e revizionistëve ngriti në qiell disa reforma që klika e Titos u detyrua të bënte pas vitit 1967 dhe u përpoq ta bindë popullin tonë se tani e tutje do të ndryshonte politika titiste ndaj shqiptarëve, se tani atyre do t'u sigurohej liria e barazia e vërtetë etj., etj. Krimet e pashembullta që klika titiste kishte kryer kundër popullit tonë u quajtën "deformime", "shtrembërime" e "gabime" që qenkan bërë "pa dijeninë e Titos" dhe në "kundërshtim me politikën e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë". Të gjitha fajet për ato që ishin bërë kundër shqiptarëve iu ngarkuan njërit nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Titos, xhelatit Rankoviç, të cilin klika e Titos e rrëzoi për hesape të veta dhe aspak për krimet ndaj popullit shqiptar që kishin kryer së bashku me të sa e sa vite më parë.

Kishte edhe nga ata që u gënjyen nga kjo demagogji dhe menduan se duke ndërruar qimen, ujku po e harronte edhe zakonin. Por, populli ynë, që në shekuj është mësuar me manovra të ndryshme të armiqve të tij, nuk u mashtrua nga reformat dhe propaganda e revizionistëve. Ai e kuptoi se ishin të njejtat qëllime të të njejtin armik, se ato që po ndryshonin ishin vetëm format e mjetet e shtypjes e shfrytëzimit. Masat e reja të revizionistëve jo vetëm që nuk e gënjyen popullin tonë, por përkundrazi, bënë që të shtohet edhe më shumë urrejtja ndaj shtypësve e shfrytëzuesve dhe lufta e tij për të drejta e liri.

Viteve të fundit, kur kjo luftë, si rezultat i shtimit të pakënaqësisë e urrejtjes së masave dhe ngritjes së ndërgjegjes së tyre kombëtare e klasore, po bëhet gjithnjë më e vendosur, më e organizuar dhe po merr përmasa gjithnjë e më shqetësuese për regjimin, klika titiste dhe zagarët e saj shqiptarë kanë hequr maskën dhe janë hedhur mbi popullin tonë me të gjitha mjetet dhe forcat e tyre. Periudhën pas Rankoviçit, gjatë së cilës populli ynë fitoi disa të drejta, revizionistët tani po e dënojnë si "periudhë të liberalizmit", duke arsyetuar kështu hapur vënien përsëri në plan të parë të politikës së tyre të dhunës. Si rezultat numri i policëve, agjentëve e spiujve po shtohet pa ndërprerje. Bastisjet dhe arrestimet janë bërë të zakonshme dhe shtohen nga viti në vit. Populli ynë po sheh të ringjallen përsëri veprimet gjakatare të kohës së Rankoviçit.

Revizionistët jugosllavë asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga politika e shkombëtarizimit të viseve të pushtuara shqiptare dhe sllavizimit të tyre. Këtë politikë të poshtër ata po e ndjekin edhe sot me mjete e forma të ndryshme. Më tepër se 130 mijë shqiptarë kanë lënë shtëpitë e tyre dhe për të siguruar kafshatën e gojës derdhin djersën nëpër viset e ndryshme të Jugosllavisë dhe jashtë saj. Sa familje shqiptare nga Kosova, Maqedonia, e tani pas tërmetit të 15 prillit, sidomos nga Mali i Zi, braktisin përgjithmonë vatrat e tyre dhe vendosen nëpër republikat jugosllave apo vende të ndryshme të botës. Nga ana tjetër tokat shqiptare popullohen vazhdimisht me popullsi sllave. Në mënyrë të veçantë shovinistët maqedonas po përpiqen me çdo kusht të grumbullojnë gjithë diasporën maqedonase dhe ta vendosin atë nëpër viset shqiptare. Në këtë mënyrë shovinistët jugosllavë synojnë të ndryshojnë strukturën nacionale të popullsisë së tokave

shqiptare dhe t'i shpallin pastaj tokat tona si toka serbe, malazeze apo maqedonase. Aq larg kanë shkuar ata në këto përpjekje sa që në emër të planifikimit të familjes etj. të përpiqen që me masa mjekësore të pengojnë edhe shtimin natyror të shqiptarëve! Vallë a s'janë këto vazhdim i planeve dhe masave të egra të Çubrilloviçit, Rankoviçit e xhelatëve të tjerë si këta?

Gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë, ashtu si edhe gjatë vizitave të tij të mëparshme, kryerevizionisti Tito i ndërseu disa herë kundër popullit tonë këlyshët e tij në Kosovë, të cilët ende pa u larguar ai filluan një fushatë të paparë ndjekjesh, bastisjesh e arrestimesh. Mijëra bijë e bija të popullit nga më të mirët u rrahën e u torturuan në mënyrë shtazarake, të denjë vetëm për "udbashët" e Rankoviçit. Dhjetëra bijë të popullit u nxorën para gjyqeve revizioniste dhe iu dhanë dënime të rënda, të shumtën në mungesë të plotë të fakteve. Të gjitha proceset gjyqësore u mbajtën me dyer të mbyllura, sigurisht jo nga frika se mos populli do t'i sulmonte bijtë e tij, siç përralliste "Politika", por nga frika e madhe që ka regjimi titist nga populli i mbushur plotë pezëm e urrejtje.

Pushtuesit revizionist dhe hyzmeqarët e tyre shqiptarë shpresuan se me këto masa do ta frikësonin popullin tonë, por, siç detyrohen të pranojnë edhe vetë, u gabuan keq. Populli ynë jo vetëm nuk u frikësua, por e shtoi edhe më shumë urrejtjen dhe luftën e tij kundër regjimit titist, kurse bijtë e tij me qëndresën dhe luftën heroike në gjyqet dhe burgjet anë e kënd Jugosllavisë, po u kallin tmerrin armiqve e tradhtarëve, edhe duke qenë të lidhur me pranga e zinxhirë.

Ma anë të këtyre masave armiku synon të zbulojë e të zhdukë në radhë të parë patriotët dhe komunistët e vërtetë, tek të cilët ai me të drejtë sheh edhe rrezikun më të madh. Me qëllim që t'i diskreditojë ata dhe t'i izolojë nga populli, nga nëna që i ka lindur, ai ka ndërmarrë kundër tyre një fushatë të gjerë shpifjesh e trillimesh. Për këtë qëllim, armiku mundohet t'i futë ata në një thes me gjithfarë elementësh, t'i akuzojë ata si "nacionalistë", "irredentistë", "reaksionar", "armiq të popullit" etj., etj. Por populli ynë nuk mashtrohet. Ai i njeh mirë dhe din t'i dallojë bijtë e tij të vërtetë dhe armiqtë e tij të vërtetë.

Krahas masave të egra të dhunës, revizionistët jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre kanë vënë në veprim një makinë të tërë propagandistike me qëllim që t'i mashtrojnë, çorodisin e degjenerojnë masat popullore dhe, në këtë mënyrë, t'i largojnë ato nga hallet dhe problemet e shumta që i preokupojnë, nga lufta e tyre për të drejta e liri.

Mjetet e propagandës revizioniste, shtypi, radioja, televizioni etj. po mundohen me të gjitha mënyrat t'ia mbushin mendjen popullit tonë se Jugosllavia na qenka atdheu ynë, se sistemi i saj "vetadministrues" na qenka "sistemi i vërtetë socialist", sistemi "më human" e "demokratik", sistem që u siguroka masave "liri", "mirëqenie", e "begati", se politika e "mosangazhimit" na qenka "e vetmja politikë e jashtme e drejtë" etj., etj. Por, populli ynë nuk mashtrohet nga këto profka. Ai e ka të qartë dhe e po e kupton gjithnjë e më mirë se Jugosllavia e revizionistëve është atdheu ynë aq sa ishte Turqia e sulltanëve, Jugosllavia e kralëve apo Italia fashiste, se Jugosllavia e Titos është socialiste, humane e demokratike aq sa është Spanja e Karlosit apo Kili i Pinoçetit. Populli ynë po e kupton gjithnjë e më mirë se "liria", "barazia", "mirëqenia" e "begatia" revizioniste s'janë gjë tjetër pos shtypje e shfrytëzim i egër kolonial e kapitalist, pos krizë e inflacion i papërmbajtur, ngritje e përditshme e çmimeve, papunësi, skamje, kurbet e mjerim. Ai po e kupton, gjithashtu, se politika e jashtme e revizionistëve jugosllavë s'është gjë tjetër pos një politikë antimarksiste e kundërrevolucionare, politikë e shitjes së interesave dhe sovranitetit të popujve të Jugosllavisë tek superfuqitë dhe vendet tjera imperialiste.

Qysh kur ishte gjallë Titoja dhe sidomos pas vdekjes së tij, propaganda revizioniste në Jugosllavi dhe Kosovë, duke fryrë deri në absurd kultin e Titos, u mundua

ta nxirrte atë si "njeriun më të madh të shekullit" (më i madh edhe se Lenini!), si "birin më të dashur të kombeve e kombësive të Jugosllavisë" etj., etj.

Në mënyrë të veçantë krerët sahanlëpirës të Kosovës dhe disa kalemxhinj të shitur u munduan ta nxjerrin Titon edhe si "mikun më të madh" dhe "njeriun më të dashur të shqiptarëve." Por populli ynë i njeh mirë "meritat" e revizionistit Tito, i njeh krimet dhe mizoritë e pashembullta që janë kryer mbi kurrizin e tij nga ky tiran dhe antishqiptar i tërbuar dhe nuk gënjehet dot.

Rëndësi të veçantë, në përpjekjet e tyre për ta mbajtur popullin tonë në robëri, revizionistët jugosllavë dhe tradhtarët shqiptarë po i kushtojnë shthurjes dhe degjenerimit të masave popullore dhe sidomos të rinisë, si mjet të preferuar për t'i trullosur e çoroditur ato dhe për t'iu shuar kështu atyre çdo ndjenjë patriotike e revolucionare. Për këtë qëllim ata po përhapin me të gjitha mjetet e tyre artin dhe kulturën dekadente, religjionin, modën borgjeze e mënyrën amerikane të jetesës, alkoholizmin, pornografinë, prostitucionin etj. Por, a do të lejojë vallë rinia jonë e pastër dhe e zjarrtë që të bjerë në batakun ku duan ta hedhin armiqtë e saj? Jo. Ajo po e kupton se rruga e saj nuk është rruga e jetës së shthurur, boshe e pa ideale, të cilën ia tregojnë revizionistët, por rruga që u tregon atyre Avni Rrustemi, Qemal Stafa e Emin Duraku, rruga që u tregon marksizëm-leninizmi, rruga e luftës për liri e socializëm. Këtë dhe vetëm këtë rrugë do të ndjekë rinia jonë revolucionare.

Një propagandë të poshtër po bëjnë pushtuesit revizionistë dhe zagarët e tyre shqiptarë edhe kundër Atdheut tonë të dashur, Shqipërisë socialiste. Ata, për demagogji, herë pas here deklarojnë se janë të interesuar për marrëdhënie "të mira" e "miqësore" me Shqipërinë, kurse në mbledhjet e shumta që organizojnë në popull fabrikojnë kundër saj trillime e shpifje nga më të poshtrat. Në këtë mënyrë ata përpiqen, përveç tjerash, edhe të armiqësojnë popullin tonë të robëruar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi me vëllezërit tanë të lirë në Shqipëri, me Partinë e lavdishme të Punës dhe udhëheqjen e saj marksiste-leniniste. Por, siç e ka bërë të qartë shoku Enver në Kongresin VII të Partisë, këto përpjekje janë krejt të kota dhe do të dështojnë me turp. Populli ynë po i sheh sukseset madhështore që po korr Atdheu i tij në të gjitha fushat, po e sheh në praktikë drejtësinë e politikës së kristaltë marksiste-leniniste të Partisë së Punës dhe nuk po u beson më të lehurave të armiqve dhe tradhtarëve. Dashuria e tij ndaj Shqipërisë socialiste, Partisë së saj syshqiponjë dhe udhëheqësit tonë të madh shokut Enver Hoxha, është aq e madhe sa që nuk mund ta shuajë e lëkundë dot asnjë forcë në botë.

Populli ynë heroik, që kurrë në historinë e tij të lavdishme nuk është nënshtruar e përulur para armiqve të tij të shumtë e të egër, nuk bie në gjunjë as para kralëve revizionistë të Beogradit dhe një grushti shqiptarësh të shitur. Ai nuk frikësohet nga dhuna e egër e regjimit titist dhe as mashtrohet nga propaganda e tij e poshtër, por ashtu si të gjithë armiqve të tjerë, do t'i tregoj edhe atij grushtin e tij dërmues. I bashkuar si një trup i vetëm, populli ynë do të vazhdojë luftën e tij deri në fitoren e plotë dhe do të çojë në vend amanetin e shenjtë të Isa Boletinit, Bajram Currit e Shotë Galicës, të Ali Kelmendit, Asim Vokshit, Emin Durakut e mijëra dëshmorëve të ndritur, që jetën e tyre ia falën lirisë së shtrenjtë. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 2-3)

Shoku Enver Hoxha për Kosovën

1-3. ZEMRA JONË LËNGON PËR TA

Pjesë nga libri "TËRMETI LËKUND MALET POR JO SHQIPTARIN" (Fjalime të mbajtura në rrethin e Shkodrës, Tetor 1979, faqe 155-158)

Asnjëherë nuk kemi pasur dhe nuk do të kemi besim tek imperialistët dhe te revizionistët. Asnjëherë nuk jemi gënjyer e nuk do të gënjehemi nga fjalët dhe nga qëndrimet e tyre të pabesa. Historia ne na ka mësuar të ruhemi nga imperialistët, nga kapitalistët dhe nga imperialistët e rinj - revizionistët, të cilët, si dinakë që janë, në çdo kohë e kanë djegur, e kanë vjedhur, e kanë grabitur dhe e kanë copëtuar Shqipërinë.

Vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi vuajnë. Një nga vendet më të prapambetura në Jugosllavi është Kosova. Edhe shqiptarët në Maqedoni vuajnë, por tashti, pas tërmetit të 15 prillit të këtij viti, më keq akoma janë vëllezërit tanë shqiptarë në Mal të Zi. Zemra jonë lëngon për ta. Si të mos na dhembë zemra për mijëra vëllezërit tanë në Hot e në Grudë, në Ulqin e në Tivar, kur tash që po vjen dimri nuk do të kenë çati për të futur kokën?

Jugosllavia e Titos është një shtet bankrut, i falimentuar me tërë kuptimin e fjalës. Themi kështu jo thjesht për arsye se ne i kemi armiq titizmin, Titon dhe sistemin kapitalist jugosllav, por sepse ky është një realitet që e njeh gjithë bota. Në Jugosllavinë titiste kapitali i huaj, me ligj, ka hedhur kthetrat e përgjakura. Ndërmarrjet "vetadministruese", me të cilat mburren revizionistët jugosllavë, janë të kapitalit amerikan, gjermanoperëndimor, francez dhe të vendeve të tjera kapitaliste, që kanë siguruar, me ligj, të drejtën e pronësisë mbi to. Vetëm borxhet e deklaruara të Titos ndaj kapitalit të huaj arrijnë shumën prej 16 miliardë dollarësh. Këto borxhe e kapërcejnë kufirin maksimal të 49 përqindëshit, që ka caktuar Skupshtina Federative për investimet e huaja. Sipas ligjit jugosllav aksionet e huaja nuk mund të jenë më tepër se 49 për qind, kurse 51 për qind duhet të jenë kapitale të jugosllavëve. Duke dhënë vazhdimisht kredi e duke investuar kapitale, kapitalistët e huaj, në një përqindje mjaft të madhe. i kanë kthyer ndërmarrjet jugosllave në pronësi të tyre. Një përqindje e vogël e kapitalit është e shtetit jugosllav. Gjysma e interesit të këtij kapitali shkon në xhepin e klikës së Titos dhe të borgjezisë së re titiste.

Miqtë, vëllezërit dhe motrat, që na vijnë këtu nga Jugosllavia, kënaqen kur shohin vendin tonë socialist. Ndjenja e vetëmbrojtjes, e qëndrueshmërisë dhe e vendosmërisë për të mos lënë të zhduken gjuha, zakonet. dhe traditat e shqiptarizmit,
atyre u shtohen çdo ditë e më shumë. Edhe armiqtë e kanë marrë vesh se ç'po bëhet këtu, ku, për 5 muaj, po inaugurohen këto ndërtime, që janë më të bukura se ç'ishin para tërmetit.

Titoja ka katër ditë që u ngrit dhe vajti në Kosovë dhe, prej andej u kthye prapë në Beograd. Atje ai bëri disa mbledhje dhe përrallisi disa fjalë. U detyrua të pranonte realitetin që në Jugosllavi ka një minoritet të madh shqiptar, por këtë fakt ai nuk e fsheh dot, se në Kosovë ka 1 milion e 500 mijë shqiptarë, në Maqedoni nja 400 mijë, në Malin e Zi 40 mijë. Kështu në Jugosllavi bëhen rreth dy milionë Shqiptarë.

Titoja gjatë vizitës në Kosovë nuk harroi të na atakonte ne kur tha se nuk mund të zhvillohet një vend në qoftë se rri i mbyllur. Ai nuk na përmendi me emër, por aluzioni i tij ishte për ne, se armiqtë, duke shpifur kundër nesh, na akuzojnë për vetizolim. Gjatë bisedave që bëri, ai tha se Kosova ka pasuri të mëdha, sikur këtë nuk e dinin kosovarët, por heshti për faktin që këto pasuri i përpunon Sllovenia e Kroacia. Nuk i bëri zemra të thoshte që të ngrihen fabrika dhe të përpunohen mineralet në Kosovë. Ai u detyrua të

konstatojë faktin e pamohueshëm dhe të hidhur që frytet e pasurisë së Kosovës i rrëmbejnë të tjerët, por nuk zuri në gojë se në qoftë se Sllovenia e ka nivelin e jetesës 100 për qind, Kosova e ka 30-35 për qind.

Titoja bëri një xhiro të shpejtë në Pejë, në Prizren e në Gjakovë. Po përse e bëri këtë vizitë në Kosovë Titoja? E bëri për të qetësuar disi ndjenjat e patriotizmit, të lirisë dhe të pavarësisë, që janë të mëdha në Kosovë. Këto ndjenja patriotike të shqiptarëve, që jetojnë në Jugosllavi, Titoja dhe shokët e tij i cilësojnë si «irredentizëm», si «nacionalizëm»!

Ndihma jonë për zhvillimin c kulturës luan një rol të madh në Kosovë. Ky zhvillim dhe gjuha amtare atje nuk mund të frenohen. Në radion, në televizionin dhe në shtypin kosovar është adaptuar drejtshkrimi i gjuhës shqipe, tash kosovari lexon, flet dhe shkruan ashtu si ne. Këtë gjë populli atje e realizoi në një kohë shumë të shkurtër, se e ka nxitur zjarri që e digjte nga brenda. Ne do të vazhdojmë politikën e marrëdhënieve të drejta me vëllezërit tanë të gjakut e të gjuhës.

Jo vetëm arsimin e kulturën, por edhe tregtinë ne përpiqemi ta zhvillojmë e ta zgjerojmë me Kosovën dhe me Maqedoninë ku jetojnë vëllezërit tanë shqiptarë, se, nëpërmjet këtyre marrëdhënieve, ata do të shohin më nga afër zhvillimin e vendit tonë në rrugën e socializmit. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 4)

1-4. GJENDJE E RËNDË NË EKONOMINË E KOSOVËS

Nga Jakup Krasniqi dhe Jahir Hajrizi

Si rrjedhim i rrugës kapitaliste të zhvillimit dhe të pozitës koloniale në të cilin ndodhet, ekonomia e Kosovës është mbërthyer në darën e një krize të rëndë e të gjithanshme. Viti 1980, si edhe vitet e mëparshme, për Jugosllavinë revizioniste është një vit i vështirë. Veçanërisht e rëndë paraqitet gjendja në Kosovë, ku pasojat e krizës ekonomike janë më të theksuara se kudo tjetër në Jugosllavi. Ekonomia e Kosovës jo vetëm që nuk po bën hapa përpara, por gjendja e saj po keqësohet edhe më shumë. Mosrealizimi i planeve të prodhimit e në shumë degë rënia e dukshme e tij, humbjet gjithnjë e më të mëdha, borxhet e shumta e deficiti tregtar rekord, aftësia e dobët riprodhuese dhe akumuluese, ngritja astronomike e çmimeve dhe e kostos së jetesës, shtimi i madh i numrit të papunëve, emigrimi në masë i fuqisë punëtore e plagë të tjera si këto, që po vazhdojnë të thellohen, e sollën ekonominë e Kosovës në një gjendje tepër të rëndë. Këto plagë bënë që gjatë viteve të fundit Kosova jo vetëm nuk u zhvillua 50 për qind më shpejtë se mesatarja jugosllave, siç planifikohej, por përkundrazi, ritmet e zhvillimit të saj ishin për jo më pak se 50 për qind nën këtë mesatare.

Një nga sëmundjet më të rënda e të pashërueshme në ekonominë e Kosovës janë humbjet e mëdha dhe të vazhdueshme. Gjatë vitit të kaluar, jo më pak se 12 ndërmarrje ekonomike kishin hiç më pak se 1,4 miliard dinarë (të rinj) humbje, prej të cilave 72 për qind i takonin industrisë dhe xehtarisë.

As këtë vit nuk u bënë hapa përpara, por gjendja u keqësua edhe më. Nën nivelin e vitit të kaluar, gjatë gjashtëmujorit, prodhuan 17 degë të rëndësishme të industrisë. Vetëm ekonomia e Prishtinës, gjatë gjysmës së parë të këtij viti kishte rreth 242 milionë dinarë humbje, e Mitrovicës 117, e Ferizajt 119 milion etj.

Shtimi i vazhdueshëm i humbjeve, i numrit të organizatave që i krijojnë ato dhe i numrit të punonjësve mbi të cilët bie barra e tyre është vetëm njëra anë e së keqes. E keqja tjetër është se ato duhet të mbulohen duke u futur në borxhe të reja, në bankat dhe fondet e ndryshme, duke i shfrytëzuar rezervat e fundit, mjetet e destinuara për zgjerimin e

kapaciteteve, mjetet për pushim e konsum të përbashkët të punonjësve etj. Si pasojë vështirësohen edhe më shumë kushtet e punës, punëtorët marrin paga të zvogëluara e minimale ose hidhen krejtësisht në rrugë. (Vetëm gjatë vitit 1978 rreth 1000 vetë). Shumë ndërmarrje, për çdo vit, falimentojnë ose gëlltiten nga ndërmarrjet më të mëdha. Megjithatë, më se 84 për qind e humbjeve në industri, vitin e kaluar mbetën të pambuluara.

Edhe në ato pak ndërmarrje ku kishte njëfarë rritje të prodhimit, kjo ishte rezultat para së gjithash i eksploatimit në shkallë të lartë të pasurive të shumta natyrore dhe fuqisë punëtore kosovare nga borgjezia e republikave jugosllave.

Gjendja në bujqësi është edhe më e vështirë. Pos humbjeve të mëdha, që vitin e kaluar arritën në shkallën 8,4 për qind të të gjitha humbjeve të ekonomisë kosovare, për çdo vit, siç shkruan shtypi, mbesin të pambjella mijëra hektarë tokë të punueshme, përveç mijëra të tjerëve që janë djerrinë e përhershme. Kjo degë e ekonomisë jep vetëm 20,9 për qind të prodhimit shoqëror, kur dihet se me te merret më se gjysma e popullsisë. Gjatë viteve të fundit prodhimtaria bujqësore ka rënë 5,4 për qind, kurse planifikohej të rritet 4 për qind.

Edhe pse toka e Kosovës është e njohur për plleshmërinë e saj, rendimentet e kulturave lavërtare janë deri në 50 për qind nën mesataren jugosllave.

Ashtu si në të gjithë bujqësinë jugosllave edhe në atë kosovare mbizotëron prona private. Sektori privat ka më se 88 për qind të tokave të punueshme, pesë të gjashtat të mekanizmit bujqësor etj. Toka e punueshme bujqësore është e copëtuar në parcela tejet të vogla. Mesatarja e tyre është vetëm 0,24 hektar, kurse jo më pak se 4 për qind e zënë mezhdat (megjat).

Blegtoria, e cila jep 33 për qind të prodhimit bujqësor, ka rendimente shumë të ulëta. Fondi i përgjithshëm i bagëtive po varfërohet gjithnjë, ndërsa 95 për qind e tij i takon sektorit privat. Nga 600 mijë dele, sa kishte Kosova në vitin 1970, sivjet mbetën vetëm 295600 copë.

Në një gjendje të rëndë gjendet edhe pylltaria. Pyjet e pasura të Kosovës, po plaçkiten me të madhe nga regjimi antipopullor titist dhe po shkatërrohen vazhdimisht.

Kosova përdoret si një zonë tregu për shitjen e mallrave të gatshme industriale nga republikat e Jugosllavisë. Rreth 70 për qind të tregtisë së Kosovës e mbajnë mbi 200 firma tregtare jugosllave me më shumë se 600 njësi tregtare, 200 prej të cilave vetëm në Prishtinë. Ndërmarrjet e republikave jugosllave nuk kanë kurrfarë pengese për shitjen e mallrave të tyre në Kosovë, ndërsa mallrat e pakta kosovare vështirë gjejnë vend në tregjet jugosllave, bile edhe në tregun kosovar, jo vetëm për shkak të konkurrencës së egër, por edhe nga pengesat administrative. Në këtë mënyrë shumë ndërmarrje kosovare punojnë me kapacitete të përgjysmuara ose i kanë mbushur depot me mallra stoqe, duke i shtuar edhe më humbjet. Mirëpo kjo nuk ndodhë me lëndët e para minerale që nxirren në "Trepçë", "Kosovë", Novobërdë, Kishnicë, Hajvali, Golesh, Devë, Volljak, Karaçevë, Strezovc, Babush e në vende të tjera.

Edhe në tregtinë e jashtme nuk ka raporte të drejta. Derisa në Jugosllavi vitin e kaluar iu dhanë ndërmarrjeve 1188 pëlqime për tregti të jashtme, në Kosovë u dhanë vetëm 5 sosh. Tregtia e jashtme e Kosovës, e cila bëhet të shumtën me ndërmjetësimin e ndërmarrjeve jashtë Kosovës, vitin e kaluar kishte një deficit prej 3 miliardë dinarësh, ose dyfish më shumë se një vit më parë. Importi, që u rrit 67 për qind, ishte dyfish më i madh se eksporti, ndërsa vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, edhe përkundër masave të kufizimit, u rrit për 34 për qind. Vlera e eksportit mbulonte vetëm 50 për qind të vlerës së importit.

Deficiti i madh tregtar dhe inflacioni i lartë në Jugosllavi, që arriti shkallën 32 për qind, bënë që qeveria jugosllave të detyrohet, për të shtatën herë pas luftës, të zhvleftësojë dinarin, këtë herë për jo më pak se 30 për qind.

Kjo masë e ka vështirësuar edhe për më tepër gjendjen në ekonominë jugosllave, por në mënyrë të veçantë e ka goditur rëndë ekonominë e varfër të Kosovës, e cila 25 për qind të kapaciteteve i bazon në lëndët e para nga importi. Për këtë shkak vetëm në industrinë kimike të "Trepçës", siç shkruan "Rilindja", parashikohet të ketë 103 milionë e 800 mijë dinarë humbje.

PASOJAT E KRIZËS U HIDHEN MBI KURRIZ TË MASAVE PUNONJËSE

Për të dalur nga kjo gjendje e vështirë, revizionistët jugosllavë i ngrejnë çdo ditë çmimet, duke e bërë në këtë mënyrë jetën e masave gjithnjë e më të shtrenjtë dhe më të vështirë. Gjatë vitit të kaluar, në mesin e shumë artikujve të tjerë u shtrenjtuan qumështi 43 për qind, mishi 29 për qind, energjia elektrike 24 për qind e shumë të tjerë. Vetëm gjatë tre muajve të parë të këtij viti çmimet u rritën dy herë më shpejtë se sa planifikohej. Në pesë muajtë e parë çmimet u ngritën 26,2 për qind, ndërsa vetëm gjatë muajit korrik çmimet me pakicë ishin 3,8 për qind më të larta se sa një muaj më parë, kurse ato të prodhimeve industriale 5,8 për qind. Kohëve të fundit u ngritën çmimet e miellit 2 dinarë për kilogram, të kafes 50 për qind, të detergjentëve 38 për qind etj. Tregu, ashtu si edhe prodhimi, nuk është aspak stabil dhe shpesh ka mungesa të artikujve të domosdoshëm. Edhe pas ngritjes së lartë të çmimeve artikuj si sheqeri, kripa, detergjentet, yndyrnat, kafeja, çaji, ilaçet, çimentoja, plehrat artificiale e shumë të tjerë ose mungojnë plotësisht ose gjenden me shumë vështirësi. Derisa shpenzimet e jetesës po shtohen me të madhe, të ardhurat personale pothuajse nuk ngriten fare, kurse të ardhurat reale janë në rënie të vazhdueshme. Të ardhurat personale në Kosovë ngriten për 4 për qind më ngadalë se mesatarja jugosllave.

Rrjedhim i krizës së rëndë ekonomike është edhe shkalla e lartë e papunësisë dhe kurbetit. Të aftë për punë Kosova ka 52 për qind të popullsisë (rreth 800 mijë vetë), por të zënë në punë, në të ashtuquajturin sektor shoqëror ka vetëm rreth 168 mijë vetë. Më tepër se 70 mijë vetë kërkojnë punë nëpër entet e punës, por numri i vërtetë i të papunëve është shumë më i madh, sepse shumica e tyre as që paraqiten fare në këso farë entesh. Shkalla e zënies në punë e popullsisë së Kosovës është më shumë se katër herë më e ulët se ajo në Slloveni.

As struktura nacionale e punonjësve nuk është në proporcion të drejtë me strukturën nacionale të popullsisë. Vetëm 62 për qind të punonjësve janë shqiptarë, kurse serb e malazezë jo më pak se 32,4 për qind. Kjo mospërputhje do të ishte shumë më e madhe po të analizohej struktura e atyre që punojnë nëpër zyra dhe vende udhëheqëse.

Akoma më të vështirë e bën gjendjen fakti se 52,3 për qind të vendeve të lira nuk plotësohen fare. Në anën tjetër shteti ka futur sistemin e punës jashtë orarit. Vetëm gjatë vitit 1978 me orar të zgjatur kanë punuar 51 865 vetë, ndërsa vitin e kaluar 7400 vende të punës janë mbajtur nga honorarxhinjtë.

Papunësia e madhe, varfëria dhe jeta e vështirë i kanë detyruar një numër të madh të të papunëve të marrin rrugën e trishtueshme të kurbetit. Siç detyrohen të pranojnë edhe vetë revizionistët rreth 120 000 vetë nga Kosova punojnë në viset e ndryshme të Jugosllavisë apo në vende tjera kapitaliste. Por ky numër do të ishte shumë më i madh sikur të llogariteshin edhe kurbetqinjtë që shkojnë pa ndërmjetësimin e enteve të punës dhe nuk evidentohen fare. Nga ana tjetër numri i të mërguarve nga viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi është gjithashtu shumë i madh. Vetëm nga komunat e

Tetovës, Gostivarit, Strugës e Kumanovës kanë emigruar 16 000 shqiptar, ndërsa nga komuna e Ulqinit mbi 4000 vetë.

Revizionistët flasin shpesh për gjoja përpjekjet që bëkan ata për kthimin e kurbetqinjëve, por kjo është thjeshtë një demagogji. Nga të 17 000 vetët që u kthyen nga kurbeti në vitin 1978, vetëm 1000 prej tyre gjetën punë, kurse të tjerët u rreshtuan sërish në ushtrinë e të papunëve. Entet e punës përkundrazi përgatisin plane dhe hapin rrugë të reja të kurbetit. Gjatë tre-katër vjetëve të ardhshëm, planifikohet të dërgohen në Libi jo më pak se 10 000 kosovarë.

Pasojat e krizës së rëndë që ka mbërthyer ekonominë e Kosovës, revizionistët jugosllavë mundohen t'i hedhin mbi kurrizin e klasës punëtore dhe masave të tjera punonjëse. Kështu rreth 67 për qind të punonjësve kosovarë kishin të ardhura personale nën 5000 dinarë, ndërsa 12,1 për qind e tyre, nën 3000 dinarë.

Veçanërisht e vështirë është gjendja e punëtorëve në prodhim të drejtpërdrejtë. Xehtarët e minierave të Kosovës, siç shkruante "Rilindja" me shumicë po i lëshojnë minierat, për shkak të kushteve të vështira të punës dhe të pagave tepër të ulëta. Mesatarja e pagave të tyre, në vitin e kaluar, ishte vetëm rreth 2800 dinarë.

GJENDJA E RËNDË NË EKONOMINË E KOSOVËS - PASOJË E SHFRYTËZIMIT KOLONIAL E KAPITALIST

Revizionistët jugosllavë dhe renegatët shqiptarë këtë gjendje të vështirë të ekonomisë së Kosovës mundohen ta paraqesin si pasojë të gjendjes së rëndë të ekonomisë botërore, prapambetjes së trashëguar të Kosovës, dobësive subjektive e profka të tjera si këto. Por e vërteta qëndron krejt ndryshe.

Kosova, siç shihet, është një krahinë e begatshme me pasuri të shumta natyrore. Rezervat e saj të thëngjill-linjitit kapin 64 për qind të të gjitha rezervave jugosllave, ato të plumbit e të zinkut 67 për qind, të hekurnikelit 24 për qind, të energjisë elektrike 30 për qind, pastaj gati të gjitha rezervave të argjendit, kromit, etj. Por, këto pasuri nuk shfrytëzohen nga ne kosovarët. Ato grabiten dhe shfrytëzohen si lëndë të para nga pushtuesit revizionistë jugosllavë. Prandaj, ekonomia e Kosovës është e gjymtuar, e njëanshme dhe e varur nga ekonomia e republikave jugosllave. Vendin kryesor në ekonomi e zënë bujqësia, industria nxjerrëse e lëndëve të para dhe ajo e përpunimit fillestar të tyre. Vetëm Kombinatet "Trepça" dhe "Kosova", të cilët prodhojnë energji elektrike dhe lëndë të para minerale, japin 48,8 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial të Kosovës. Industria e lëndëve të para minerare dhe bazike japin dy të tretat e prodhimit të përgjithshëm industrial. Në këto degë derdhen edhe shumica e investimeve të kapitalit jugosllav dhe atij botëror.

Politika e gërshërës së çmimeve është një mjet tjetër i borgjezisë jugosllave për të nxjerrë fitime nga Kosova. Prodhimet e Kosovës si gruri, thëngjilli, energjia elektrike, plumbi, zinku, kromi, argjendi etj. merren si lëndë të para me çmime shumë të ulëta dhe pothuajse të pandryshueshme. Më tepër se 90 për qind të prodhimit të papërpunuar të plumbit e zinkut "Trepça" ua jep blerësve jashtë Kosovës. "Pjesa që shkon për të plotësuar nevojat e vendit tonë, shkruan revista "Economia" nuk shitet sipas çmimeve të tregut botëror, por me çmime të brendshme të caktuara me marrëveshje, të cilat shpeshherë janë (gjer në 20 për qind) nën çmimet botërore." Kështu, p.sh. çmimi i plumbit në tregun e vendit është 20 për qind më i ulët se ai në tregun botëror, ndërsa çmimet e hekurit, çelikut për betonim dhe bakrit (që prodhohen jashtë Kosovës) janë më të mëdha në tregun e brendshëm se sa në atë të jashtmin përkatësisht 124 për qind, 72 për qind dhe 27,5 për qind. Vetëm për shkak të çmimeve të ulëta, me të cilat "Trepça" detyrohet t'ua shes

prodhimet e veta ndërmarrjeve jugosllave, gjatë vitit 1978 ajo kishte mbi 300 milionë dinarë humbje.

Kosova e shfrytëzon vetëm 37 për qind të energjisë elektrike që prodhon, ndërsa pjesën tjetër e marrin republikat jugosllave. Vetëm Bashkësia Elektroekonomike e Serbisë vjet mori mbi 2 milionë e 360 000 megavatorë energji elektrike. "Një pjesë e energjisë elektrike e cila i përcillet Elektroekonomisë së Serbisë, shkruante "Economia", realizohet me çmime shumë të ulëta në krahasim me çmimet me të cilat ne e blejmë të njejtën energji elektrike nga Elektrodistribucioni i Serbisë." Nga ana tjetër, "Zhelezara" e Shkupit, që merr për çdo vit rreth një milionë megavatorë energji elektrike, deri më 1977 paguante një kilovatorë vetëm 0,25 dinarë, ose disa herë më pak se sa paguanim ne kosovarët. Nga ky çmim Kombinati "Kosova" çdo vit kishte rreth 150 milionë dinarë humbje. Kontestin rreth çmimit të kësaj energjie padrejtësisht e mori në dorë një komision jugosllav i arbitrazhit i cili sigurisht që nuk do ta zgjidhte atë drejtë. Përveç kësaj pothuajse gjithë sasinë e thëngjillit të këtij Kombinati që nuk e harxhojnë termocentralet e tij, shkon në republikat jugosllave siç shkon edhe gati gjithë gazi industrial i këtij gjiganti.

Borgjezia e republikave jugosllave bën përgatitje intensive për shfrytëzimin e mëtejshëm, shumë më të madh, të lëndëve të para dhe të energjisë së Kosovës. Për të shuar etjen e ekonomisë jugosllave për energji, dhe në zbatim të porosive të Titos gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë, kohëve të fundit, federata formoi një komitet koordinues në nivel jugosllav për shfrytëzimin e thëngjillit të Kosovës. Republikat jugosllave parashohin të ndërtojnë në Kosovë termocentrale me fuqi prej 4500-5000 megavatorësh. "Tanimë arritëm marrëveshje konkrete me Kosovën, në mënyrë që nga potencialet e saj energjetike të sigurojmë energji elektrike afatgjate" - i deklaronte "Rilindjes" kryetari i Veçes Ekzekutive të Sllovenisë, në një kohë kur një slloven mesatarisht harxhon 4 herë më shumë energji se një kosovar. Kosova i ka edhe 170 fshatra të paelektrifikuara dhe jo rrallë detyrohet të ndërpresë furnizimin e vet me energji, kurse me energjinë e saj furnizohen rregullisht republikat jugosllave.

Burimeve të pasura energjetike të Kosovës ia vënë syrin edhe borgjezia e vendeve kapitaliste e revizioniste. Disa vende të Evropës Perëndimore, siç shkruan shtypi, po bëjnë përgatitje për ngritjen e kapaciteteve të veta energjetike në Kosovë.

Ekonomia e Kosovës, siç shihet, është në vartësi dhe kontroll të plotë nga Serbia dhe republikat tjera jugosllave. Ndryshe nuk mund të kuptohet deklarata e kryetarit të Veqes së Serbisë, I. Stamboliç, kur thotë: "Sipas mendimit tim nuk ka pjesë të vendit tonë që nuk ka interes dhe leverdi për zhvillimin e "Trepçës".

Vërshimi i vrullshëm i kapitaleve të huaja ka bërë që ekonomia e Kosovës që ngarkohet me borxhe të mëdha. Ekonomia jugosllave është njëra nga ekonomitë më të ngarkuara në botë me borxhe, ndërsa borxhet e ekonomisë së Kosovës për banorë janë tri herë më të mëdha se mesatarja jugosllave. Në vitin 1978 kreditë e papaguara u shtuan 43 për qind dhe arritën shumën 2,4 miliardë dinarë. Vetëm në formë të kamatës për kreditë e marra në atë vit, Kosova u pagoi bankave jugosllave dhe atyre të jashtmeve mbi 1 miliardë dinarë. Krahina e Kosovës për çdo 100 dinarë të marrë, në vitin 1978 paguante 140 dinarë. "Për pesë vitet e ardhshme, shkruante "Politika" e datës 30. 3. 1980, Kosova duhet të kthej borxhin prej 1.350 miliardë (dinarë të vjetër)."

Humbjet e mëdha financiare, borxhet e shumta e deficiti tregtar kanë bërë që aftësia akumuluese dhe riprodhuese e ekonomisë kosovare të jetë shumë e dobët dhe të ketë tendencë të vazhdueshme rënieje. Në krahasim me mesataren jugosllave ajo është 4 deri 5 herë më e vogël. Mjetet financiare të ndërmarrjeve kosovare përbëjnë vetëm 7,7 për qind të investimeve të përgjithshme në Kosovë, kurse gjithë pjesa tjetër është kapital i bankave dhe fondeve jugosllave e atyre botërore.

Propaganda revizioniste çirret se gjoja federata jugosllave ndihmon zhvillimin më të shpejtë të Kosovës e bile se kjo Krahinë gëzoka prioritet në Fondin federativ për të pazhvilluarit. Kjo zhurmë nuk bëhet për tjetër, veçse për t'i hedhur hi syve kosovarëve dhe për ta mashtruar opinionin jugosllav e atë të jashtëm rreth gjendjes së vërtetë në Kosovë. Por faktet tregojnë të kundërtën. Shkalla e zhvillimit të Krahinës jo vetëm që nuk bëri asnjë hap përpara, por, siç detyrohet të pranojë edhe shtypi revizionist, viteve të fundit ajo ka rënë edhe për 5,1 për qind (në vitin 1975 ishte 33,1 për qind, ndërsa sivjet ajo ra në 28 për qind).

Në periudhën prej vitit 1953-1978 prodhimi shoqëror për banor në Kosovë u rrit më ngadalë se në Jugosllavi. Derisa në vitin 1953 ai arrinte në shkallën 46,1 për qind të mesatares jugosllave, 25 vjetë më vonë (më 1978) arriti në shkallën 28,8 për qind. Popullsia e Kosovës përbën 7 për qind të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë, kurse pjesëmarrja e saj në të ardhurat kombëtare mezi arrin shkallën 1,9 për qind.

Revizionistët jugosllavë dhe krerët tradhtarë të Kosovës po i kushtojnë një vëmendje edhe më të madhe intensifikimit të eksploatimit të pasurive tona, si rrugë gjoja për nxjerrjen e Kosovës nga gjendja e vështirë dhe për zhvillimin e saj më të shpejtë. Republikat jugosllave kanë hartuar programe dhe projekte të reja për ndërtimin e reparteve të tjera në Kosovë. Në këtë mënyrë Kosova jo vetëm që nuk do të fitoj asgjë por, përkundrazi, gjendja e saj do të keqësohet edhe më shumë. Ekonomia e saj do të futet edhe më nën vartësinë e republikave të Jugosllavisë të cilat do t'i shfrytëzojnë egërsisht pasuritë e shumta të Kosovës për të përballuar krizën e rëndë në të cilën ndodhen edhe ato.

Propaganda revizioniste në Kosovë dhe Jugosllavi më kot mundohet ta arsyetojë prapambetjen e Kosovës dhe gjendjen e vështirë të ekonomisë së saj. Gënjeshtrave dhe demagogjisë së tyre djallëzore nuk u beson më njeri. Populli i Kosovës po sheh gjithnjë e më qartë se shkaktari i vërtetë i kësaj gjendjeje është kriza e thellë politike, ekonomike e shoqërore që po e bren nga themelet regjimin titist dhe shtypja e shfrytëzimi i egër kolonial e kapitalist që ushtrohet mbi të. Ai po e kupton gjithashtu se e vetmja rrugë për të dalur nga kjo gjendje është lufta e pakompromis kundër regjimit revizionist jugosllav dhe tradhtarëve shqiptarë. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 5-7)

1-5. NJË FAQE E LAVDISHME E LUFTËS PËR LIRI E PAVARËSI

Nga Kadri Zeka

Detyrat historike të shtruara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit vazhdonin të mbeteshin ende në fillim të shekullit tonë në rend të ditës.

Pranvera e vitit 1910 e gjeti mbarë Kosovën në këmbë e me armë në dorë. Kryengritja, siç pohonin edhe dëshmitarë të kohës, kishte në bazë idenë kombëtare të pavarësisë. Dhe, në fakt, udhëheqës të lëvizjes si Idriz Seferi, si dhe shtypi patriotik shqiptar që e mbështeti kryengritjen, deklaruan se lufta bëhej për realizimin e autonomisë administrative të Shqipërisë.

Për të shtypur kryengritjen, qeveria xhonturke mobilizon forca të mëdha ushtarake dhe gjeneralët e saj më të zotë. U angazhua drejtpërsëdrejti edhe erdhi për këtë qëllim në Kosovë vetë ministri i luftës i Perandorisë në atë kohë, Mahmut Shefqet Pasha. Ata ushtruan një terror të pashembullt. Megjithatë, qëndresa e kryengritësve shqiptarë qe heroike. Ata zunë pikat strategjike kryesore. Momentet kulmore të saj u bënë betejat e Kaçanikut e të Carralevës. Aty u gozhduan forcat 20-mijëshe xhonturke dhe u ndalua

përkohësisht marshimi i tyre drejt Kosovës. Bijtë e Kosovës heroike e liridashëse të udhëhequr nga strategë të luftës popullore si Isa Boletini e Idriz Seferi me shokë shkruan faqe lavdie e trimërie, të cilat do të mbeten edhe në të ardhmen të pashlyera në ndërgjegjen e mbarë kombit, i cili i ka përjetësuar e skalitur ata në vargje epike legjendare:

Ç'ka ka dielli që s'ban dritë?
Ka krisë pushka n'Kaçanik.
Kaçanikut raft-i pika.
Nuk e dijtka ç'ka a frika
Nandë sahat tuj u therë me thika
Therë me thika nandë sahat
Ka ra kali not në gjak!

Shtypi i kohës, jo vetëm ai shqiptar, por edhe shtypi i huaj, i krahasoi betejat e Kaçanikut e të Carralevës, me betejën e Termopileve të epokës së lashtësisë. Porse gjatë kryengritjes së vitit 1910 pati edhe beteja të tjera të mëdha midis forcave shqiptare dhe forcave të panumërta xhonturke, siç qenë ato të Qafës së Morinës dhe të Qafës së Agrit. Aty gjenerali famëkeq Shefqet Turgut Pasha u ngujua me javë të tëra. Qeverisë dhe autoriteteve ushtarake xhonturke iu deshën më se tre muaj për ta shtypur këtë kryengritje.

Kryengritja pati jehonë të thellë e të gjerë jo vetëm brenda vendit në vilajetet e Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës, por edhe jashtë tij.

Përvoja e kryengritjes së Kosovës nuk shkoi kot. Lëvizja kombëtare shqiptare nxorri prej saj mësimet e duhura. Në këtë kuptim Kryengritja e Kosovës e vitit 1910 dhe Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës, Hotit e Grudës e vitit 1911 mund të merren si parathënie e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912. Si rrjedhim logjik dhe i drejtpërdrejtë i kësaj lufte mbarëshqiptare erdhi Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

Por, si pasojë e vendimeve të padrejta, të fuqive imperialiste, me të cilat u lanë jashtë kufijve të shtetit të ri shqiptar Kosova e Rrafshi i Dukagjinit, dhe toka të tjera shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, kjo fitore mbeti e gjymtuar. Megjithatë në themelet e çimentuara me gjak të pavarësisë shqiptare qëndron edhe Kryengritja e vitit 1910 e popullit trim e liridashës të Kosovës, e udhëhequr nga trima e patriotë të shquar si Isa Boletini e Idriz Seferi me shokë. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 7)

1-6. VEPËR ME RËNDËSI TË MADHE TEORIKE DHE PRAKTIKE

(LIBRI I SHOKUT ENVER HOXHA "VETADMINISTRIMI" JUGOSLLAV TEORI DHE PRAKTIKË KAPITALISTE")

Nga Jakup Krasniqi

Në vitin 1978, vargut të veprave të marksist-leninistit të shquar të kohës sonë, shokut Enver Hoxha, iu shtua edhe një vepër e re me rëndësi të madhe teorike e praktike për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit e të socializmit. Në këtë vepër, si edhe herë të tjera, shoku Enver Hoxha tregon me logjikë të hekurtë, me gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme rrënjët e revizionizmit titist, pasojat dhe rrezikun që paraqet ku variant i revizionizmit modern. Vepra është një thesar shumë i çmuar në duartë e marksistë-leninistëve dhe proletarëve kudo në botë që u tregon atyre të vërtetën mbi "vetadministrimin" jugosllav ("vetqeverisjen") si një teori dhe praktikë kapitaliste, të cilën siç thekson shoku Enver Hoxha, "... titistët dhe kapitalizmi ndërkombëtar... e propagandojnë si një rrugë të

gatshme të sprovuar të socializmit" dhe e përdorin si një armë të preferuar në luftë kundër socializmit, revolucionit dhe luftërave çlirimtare".

Shoku Enver Hoxha, në veprën "Vetadministrimi jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste" demaskon në mënyrë të pakundërshtueshme teorizimet e telallit titist, Eduard Kardelit, të shprehura në librin "Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetqeverisjes socialiste". Lufta e drejtë e parimore, kurdoherë në baza marksiste-leniniste, e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit titist ka qenë dhe është një shkollë e madhe që i mësoi marksist-leninistët, proletarët dhe popujt e botës se si luftohen armiqtë e revolucionit dhe të socializmit, sado të maskuar që të jenë ata.

Në veprën "Vetadministrimi" jugosllav..." i bëhet një analizë shkencore rrugës së zhvillimit të revizionizmit titist, si varianti i parë i revizionizmit modern në pushtet. Ai, siç thotë shoku Enver, ishte i pari që i doli përkrah kapitalizmit botëror dhe që iu vu me zell të papërmbajtur luftës kundër revolucionit e marksizëm-leninizmit. "... si përpara edhe pas çlirimit të Jugosllavisë, konkludon shoku Enver Hoxha, grupi renegat titist, që ishte i maskuar, që hiqej si përkrahës i sistemit socialist të vendosur në Bashkimin Sovjetik, që trumpetonte se do të ndërtonte socializmin në bazë të teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit, në të vërtetë ka qenë kundër kësaj ideologjie dhe kundër përvojës revolucionare sovjetike".

Lufta nacionalçlirimtare e popujve jugosllav, padyshim, është epopeja e tyre më e lavdishme. Ajo përveç trimërisë, guximit dhe heroizmit të popujve, kishte edhe ndershmërinë e komunistëve të vërtetë e konsekuentë jugosllavë. Por, në anën tjetër, në gjirin dhe sidomos në udhëheqjen e PKJ-së kishte shumë fraksionistë, devijatorë e nacionalistë borgjezë, të cilët bënë që të tradhtohej Lufta nacionalçlirimtare dhe revolucioni në Jugosllavi.

Kjo tradhti u duk qartë, përveç tjerash, edhe në qëndrimin e udhëheqjes së PKJ ndaj aleancës antifashiste. Grupi titist, siç vë në dukje shoku Enver Hoxha, afrohej dhe anonte nga angloamerikanët, në një kohë kur lufta nacionalçlirimtare e Jugosllavisë duhej të lidhej ngushtë me luftën çlirimtare të Bashkimit Sovjetik.

Nga ana tjetër, si nacionalistë që ishin, ata mbanin një qëndrim shovinist ndaj popujve të shtypur në Jugosllavi dhe atyre fqinj. "Jugosllavia, thotë shoku Enver, rivendikonte toka në veri, sidomos në kufi me Italinë. Por ajo heshtte për kufijtë në jug, veçanërisht për ato me Shqipërinë, për Kosovën dhe tokat shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi."

Pas luftës Grupi Tito-Kardel-Rankoviç ndërmori likuidimin e të gjitha tipareve marksiste-leniniste të revolucionit dhe u vu në kërkim të rrugëve gjoja të reja "socialiste" në fushën ekonomike, në politikën e brendshme dhe të jashtme, në arsim, në kulturë dhe në të gjitha fushat e jetës. Brenda një kohe të shkurtër u zhdukën edhe ato pak elemente socialiste që kishin lindur në ekonomi, normat e centralizmit demokratik në parti u shkelën brutalisht, partia u "pastrua" nga njerëzit besnik të socializmit dhe u vu në vartësi të plotë të UDB-së famëkeqe, kurse në politikën e jashtme Jugosllavia u lidh edhe më shumë me imperializmin. "Këto masa, shkruan shoku Enver Hoxha, provonin jashtë çdo dyshimi se ky "socializëm" që po ndërtonte Jugosllavia, nuk ishte gjë tjetër veçse rruga e integrimit në kapitalizëm".

Ishte kjo rrugë antimarksiste e titistëve ajo që i çoi ata në konfliktin me Bashkimin Sovjetik, me Stalinin dhe me të gjitha vendet e atëhershme socialiste dhe jo aspak përpjekjet që gjoja bënin Bashkimi Sovjetik dhe Stalini për ta mbajtur Jugosllavinë në tutelën e tyre , siç dërdëllisin revizionistët.

Pas largimit nga Kampi socialist Jugosllavia titiste u lidh edhe më fortë pas qerres së imperializmit botëror. "Si agjenturë e kapitalizmit botëror e përpunuar me kohë, thotë shoku Enver Hoxha, ajo iu drejtua atij menjëherë për ndihmë dhe ky, sidomos

imperializmi amerikan, u tregua plotësisht i gatshëm t'u jepte Titos me shokë gjithë ndihmat e mbështetjen e nevojshme për t'u shpëtuar lëkurën dhe për t'i bërë ata një vegël të rëndësishme në luftën kundër socializmit, revolucionit dhe lëvizjeve çlirimtare."

Në këtë vepër shoku Enver argumenton me fakte bindëse se "teoria dhe praktika e 'vetadministrimit' jugosllav është një mohim i hapët i mësimeve të marksizëm-leninizmit dhe i ligjeve të përgjithshme mbi ndërtimin e socializmit."

Duke u mbështetur në mësimet jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit, në përvojën e pasur të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe Stalinit si dhe në përvojën e madhe të socializmit në Shqipëri, shoku Enver hedh poshtë teorizimet e revizionistëve titistë, sipas të cilëve, socializmi s' mund të ndërtohet duke i përqendruar mjetet e prodhimit në duartë e shtetit socialist, por duke e copëtuar pronën shtetërore socialiste, në duartë e grupeve të veçanta të punëtorëve të cilët gjoja e vetadministrokan atë drejtpërdrejtë. Revizionistët jugosllavë kanë bërë të tyren tezën antimarksiste të Bauerit, sipas së cilës, nëse shteti drejton ekonominë ai bëhet tepër i fuqishëm kundrejt popullit dhe përfaqësisë kombëtare, gjë që, sipas tij, do të ishte e rrezikshme për demokracinë. Por, krejt të kundërtën vërteton përvoja e Shqipërisë socialiste, ku ndërtohet socializmi i vërtetë, ku ekonomia drejtohet nga shteti në mënyrë të planifikuar e të centralizuar dhe ku ka për masat liri e demokraci të vërtetë proletare.

Realiteti i zi në Jugosllavinë titiste, e cila është mbërthyer në darën e një krize të rëndë e të gjithanshme, vërteton më së miri konkluzionin e shokut Enver Hoxha se në Jugosllavi nuk ndërtohet dhe as që është ndërtuar ndonjëherë socializmi. Prona private mbi mjetet e prodhimit është shtrirë kudo në Jugosllavi. Ligje të shumta lejojnë bile stimulojnë ekonominë private dhe u lënë duartë të lira borgjezëve të rinj dhe të vjetër për të shtypur e shfrytëzuar masat punonjëse, të cilat jetojnë në kushte shumë të vështira edhe se ato të shokëve të tyre në vendet borgjeze. Në tërë Jugosllavinë është krijuar një klasë borgjeze në qytet e fshat e cila vazhdimisht pasurohet në dëm të masave popullore. Vetë Titua detyrohej të pranonte se disa borgjezë jugosllavë kanë depozituar në bankat jugosllave mbi 4-5 miliardë dollarë, pa llogaritur këtu miliadat tjerë që kanë depozituar ata në bankat e huaja.

Ekonomia jugosllave i ka hapur dyertë për kapitalin botëror e në mënyrë të veçantë për atë amerikan. Firmat e ndryshme kapitaliste janë lënë të lira të bëjnë investime kudo në Jugosllavi, për të shfrytëzuar lëndët e para dhe krahun e lirë të punëtorit jugosllav. Revizionistët jugosllavë mburren me disa fabrika e ndërmarrje që i kanë, por në fakt ato janë ngritur me kapitalin e borgjezisë perëndimore e cila aktualisht posedon më shumë se gjysmën e kapitalit të përgjithshëm jugosllav. Vetë fakti se Jugosllavia titiste sot ka rreth 20 miliardë dollarë borxhe të jashtme tregon se çfarë ekonomie kanë ngritur revizionistët në Jugosllavi. "Sistemi i 'vetadministrimit' jugosllav mund të quhet një pushtet i kooperimit të kapitalizmit jugosllav me kapitalizmin amerikan dhe me kapitalistë të tjerë. Këta janë ortakë në pasuritë e Jugosllavisë në çdo gjë, në fabrika, në komunikacion, në hotele, në shtëpitë e banimit, deri edhe në shpirtin e njerëzve."

Revizionisti Kardel mundohet t'i bindë të tjerët se gjoja klasa punëtore në Jugosllavi administron vetë ndërmarrjet nëpërmjet të ashtuquajturave këshilla të punëtorëve të cilët gjoja zgjidhen nga vetë punëtorët etj.

Por në të vërtetë, siç shkruan shoku Enver Hoxha në librin "'Vetadministrimi' jugosllav", "Punëtori në Jugosllavi nuk drejton dhe nuk gëzon ato të drejta që i shpall me aq pompë "ideologu Kardel"... "Në fakt, vendimtar është roli i asaj shtrese funksionarësh dhe borgjezësh të rinj që sundojnë në ndërmarrjen "vetadministruese". Janë ata që bëjnë planin, që caktojnë investimet, të ardhurat e gjithsecilit, të punëtorit dhe të vetes; natyrisht kërraba tërheq nga vetja e tyre. Janë krijuar të tilla ligje e rregullore që fitimet të jenë më të mëdha për udhëheqjen dhe të pakta për punëtorët."

Revizionistët jugosllavë, kur është fjala për ndërtimin e socializmit në fshat, mbajnë heshtje të plotë, pasi në fshatin jugosllav as që është ndërtuar socializmi ndonjëherë. Ligjet e shtetit jugosllav, siç thekson shoku Enver Hoxha, kanë krijuar mundësitë për lindjen dhe pasurimin e klasës së re borgjeze të fshatit dhe kulakërisë në kurriz të fshatarësisë së varfër.

Zhurmë të madhe bëjnë revizionistët titistë edhe rreth "lirive individuale" dhe "demokracisë" që ekzistokan në Jugosllavi. Por, lufta e proletariatit jugosllav, fshatarësisë, rinisë etj. nëpërmjet grevave, protestave, demonstratave etj. kundër regjimit titist, nuk tregon për ndonjë demokraci për masat, por të kundërtën; mungesën e lirisë dhe të drejtave për to. Për punonjësit në Jugosllavi, siç thotë shoku Enver, ka "liri" për të qenë të papunë, për të migruar jashtë atdheut e për t'u endur si hamenj nëpër rrugët e metropoleve kapitaliste, për të paguar taksa, për t'u diskriminuar dhe për t'u shfrytëzuar egërsisht nga borgjezia e vjetër dhe e re jugosllave, si dhe nga ajo e huaj.

Vend të veçantë në veprën "Vetadministrimi' jugosllav..." zë kritika e pikëpamjeve revizioniste të "teoricienit" Kardel mbi shtetin. Duke hedhur poshtë pretendimet e këtij telalli titist, i cili me fraza abstrakte e konfuze përpiqet ta paraqesë sistemin jugosllav të delegimit si bartës të demokracisë së vërtetë, si shprehje e drejtpërdrejtë të "vetadministrimit" të masave popullore, shoku Enver Hoxha thekson: "Në Jugosllavi nuk ekzistojnë organe të pushtetit shtetëror si përfaqësuese të vërteta të popullit. Atje ekziston vetëm sistemi burokratik i quajtur "sistemi i delegatëve."

Sistemi politik i "vetadministrimit socialist" është i ndërtuar në kundërshtim flagrant me diktaturën e proletariatit. Marksizëm-leninizmi na mëson se midis shoqërisë kapitaliste dhe asaj komuniste është i domosdoshëm shteti i diktaturës së proletariatit. Në kundërshtim me këto mësime, revizionistët jugosllavë mohojnë rolin e shtetit të diktaturës së proletariatit, të cilin pa fije turpi, pa bërë kurrfarë dallimi e barazojnë me shtetin e diktaturës borgjeze. Revizionisti me damkë Kardel, duke dëshiruar ta prezentojë sistemin famëkeq të "vetadministrimit" si sistemin më "human" ia kundërvë atë diktaturës borgjeze dhe asaj proletare, të cilat, pa bërë dallim mes tyre, i konsiderojnë që të dyja dogmatike. E gjithë kjo bëhet për ta nxjerrë sistemin e vetadministrimit jugosllav si të vetmin sistem të drejtë dhe jodogmatik.

Problem tjetër që trajton shoku Enver në këtë libër, është edhe çështja nacionale e pazgjidhur në Jugosllavinë revizioniste, problem i trashëguar nga koha e kralëve të vjetër. Pas Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste e Jugosllavisë lëshoi parullën e "vëllazërim-bashkimit", por vetë parulla nuk mund t'i zgjidhte grindjet e vjetra nacionale, që u thelluan edhe më shumë. "Bashkimi" dhe "vëllazërimi" i popujve, për të cilët flitet shumë në Jugosllavi, kurrë nuk është shtruar mbi themele të drejta të barazisë ekonomike, politike, sociale e kulturore të kombeve e të kombësive. Këtë e dëshmon më së miri politika fashiste e bandës së Beogradit e ushtruar, për decenie me radhë, mbi popullsinë shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi.

Për të dobësuar sa më shumë rezistencën e shqiptarëve, revizionistët jugosllavë bënë atë që kishin bërë pushtuesit osmanë shumë kohë më parë; copëtuan tokat shqiptare në dy republika dhe një krahinë autonome, pasi, si ekonomikisht ashtu edhe politikisht, është e varur plotësisht nga republika e Serbisë. Popullsia shqiptare në Jugosllavi edhe pse siç tha shoku Enver në fjalën e 9 Nëntorit, si për nga madhësia e tokave, ashtu edhe për nga numri i popullsisë bënë sa dy republika të marra së bashku të Jugosllavisë, bile edhe më shumë, ndodhet në një prapambetje të theksuar ekonomike, politike, sociale e kulturore.

Revizionistët titistë mundohen ta paraqesin Jugosllavinë si vendin ku është zgjidhur më së miri çështja nacionale. Por, siç thekson shoku Enver, "me fjalë

revizionistët mund t'i paraqesin si të duan marrëdhëniet midis kombeve e kombësive në Jugosllavi, por e vërteta e hidhur për këtë problem do t'i tmerroj ata edhe pas vdekjes."

Duke e analizuar me objektivitet shkencor këtë situatë mjaft të vështirë e të turbullt, shoku Enver nxjerr konkluzionin e pakundërshtueshëm se "çështja nacionale në Jugosllavi nuk do të zgjidhet në qoftë se atje nuk përmbyset rendi kapitalist i ashtuquajtur vetadministrues".

Në veprën "Vetadministrimi' jugosllav..." shoku Enver Hoxha hedh poshtë gjithashtu edhe pikëpamjet e revizionistëve jugosllav mbi revolucionin dhe luftën e klasave. Sipas revizionistëve titistë sot nuk mund të bëhet fjalë për përmbysjen me dhunë të shtetit kapitalist, për marrjen e pushtetit nga klasa punëtore dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit. Revizionistët jugosllavë, ashtu si të gjithë revizionistët tjerë, mohojnë revolucionin proletar dhe luftën e klasave. Ata janë kundër dhe sabotojnë gjithashtu edhe luftërat çlirimtare të popujve të shtypur.

Në këtë vepër, shoku Enver demaskon edhe pikëpamjet antimarksiste të revizionistëve jugosllavë mbi rolin e partisë marksiste-leniniste në revolucion e në ndërtimin socialist. Sipas revizionistit Kardel, partia e klasës punëtore duhet të merret vetëm me punën edukuese dhe nuk duhet të ketë rol udhëheqës. Mohimi i rolit udhëheqës të partisë dhe reduktimi i rolit të saj vetëm në sferën ideologjike e edukuese është në kundërshtim të plotë me doktrinën marksiste-leniniste. Duke hedhur poshtë këto teorizime të Kardelit, shoku Enver Hoxha thekson: "... udhëheqja e partisë përbën një çështje me rëndësi jetike për fatet e revolucionit dhe diktaturën e proletariatit, ajo pasqyron një ligj të përgjithshëm të revolucionit socialist".

Revizionistët jugosllavë, si antimarksistë që janë, duan një parti të tipit borgjez, të xhveshur nga çdo gjë komuniste, ashtu siç është Lidhja e tyre e "Komunistëve". Ata siç thotë shoku Enver, nuk duan, dhe në të vërtetë nuk kanë parti politike të klasës punëtore, por një organizatë borgjeze, një klub ku mund të futet e të dalë cilido, kur të dojë e si të dojë, mjafton të deklarojë se është komunist, pa qenë nevoja të jetë i tillë. Natyrisht kjo është një gjë normale për një parti si Lidhja e "Komunistëve" të Jugosllavisë që s'ka gjë prej gjëje komuniste."

Ka kohë që revizionistët titistë po bëjnë një zhurmë rreth të ashtuquajturit "pluralizëm të interesave", që, sipas tyre, u shprehka në kuadrin e "Lidhjes Socialiste" e cila përmbledh në gjirin e saj të gjitha rrymat politike, deri edhe te ato reaksionaret. Në veprën e tij shoku Enver Hoxha, argumenton se "ky 'pluralizëm', sido që të quhet "pluralizëm demokratik" ose "pluralizëm i interesave të punonjësve, ose ndonjë lloj tjetër, në të vërtetë ndryshon vetëm formalisht nga pluralizmi borgjez" dhe nxjerrë konkluzionin se sistemi politik i "Vetadministrimit" në Jugosllavi është një maskim i pacipë i tradhtisë revizioniste ndaj marksizëm-leninizmit; ndaj socializmit shkencor dhe komunizmit."

Për ta luftuar socializmin e vërtetë që u ndërtua në Bashkimin Sovjetik, të kohës së Leninit e Stalinit dhe që po ndërtohet sot në Shqipëri si dhe për ta ngadalësuar procesin e kalbëzimit të rendit kapitalist, titistët, kanë sajuar "teori" të ndryshme rreth "rrugëve të ndryshme për në socializëm", "llojeve të ndryshme të socializmit" etj. Në emër të zbatimit gjoja krijues të marksizmit dhe në përputhje me kushtet konkrete, ata mohojnë ligjet e përgjithshme të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit. Duke hedhur poshtë këto teorizime, shoku Enver Hoxha shkruan: "E vërteta është se për ndërtimin socialist kërkohet të mbahen parasysh doemos kushtet konkrete të çdo vendi, por socializmi në çdo vend mund të ndërtohet vetëm në bazë të marksizëm-leninizmit, në bazë të ligjeve e të parimeve të përbashkëta për të gjitha vendet, të cilave nuk mund t'u shmangesh nëqoftëse nuk don të përfundosh në kapitalizëm si Jugosllavia."

Në gjirin e klikës titiste, gjatë gjithë jetës së saj është zhvilluar një luftë e ashpër për pushtet në mes klanesh sunduese. Kohëve të fundit kjo luftë ka marrë përpjestime të

reja. Për ta zbutur sado pak këtë gjendje, Titoja "zbuloi" "udhëheqjen kolektive", qëllimi i së cilës është ruajtja e titizmit pas vdekjes së Titos (sa ishte gjallë Titoja nuk lejonte t'i cënohej sado pak sundimi personal mbretëror). "Udhëheqja kolektive" rreth së cilës po bëhet një zhurmë shurdhuese, është një reformë borgjeze si motrat e saj të mëparshme, si "sistemi i delegimit", "Ligji mbi punën e bashkuar" etj. Por, as kjo "shpikje" e famshme nuk mund ta shpëtojë titizmin nga fundi i turpshëm që e pret.

Titizmi, ashtu siç mëson shoku Enver Hoxha ka qenë dhe mbetet një armë e borgjezisë imperialiste, një zjarrfikës i revolucionit. Ai qëndron në një radhë, ka të njejtat qëllime dhe është në unitet ideologjik me revizionizmin modern në përgjithësi dhe me variantet e ndryshme të tij.

Edhe pse përpiqen ta fshehin, revizionistët titistë bëjnë të gjitha përpjekjet që sistemi i tyre "vetadministrues" të adoptohet e të zbatohet në shkallë ndërkombëtare. Por popujt dhe klasa punëtore në Jugosllavi dhe kudo në botë po e shohin çdo ditë e më mirë se "vetadministrimi" jugosllav është një teori dhe praktikë vërtetë kapitaliste që nuk ka asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe socializmin e vërtetë. "Realiteti jugosllav, shkruan shoku Enver Hoxha, provon çdo ditë tani dhe do të provojë akoma më mirë nesër se ku i shpie Jugosllavinë, popujt e saj dhe klasën punëtore klika e Titos dhe e Kardelit.

Për vlerat e saj të gjithanshme teorike dhe praktike për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit, vepra e shokut Enver Hoxha "Vetadministrimi' jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste" është një armë e fuqishme në duartë e popullit tonë të robëruar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi për ta njohur titizmin, armikun tonë të urryer, dhe sistemin e tij të kalbur "Vetadministrues".
(Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 8-10)

1-7. LIBËR I RI I SHOKUT ENVER HOXHA

Nga Kadri Zeka

Këto ditë doli nga shtypi libri i ri i shokut Enver Hoxha "HRUSHOVIANËT", që përmban kujtime nga takimet që ka pasur shoku Enver me krerët revizionistë krushovianë që erdhën në fuqi pas vdekjes së Stalinit. Libri është pasqyrë e luftës heroike që ka zhvilluar PPSH dhe shoku Enver Hoxha kundër revizionizmit krushovian.

Ky libër po transmetohet çdo ditë në emisionet e Radio Tiranës. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 10)

1-8. POPULLI AFGAN DO TË FITOJË

Nga Kadri Zeka

Po bëhet gati një vit që populli afgan po lufton me heroizëm kundër pushtuesve sovjetik dhe regjimit kukull të Kabulit. Në fillim agresorët sovjetikë u përpoqën të mashtronin opinionin duke trumbetuar se gjoja ata dërguan atje ushtrinë e tyre me kërkesën e Afganistanit, por lufta e vendosur dhe e pakompromis kundër pushtuesve sovjetikë dhe mercenarëve afganë po u çjerrë maskën më së miri carëve të rinj të Kremlinit.

Me gjithë masat e shumta të socialimperialistëve sovjetik për ta shuar këtë luftë, flaka e saj po rritet çdo ditë dhe ka përfshirë pothuajse gjithë Afganistanin. Ushtria pushtuese sovjetike nuk po e ndjenë asnjë moment veten të qetë dhe po merr goditje të

rënda e të njëpasnjëshme nga luftëtarët popullor të cilët gëzojnë përkrahjen e mbështetjen e plotë të masave popullore afgane.

Në vargun e betejave të shumta është për t'u theksuar ajo që u zhvillua, gjatë muajit shtator në luginën e Panshirit (150 kilometra në veri të Kabulit). Në këtë luftë agresorët sovjetikë angazhuan një numër të madh ushtarësh dhe mjete të shumta luftarake si tanksa e helikopterë. Qëndresa e vendosur e luftëtarëve të popullit të kësaj krahine i detyroi ushtrinë pushtuese dhe tradhtarët që pas tri javë luftimesh të tërhiqen me turp nga kjo zonë dhe të struken në Kabul. Gjatë këtyre luftimeve ata lanë në fushën e betejës më tepër se 1500 ushtarë të vrarë e shumë të tjerë të plagosur si dhe u zunë nga populli 35 tanke e mbi 120 maqina të ndryshme luftarake.

Lufta e drejtë e popullit afgan, i cili po bën sakrifica të mëdha për të jetuar i lirë e i pavarur, i ka sjellë në një gjendje tepër të rëndë si pushtuesit sovjetikë ashtu edhe qeverinë kuislinge të Karmalit. Socialimperialistët sovjetikë për t'u hakmarrë për humbjet që kanë pësuar dhe për të mbuluar disfatat e njëpasnjëshme, po përdorin kundër popullsisë së pafajshme edhe mjete e metoda të shfarosjes masive, si bombardimet, djegiet e fshatrave të tëra e deri te përdorimi edhe i bombave me napalm. Në kuadrin e këtyre masave, ata, nga fundi i shtatorit ndërmorën një fushatë të gjerë spastrimi në juglindje të Kabulit, gjatë së cilës më se 200 fshatra e bën objekt bombardimi të artilerisë dhe aviacionit. Me këtë rast u shkatërruan dhjetëra shtëpi banimi e objekte ekonomike dhe gjetën vdekjen një numër i madh banorësh të pafajshëm.

Burgosjet, vrasjet, shfarosjet masive e masat tjera të dhunës e terrorit fashist që po ndërmarrin pushtuesit sovjetikë në bashkëpunim me tradhtarët e vendit po shtojnë çdo ditë e më shumë urrejtjen ndër masat popullore, bile edhe në radhët e ushtrisë mercenare. Si rezultat i kësaj, ushtria e klikës së Karmalit është katandisur në një gjendje shumë të vështirë. Për çdo ditë, ushtarë të shumtë, madje edhe reparte të tëra, dezertojnë dhe bashkë me armët që kanë kalojnë në anën e luftëtarëve të lirisë. Dezertimet e shumta dhe humbjet e pësuara kanë bërë që numri i ushtarëve të ushtrisë mercenare të Karmalit të bie në 20 000 vetë nga 80 000 sa ishte në prag të agresionit sovjetik.

Një veprimtari të rrezikshme kundër popullit afgan po zhvillojnë edhe imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët kinezë të cilët s'po lënë mjet pa përdorur për ta shfrytëzuar luftën e drejtë të popullit afgan për interesat e tyre imperialiste.

Por, populli afgan nuk mashtrohet. Ai do të dijë t'i dallojë miqtë e vërtetë nga armiqtë e tij të përbetuar. Me popullin afgan janë proletariati dhe popujt liridashës të botës.

Lufta e tij është e drejtë dhe patjetër do të fitojë. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 10)

1-9. DIKTATURA FASHISTE NUK MUND TA MPOSHTË POPULLIN TURK

Nga Kadri Zeka

Më 12 shtator të këtij viti oficerët e lartë dhe gjeneralët e ushtrisë turke, në krye me Kenan Evrenin, duke pasur edhe ndihmën e reaksionit të brendshëm e të jashtëm, organizuan një puç ushtarak me anë të të cilit përmbysën qeverinë e Demirelit dhe vendosën diktaturën fashiste në Turqi.

Marrjen e pushtetit nga junta ushtarake, puçistët dhe reaksioni ndërkombëtar po mundohen ta paraqesin si një masë të domosdoshme për gjoja shpëtimin e "demokracisë" në Turqi. Por, në të vërtetë, ky puç u bë për t'i zgjatur jetën sistemit të shtypjes dhe shfrytëzimit dhe për të shuar me forcën e armëve revoltën e masave popullore turke, që kohëve të fundit ka shpërthyer si kurrë më parë.

Masat e shumta që ndërmorën gjeneralët puçist, menjëherë pas marrjes së pushtetit, si ndalimi i të gjitha partive politike e gazetave përparimtare, i grevave dhe

demonstratave, ndalimi i sindikatave punëtore dhe shumë masa të tjera të dhunës e terrorit fashist, tregojnë më së miri qëllimet dhe fytyrën e tyre të vërtetë.

Por, as demagogjia e premtimet mashtruese, as qizmja e bajonetat e diktatorëve fashistë dhe as planet e intrigat e superfuqive imperialiste nuk mund ta ndalin hovin e klasës punëtore dhe popullit revolucionar turk. Nën udhëheqjen e bijve të tij komunistë ai me siguri do të ngritet dhe do të këpusë prangat e rënda me të cilat e kanë lidhur diktatorët fashistë dhe imperialistët e huaj. Vetëm lufta e vendosur, ashtu si të gjithë popujve të shtypur të botës, do t'i sjellë edhe popullit fqinj të Turqisë, lirinë e demokracinë e vërtetë dhe do ta shpëtojë nga skamja, mjerimi dhe tirania e egër fashiste. (Liria, nr. 1, tetor 1980, faqe 10)

==========

KËTO DITË NA RA NË DORË

Jusuf Gërvalla: *"Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare 'Liria', organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndrimi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale, si dhe nga gjuha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndershme të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta gjejnë e ta lexojnë me kujdes 'Lirinë'.*

Po këtë porosi kemi edhe kur është fjala për revistën 'Bashkimi', organ i Frontit të Kuq, me të cilin besojmë, lexuesit tanë të ndershëm kanë pasur rastin të njihen edhe më herët." (Lajmëtari i lirisë, nr.2, tetor - nëntor 1980, faqe 14)

==========

L I R I A

DHJETOR 1980, Nr. 2

2-1. KUSH JANË LUFTËTARËT E LIRISË NË KOSOVË DHE Ç'DUAN ATA?
2-2. TË BURGOSURIT KOSOVARË TË KTHEHEN NË KOSOVË!
2-3. "...PLAGË E HAPËT QË KËRKON SHËRIM"
2-4. ÇËSHTJA PËR TË CILËN LUFTOI ALI KELMENDI DO TË TRIUMFOJË EDHE NË KOSOVË
2-5. JEMI SHQIPTARË E ASGJË TJETËR
2-6. HAPAT KILOMETËR TË SHQIPËRISË SOCIALISTE
2-7. KRIZË E DEGJENERIM NË JUGOSLLAVINË TITISTE
2-8. MASKARADË E PASIGURISË EVROPIANE

2-1. KUSH JANË LUFTËTARËT E LIRISË NË KOSOVË DHE Ç'DUAN ATA?

Nga Mehmet Hajrizi

Një luftë e ashpër po zhvillohet kudo në Kosovë kundër "irredentizmit", "nacionalizmit", kundër "reaksionarëve" e "armiqve të të gjithë (sic.) popullit shqiptar", "armiqve të socializmit" etj. etj. Këtë front kaq të gjerë lufte e kanë hapur prej kohësh në Kosovë armiqtë e vërtetë të saj, revizionistët gjakatarë të Beogradit dhe sahanlëpirësit e tyre në Kosovë. Sa fjalime "të zjarrta" kanë mbajtur politikanët zagarë nëpër Kosovë për

t'i "demaskuar", "irredentistët" etj., në pikëpamje "ideologjike", e "politike", sa artikuj janë shkruar nëpër fletushkat revizioniste kundër "nacionalizmit shqiptar", sa "vizita" të krerëve revizionistë janë organizuar këtu (bile edhe vetë Titua zbriti në Kosovë për këtë qëllim para më se një viti) dhe më në fund, sa arrestime, sa bastisje e sa dënime janë bërë në popullsinë shqiptare të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi që të qërohen hesapet përfundimisht me "irredentizmin", që si një "epidemi" po përhapet te shqiptarët. Padronë të Beogradit, krerë e ministra të mbrojtjes e sigurimit të shtetit në përgjithësi janë ndarë të kënaqur nga mjetet e format e luftës që përdorin tradhtarët tanë kundër popullit, bile kohë pas kohe edhe i kanë lavdëruar ata, por me rezultatet e kësaj lufte nuk kanë qenë dhe nuk janë të kënaqur as pushtuesit e as tradhtarët.

Po kush janë "irredentistët" e "nacionalistët" në Kosovë? Kundër regjimit titist luftojnë edhe njerëz e grupe të ndryshme vërtetë reaksionare e nacionaliste, por tradhtarët dhe revizionistët nuk e kanë hallin tek ata. Në gjuhën e tradhtarëve dhe revizionistëve pushtues, "irredentistë" e "nacionalistë" quhen të gjithë ata patriotë liridashës, revolucionarë, që nuk durojnë robërinë, marksistë-leninistë, luftëtarët e lirisë në Kosovë, që përpiqen për të drejtat e popullit tonë të robëruar, për lirinë e tij, për bashkimin kombëtar dhe për socializmin e vërtetë. Në propagandën e tyre të poshtër ata thonë se këta njerëz janë "të pakët", "njerëz të këqinj", "pa ndikim në popull", të cilët "nxisin nacionalizmin e irredentizmin në popullsinë shqiptare", janë reaksionarë të ndihmuar nga jashtë" dhe se "duan të shkatërrojnë atë që e ka arritur populli shqiptar, vëllazërim-bashkimin e popujve jugosllavë, socializmin vetëqeverisës" etj. etj., prandaj si "armiq jo vetëm të regjimit por edhe të vetë popullit shqiptar duhet të luftohen nga vetë populli".

Është bërë tashmë zakon i tradhtarëve që në fushatat "demaskuese" kundër "nacionalistëve" shqiptarë, fjalimet e tyre plot sharje e shpifje për "armiqtë" e zakonisht edhe për Shqipërinë socialiste, t'i "ëmbëlsojnë" pastaj me fjalët më të bukura për sunduesit tanë shovinistë e revizionistë, për të "mirat që na vijnë nga Beogradi, për "atdheun tonë vetëqeverisës", Jugosllavinë revizioniste, për "aspiratat tona të reja e ato shekullore që i realizon në epokën e Titos" e plot xhevahire të tjera. (Na kujtohet Koçi Xoxeja i shkretë që nuk arriti të fuste nën sundimin e Titos edhe Shqipërinë Socialiste e të "realizonte" edhe atje "aspiratat shekullore të popullit, por populli i këputi me kohë kokën këtij agjenti të ndyrë titist).

Është krejt e kuptueshme pse armiqtë nuk na quajnë me emrin e vërtetë. Kështu kanë bërë edhe paraardhësit e tyre që t'u kishte efekt propaganda në popull. Është po ashtu e natyrshme që ata të zgjedhin emrat më të këqinj dhe më të urryer për ne, me qëllim njollosjeje të idealeve tona, qëllimeve tona të vërteta. Irredentizëm! Sa e preferuar është bërë kjo fjalëz në fjalorin e pushtuesve e tradhtarëve tanë. Zotëri nj! Shfletoni fjalorin dhe kërkoni këtë fjalëz absurde për realitetin tonë. Të paktën dy fakte të domosdoshme duhet t'i keni parasysh: nuk mund të quhet "irredentist" një popull i tërë që nuk don të jetojë në robëri dhe trojet e këtij populli nuk janë pjesë të vogla toke të shpërndara, por gjysma e Atdheut të tij që padrejtësisht u shkel nga këmba okupuese fashiste e mbretërisë revizioniste të Titos. Faktet historike nuk mbulohen dhe nuk zhduken dot me një fjalëz qesharake, me një propagandë të shfrenuar dhe as me dhunë fashiste sado e tërbuar të jetë ajo. Një popull, si ky i yni, që në shekuj kurrë nuk e ka pushuar luftën për liri, të drejta e demokraci, që rrugën e historisë së tij e ka çarë me shpatë në dorë, nuk mashtrohet e nuk përulet dot sado dinak e i egër të jetë armiku i tij. Tokat e më shumë se dy milionë shqiptarëve të robëruar nga Jugosllavia titiste, përbëjnë një tërësi të vetme dhe janë ndarë artificialisht nëpër republika jugosllave për t'i sunduar më lehtë ato dhe për t'i kënaqur interesat historike të shovinistëve grabitqarë të këtyre republikave. Kërkesa e popullit tonë të robëruar që të bashkohen trojet e tij në një njësi të vetme administrative është e drejtë dhe e ligjshme.

Ndjenjat e patriotizmit dhe të lirisë tek shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi është sot shumë e madhe. Kështu, po të shprehemi në fjalë të armikut, i gjithë populli është "i infektuar" nga "irredentizmi" dhe "nacionalizmi". Me këtë fakt shpjegohet intensifikimi i shqetësuar i luftës së pushtuesve e tradhtarëve kundër popullit tonë viteve të fundit. Por armiqtë tanë mundohen ta fshehin të vërtetën, gënjejnë. Njerëzit që arrestojnë, bastisin e persekutojnë ata në Kosovë, nuk janë disa, por me mijëra. Me dhjetëra mija dosje janë hapur nga organet titiste të dhunës për patriotë e revolucionarë shqiptarë në Kosovë. Gjatë fushatës së arrestimeve në masë, pas vizitës së fundit të Titos në Kosovë, p.sh. burgjet nuk i zinin të burgosurit politikë shqiptarë. Këtë e di populli ynë. Por, megjithë masat fashiste regresive, patriotët e revolucionarët nuk po zhduken, as nuk do të zhduken kurrë në Kosovë, sepse vetë populli ynë është patriot e revolucionar. Populli ynë i robëruar kurrë nuk i është frikësuar zinxhirëve titistë. Bijtë e Kosovës trime, që këto troje i trashëguan të lara me gjakun e baballarëve të tyre, kurrë nuk do t'i shesin as nuk do t'i falin ato.

Ne akuzohemi se "nxisim" "nacionalizmin" dhe "irredentizmin" në masat popullore shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Një "akuzë" të tillë tradhtarët i bëjnë, bile, kohë pas kohe edhe Shqipëria socialiste. Por, kush mund të jetë vallë nxitës më i fuqishëm i ndjenjës së lirisë e i urrejtjes së masave ndaj regjimit se sa vetë gjendja në të cilën i ka katandisur këto masa regjimi skllavërues, shtypës e shfrytëzues barbar e revizionist. Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi vërtetë është i prapambetur (sepse sundimi kolonial e ka lënë ashtu), por nuk është injorant, sa të mos kuptojë gjendjen e tij të mjeruar.

Realiteti i shkëlqyer socialist në RPS të Shqipërisë është frymëzues për miliona proletarë të shtypur në botën e kapitalit, për popujt e shtypur e të robëruar në të gjithë botën. Në Shqipëri ata shohin të vendosur diktaturën e proletariatit, shohin lirinë dhe socializmin e vërtetë. Nëse tradhtarët kështu e kuptojnë "nxitjen" e Shqipërisë, vërtetë ajo përbën një faktor shumë të fuqishëm frymëzues në luftën e popullit tonë të robëruar për liri e socializëm. Populli ynë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, po e sheh me sytë e tij realitetin në Shqipërinë socialiste. Punëtori ynë, fshatari, rinia, gruaja, inteligjencia jonë revolucionare, shohin në Shqipëri ëndrrat e tyre të materializuara, shohin lirinë e vërtetë të masave punonjëse, madhështinë e atdheut të tyre të dashur dhe krahasojnë jetën e lumtur plotë dritë të vëllezërve e motrave të tyre me jetën e vet skëterrë, plotë vuajtje e mjerim, pa dritë e dituri, në skamje e varfëri, kurbet e mjerim.

Ne jo vetëm nuk "nxisim" "nacionalizmin" e "irredentizmin" në masa, por edhe vetë luftën kundër regjimit, në forma e me mjete të ndryshme, populli e bën edhe pa nxitjen tonë. Ne shpallim hapur se do të ndihmojmë gjer në fitoren përfundimtare këtë luftë.

Në propagandën e tyre shpifëse e mashtruese tradhtarët poshtë e lart nëpër Kosovë, mundohen të bindin popullin se gjoja ne qenkemi "reaksionarë" të lidhur me forca reaksionare jashtë, të ndihmuar prej tyre dhe se dashkemi t'i shesim interesat e popullit tek të huajt. Kush i ka shitur interesat e popullit, Atdheut tek të huajt, ne apo ata? Reaksionarë, revizionistë dhe tradhtarë janë ata dhe jo ne.

Ne nuk kemi kërkuar dhe nuk do të kërkojmë kurrë ndihmën e reaksionit të jashtëm. Reaksion ka brenda me bollëk, por populli don liri dhe liria mund të fitohet vetëm nga vetë masat popullore. Popullin tonë kurrë nuk e ka çliruar askush; vetë ka luftuar, vetë është mbrojtur, vetë i ka mundur armiqtë. Edhe sot, ai ka forcë të mjaftueshme për t'u çliruar vetë nga armiku, ka bijat e bijtë e tij besnikë që janë të gatshëm të derdhin gjakun e tyre prej shqiptari në altarin e lirisë. Armiku le t'i quajë si të dëshirojë bijtë e popullit, luftëtarët e lirisë por ata nuk njollosen aq lehtë në sytë e popullit.

Populli ynë e ka zakon të shikojë punën dhe jo fjalën. Puna e tradhtarëve dhe revizionistëve në Kosovë është parë prej kohësh.

Se sa shumë efekt ka patur propaganda tradhtare kundër nesh në popull tregon më së miri organi ynë "Liria". Armiku do të dëshironte sigurisht që populli këtë organ ta hudhte tej, të mos e lexonte dhe t'ia dorëzonte atij. Por ç'ndodhi? Populli e mori "Lirinë", e lexoi e po e lexon dorë më dorë, po e ruan si sytë që të mos bie në dorë të armikut, e bile edhe e ka shumëzuar në kopje të reja. Nëse armiku ka arritur të shtie në dorë ndonjë kopje, kjo ka ardhur nga ndonjë frikacak i rrallë që rastësisht i ka rënë në dorë. Për se "Liria" u bë kaq e dashur për popullin që në numrin e saj të parë? Është e qartë: "Liria" nuk është organ i armiqve të popullit, i reaksionarëve etj., por i bijëve të vërtetë të popullit. Ajo ka dalur nga vetë populli, ashtu siç kanë dalë marksistë-leninistët, bijtë besnikë të tij. "Liria" shpreh aspiratat e popullit tonë të etur për liri, ajo është tribunë e vërtetë e popullit tonë të robëruar. Porosisin çdo patriot, çdo shqiptar të ndershëm, gjithë popullin, që ta lexojë e ta përhapë "Lirinë", që ky organ të bëhet pjesëtar i pandarë i çdo vatre shqiptare, rreze drite në këto netë të gjata robërie.

Akuzat e armiqve kundër nesh si "armiq të vëllazërim-bashkimit e të socializmit në Jugosllavi" janë krejt të pabaza sepse në të vërtetë këto asnjëra nuk ekzistojnë në Jugosllavi dhe s'ka se si të luftohen. Por, ne nuk jemi kundër popujve fqinjë jugosllavë, të cilët po ashtu janë të robëruar. Ne nuk duam asnjë pëllëmbë toke të tyre, jashtë tonës dhe dëshirojmë të jetojmë në miqësi e fqinjësi të mirë me ta, por secili në shtëpi të vet. Populli serb, malazez e maqedonas duhet të luftojnë kundër shovinistëve të tyre bashkë me ne, sepse ata i sundojnë edhe vetë këta popuj dhe janë armiq të tyre. Ne dëshirojmë që popujt e Jugosllavisë të çlirohen e të jetojnë të lirë. Shqiptari e ka treguar në vepra këtë dëshirë të sinqertë, ai ka derdhur gjak për lirinë e popujve të Jugosllavisë. Revolucioni popullor në Jugosllavinë revizioniste është i pashmangshëm dhe popujt jugosllavë me siguri do ta kryejnë me sukses atë.

I ndodhur në një robëri të egër, në një shfrytëzim kolonial e kapitalist, i shtypur me dhunë fashiste, populli ynë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, po e kupton gjithnjë e më mirë se të drejtat e tij me dhunë janë rrëmbyer dhe se vetëm me dhunë mund të fitohen se nevoja e luftës kundër regjimit gjakatar revizionist është e domosdoshme për të shporrur pushtuesit, për të hequr qafe një herë e përgjithmonë robërinë, skamjen, varfërinë, kurbetin e ri e padituriné dhe për të jetuar të lirë dhe sovran në atdheun e tij të shtrenjtë.. Si pasojë e gjendjes së padëshirueshme të masave, në gjithë popullin po zien sot më shumë se kurrë zjarri i urrejtjes e revoltës kundër revizionistëve shtypës e tradhtarëve të shitur. Propaganda e shfrenuar demagogjike, arrestimet në masë, torturat e mjetet e tjera të represionit fashist të armikut nuk po e ulin por përkundrazi po e shtojnë akoma më shumë këtë urrejtje. Lufta e popullit tonë për të drejta e liri po ngjitej përpjetë hap pas hapi. Nuk ka asnjë forcë që ta ndalë këtë luftë.

Në këtë gjendje, thirrjet e shqetësuara të armikut drejtuar popullit për të luftuar kundër patriotëve e revolucionarëve, kundër vetë bijve të tij, të bëjnë vërtetë për të qeshur. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 1-2)

2-2. TË BURGOSURIT KOSOVARË TË KTHEHEN NË KOSOVË!

Nga Hydajet Hyseni

Me mijëra po kalben sot nëpër qelitë e burgjeve të shumtë anë e kënd Jugosllavisë. Organet e pushtetit tradhtar në Kosovë dhe gjykatat që i kanë dënuar ata me faj, me fakte

e pa fakte, jo vetëm që nuk çajnë fare kokën për ta, por "kujdesen" që të dënojnë sa më shumë kosovarë të tjerë dhe t'ua japin për t'i "riedukuar" shtëpive ndëshkimore fashiste të republikave jugosllave. Lihen kështu me mijëra kosovarë në "mëshirën" e shovinistëve, rankoviçistëve, çetnikëve e ustashëve nga më të tërbuarit të Jugosllavisë.

Të burgosurit e republikave të Jugosllavisë dhe ata të Krahinës së Vojvodinës nuk dërgohen kështu nëpër burgjet e republikave të tjera, por e mbajnë burgun në republikën a krahinën e vet. Vetëm krerët tradhtarë të Kosovës janë kaq "bujar" e "zemërgjerë" sa t'ua dërgojnë xhelatëve të burgjeve jugosllave me mijëra shqiptarë që t'ua thithin, siç dinë ata, edhe pikën e fundit të djersës e gjakut.

Me mijëra të burgosur kosovarë po derdhin djersën nëpër punishtet e shumta të burgjeve jugosllave.

Përse ky lum i madh djerse të derdhet në republikat jugosllave e jo në Kosovën tonë të varfër?

Regjimi fashist në Jugosllavi dhe orgenet e "kapedomëve" famëkeq ua kanë bërë të rëndë jetën të gjithë të burgosurve, por jeta e të burgosurve shqiptarë, dhe sidomos atyre politikë, jo vetëm është e padurueshme por është edhe krejt e pasigurtë. Mbi ta ushtrohen masa të tilla çnjerëzore, çfarë nuk kanë ushtruar as nazistët hitlerianë ndaj të burgosurve dhe robërve të luftës. Nuk janë të pakta rastet kur policia jugosllave ka bërë masakra të vërteta mbi të burgosurit shqiptarë që kanë mbetur të plagosur, të gjymtuar a të vrarë mizorisht në këto kasaphana kriminale.

Përse të lihen me mijëra shqiptarë në duartë e përgjakura të kriminelëve e xhelatëve gjakpirës të Jugosllavisë që të shfryjnë sa të duan dhe si të duan ata mbi trupat e lidhur të bijve e vëllezërve tanë?

Janë vetë revizionistët dhe organet e burgjeve ata që nxisin, përgatisin e organizojnë përleshje të përgjakshme në mes të burgosurve shqiptarë dhe atyre jugosllavë. Këto i bëjnë ata më qëllim që të "arsyetojnë" masakrat masive që bëjnë pastaj mbi të burgosurit shqiptarë dhe, njëkohësisht t'i armiqësojnë, në këtë mënyrë, të burgosurit dhe nëpërmjet tyre edhe popujt jugosllavë me të burgosurit dhe gjithë popullin shqiptar. Duke i paraqitur të burgosurit shqiptarë si shkaktarë të turbullirave e përleshjeve nëpër burgje, ata mundohen t'i bindin popujt jugosllavë se jemi ne shqiptarët, "fajtorë" edhe për mosstabilitetin, pasigurinë dhe të këqijat tjera që e mundojnë sot Jugosllavinë revizioniste.

Nëse të burgosurit shqiptarë qenkan shkaktarë të përleshjeve të përgjakshme të Nishit, Idrizovës, Titogradit, Pozharevcit etj., atëherë përse nuk sillen ata në Kosovë, por lihen atje, që të "shkaktojnë" gjakderdhje të tjera?

Duke qenë kështu të shkapërderdhur nëpër skajet e largëta të Jugosllavisë, të burgosurve kosovarë dhe familjeve të tyre u bëhet edhe një dënim tjetër i rëndë. Për t'i shkuar njeriut të tyre në vizitë, familjeve të shumta të burgosurve kosovarë u duhet të kalojnë qindra kilometra rrugë e të harxhojnë shuma të mëdha parash. E ku t'i marrin paratë familjet tona, në këtë gjendje të rëndë që kanë krijuar revizionistët? Nuk janë të pakta familjet, të cilat në mungesë të parave, megjithë mallin e madh që kanë, detyrohen t'i vizitojnë shumë rrallë ose fare njerëzit e tyre të dashur. Nëna e baballarë vdesin pa i parë edhe njëherë djemtë e tyre të burgosur...

Përse ky dënim i dyfishtë për të burgosurit kosovarë dhe familjet e tyre?

Nën pretekstin se burgjet jugosllave nuk kanë përkthyes (që t'i cenzurojnë bisedat) të burgosurve shqiptarë dhe familjeve të tyre u kërkohet që edhe në ato takime të shkurta e të rralla që u lejohen, të flasin jo në gjuhën shqipe, në gjuhën e nënës, por në gjuhën serbokroate, "në gjuhën që e kupton edhe zoti..." Ç'dënim tjetër i rëndë! Të detyrohet shqiptari të flasë në gjuhë të huaj me prindërit e tij, me vëllezërit e motrat e tij, me gruan e fëmijët e tij! Të flasin në gjuhë të huaj edhe ata që po kalben burgjeve pikërisht që ne

të flasim gjuhën tonë të ëmbël; të flasin në gjuhë të huaj edhe ata që nuk dinë asnjë gjuhë të huaj...! Sa e sa familjeve u ka ndeshur të kthehen prapa pa këmbyer asnjë fjalë me djemtë e tyre!

Përse të mbahen të burgosurit shqiptarë nëpër burgjet jugosllave ku "nuk ka" (dhe nuk po mundkan të sigurohen!) përkthyes? Përse njerëzit tanë të detyrohen të flasin në mes veti në gjuhë të huaj?

Përse të burgosurit kosovarë nuk kthehen në Kosovë? Këtë pyetje e bëjnë sot, me të drejtë, të gjithë të burgosurit kosovarë, e bëjnë familjet e tyre, e bën gjithë populli ynë.

"Arsyeja" që sjellin tradhtarët se në Kosovë nuk paska mjaft burgje është sa pa bazë aq edhe e poshtër. Kosova ka pak shkolla, pak spitale, pak shtëpi kulture, pak biblioteka, muzeume e çerdhe fëmijësh, se sa për burgje e stacione policie nuk ia kalon kush. Burg sot është e gjithë Kosova.

Të burgosurit kosovarë kanë kërkuar kaherë dhe kërkojnë edhe sot që të kthehen në Kosovë. Për këtë kërkesë ata kanë luftuar dhe po luftojnë edhe tani, kanë derdhur dhe po derdhin edhe gjak. Kërkesa e tyre për të mbajtur burgun në vendin e tyre, për të derdhur djersën në tokën e tyre... është e drejtë dhe gjen përkrahjen e të gjithëve. Kërkesa e tyre është edhe kërkesë e të gjithë popullit. Luftës heroike të bijve, vëllezërve e shokëve tanë që po treten nëpër burgjet e errëta jugosllave duhet t'i bashkohet çdo kosovar i ndershëm, duke kërkuar me këmbëngulje që

TË BURGOSURIT KOSOVARË

TË KTHEHEN NË KOSOVË! (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 3)

Shoku Enver Hoxha për Kosovën

2-3. "...PLAGË E HAPËT QË KËRKON SHËRIM"

PJESË NGA LIBRI "ME STALININ" KUJTIME

Si shpjegova gjendjen e nderë të marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, veprimtarinë armiqësore të tradhtarëve jugosllavë, organizimin prej tyre të bandave kriminale dhe futjen e këtyre banda ve në tokën shqiptare për veprimtari diversioniste e sabotuese kundër vendit tonë, i fola shokut Stalin për politikën e terr or it të egër që ndjek klika e Titos ndej shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi.

- Jetojnë shumë shqiptarë në Jugosllavi? – më pyeti Stalini. - Çfarë besimi fetar kanë?

– Më tepër se një milion shqiptarë – i thashë. (Vishinski në këtë çast shprehu habinë e tij për këtë numër kaq të madh, që, me sa duket, nuk e kishte dëgjuar më parë), dhe vazhdova: – Thuajse të gjithë janë të fesë myslimane.

– Si nuk janë asimiluar nga sllavët dhe ç'lidhje mbajnë shqiptarët me banim në Jugosllavi me ata në Shqipëri? -- pyeti përsëri Stalini.

– Shqiptarët që banojnë në Jugosllavi – i thashë shokut Stalin në përgjigje të pyetjes së tij - në të gjitha kohërat janë shquar për patriotizmin e zjarrtë dhe lidhjet e fuqishme me atdheun dhe me bashkatdhetarët e tyre. Ata kurdoherë u janë kundërvënë me forcë përpjekjeve të ethshme ekspansioniste e asimiluese të reaksionarëve serbomëdhenj e sllavomëdhenj dhe kanë ruajtur me fanatizëm identitetin e tyre shqiptar në çdo pikëpamje.

Aktualisht, klika e Titos ndjek në Kosovë dhe në viset me popullsi shqiptare në Mal të Zi e Maqedoni të njëjtën vijë, dhe të njëjtat metoda që kanë përdorur të ngjashmit e tyre, car Aleksandri e të tjerët në kohën e kaluar. Për klikën e Beogradit, Kosova është një pikë shumë e dobët, prandaj ajo ushtron në Kosovë një terror të madh, largime në

masë, arrestime dhe punë të detyruar, rekrutime në ushtri me forcë si dhe shpronësime të një numri të madh njerëzish. Elementi shqiptar goditet posaçërisht në Jugosllavinë titiste, sepse udhëheqësit e tanishëm jugosllavë i njohin mirë tiparet patriotike e revolucionare të popullsisë shqiptare të atjeshme, e dinë mirë se për këtë popullsi problemi nacional gjithmonë ka qenë dhe mbetet një plagë e hapët që kërkon shërim. Përveç kësaj, Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi janë bërë prej titistëve qendra të rëndësishme grumbullimi të kuislingëve shqiptarë, të banditëve, të spiunëve që, të instruktuar nga njerëzit e UDB-së, përgatitin kundër vendit tonë akte terroriste, diversioniste, sabotuese dhe sulme të armatosura. Klika e Beogradit ka vënë në lëvizje agjentë të vjetër serbë, anglezë dhe amerikanë si dhe agjentë italianë dhe gjermanë, për të mobilizuar reaksionin shqiptar të Kosovës dhe për të organizuar me këtë reaksion detashmente, të cilat, së bashku me banditët e tjerë shqiptarë, të hyjnë në territorin tonë dhe të shkaktojnë turbullira. ...

Në vazhdim të bisedës me shokun Stalin folëm për gjendjen e rëndë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë pas tradhtisë së Titos, për politikën antimarksiste, nacionaliste e shoviniste që ndiqte klika titiste kundër Shqipërisë e vendeve të tjera të demokracisë popullore. Në mënyrë të veçantë unë fola për gjendjen e popullsisë shqiptare në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë.

– Vija e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj Kosovës dhe viseve të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, i thashë shokut Stalin, që nga fillimi i Luftës Antifashiste e gjer në Çlirim dhe akoma më tepër pas Çlirimit, ka qenë dhe është në pozita shoviniste e nacionaliste. Partia Komuniste e Jugosllavisë, nëse do të qe në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, duhej t'i kishte kushtuar rëndësi të veçantë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare çështjes së popullsisë shqiptare në Jugosllavi, pse ishte një minoritet i madh në numër dhe ngjitur me kufirin shqiptar. Pikëpamja jonë në vitet e para të luftës ishte se çështja e së ardhmes së Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi nuk duhej ngritur gjatë luftës, por shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare duhej të luftonin kundër fashizmit në kuadrin e Jugosllavisë dhe mbas luftës ky problem do të zgjidhej nga të dyja partitë motra, nga regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, nga vetë popullsia shqiptare e atjeshme.

Çështja kryesore ishte që shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera të Jugosllavisë të ishin të sigurt e të bindeshin se, duke luftuar fashizmin krah për krah me popujt e Jugosllavisë, pas fitores do të ishin të lirë e do t'u krijoheshin mundësitë të vetëvendosnin për të ardhmen e tyre, pra të vendosnin vetë nëse do të bashkoheshin me Shqipërinë apo do të qëndronin në kuadrin e Jugosllavisë si një entitet me status të veçantë.

Një politikë e drejtë dhe parimore në këtë drejtim do të bënte që popullsia e Kosovës dhe e viseve të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, pavarësisht nga reaksioni i egër dhe propaganda demagogjike fashiste, të mobilizohej me të gjitha forcat ne luftën e madhe antifashiste. Qysh në fillim të luftës ne ua shfaqëm udhëheqësve jugosllavë mendimin tonë se ata duhet ta mobilizonin popullsinë shqiptare në frymë patriotike, të lejonin që krahas flamurit jugosllav të mbanin edhe flamurin shqiptar, të mendonin për pjesëmarrjen në numër më të madh të elementit shqiptar në pushtetin e ri që do të krijohej në luftë e sipër, të përkrahej e të zhvillohej te shqiptarët si ndjenja e madhe e dashurisë për Shqipërinë, atdheun e tyre, ashtu edhe ndjenja e vëllazërimit me luftën e drejtë të popujve të Jugosllavisë, të krijohej dhe të forcohej bashkëpunimi shumë i ngushtë i çetave shqiptare të Kosovës me Luftën Nacionalçlirimtare të vendit tonë, duke qenë këto çeta të Kosovës e të viseve të tjera të lidhura e të drejtuara nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë etj. Por, siç tregoi realiteti, vazhdova t'i parashtroj mendimin tim shokut Stalin, udhëheqjes jugosllave nuk i

leverdisnin këto kërkesa të drejta e të domosdoshme, ndaj ajo jo vetëm ishte e errët në deklaratat e saj me karakter parimor, por Titoja, edhe ne edhe ata shokë jugosllavë që i konsideronin të drejta këto kërkesa, na akuzoi për «devijim nacionalist».

Politika shoviniste e nacionaliste nga ana e udhëheqjes jugosllave në Kosovë e në viset e banuara nga shqiptarët u intensifikua më tepër pas luftës, pavarësisht nga demagogjia dhe disa masa gjysmake, siç qe hapja e ndonjë shkolle shqipe, që ndërmori në fillim klika Tito-Rankoviç.

Sidoqoftë në vitet e para pas luftës ne akoma e quanim Partinë Komuniste të Jugosllavisë një parti motër dhe shpresonim se çështja e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare do të gjente zgjidhjen e drejtë sapo të krijohej momenti i përshtatshëm.

Ky moment menduam se u krijua në kohën e nënshkrimit të traktatit (*Është fjala për Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, që nënshkrua në korrik të vitit 1946)* me Jugosllavinë dhe në atë kohë unë ia shtrova Titos këtë problem. Titoja më pyeti se ç'mendoja unë për Kosovën. «Kosova e viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, i thashë unë, janë toka shqiptare që fuqitë e mëdha padrejtësisht ia shkëputën Shqipërisë; ato i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë. Tani që ne jemi dy vende socialiste janë kushtet që ky problem të zgjidhet drejt». Titoja më tha: «Jam dakord, ne e dëshirojmë këtë, por tash për tash nuk mund të bëjmë gjë, sepse nuk e kuptojnë dot serbët një gjë të tillë». «Në rast se nuk e kuptojnë sot, i thashë unë, duhet ta kuptojnë nesër».

Në këtë moment shoku Stalin më pyeti se kur i kam njohur unë Titon dhe udhëheqësit e tjerë jugosllavë. Pasi i thashë se i kam njohur pas luftës, në vizitën e parë që bëra në Beograd në vitin 1946, vazhdova:

– Problemi i Kosovës dhe i popullsisë shqiptare me banim në vise të tjera të Jugosllavisë, e ardhmja e tij mbetet një çështje për të cilën i takon të vendosë vetë populli i Kosovës dhe i viseve të tjera. Por ne, nga ana jonë, pa ndërhyrë kurrsesi në punët e brendshme të Jugosllavisë, asnjëherë s'do të pushojmë së përkrahuri të drejtat e vëllezërve tanë të një gjaku me banim në Jugosllavi, ne do të ngremë zërin kundër terrorit dhe politikës së shfarosjes që ndjek ndaj tyre klika e Tito-Rankoviçit. Në fund i thashë shokut Stalin, se rreth këtij problemi u kemi drejtuar juve një letër.

– Letrën tuaj e kam lexuar - m'u përgjigj shoku Stalin. - Jam i një mendimi me ju, se çështjen e së ardhmes së tij e vendos e do ta vendosë vetë populli i Kosovës.

Titoja, përveç politikës antimarksiste që ka ndjekur ndaj Kosovës, vazhdoi shoku Stalin, ka dashur të aneksojë edhe vetë Shqipërinë. Kjo u duk haptazi kur Titoja u orvat të dërgonte divizionet e tij në Shqipëri. Ne e ndaluam një veprim të tillë. Ne dhe ju e dimë se njësitë e ushtrisë jugosllave do të dërgoheshin në Shqipëri në ndihmë të Koçi Xoxes që ky, nëpërmjet forcave jugosllave, të likuidonte Shqipërinë e lirë dhe Qeverinë Shqiptare.

– Titoja, i thashë unë, përfitoi riga fakti që Greqia në atë periudhë, në çdo rast, bënte provokacione në kufijtë tanë dhe kurdisi intrigën se gjoja ne do të sulmoheshim «në shkallë të gjerë nga Greqia» se «sulmi është i afërt» dhe «përbën rrezik për Shqipërinë» etj. Pas kësaj Titoja, në bashkëpunim edhe me tradhtarët Koçi Xoxe e të tjerë, me të cilët qe lidhur tinëz, na propozoi që të dërgonte forcat e veta ushtarake në Shqipëri, pikërisht në Korçë e pastaj edhe në Gjirokastër për «të na mbrojtur riga sulmi grek». Ne e kundërshtuam me forcë këtë propozim dhe menjëherë ju vumë në dijeni edhe ju. Ishim të bindur se, nën maskën e divizioneve të ndihmës, ai synonte të pushtonte Shqipërinë dhe kjo ishte edhe përgiigjja që na erdhi nga ju në lidhje me njoftimin tonë.

Stalini me një nënqeshje, ku dukej edhe zemërimi edhe ironia e thellë, tha:

– Dhe tani Titoja na akuzon ne, sovjetikëve, se gjoja ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë, se gjoja paskemi dashur të sulmojmë Jugosllavinë! Jo, ne kurrë as kemi dashur e as mund të na shkojë ndër mend një gjë e tillë, sepse ne jemi marksistë-leninistë, jemi një vend socialist, dhe s'mund të veprojmë ashtu si mendon e vepron Titoja.

Unë, mendoj – vazhdoi shoku Stalin – që edhe në të ardhmen ne, si marksistë-leninistë, t'i godasim veprimet dhe pikëpamjet antimarksiste të Titos e të udhëheqjes jugosllave, por e theksoj, në asnjë mënyrë s'duhet të ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme. Kjo s'do të ishte marksiste. Këtë çështje ta shikojnë komunistët jugosllavë dhe populli jugosllav; atyre u takon të zgjidhin problemet e të sotmes dhe të së ardhmes së vendit të tyre. Në këtë kuadër e shoh unë edhe problemin e Kosovës e të popullsisë tjetër shqiptare me banim në Jugosllavi. Ne s'duhet të lëmë asnjë shteg që armiku titist të na akuzojë pastaj se gjoja luftën tonë e bëjmë për prishjen e Federatës Jugosllave. Ky moment është delikat dhe do trajtuar me shumë kujdes, pse Titoja, duke thënë: «Ja, kërkojnë të na copëtojnë Jugosllavinë», jo vetëm grumbullon reaksionin, por përpiqet të tërheqë në anën e tij edhe elementët patriotë. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 4-5)

Me rastin e 80 vjetorit të lindjes

2-4. ÇËSHTJA PËR TË CILËN LUFTOI ALI KELMENDI DO TË TRIUMFOJË EDHE NË KOSOVË

Nga Kadri Zeka

Para do kohe, populli shqiptar përkujtoi me respekt të madh, me rastin e 80 vjetorit të lindjes, birin e lavdishëm të Kosovës dhe gjithë Shqipërisë, anëtarin e Kominternit, shokun e Dimitrovit e Telmanit, militantin e shquar komunist, Ali Kelmendin.

Qysh në fëmijëri Ali Kelmendi ndjeu thellë peshën e rëndë të robërisë dhe në moshë fare të re ai iu bashkua luftës për liri. Nën udhëheqjen e tribunit të vegjëlisë, Bajram Currit, ai luftoi me trimëri kundër armiqve të Kosovës dhe gjithë Shqipërisë. Lufta kundër pushtuesve të huaj ishte një shkollë e madhe për edukimin patriotik e revolucionar të Ali Kelmendit.

I ndjekur nga shovinistët jugosllavë, Aliu detyrohet të kalojë në Shqipëri, ku së bashku me të rinjtë përparimtarë të asaj kohe, zhvilloi një veprimtari të gjerë kundër regjimit feudoborgjez dhe shquhet si luftëtar i vendosur dhe organizator i talentuar në luftën për fitoren e forcave demokratike në Shqipëri. Ai mori pjesë me armë në dorë në Revolucionin Demokratik të Qershorit që përmbysi regjimin e urryer të satrapit Ahmet Zogu.

Kur reaksioni shqiptar, me ndihmën e krajlit të Jugosllavisë dhe reaksionit ndërkombëtar, përmbysi qeverinë demokratike dhe vendosi përsëri regjimin anadollak zogollian, Ali Kelmendi ishte nga të parët që e kuptoi të vërtetën e madhe se liria e demokracia e vërtetë mund të fitohen vetëm kur vetë populli merr fatet e tij në duartë e veta dhe vetëm kur lufta e tij udhëhiqet nga një udhëheqje e sigurtë dhe besnike, që mund të jetë vetëm një parti e vërtetë komuniste. Për këtë qëllim të madh punoi dhe luftoi Ali Kelmendi, gjatë gjithë jetës së tij.

Veprimtarinë revolucionare Ali Kelmendi nuk e pushoi as jashtë Atdheut, ku u detyrua të emigrojë, i ndjekur nga reaksioni zogollian. Atje ai u edukua dhe u kalit si militant komunist, bëri në punë të madhe për sqarimin dhe bashkimin e emigrantëve shqiptar. Në mars të vitit 1924, ai pranohet anëtar i Grupit Komunist shqiptar, të themeluar në Bashkimin Sovjetik.

Një vit më vonë Ali Kelmendi kthehet në Shqipëri dhe menjëherë i përvishet punës për përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit dhe organizimin e lëvizjes punëtore e komuniste. Në Shqipërinë e atëhershme, Aliu gjeti terren të favorshëm për një punë të tillë, që i detyrohej, siç shkruante ai, "karakterit të gjallë dhe të papajtueshëm të luftës së popullit shqiptar kundër regjimit nga njëra anë dhe nga ana tjetër, tradhtisë, pavendosmërisë dhe pasivitetit të politikanëve të drejtimeve tjera". Si detyrë të parë Aliu i shtroi vetes formimin e një grupi komunist me një qendër të vetme, e cila do ta drejtonte gjithë lëvizjen komuniste në Shqipëri dhe do ta përgatiste terrenin për formimin e Partisë Komuniste, pa të cilën nuk mund të bëhej fjalë as për liri e pavarësi të vërtetë dhe as për demokraci e socializëm.

Grupi Komunist i Korçës që vepronte në atë kohë kishte të meta serioze në punën e tij, kurse, nga ana tjetër, elementët antimarksistë që kishin infiltruar brenda grupit e dëmtonin shumë veprimtarinë e tij. Ali Kelmendi mori kontakt me komunistët e këtij grupi dhe e ndihmoi atë të dilte nga gjendja në të cilën ndodhej. Udhëzimet e tij për shtrirjen e veprimtarisë ndër masat popullore në të gjithë Shqipërinë dhe sidomos ndër punëtorët, për kombinimin e punës legale me atë ilegale, për punët në radhët e shoqërive legale të punëtorëve e zejtarëve, për sigurimin e literaturës marksiste-leniniste, studimin dhe përvetësimin e saj nga komunistët dhe punëtorët, për hedhjen në aksionet konkrete revolucionare etj. i hapën Grupit Komunist të Korçës perspektiva të reja e të qarta. Komunistët e Grupit të Korçës dhe të grupeve të tjera komuniste që u ngritën me iniciativën e tij, u lidhën më mirë me masat dhe formuan shoqëri të ndryshme të punëtorëve dhe zejtarëve, organizuan një varg grevash e demonstratash anë e kënd Shqipërisë dhe morën pjesë aktive në Kryengritjen antizogiste të Fierit. Këto aksione Ali Kelmendi i vlerësonte si "pagëzimi i parë i zjarrit dhe guri i provës" për komunistët shqiptarë.

Ali Kelmendi bëri një punë të madhe për njohjen nga komunistët shqiptarë të direktivave të Kominternit dhe zbatimin e tyre në mënyrë krijuese dhe në përshtatje me kushtet konkrete në Shqipëri. Ai propagandoi gjerësisht direktivën e Kominternit për krijimin e Frontit popullor antifashist, të cilin front ai e kuptonte si bashkim luftarak të masave popullore, të të gjithë patriotëve, demokratëve e antifashistëve të vërtetë, nën udhëheqjen e një pararoje të vërtetë komuniste.

Ali Kelmendi ishte patriot i flaktë, por ai ishte edhe një internacionalist i vërtetë dhe konsekuent. Ai njihej dhe bashkëpunonte me komunistë nga vendet e ndryshme të Evropës e Ballkanit dhe ishte shok i ngushtë i udhëheqësve të mëdhenj proletarë, Gergj Dimitrovit dhe Ernest Telmanit. Shpirtin e tij të madh internacionalist, ai e dëshmoi edhe me punën e madhe që bëri për organizimin e dërgimit të komunistëve e antifashistëve shqiptarë në ndihmë të popullit spanjoll, ku ishte i gatshëm të shkonte edhe vetë, me gjithë se ishte i sëmurë rëndë.

Puna e madhe që bënte Ali Kelmendi dhe cilësitë e rralla prej komunisti të vërtetë bënë që ai të fitonte dashurinë dhe respektin e të gjithë komunistëve të vërtetë shqiptarë dhe urrejtjen e renegatëve e trockistëve si Niko Xoxe, Zai Fundo etj. Ndaj armiqve, tradhtarëve dhe deviatorëve të ndryshëm ai nuk kishte mëshirë dhe i luftonte e demaskonte me ashpërsinë më të madhe. Në luftën konsekuente që bëri kundër elementëve deviacionistë dhe pikëpamjeve të tyre antimarksiste, Ali Kelmendi ndihmoi komunistët e vërtetë shqiptarë të gjenin rrugën e drejtë për realizimin e qëllimeve të tyre. Para largimit nga Shqipëria ai takohet edhe me shokun Enver Hoxha, tek i cili ai pa që në fillim një marksist-leninist të aftë, të pjekur e të vendosur.

Duke parë se ndjekjet, kërcënimet, burgosjet e internimet nuk mund ta ndalnin aktivitetin revolucionar të Ali Kelmendit, qeveria zogiste e dëboi atë nga Shqipëria. Vuajtjet dhe mundimet e shumta e lodhën aq shumë Aliun, sa që u sëmurë rëndë nga tuberkulozi. Por, aktivitetin e tij revolucionar ai nuk e pushoi për asnjë çast, deri sa mbylli sytë përgjithmonë, në moshën më të mirë, më 11 shkurt 1939.

Emri i Ali Kelmendit ishte i njohur jo vetëm për komunistët shqiptarë, por edhe për komunistët e vendeve tjera. I madh ishte Aliu ynë e madhështor u bë edhe varrimi i tij. Pos emigrantëve të shumtë shqiptarë, në të morën pjesë dhe vunë kurora mbi arkivolin e tij edhe përfaqësues të Kominternit, të proletariatit francez, italian, jugosllav, grek, bullgar, rumun, polakë etj. që ishte shprehje e dashurisë dhe respektit të tyre për Ali Kelmendin, "udhëheqësin e komunistëve shqiptar".

Ali Kelmendi vdiq, por çështja për të cilën luftoi ai ishte e pavdekshme. Komunistët shqiptarë, shokët dhe nxënësit e Ali Kelmendit nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha, themeluan më 8 Nëntor 1941 Partinë Komuniste Shqiptare dhe realizuan kështu ëndrrën e madhe të Ali Kelmendit për t'i siguruar popullit shqiptar një udhëheqje të sigurtë. I bashkuar si një trup rreth Partisë, populli shqiptar u ngrit në Luftën antifashiste nacionalçlirimtare, dëboi pushtuesit nazi-fashistë, përmbysi pushtetin e klasave shfrytëzuese dhe vendosi pushtetin popullor, diktaturën e proletariatit. Shqipëria, të cilës Ali Kelmendi ia kushtoi gjithë jetën, nën udhëheqjen e Partisë dhe shokut Enver, është bërë sot një kopsht i lulëzuar, Kështjellë e pamposhtur e socializmit, Atdhe për të gjithë komunistët e vërtetë të botës. Shqipëria Socialiste është bërë ashtu siç e ëndërronte biri i saj i madh, Ali Kelmendi.

Partia e punës e ka vlerësuar lart veprën revolucionare të Heroit të Popullit, Ali Kelmendi, njërit nga flamurtarët e parë të ideve të komunizmit në Shqipëri. Duke çmuar rolin e tij të madh, shoku Enver Hoxha ka thënë: "Shoku ynë i shquar, Ali Kelmendi, vazhdimisht i persekutuar, i torturuar, i burgosur, i internuar nga regjimi i Zogut, ka dhënë një kontribut të madh për lëvizjen komuniste; ai e orientoi në një vijë të drejtë grupin e Korçës dhe gjithë komunistët, me të cilët merrte kontakt, i mësonte dhe i edukonte. Ai ndihmoi për organizimin e shëndoshë të punës në lëvizjen punëtore."

Çështja për të cilën Ali Kelmendi shkriu të gjitha energjitë e tij, triumfoi në RPS të Shqipërisë por jo edhe në Kosovën e tij të dashur. Tradhtia e poshtër e revizionistëve titistë dhe disa sahanlëpirësve shqiptarë bëri që populli martir i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, megjithë gjakun që derdhi si lumë të mbetej përsëri në robëri, në shtypje e shfrytëzim të egër, në errësirë, skamje e mjerim.

Armiqtë dhe tradhtarët janë munduar ta bëjnë popullin tonë të robëruar që ta harrojë birin e tij të shtrenjtë dhe çështjen e madhe për të cilën punoi dhe luftoi ai. Por këtij qëllimi të poshtër ata nuk do t'ia arrijnë kurrë. Emri dhe vepra e Ali Kelmendit janë të gjallë dhe të shtrenjtë në zemrat e gjithë klasës punëtore, patriotëve e komunistëve të Kosovës, janë burim i madh frymëzimi në luftën e madhe të popullit tonë për liri e socializëm. Populli heroik i Kosovës, i prirë nga bijtë e tij marksistë-leninistë, vazhduesit e vërtetë të rrugës së Ali Kelmendit, do të ngritet përsëri dhe me gjakun e tij do ta bëjë Kosovën të lirë dhe socialiste, ashtu siç e dëshironte edhe biri i saj dhe i gjithë Shqipërisë, Ali Kelmendi. Çështje për të cilën punoi dhe luftoi Ali Kelmendi do të trumfojë patjetër edhe në Kosovë. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 6-7)

2-5. JEMI SHQIPTARË E ASGJË TJETËR

Nga Hydajet Hyseni

"Çonju shqyptarë prej gjumit çonju
T'gjithë si vllazën n'i besë shtrëngonju
E mos shiqoni kisha e xhamia
Feja e shqyptarit asht shqyptaria"

Siç është njoftuar edhe zyrtarisht, gjatë gjysmës së parë të muajit prill, në Jugosllavi do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë (i pesti me radhë pas luftës) Këto regjistrime, regjimi titist i ka bërë gjithmonë për hesape të vetat dhe me qëllime të caktuara politike. Pos, tjerash, revizionistët jugosllavë i kanë shfrytëzuar ato edhe për qëllime të poshtra antikombëtare. Me anë të mashtrimeve, presioneve, spekulimeve e falsifikimeve të ndryshme ata kanë bërë që gjatë çdo regjistrimi shumë shqiptarë të mos "regjistrohen" fare ose të regjistrohen jo shqiptarë, por "turq", "muslimanë", "serb", "maqedonas" e "malazez". Në këtë mënyrë numri i shqiptarëve në Jugosllavi, sipas statistikave, ishte gjithmonë shumë më i vogël se numri i tyre i vërtetë.

SHQIPTARËT NUK JANË JUGOSLLAVË

Qëllime të tilla padyshim që fshihen edhe pas regjistrimit të prillit. Jo rastësisht, në shtypin jugosllav, ka kohë që është shtruar çështja e deklarimit të pjesëtarëve të kombeve të ndryshme si " jugosllavë". Propaganduesit dhe përkrahësit e një deklarimi të tillë mundohen ta arsyetojnë atë me "përzierjen e popullsisë në Jugosllavi", me "ndjenjën e patriotizmit jugosllav", me "rëndësinë që do të kishte një deklarim i tillë për forcimin e vëllazërim-bashkimit" etj., etj., por, në të vërtetë, pas idesë për t'u deklaruar "jugosllav" fshihen qëllime të rrezikshme shoviniste e reaksionare.

Shovinistët serbomëdhenj gjithmonë janë përpjekur për një Jugosllavi unitariste, ku nuk do të kishte kombe e kombësi të ndryshme, por të gjithë do të ishin e do të quheshin "jugosllavë" ; e dihet pastaj se e kujt do të ishte një Jugosllavi e tillë. Qëllime të tilla shoviniste ka edhe kërkesa që në regjistrimin e popullsisë njerëzit në vend të përkatësisë së tyre kombëtare të shënojnë "jugosllavë".

Në pamje të parë duket (dhe revizionistët lënë të kuptohet kështu) sikur kjo çështje është shtruar pa ndonjë qëllim të keq dhe jo nga ndonjë organ a personalitet shtetëror, por si mendime dhe dëshira spontane të lexuesve e individëve të ndryshëm nga radhët e masave. Por, në fakt, po ta shikosh thellë këtë çështje del çartë se ajo jo vetëm është organizuar, por edhe burimi i këtij helmi gjindet në qarqet reaksionare të udhëheqjes së lartë të Jugosllavisë revizioniste. Vetë kryeministri Tito, në intervistën e tij të fundit me rastin e Ditës së Republikës dhënë gazetës "Mlladost", theksonte se i kishte pëlqyer shumë, kur "qysh para dhjetë vitesh" kishte lexuar "se të rinjtë në numër të madh deklarohen për Jugosllavinë" ("za Jugosllovenstvo")… ne të gjithë, në të njëjtën kohë, shtonte ai, jemi jugosllavë"? Ndërsa shtypi jugosllav, duke u mbështetur në këto "deklarime avangarde të Titos" shkon edhe më larg, duke theksuar se "… çdo deklarim tjetër (d.m.th. "jugosllav") do të ishte i zbehtë dhe pothuajse i parëndësishëm"?!

Por, nuk është çështje e Titos dhe e këlyshëve të tij se si do të deklarohen popujt jugosllavë. Ajo është çështje e vetë këtyre popujve dhe ata me siguri nuk do lejojnë të bien në kurthet e rrezikshme që u ngrehin shovinistët.

Aq më pak mund të shiten këtu këshilla "avangarde" tek shqiptarët në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi. J u g o s l l a v do të thotë s l l a v i j u g u t, e dihet botërisht se ne jo vetëm nuk jemi sllavë të jugut, por nuk jemi fare

sllavë. Ne nuk jemi sllavë të jugut, por jemi shqiptarë të veriut. Fakti se ne jemi të pushtuar nga Jugosllavia, këtu nuk ndryshon asgjë. Në trojet tona kanë ardhur e kanë shkuar shumë pushtues, por ne kemi qenë dhe kemi mbetur shqiptarë. Prandaj, të deklarohet në çfarëdo mënyre një shqiptar "jugosllav", kjo do të thotë që ai të mohojë gjakun e tij shqiptar, të mohojë prejardhjen e tij, të mohojë gjuhën shqipe… do të thotë të mos jetë më shqiptar. E të mohosh atë që të parët tanë e kanë ruajtur në shekuj me aq shumë gjak e sakrifica, është një ligësi dhe poshtërsi e madhe. "Shqiptarë" të tillë sot ka shumë pak dhe, nëse ka ndonjë ai meriton urrejtjen dhe përbuzjen më të madhe të të gjithëve. Mjer nënat që kanë lindur "shqiptarë" të tillë.

TË MOS NGATËRROHEN KOMBI DHE FEJA

Ashtu si në të kaluarën armiqtë e popullit tonë do të përpiqen që ne shqiptarët të deklarohemi si "turq" ose "muslimanë", duke e ngatërruar me qëllim përkatësinë kombëtare me atë fetare.

Por, kombi dhe feja nuk janë e njëjta gjë. Kur, në regjistrim kërkohet përkatësia kombëtare, kjo nuk ka të bëjë fare me besimin fetar që kanë banorët, por me kombin e tyre, me gjakun që kanë, me gjuhën, zakonet etj. Nëse një shqiptar deklarohet se është "turk" apo "musliman" kjo nuk don të thotë se ai u "shkrua" si besimtar i fesë islame, por llogaritet se nuk është shqiptar, por pjesëtar i një kombi tjetër, i kombit turk, "boshnjak" ("musliman") etj. Ata që regjistrohen kështu bëjnë vetëm që të zvogëlohet numri i vërtetë i shqiptarëve në Jugosllavi e mu këtë e dëshirojnë armiqtë e popullit tonë.

Regjistrimi që do të bëhet nuk është një regjistrim i thjeshtë i popullsisë, nuk është vetëm një çështje statistike e demografie, por është edhe një çështje me rëndësi të madhe politike për të ardhmen. Prandaj, ne u bëjmë thirrje të gjithë shqiptarëve të ndershëm në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi që të mos mashtrohen nga propaganda e rrezikshme e armiqve tanë, që në shekuj janë munduar të na zhdukin e shkombëtarizojnë. Ne shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi nuk jemi as jugosllavë, as turq dhe as "muslimanë" ("boshnjakë"), prandaj asnjë shqiptar nuk duhet të deklarohet i tillë. Ne jemi vetëm shqiptarë dhe në rubrikën ku shënohet përkatësia kombëtare, të gjithë duhet të shkruajmë vetëm fjalën e dashur " shqiptar" dhe asgjë tjetër. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 7)

2-6. HAPAT KILOMETËR TË SHQIPËRISË SOCIALISTE

Nga Jakup Krasniqi

Ëndrrat shekullore të popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror u bënë realitet vetëm me fitoren e revolucionit popullor dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit në Shqipëri. Shqipëria e para çlirimit ishte vendi më i prapambetur në Evropë si në pikëpamje ekonomike ashtu edhe në atë arsimore, kulturore, sociale e shëndetësore. Populli jetonte në skamje e mjerim, kurse pasuritë e tij i shfrytëzonin e i grabitnin të huajtë dhe regjimi satrap i Zogut.

Çlirimi e gjeti Shqipërinë në një gjendje të rëndë e të vajtueshme. Ekonomia e prapambetur shqiptare, gjatë luftës u shkatërrua plotësisht. Për industri as që mund të bëhej fjalë, sepse edhe ato pak objekte industriale, miniera etj. kishin dalur jashtë përdorimit. U shkatërruan rrugë e ura, fshatra e qytete. Nga 2500 fshatra e qytete, sa kishte Shqipëria, 1850 u rrënuan e dëmtuan nga lufta. Partia dhe pushteti i ri, në vitet e para të çlirimit, përveç vështirësive e pengesave tjera u desht të përballonin edhe veprimtarinë

sabotuese e armiqësore të angloamerikanëve, revizionistëve titistë etj. të cilët donin ta zhduknin fare Shqipërinë e re socialiste.

Por, populli ynë patriot, i mobilizuar si në epopenë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, me vullnet të çeliktë, i udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare (sot PPSH), i hyri veprës së madhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Kështu, vetëm për dy vjet u zhdukën pasojat e rënda që la lufta kudo në Shqipëri.

Vetëm 36 vjet kanë kaluar prej atyre kohëve të vështira, por transformimet që kanë ndodhur në Shqipërinë socialiste mund të maten vetëm me shekuj. Shqipëria, dikur e varfër dhe e prapambetur, Shqipëria e kandilit, sëmundjeve dhe legjendave të misrit, sot është shndërruar në vend socialist me ekonomi të zhvilluar e dinamike, me nivel arsimor e kulturor të lartë dhe me një mbrojtje të fuqishme e të sigurtë.

Shqipëria socialiste ka sot një ekonomi të zhvilluar që nuk i njeh asnjë nga plagët e ekonomive kapitaliste e revizioniste si krizat, inflacionin, ngritjen e çmimeve, papunësinë e kurbetin, rënien e prodhimit, borxhet e plagë të tjera.

Industria e sotme shqiptare është një industri e zhvilluar dhe shumëdegëshe. Krahasuar me vitin 1938, në vitin 1960 prodhimi i qymyrgurit, p.sh. u rrit 86,6 herë, kurse në vitin 1979 mbi 400 herë. Prodhimi i kromit u shtua, më 1960 dhe 1979 kundrejt vitit 1938, respektivisht 38,7 herë dhe 176 herë, i bakrit 12 dhe 336 herë i hekur nikelit 3, 6 dhe 353 herë etj. Zhvillim të shpejtë dhe të pandërprerë ka pasur edhe energjetika. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1979 kundrejt vitit 1938 është rritur 322 herë, kurse vetëm ajo që prodhohet nga hidrocentralet, 580 herë. Duke marrë për bazë vitin 1938, prodhimi i përgjithshëm industrial më 1979 ishte 125 herë më i madh. I gjithë prodhimi industrial i viti 1938 sot realizohet për më pak se tri ditë.

Gjatë pesëvjeçarit të fundit u ndërtuan e u vunë në shfrytëzim shumë vepra të rëndësishme të industrisë shqiptare. Këto ditë përfundoi ndërtimi i Hidrocentralit të madh "Drita e Partisë", kurse disa reparte të Kombinatit Metalurgjik, ka kohë që janë vënë në shfrytëzim. Nga ky kombinat, qysh moti doli giza dhe çeliku i parë i markës shqiptare, kurse tash, aty, prodhohen rreth 50 lloje çeliqesh. Në Kombinatin e autotraktorëve "Enver Hoxha", në vitin 1978 u prodhua traktori i parë shqiptar e së shpejti do të prodhohet edhe kamioni. Këtyre gjiganteve iu shtuan edhe fabrika e pasurimit të hekur-nikelit në Gurin e Kuq, Uzina e pasurimit të bakrit në Laç, Uzina e plastmasit në Lushnje, Kombinati Poligrafik në Tiranë, Fabrika e letrës në Lezhë, Uzina e përpunimit të thellë të Naftës në Ballsh etj. etj. Zhvillim të hovshëm, gjatë viteve të pushtetit popullor pati edhe industria e materialit ndërtimor, e cila në vitin 1979, kundrejt vitit 1938 është rritur 263 herë. Krejt e re në Shqipërinë socialiste është industria kimike, e cila për herë të parë ka filluar prodhimin në vitin 1950 dhe që sot është bërë një industri e zhvilluar dhe komplekse.

Shqipëria sot eksporton shumë artikuj industrialë e bujqësorë. Në vitin 1980 rreth 70 për qind të eksportit shqiptar e përbënin mallrat e përpunuara dhe gjysëm të përpunuara. Sot Shqipëria eksporton naftë, energji elektrike, tela bakri, krom (me eksportin e kromit Shqipëria zë një ndër vendet e para në botë), prodhime të industrisë mekanike, prodhime bujqësore e blegtorale, prodhime kimike, çimento etj. Eksporti shqiptar është në rritje të vazhdueshme dhe mbulon krejtësisht importin. Shqipëria nuk njeh deficite tregtare.

Krahas industrisë, një zhvillim të hovshëm nga pesëvjeçari në pesëvjeçar, nga viti në vit, ka pasur edhe bujqësia, baza e ekonomisë socialiste. Me kolektivizimin e përgjithshëm të bujqësisë u krijua baza e ekonomisë socialiste edhe në fshatin shqiptar. Zhvillimi aq i vrullshëm i industrisë shqiptare nuk do të ishte i mundshëm pa zhvillimin e shpejt të bujqësisë në baza socialiste.

Shqipëria socialiste ka shënuar suksese të mëdha në zhvillimin dhe intensifikimin e bujqësisë. Rritje e ndieshme është shënuar në prodhimin e drithërave të bukës, të bimëve

industriale, në blegtori, pemëtari etj. Fitore e madhe historike për Shqipërinë është sigurimi i të gjithë bukës në vend. Shqipëria nuk blen më buk nga vendet e tjera. Viti 1980 është viti i pestë që prodhimi i drithërave plotëson nevojat e vendit, bile edhe eksportohet. Zhvillimi i bujqësisë është i kundërt me atë që po ndodh në vendet borgjeze e revizioniste, ku bujqësia është në krizë të rëndë dhe shkatërrim të vazhdueshëm. Në RPS të Shqipërisë fshati rritet e lulëzon çdo ditë, diferencat e tij me qytetin zvogëlohen vazhdimisht. Sot në Shqipëri ka 2,5 herë tokë të punueshme më shumë se në vitin 1938, kurse 60 për qind e saj ujitet dhe me këto Shqipëria zë një ndër vendet e para në botë.

Partia dhe pushteti popullor i kanë kushtuar dhe i kushtojnë një kujdes të veçantë arsimit e kulturës së popullit. Rrjeti i shkollave të të gjitha kategorive, i shtëpive të kulturës, bibliotekave, muzeumeve e institucioneve tjera arsimore e kulturore është shtrirë në të gjithë vendin. Brenda vitit, në Shqipëri, botohen 10 milionë e 500 mijë ekzemplarë librash, ose rreth katër ekzemplarë për banorë. Libri shqiptar shkon në 34 vende të botës, ndërsa gazetat e revistat shqiptare shiten në mbi 60 vende.

Krahas arsimit e kulturës, hapa të mëdhenj përpara ka bërë edhe shëndetësia. Shqipëria feudoborgjeze ishte e njohur si vend i sëmundjeve të shumta, kurse epidemitë e ndryshme shpesh bënin kërdinë në popull. Në vitin 1938 Shqipëria kishte gjithsejtë 122 mjekë, e edhe ata punonin kryesisht në qytete. Një mjeku i takonin atëherë, mesatarisht, jo më pak se 8500 banorë, kurse sot Shqipëria ka një mjek e stomatolog për vetëm 579 banorë. (Në komunën e Prizrenit, që në Kosovë konsiderohet e zhvilluar, një mjeku i takojnë 4800 banorë.) Në Shqipërinë socialiste kontrollimi, shërbimi mjekësor dhe kurimi janë falas për të gjithë popullin. Ky është një tregues tjetër që dëshmon se shteti socialist çdo gjë e bën për të mirën e popullit.

Bashkë me jetën e re socialiste që po lulëzon kudo në Shqipëri, po formohet e kalitet njeriu i ri socialist, me ide e mendime të reja revolucionare, me botëkuptim të ri e me moral të lartë komunist. Partia dhe shteti shqiptar gjatë gjithë kohës i kanë kushtuar dhe i kushtojnë kujdes të madh edukimit e formimit të njeriut të ri, krijuesit e farkëtuesit të të gjitha fitoreve. Formimi i njeriut të ri, me të drejtë, vlerësohet si njëra nga fitore kryesore të Shqipërisë socialiste.

Arritjet e rëndësishme në industri, bujqësi e në sektorët e tjerë të ekonomisë kanë bërë që të realizohet me sukses politika e Partisë për ngritjen e mirëqenies së popullit. Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies materiale e kulturore të masave është një nga qëllimet më të larta të rendit socialist. Shqipëria socialiste është i vetmi vend në botë pa taksa e tatime. Ajo është i vetmi vend ku çmimet jo vetëm që nuk ngriten, por ulen vazhdimisht, kurse të ardhurat dhe standardi jetësor njohin vetëm ngritje të pandërprerë.

Kujdesin e Partisë dhe shtetit shqiptar për popullin e tregoi edhe rasti i tërmetit të 15 prillit të vitit 1979. Nën parullën revolucionare "një për të gjithë e të gjithë për një", vetëm gjatë pesë muajve, u meremetuan jo më pak se 14 mijë e 522 shtëpi banimi dhe 165 objekte të ndryshme ekonomike e shoqërore, si shkolla, kopshte, çerdhe, shtëpi kulture, qendra shëndetësore etj. Shtëpitë e reja që u ndërtuan me shpenzime të shtetit, iu dhanë falas, si pronë personale, të gjithë banorëve të goditur nga tërmeti. Krejt ndryshe ndodhi në viset e goditura nga i njejti tërmet në Mal të Zi, ku popullsia, sidomos ajo shqiptare, jo vetëm nuk u ndihmua, por edhe pengohet t'i rindërtojë shtëpitë e rrënuara. (Në qytetin e Ulqinit, ku as për së afërmi nuk janë zhdukur pasojat e tërmetit, nën pretekstin e "urbanizimit" të qytetit, banorët nuk mund të ndërtojnë ose të meremetojnë shtëpitë, por detyrohen të marrin rrugën e hidhur të kurbetit.)

Të shumtë e të egër kanë qenë armiqtë që janë përpjekur dhe përpiqen ta ndalin marshimin e Shqipërisë socialiste, por gjithmonë kanë dështuar e do të dështojnë me turp para unitetit të çeliktë Parti-popull. Këtë fat e kanë pësuar të gjithë armiqtë e Shqipërisë që nga imperialistët anglo-amerikanë e deri te revizionistët titistë. Këta armiq të tërbuar

të marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit, kanë vendosur sot një bllokadë të egër e të gjithanshme ndaj atdheut tonë të dashur, por nuk ka forcë në botë që ta ndalë marshimin e tij fitimtar drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në Shqipëri.

Shqipëria është vendi i vetëm në botë, ku valvitet i lirë flamuri i kuq i Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, ku forcohet çdo ditë e më shumë diktatura e proletariatit. Vetëm nën flamurin e lavdishëm të marksizëm-leninizmit dhe nën udhëheqjen e urtë e largpamëse të Partisë së madhe të Punës, mund të arrinte Shqipëria jonë suksese të tilla madhështore.

Populli ynë në Shqipërinë socialiste punon, ndërton dhe mbron socializmin duke e mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën, Nën udhëheqjen e urtë të Partisë, me besim të plotë në forcat e veta, me vullnet e optimizëm revolucionar dhe me vendosmërinë për të ecur kurdoherë përpara ai po e mbyll vitin 1980 me një bilanc të pasur fitoresh të reja në të gjitha fushat, duke e bërë Atdheun edhe më të bukur, më të begatshëm e më të fortë.

Me mbylljen e këtij viti, Shqipëria mbyll me sukses planin e saj të gjashtë pesëvjeçar. Nga pesëvjeçari në pesëvjeçar, Shqipëria ngjiti shkallët e socializmit, ndërtoi vendin, ngriti atë ekonomi të fuqishme, atë industri të zhvilluar e shumëdegëshe, atë bujqësi moderne socialiste e atë mbrojtje të pathyeshme. Në kohën kur ekonomia e botës kapitaliste e revizioniste vuan nga plagë të pashërueshme dhe shkatërrimtare, ekonomia shqiptare ecën me ritmet e rritjes së vazhdueshme. Nga viti 1950 e gjer më sot, produkti i përgjithshëm shoqëror është rritur 3,2 herë më shpejt se rritja e popullsisë. Të ardhurat kombëtare janë rritur 2,7 herë më shpejt, prodhimi i përgjithshëm bujqësor 2 herë më shpejtë se rritja e popullsisë. Vetëm gjatë viteve 1979/1980, kur Shqipëria nuk merrte asnjë ndihmë e kredi nga jashtë, produkti shoqëror u rrit mesatarisht 6,3 për qind, kurse prodhimi industrial u rrit me ritëm mesatar vjetor prej 8,1 për qind.

Edhe gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, të shtatit me radhë, populli ynë në Shqipërinë socialiste do të mobilizohet dhe do të realizojë me sukses detyrat e caktuara për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit dhe mbrojtjen e Atdheut. Viti 1980 është viti i parë i Pesëvjeçarit të shtatë, i cili hartohet duke u mbështetur krejtësisht në forcat e veta dhe pa asnjë ndihmë e kredi të huaj. Ky plan do të jetë plani më madhështor që ka hartuar gjer më tani Shqipëria. Ai parasheh të ndërtohen vepra industriale, bujqësore, arsimore, kulturore, shëndetësore etj. aq sa janë ndërtuar gjatë katër pesëvjeçarëve të parë të marrë së bashku (1950-1970).

Viti 1981 do të jetë me siguri vit i fitoreve të reja, akoma më të mëdha. Grushtbashkuar rreth Partisë dhe Komitetit të saj Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, populli heroik shqiptar do të shkojë duarplotë e ballëlartë në Kongresin 8-të të Partisë së lavdishme të Punës. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 8-9)

2-7. KRIZË E DEGJENERIM NË JUGOSLLAVINË TITISTE

Nga Berat Luzha

Jugosllavia titiste është mbërthyer sot nga një krizë e thellë dhe e gjithanshme. Kjo krizë sa vjen e thellohet duke e bërë kështu jetën e masave popullore gjithnjë e më të vështirë e të padurueshme. Në këtë krizë kaq të thellë sistemin anarko-sindikalist "vetadministrues" jugosllav e solli zhvillimi në rrugë kapitaliste i ekonomisë dhe i sferave të tjera të jetës. Si rrjedhim, sistemi jugosllav vuan nga plagë të njejta e të pashërueshme të sistemit kapitalisto-revizionist botëror.

Rënia e prodhimit në shumë degë dhe anarkia në prodhim, ngritja e përditshme e çmimeve, ngritja e shpejtë e kostos së jetesës së masave popullore, inflacioni i papërmbajtur, papunësia dhe emigracioni i shfrenuar i krahut të lirë të punës jashtë shtetit, borxhet deri në fyt, konkurrenca e egër në treg, zhvillimi jo i barabartë, kaosi politik e ideologjik, grindjet e konfliktet për pushtet, shthurja morale, mënyra kapitaliste e jetesës, etj. janë disa nga pamjet e shëmtuara të krizës së gjithanshme që e ka mbërthyer Jugosllavinë titiste prej kohësh.

Karakteristikë e ekonomisë jugosllave është jo vetëm zhvillimi i dobët e disproporcional, por edhe mosrealizimi i planeve të prodhimit e humbjet përditë e më të mëdha. Gjatë vitit 1979 ekonomia jugosllave kishte rreth 19 miliardë dinarë humbje, që ishin 23 për qind më të mëdha se ato të një viti më parë. Ndërkaq, vetëm për nëntë muajtë e parë të vitit 1980 humbjet kapnin shumën prej 20,3 miliardë dinarësh (30 për qind më tepër se në periudhën e njejtë të vitit 1979). Këto humbje u krijuan në degët dhe sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, si në metalurgjinë e zezë dhe atë të ngjyrosur, në industrinë ushqimore e atë të jometaleve, bujqësi etj.

Humbjet e vazhdueshme dhe gjithnjë në rritje bien mbi kurrizin e punëtorëve dhe të masave tjera punonjëse. Për t'i zhdukur humbjet, ndërmarrjet futen në borxhe të reja te bankat, apo i harxhojnë rezervat e tyre të fundit, i ulin pagat e punëtorëve etj. Megjithatë humbjet e vitit 1979 u mbuluan vetëm 84 për qind (më se 90 për qind e mjeteve për mbulimin e humbjeve kanë qenë kredi "sanuese" të bankave me afate të shkurtra kthimi e kamata të larta).

Bankat janë faktor vendimtar dhe dirigjues në ekonominë jugosllave. Kështu, shpeshherë ato duke parë gjendjen e vështirë në ndërmarrje, nuk u lejojnë atyre kredi "sanuese". Prandaj jo rrallë reparte e ndërmarrje të tëra falimentojnë, duke i lënë rrugëve qindra e mijëra punëtorë.

Ekonomia jugosllave i ka hapur dyertë për kapitalin botëror e veçanërisht atë amerikan, gjermanoperëndimor, sovjetik, francez, japonez, kanadez, anglez etj. Firmat e ndryshme kapitaliste janë të lira të bëjnë investim kudo në Jugosllavi, të shfrytëzojnë lëndët e para dhe krahun e lirë të fuqisë punëtore. Borxhet ndaj kapitalit të huaj kalojnë mbi 20 miliardë dollarë amerikanë. Kapitali i huaj kapërcen gjysmën e vlerës së kapitalit të përgjithshëm në Jugosllavi. Nga gjithsejtë 996 miliardë dinarë të investuar gjatë vjetëve 1976-1979, më se 653 miliardë ishin kredi nga bankat dhe mjetet e huaja. Vetëm obligimet e ekonomisë jugosllave për kamata të kredive të shfrytëzuara në vitin 1977 kapin shumën prej 62,7 milionë dinarëve, ndaj 44,1 milionëve, sa kishte një vit më parë.

Edhe në vitin 1980 revizionistët jugosllavë i shtrinë dorën vendeve kapitaliste dhe morën një numër kredish. Nga banka ndërkombëtare e Uashingtonit u morën disa sosh. Njëra që gjoja do të përdoret për zhvillimin e bujqësisë kapitaliste jugosllave kap vlerën prej 86 milionë dollarësh amerikanë, tjetra për ndërtimin e rrugëve në Slloveni, Kroaci, Vojvodinë e Serbi kap vlerën prej 125 milionësh ndërsa një tjetër me vlerë prej 120 milionë dollarësh do të përdoret gjoja për zhvillimin e industrisë jugosllave. Regjimi nuk ngurroi që vitin e kaluar tua shtrijë dorën edhe kapitalistëve kanadezë, francezë, japonezë, anglezë, sheikëve kuvajtas etj. Kohëve të fundit vetëm nga bankat kapitaliste angleze për bankat jugosllave u akordua një kredi e re prej 400 milionë dollarësh amerikanë.

Propaganda çjerrëse jugosllave mundohet më kot të na e mbush mendjen se ngritja e disa objekteve të reja është rezultat i ndërtimit të socializmit në Jugosllavi. Por, siç na mëzon marksizëm-leninizmi, socializmi kurrë nuk mund të ndërtohet me ndihmën e imperialistëve. Barra e borxheve kaq të mëdha e rëndon akoma gjendjen edhe ashtu të vështirë të klasës punëtore jugosllave dhe të masave të gjera, siç u detyrua të pohoj para sa ditësh edhe njëri nga krerët e klikës titiste V. Bakariç.

Përveç borxheve të mëdha, Jugosllavia ka një deficit të madh tregtar me vendet tjera, e në mënyrë të veçantë me vendet e zhvilluara kapitaliste, që e ka vënë ekonominë jugosllave në një pozitë shumë të vështirë. Vetëm gjatë vitit 1979 deficiti në tregtinë e jashtme arriti në 6 miliardë e 372 milionë dollarë amerikan. Eksporti mezi mbulonte gjysmën e vlerës së importit, por megjithatë përveç pasojave të mëdha në çrregullimin e tregut nuk përfitoi gati asgjë. Veç kësaj, kjo "veçe" u detyrua të bëjë zhvleftësimin e dinarit për të shtatën herë pas luftës, këtë herë jo më pak se 30 për qind. Inflacioni ishte i papërmbajtur dhe kaloi shkallën 32 për qind. Aftësia riprodhuese dhe akumuluese e ekonomisë është në rënie të vazhdueshme.

Për të dalë nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhen, revizionistët kanë ndërmarrë një varg masash, si ato për kursim, për stabilizim, ngritje çmimesh, ngritje të taksave e tatimeve etj. Vetëm gjatë vitit 1980 u ngritën çmimet e gati të gjithë artikujve në treg dhe të shërbimeve, bile në shumë raste mbi 100 për qind. Gjatë këtij viti, u ngritën çmimet e miellit e të bukës, të qumështit e yndyrnave ushqimore, të sheqerit, mishit, pemëve e perimeve, të kafesë e çajit, të barnave, detergjenteve, naftës, rrymës elektrike, çmimet e udhëtimit, të qirasë, të shërbimeve komunale etj., etj. Vetëm për shtatë muajtë e parë indeksi i çmimeve u rrit jo më pak se 27,3 për qind. Çmimet me pakicë gjatë 11 muajve u shtuan me 35,7 për qind, ndërsa vetëm gjatë nëntorit, në krahasim me tetorin, 2,5 për qind.

Derisa çmimet ngriten përditë e pa kontroll, pagat e punëtorëve mbesin "të ngrira", zvogëlohen (në përqindje) apo bllokohen fare për kohë të gjatë. Kështu, të ardhurat personale reale, siç u detyruan të pranojnë edhe vetë revizionistët në mbledhjen e parakohshme të KQ të LKJ janë në rënie të vazhdueshme, siç është në rënie edhe shkalla e konsumit të përgjithshëm. Kostoja e jetesës ishte përditë e më e lartë dhe vetëm gjatë gjysmës së parë të vitit 1980 ajo u shtrenjtua 32 për qind. Në shtator të këtij viti shpenzimet e jetesës ishin jo më pak se 3,4 për qind më të larta se një muaj më parë.

Përveç çmimeve, revizionistët ngrisin edhe taksat e tatimet mbi popullsinë. Me anë të tyre ata iu grabisin popullsisë miliarda dinarë të cilat shkojnë për fryrjen skandaloze të aparateve burokratike administrative, policore e ushtarake. Për çka nuk ka taksa e tatime në Jugosllavi? Taksa e tatime ka jo vetëm për të ardhurat dhe pasuritë e ndryshme, por edhe për shitblerjen e mallit të thjeshtë, për regjistrim nëpër shkolla, për lidhjen e marrëdhënies së punës, për instalimin e aparateve shtëpiake për shërbime komunale, për ujë, për vaditjen e tokave, për ushtrimin e profesionit, për kalim nëpër rrugë e ura, për nxjerrjen e dokumenteve shtetërore etj. Për ta nxjerrë një dokument çfardoqoftë nga një zyrë shtetërore, jo vetëm që duhet paguar taksën e caktuar, por shpesh u duhet dhënë ryshfete nëpunësve, ndryshe duhet sorollatur me ditë të tëra nga sporteli në sportel, nga zyra në zyrë.

Një formë tjetër e grabitjes së masave që po praktikojnë revizionistët janë edhe të ashtuquajturat vetkontribute për ndërtimin e objekteve të ndryshme shoqërore e komunale. Kështu s'ka komunë në Jugosllavi pothuajse që nuk e ka aplikuar shpalljen e "vetëkontributit" pesë deri dhjetëvjeçar, duke iu grabitur punonjësve dy deri dhjetë për qind të të ardhurave të përgjithshme.

Kur merret parasysh se përveç kontributeve komunale, qytetarët detyrohen të japin edhe vetëkontribute të tjera lokale në vendbanimet e tyre për ndërtimin e rrugëve e urave, ujësjellësit, shkollave, instalimin e rrymës elektrike, për të cilat regjimi nuk çan kokën, atëherë kuptohet se sa mjete u mbeten punonjësve për kafshatën e gojës.

Rrjedhimi drejtpërdrejtë i krizës së thellë dhe të gjithanshme në Jugosllavi është edhe shkalla e lartë e papunësisë dhe emigracionit ekonomik gjithnjë në rritje. Në Jugosllavinë titiste sot ka mbi një milionë të papunë (vetëm në Maqedoni 120 000 me rritje të shkallës së papunësisë 7 për qind) dhe mbi 1 milionë e 300 000 kurbetqinj të cilët

kanë marrë botën në sy për bukën e gojës. Numri i vërtetë i tyre sigurisht, është shumë më i madh, pasi shumë prej tyre emigrojnë pa ndërmjetësimin e organeve shtetërore. Numri i të papunëve dhe i të mërguarve ekonomik po rritet gjithnjë e më tepër. Po rritet edhe numri i punëtorëve me mëditje, i shërbëtorëve etj. Vetëm në Serbi te punëdhënësit privatë punojnë rreth 40 mijë vetë. Në sistemin e kalbur "vetadministrues" jugosllav sundojnë ligjet e xhunglës, konkurrenca e egër në treg bën që ndërmarrje të tëra të falimentojnë ose të detyrohen të "integrohen" me ndërmarrje më të mëdha. Përveç konkurrencës në treg manipulohet lirisht me çmime, malverzohet me artikuj konsumues etj. Jo rrallë, bile kohëve të fundit vazhdimisht, ka mungesa të shumta të artikujve më elementarë të jetës, si vaji i ushqimit, detergjentet, qumështi, barnat, kafeja, çaji, si dhe të çimentos e plehrave minerale. Edhe pse gjatë gjithë vitit 1980 kishte mungesë të madhe të detergjenteve në tregun jugosllav, një sasi e madhe e këtij artikulli u eksportua jashtë shtetit. Kështu vetëm gjatë gjashtë muajve të parë të vitit u eksportuan 6000 tonelata detergjente ose 15 herë më tepër se sa u eksportuan në periudhën e njejtë të vitit të mëparshëm. Kështu u veprua edhe me vajin e ushqimit, çimenton, plehrat minerale e një varg artikujsh të tjerë.

Edhe pse Jugosllavia ka kushte të përshtatshme për kultivimin e drithërave, gjatë gjithë periudhës së pasluftës ajo është importuese e tyre. Bujqësia jugosllave është në shkatërrim e sipër, kështu që nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e tregut, jo vetëm për drithëra, por edhe për bimë industriale, si luledielli e panxharsheqeri dhe shumë prodhime të tjera bujqësore e blegtorale. Aktualisht mbi 700 mijë hektarë tokë e punueshme nuk punohet fare dhe në poaq sipërfaqe, sipas shtypit jugosllav, mezi punohet diçka. Bujqësia jugosllave zhvillohet mbi bazën e pronës private. Sektori privat përfshin më se 90 për qind të tokave të punueshme.

Realiteti i zi vërteton se në Jugosllavi nuk ndërtohet dhe as që është ndërtuar ndonjëherë socializmi. Prona private mbi mjetet e prodhimit është shtrirë kudo. Ligje të shumta lejojnë, e bile stimulojnë, ekonominë private dhe u lënë dorë të lirë kapitalistëve të rinj e të vjetër për të shtypur e shfrytëzuar punonjësit. Në tërë Jugosllavinë është formuar një klasë borgjeze e cila vazhdimisht pasurohet në kurriz të masave të gjera popullore. Borgjezëve u ndihmohet për ngritjen e të ashtuquajturave "organizata kontraktuese", që nuk janë veçse thjesht ndërmarrje private kapitaliste, siç janë edhe shumë objekte tjera të ekonomisë së vogël. Në fshat janë ngritur "organizata të koperuesve", të cilat bashkë me kulakët e fshatit kanë për qëllim t'i shtypin e shfrytëzojnë masat e gjera fshatare dhe tua grabisin atyre prodhimet e pasuritë.

Jugosllavia titiste është përfshirë edhe nga një krizë e thellë politike e ideologjike. Pasqyrimi i kësaj krize të thellë janë edhe grindjet e konfliktet e tërbuara dhe të vazhdueshme për pushtet në mes grupeve e klaneve sunduese. Viteve të fundit kjo luftë ka marrë përmasa të gjera. "Udhëheqja kolektive", rreth së cilës po bëhet zhurmë e madhe jo vetëm që nuk do ta shuaj këtë luftë, por, përkundrazi do ta shtojë edhe më tepër.

Jugosllavia revizioniste, me politikën shumëfytyrëshe "të mosangazhimit", jo vetëm që po angazhohet në interesat e dy superfuqive dhe të blloqeve të tyre, por edhe si agjenturë e tyre është bërë zjarrfikëse e revolucioneve proletare dhe e luftërave nacionalçlirimtare kudo në botë. Lind pyetja: ndaj kujt është e paangazhuar Jugosllavia? Ndaj superfuqive imperialiste tek të cilat është shitur? Apo ndoshta ndaj blloqeve ushtarake, luftanijet e të cilave njëra pas tjetrës u bëjnë vizita "miqësore" porteve të ndryshme jugosllave.

Krahas masave të tjera të dhunës, shtypjes e eksploatimit të egër kapitalist, regjimi ka vënë në veprim edhe një makinë të tërë propagandistike me qëllim që të mashtrojë t'i çorodisë e degjenerojë masat e gjera popullore dhe t'i largojë ato nga lufta klasor e ajo çlirimtare. Propaganda çoroditëse që zhvillohet në Jugosllavi, i nxit masat pas një jete

boshe, të shurdhër e pa ideale, i shtyn në rrugën e kriminalitetit e vagabondazhit, të aventurizmit e anarkizmit, të dëshpërimit e utopisë. Në këtë mënyrë ajo mundohet t'i largoj masat nga rruga revolucionare dhe lufta për të drejta e liri. Metoda e mashtrimit dhe e skllavërimit shpirtëror të masave, e sidomos të rinisë, me anë të shtypit, radios e televizionit, të literaturës shund, të filmave të ndryshëm, muzikës çjerrëse, modës etj. është bërë shumë e preferuar për revizionistët jugosllavë. Dorë të djathtë në këtë drejtim regjimi e ka klerin reaksionar, i cili me anë të edukimit në frymën e obskurantizmit fetar të fëmijëve dhe të rinjve u fut atyre në shpirt ndjenjën e frikës e të nënshtrimit.

Gjendja e rëndë e proletariatit dhe masave tjera punonjëse, mbi të cilat bien të gjitha pasojat e krizës dhe shfrytëzimit kapitalist, i ka shtyrë ato të shpërthejnë zemërimin e tyre të papërmbajtshëm kundër regjimit me greva, përleshje, demonstrata e protesta të shumta të cilat nuk po mund t'i mbulojnë as krerët revizionistë.

Ligji i revolucionit proletar, ashtu si në të gjitha vendet kapitaliste vepron edhe në Jugosllavi. Lufta e proletariatit jugosllav dhe e masave të gjera punonjëse jugosllave do të jetë ngadhënjimtare vetëm nëse klasa punëtore, nën udhëheqjen e një partie marksiste-leniniste, do të vihet në krye të lëvizjes dhe luftës që bëjnë popujt dhe masat punonjëse në Jugosllavi kundër regjimit titist. Klasa punëtore jugosllave nuk duhet t'i lejojë vetes të bëhet rezervë e reaksionit të brendshëm e të jashtëm, dhe të bjerë në kurthin që i ngreh ai, siç ra kohëve të fundit klasa punëtore polake. Proletariati jugosllav duhet të marrë vetë fatin e tij në duartë e veta dhe të marshoj përpara në revolucion. Rrugën e drejtë për fitoren e sigurtë të diktaturës së proletariatit në Jugosllavi e tregon vetëm marksizëm-leninizmi e asnjë teori tjetër borgjeze e revizioniste.

Proletariati jugosllav është i fortë dhe me siguri do të fitojë. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 10-11)

2-8. MASKARADË E PASIGURISË EVROPIANE

Nga Hydajet Hyseni

Po bëhet një kohë e gjatë që tam-tamet e propagandës borgjezo-revizioniste bien pa pushim rreth të ashtuquajturës "Konferencë mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Evropë." Akti i parë i kësaj konference u organizua, para pesë vitesh, në Helsinki, me një pompozitet të jashtëzakonshëm. Vrapuan aso kohe, atje, burra shtetërorë, qeveritarë e diplomatë të 33 vendeve evropiane, SHBA dhe Kanadasë, folën plot pasion për "paqen, sigurinë dhe bashkëpunimin", shtruan dreka e darka të shumta ... dhe më në fund nënshkruan me zhurmë të madhe dokumentin përfundimtar "mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Evropë."

Shqipëria socialiste, që në fillim, refuzoi pjesëmarrjen e saj në këtë lojë të superfuqive dhe e quajti atë "Mbledhje të mossigurimit evropian." Duke i bërë një analizë marksiste-leniniste gjendjes në Evropë dhe në botë, shoku Enver Hoxha, në fjalimin e tij të njohur të 3 Tetorit të vitit 1974 demaskoi botërisht qëllimet e kësaj konference, kurse "Zëri i popullit" në artikullin e 29 korrikut 1975 shkruante: "Pjesëmarrësit e mbledhjes së Helsinkit të mos shpejtohen për të kënduar "fitoret" e paqes e të sigurisë, të uljes së tensionit në Evropë. Marrëveshjet, traktate, lëshimet e kompromiset që manipulohen e përfundohen nën drejtimin e Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara nuk mund të kontribuojnë kurrë për forcimin e paqes e të sigurisë as në paln rajonal as në plan ndërkombëtar." Këto parashikime largpamëse të Shqipërisë socialiste dhe të shokut Enver Hoxha po i vërteton katërcipërisht koha.

Nuk kaluan veçse dy vite nga Helsinki dhe pjesëmarrësit e kësaj konference u mblodhën prapë, kësaj here në Beograd, për të parë "zbatimin" në praktikë të klauzulave Mbledhjes së Helsinkit. Dhe patën ç'të shihnin. Me javë të tëra u grindën mes veti, përfaqësuesit e vendeve imperialiste dhe sidomos ata të superfuqive, duke u munduar që secili të bënte fajtor tjetrin për gjendjen e rëndë të krijuar në Evropë, për tensionin dhe pasigurinë, që pas Helsinkit ishin shtuar edhe më shumë. Vetë pjesëmarrësit e mbledhjes u detyruan ta pranojnë dështimin e saj, kurse shtypi borgjez e quante atë "një mbledhje për asgjë". I vetmi vendim konkret që u mor në Beograd ishte ai për t'u mbledhur edhe një herë, pas dy vitesh, në Madrid. Megjithatë, propaganda borgjeze e revizioniste vazhdonte të bëjë zhurmë rreth "rëndësisë" së kësaj mbledhje "historike".

Por, realiteti në Evropë dhe botë, pas Mbledhjes së Beogradit, demaskonte më së miri, këtë maskaradë dhe zhurmën që bëhej rreth saj. Pas Mbledhjes së Beogradit, ashtu si edhe pas asaj të Helsinkit, gjendja në Evropë erdhi e u bë gjithnjë më e rëndë e më e turbulltë, tensioni, jo vetëm nuk u ul, por u shtua edhe më shumë, kurse gara e armatimeve mori përmasa të papara. Në aleancë dhe rivalitet, dy superfuqitë ndërmorën akte të reja ndërhyrjeje e agresioni në vende të ndryshme të botës, kurse manovrat ushtarake e shpërthimet bërthamore u bënë edhe më të shpeshta...

Në këto rrethana u mblodh në Madrid mbledhja tjetër e "sigurimit dhe bashkëpunimit evropian" dhe ishte e qartë se në të s'mund të bëhej tjetër, pos muhabete pa bukë. Ka muaj të tërë që atje bëhen akuza e kundërakuza të shumta, propozime e kundërpropozime të njëpasnjëshme, dhe në fakt nuk vendoset gjë. Pjesëmarrësve iu dashtë të ndalnin orën që të fillonte "me kohë" ky "kuvend i paqes", kurse me javë të tëra ata nuk mundën të vendosin as rendin e ditës! I ashtuquajturi akti i tretë i kësaj mbledhjeje që po mbahet në Madrid dëshmon më së miri fundin e turpshëm të kësaj komedie të vërtetë të dy superfuqive.

"Konferenca mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Evropë" është pjellë e dy superfuqive dhe u shërben atyre si mjegull për të mbuluar veprimtarinë e tyre reaksionare e luftënxitëse. Në kohën kur po rritet çdo ditë lufta e proletariatit dhe e popujve të shtypur, kur po shtohen përpjekjet e vendeve të vogla dhe të mesme për të mbrojtur e forcuar sovranitetin e tyre dhe për të kundërshtuar diktatin e të mëdhenjve, me një fjalë kur revolucioni është në ngjitje, fuqitë imperialiste dhe sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, mundohen t'i mashtrojnë popujt, t'u krijojnë atyre iluzionin se edhe ato janë të interesuara për paqë e siguri, bile edhe "punojnë për këtë qëllim", dhe të ulin vigjilencën e popujve ndaj planeve të tyre të rrezikshme luftënxitëse. Por, në të njejtën kohë, nga tribunat e këtyre konferencave superfuqitë imperialiste nuk lënë pa kërcënuar, ku hapur e ku në mënyrë të kamufluar popujt dhe vendet tjera që t'u binden atyre, duke lënë të kuptohet se janë vetëm ato që vendosin për fatin e popujve dhe të paqes në botë.

Më shumë se çdo kush tjetër, zhurmë rreth paqes e sigurisë bëjnë sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe fuqitë tjera imperialiste. Shtrohet, me të drejtë, pyetja: kush po e rrezikon, atëherë, paqen e sigurinë në Evropë e në botë? Është e qartë se paqen e sigurinë nuk e rrezikon askush tjetër, por pikërisht dy superfuqitë dhe fuqitë tjera imperialiste, pikërisht ata që flasin aq shumë për paqë e siguri. Ato e kanë kthyer Evropën në një fuqi baroti dhe e kërcënojnë me një luftë të re gjithë botën. Zhurma e tyre për paqen të kujton demagogjinë "pacifiste" të Hitlerit, në prag të Luftës së Dytë Botërore.

Në kohën kur në Madrid po vazhdojnë llomotitjet e pafund rreth paqes e sigurisë, bota kurrë s'ka qenë më e rënduar nga retë e luftës. Sot vendet e zhvilluara kapitaliste, çdo ditë harxhojnë mesatarisht 1 miliardë dollarë për luftën dhe armatimet, kurse dy superfuqitë dhe blloqet e tyre, në arsenalin e armëve të tyre kanë grumbulluar më shumë

se 60 mijë lloje të armëve bërthamore, me forcë shpërthyese 1 milionë herë më të madhe se bomba e hedhur në Hiroshimë të Japonisë. Vetëm SHBA gjatë pesë viteve të ardhshme parashikojnë të investojnë mbi 1200 miliardë dollarë për luftën. Tani SHBA po punojnë për dislokimin në Evropë të 600 raketave të reja bërthamore "Pershing", kurse në qindra baza ushtarake, në të gjitha skajet e globit, janë angazhuar mbi 480 mijë ushtarë amerikan, prej të cilëve 325 mijë vetëm në Evropë. Bashkimi Sovjetik socialimperialist, përgatitjeve të SHBA për luftën, po i përgjigjet me të njejtën gjuhë. Sot në Bashkimin Sovjetik, 60 për qind e ndërmarrjeve industriale në një mënyrë ose tjetër janë të lidhura me prodhimin ushtarak. Për t'i bërë zap vendet vasale dhe për t'u përgatitur për luftëra të reja pushtuese, ai ka dërguar në vendet e Evropës Lindore mbi gjysmë milioni ushtarë, kurse tani ka në plan të dërgojë në Evropë raketa me mbushje bërthamore të tipit "SS20" etj. Të dy superfuqitë sot kanë mbi 2000 satelitë ushtarak në kosmos, kurse prej vitit 1958 ato kanë lansuar me qëllim spiunazhi, mbi 750 satelitë të tillë.

Dy superfuqitë dhe aleatët e tyre e kanë kthyer Evropën në një poligon të madh të stërvitjeve ushtarake e të përgatitjeve për luftë. Është kuptimplotë fakti që mu në kohën kur filloi Mbledhja e Madridit blloqet agresive NATO dhe Traktati i Varshavës vringëllonin armët dhe demonstronin forcën anë e kënd Evropës.

Dy superfuqitë flasin shumë për sigurimin e paqen në Evropë, por në fakt është e pamundur të ketë paqë e siguri të veçuar për Evropën. Pushtimi i Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik, presionet e kërcënimet e SHBA ndaj Iranit, rivaliteti i tyre për ndarjen e zonave të influencës dhe lëndëve të para etj., që në pamje të parë duket sikur nuk kanë të bëjnë me Evropën janë të lidhura ngushtë edhe me paqen dhe sigurinë në këtë kontinent.

Imperializmi për interesat e tij është në gjendje të hedhë botën në një luftë të re botërore. Lufta është në logjikën e tij. Ai po përgatitet për këtë kasaphanë të re të tmerrshme, prandaj, sot, është e domosdoshme të ndalet dora e tij kriminale. Por, kjo nuk mund të arrihet me konferenca si ajo e Madridit dhe as duke i mbajtur ison dy superfuqive, siç po bëjnë shumë regjime antipopullore, por vetëm duke luftuar me konsekuencë kundër dy superfuqive imperialiste dhe regjimeve reaksionare, kudo që janë. Paqa dhe siguria e vërtetë mund të sigurohen vetëm kur fatet e tyre t'i marrin në duar vetë popujt. (Liria, nr. 1, dhjetor 1980, faqe 12)

==========

NDOSHTA PIKËRISHT NGA RADHËT E TYRE

Jusuf Gërvalla: *"Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike**, pret** themelimin **e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste** e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë **inversion** qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat **patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë**. Në këtë kontekst e shohim aktivitetin e **Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi** - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për **njohje reciproke** dhe për bashkim. Në këtë kontekst jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve*

*kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta **pikërisht nga radhët e tyre**, do të realizohet edhe **kërkesa e domosdoshme** për themelimin e vetë **partisë komuniste marksiste-leniniste**."* (Bashkimi - organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1, janar 1981, faqe 2, shtylla 1)

JUSUF GËRVALLA PO I JEPTE SHENJAT E PARA TË BASHKIMIT

Kadri Rexha. *"Jusuf Gërvalla shihte në horizont bashkimin e domosdoshëm të forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, që vinte si nevojë e frontit të luftës së organizuar në kushte të reja, si nevojë e lëvizjes së masave të gjëra, si nevojë e rezistencës dhe e veprimit aktiv të popullit tonë. Prandaj duke e ndërprerë botimin e revistës (Lajmëtari i lirisë – shën. i Xh. D.) Jusuf Gërvalla në këtë drejtim po i jepte shenjat e para të bashkimit. Kontributi i Jusuf Gërvallës në botimin e revistës "Liria" u shpreh në hartimin e materialeve origjinale, në përpunimin dhe redaktimin e materialeve të ndryshme, në lekturë, në daktilografimin e materialeve, në përgatitjen teknike, në përkujdesjen artistike, në botimin definitiv të revistës si dhe më në fund, në propagandimin dhe shpërndarjen e saj. Nga ky bashkëpunim i frytshëm kanë dalë në dritë nr.3 dhe nr.4-5 i revistës "Liria".* (Fati i Luleve, faqe 199)

DY DEGË TË TË NJËJTIT TRUNG

Hydajet Hyseni: "*Qysh në bisedën e parë që kishte zgjatur gjithë natën deri në mëngjes, ata jo vetëm kishin gjetur te njëri tjetri shokun e ardhshëm të kauzës e idealit, por edhe kishin konstatuar se në të vërtetë organizatat që përfaqësonin ata vepronin mbi bazë të së njëjtës platformë politike, dhe se ishin **degë të shkëputura të të njejtës rrënjë.**"* (Për takimin e parë të Kadri Zekës me Vëllezërit Gërvalla.) ("Therror në themelet e Bashkimit", fejton në 8 vazhdime në Zëri, 21 shkurt-2 mars 2002, i ribotuar edhe në përmbledhjen e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 28)

Jusuf Gërvalla: *"Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasave, edhe LNÇKVSH edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung. Një patriot revolucionar, i cili prej kohësh qenka në burg (ai thotë se nuk është fjala për Ademin, por për dikë tjetër), qenka përgjegjës për ndërprerjen e kontakteve mes anëtarëve të vjetër të organizatës së hershme me anëtarët e krahut të ri të kësaj organizate. Kështu që, pjesa e vjetër e asaj organizate (të përbashkët) ka ndjekur një rrugë të caktuar dhe sot ka arritur deri te emri Marksistë-leninistët e Kosovës, kurse krahu i ri, duke mos marrë kontakt me kohë me anëtarët e vjetër, qenka zhvilluar në Lëvizjen e sotme Nacionalçlirimtare të Kosovës. Për këto konkludime ai merr për bazë pikërisht organin "Zëri i Kosovës", të cilin Marksistë-leninistët e paskan pasur gjithashtu organ të vetin për një kohë të gjatë(sidomos që nga viti 1974, thotë ai, paskan dalë disa numra të këtij organi). Në rast të tillë, sipas mendimit të tij, bashkimi i organizatave tona jo vetëm që nuk është i vështirë, por është puna më e natyrshme."* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 270-271)

==========

L I R I A
Nr. 3, Maj 1981

3-1. LUFTA E POPULLIT TONË ËSHTË E DREJTË DHE DO TË TRIUMFOJ
3-2. TRADHTARËT SHQIPTARË MBROJNË INTERESAT E PUSHTUESVE
3-3. 1 MAJI I KËTIJ VITI E GJETI KOSOVËN NË LLOGORE LUFTE
3-4. GRUPI TITIST ËSHTË NJË GRUP TROCKISTËSH DHE RENEGATËSH
3-5. AI RA PËR TË MOS VDEKUR KURRË
3-6. PUNËTORËT KOSOVARË NË PERËNDIM SHPALOSIN FLAMURIN E LUFTËS
3-7. REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË U BË NËN HIJEN E TANKEVE
3-8. KOSOVË, SA HIJE TË KA XHAMADANI I TRIMËRISË!
3-9. JEHONA E NGJARJEVE TË KOSOVËS NË SHTYPIN E HUAJ
3-10. KLUBET E SHQIPTARËVE KALOJNË NË DUART E TË ZOTËVE

3-1. LUFTA E POPULLIT TONË ËSHTË E DREJTË DHE DO TË TRIUMFOJ

Nga Hydajet Hyseni

Këto kohët e fundit, e tërë Kosova jonë kreshnike ishte arenë e përleshjeve të përgjakshme midis popullit tonë trim dhe regjimit të urryer të revizionistëve jugosllavë. Të bashkuar si një grusht i vetëm e i pathyeshëm, dhjetëra mijëra punëtorë, fshatarë, studentë, nxënës e intelektualë, burra, gra, pleq e fëmijë, lanë kantierët e tyre të punës, lanë arat dhe bankat, lanë shtëpitë e tyre dhe, me grushta të ngritur, vërshuan si lumë i furishëm e i papërmbajtur nëpër rrugët e pothuajse të gjitha qyteteve të Kosovës. E gjithë Kosova jonë trime u ngrit në këmbë dhe i tregoi edhe njëherë botës se si në të kaluarën e saj të lavdishme edhe sot di t'u përgjigjet armiqve të saj ashtu si i ka hije: me grusht.

Të tmerruar nga grushti i madhërishëm i popullit, robëruesit revizionistë të Beogradit dhe zagarët e tyre në Kosovë, grisën maskat, pas të cilave fshiheshin, dhe, duke përdorur mjetet dhe armët e tyre të fundit, tanket dhe çizmën ushtarake, treguan fytyrën e tyre të vërtetë fashiste. Pas maskave të çjerra, populli ynë dhe popujt e botës panë

lakuriq fantazmat e zeza të Drazha Mihajloviçëve, Çubriloviçëve e Rankoviçëve, të Zogollianëve, Xhafer Devëve e Esat Toptanëve.

Duke e parë veten të diskredituar kaq keq revizionistët jugosllavë dhe hyzmeqarët e tyre shqiptarë, kanë shpërthyer tani një fushatë të paparë propagandistike me plot e përplot gënjeshtra, falsifikime, shpifje e trillime nga më të poshtrat e më të paskrupulltat. Në këtë mënyrë, ata po orvaten t'ia arrijnë atij qëllimi, që nuk mundën t'ia arrijnë vetëm me terror e me tanke, që ta shuajnë zjarrin e pashuar të lirisë, që po i çon peshë gjokset shqiptare, t'ia mbysin popullit tonë zërin e fuqishëm dhe t'ua fshehin popujve të Jugosllavisë e të gjithë botës të vërtetën rreth Kosovës, rreth gjendjes së saj të mjeruar, rreth luftës së drejtë revolucionare që po bën populli i saj heroik, rreth shkaqeve dhe qëllimeve të saj të vërteta.

Sipas devizës: "Rrej shumë, se diçka mbetet", revizionistët dhe tradhtarët, duke mohuar edhe ato që vetë i kanë thënë vetëm pak kohë më parë, mundohen të na bindin ne dhe të tjerët se Kosova jonë e mjerë qenka një parajsë e vërtetë, një vend ku kombe e kombësi të ndryshme jetojnë të lirë, të barabartë e të lumtur, në mirëqenie e bollëk të paparë, se pikërisht kjo gjendje "kaq e mrekullueshme" po i pengoka disa forca e grupe "nacionaliste" e "irredentiste", "dogmatike e staliniste", "reaksionare" e "kundërrevolucionare", të cilat, me "parulla demagogjike sociale e nacionale" si dhe me kërcënime, shantazhe e vandalizëm", paskan arritur t'i mashtrojnë e t'i hedhin në greva e demonstrata disa qindra veta dhe kështu paskan prishur vëllazërimin e bashkimin, paskan cenuar integritetin e Jugosllavisë, paskan sulmuar frytet e revolucionit dhe, sidomos, të arriturat e popullit shqiptar, bile edhe paskan dashur të bëjnë "kontrarevoluion"!!!

Por, nuk ka plaf propagande e demagogjie, që mund ta mbulojë këtë të vërtetë të madhe ashtu si nuk ka as armë e forcë që mund ta mbysë atë. Ajo është e qartë, e thjeshtë dhe e dukshme sa mund ta shohë edhe qorri. Nuk e shohin atë dhe nuk e kuptojnë vetëm ata që nuk duan ta shohin, vetëm ata që para saj i mbyllin sytë me qëllim.

Revizionistët jugosllavë, me politikën e tyre tradhtare dhe antipopullore i kanë futur masat popullore të të gjithë Jugosllavisë në një gjendje tepër të rëndë. Kriza e përgjithshme dhe e pashërueshme, që ka mbërthyer për gryke Jugosllavinë e po ia zë frymën dhe pakënaqësia e madhe e masave punonjëse që mbretëron kudo në Jugosllavi, dëshmon më së miri se ku çojnë teoritë dhe praktikat kapitaliste që ndjekin revizionistët titistë.

CILA ËSHTË E VËRTETA

Por, në gjendje veçanërisht të rëndë dhe të padurueshme ndodhet popullsia shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, mbi të cilën ushtrohet një shtypje e shfrytëzim i egër e i shumëfishtë kolonial e kapitalist. Kjo nuk mund t'u fshehet sot as të tjerëve, pa le më ne shqiptarëve, që mbajmë mbi supe pasojat e rënda të një gjendjeje të këtillë.

Gjithkush i njeh pasuritë e shumta e të pafund të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, gjithkush e njeh edhe prapambetjen e theksuar të tyre. Gjithkush e di (dhe këtë e pranojnë edhe vetë revizionistët) se Kosova, ashtu si edhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, jo vetëm që nuk po zhvillohet më shpejt se republikat e Jugosllavisë, po përkundrazi diferenca, si në shkallën e zhvillimit ashtu edhe në dinamikën e tij, po shtohet nga viti në vit. Prandaj gjithkush me të drejtë bën pyetjen: Pse ndodh kështu ? Përgjigjja është e qartë dhe atë e di mirë populli ynë, e dinë edhe të tjerët. Ndodh kështu, pse Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi nuk janë të lira, se ato janë një koloni e thjeshtë e republikave jugosllave, se ato janë plaçkë tregu dhe burim i thjeshtë i lëndëve të para

dhe i krahut të lirë të punës. Kosova ka pasuri të shumta, në Kosovë derdhet lumë djersa e bijve të saj, por tjetërkush i shfrytëzon ato, tjetërkush pasurohet me to.

Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj pozite koloniale si dhe e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, është gjendja e mjeruar e popullit shqiptar nën robërinë jugosllave. Këtë gjendje të rëndë e njeh dhe e sheh gjithkush, e kanë pranuar shumë herë edhe vetë krerët revizionistë.

Prodhimi shoqëror dhe e ardhura kombëtare 3-4 herë më e ulët se mesatarja jugosllave, rreth gjysma e popullsisë analfabete, më shumë se çdo i dhjeti banor në kurbet e akoma më shumë të papunë ,qindra fshatra pa rrymë elektrike, pa rrugë, pa asnjë shitore e pa kurrfarë mbrojtjeje shëndetësore... Këto janë vetëm disa tregues që flasin për gjendjen e vërtetë të popullit të Kosovës, pa përfshirë këtu viset e tjera shqiptare, ku gjendja është edhe më e rëndë, ku ndaj shqiptarëve ushtrohet një politikë e tillë shoviniste, që e kanë lakmi edhe cionistët izraelitë dhe racistët e Afrikës së Jugut.

Në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi shumica e popullsisë, sidomos ajo shqiptare, jeton në skamje, varfëri e mjerim të vërtetë. Një pjesë e mirë e popullsisë nuk ka kurrfarë të ardhurash e edhe ata që marrin diçka, ose nuk mund të gjejnë në treg as mallrat më të nevojshme të jetës, ose edhe po t'i gjejnë, ato kushtojnë aq shtrenjtë (dhe shtrenjtohen çdo ditë) sa nuk mund t'i blejnë dot.

Me pagën e vogël që merr punëtori (e që është dhjetëra herë më e vogël se ajo që marrin drejtorët, burokratët e funksionarët barkmëdhenj) nuk mund t'i sigurojë familjes së vet as bukën e gojës. Vetëm për një banesë të keqe (se banesat "shoqërore" ndërtohen për të tjerët) atyre u duhet të japin së paku gjysmën e pagës, kurse një pjesë të mirë të saj duhet ta japin për taksat, obligimet e kontributet e pafund, me të cilat i kanë ngarkuar...

Në gjendje aspak më të mirë është edhe fshatari ynë, i cili, në gjendjen tepër të rëndë në të cilën ndodhet bujqësia, nuk ka leverdi të punojë as atë pak tokë, që akoma nuk ia kanë gllabëruar shteti dhe kulakët, sepse, siç thonë fshatarët, dara u del më shtrenjtë se barra. Është pikërisht kjo gjendje e padurueshme që po i detyron fshatarët tanë t'ia mësyjnë në mënyrë masive kurbetit e qytetit, ku i pret i njëjti fat.

E mjerueshme është edhe gjendja e rinisë sonë shkollore e studenteske. Aq të vështira janë kushtet e tyre të jetës dhe të mësimit sa që nuk mund të krahasohen jo vetëm me ato të shokëve të tyre në Jugosllavi, por as edhe me asnjë vend tjetër. Janë të shumta shkollat e fakultetet që zhvillojnë mësimin në kushte që janë jashtë çdo norme shëndetësore e pedagogjike. Shumë studentë dhe nxënës po kalbin trupin e tyre të njomë nëpër bodrume të lagështa dhe shtalla të tilla ku nuk jetojnë dot as kafshët. Dhe për të qenë ironia edhe më e madhe, çmimi i këtyre çelive është aq i lartë sa studenti nuk mund ta paguajë as me të gjithë bursën apo kredinë që merr. Nuk janë të pakët studentët e nxënësit që e hanë bukën thatë ose me ndonjë "zdenkë" (copë e vogël djathi) apo ata që hanë bukë të mykur, të sjellë nga shtëpia. Prandaj shëndeti i tyre është aq i dobët, prandaj edhe suksesi është aq i pakënaqshëm.

Por hallet e vuajtjet e të rinjve tanë s' mbarojnë as pas përfundimit të shkollimit. Në krizën e rëndë, në të cilën është mbërthyer Jugosllavia, ata nuk kanë asnjë siguri për të ardhmen. Shumica e të papunëve janë me kualifikime, me shkolla të mesme e të larta, e madje edhe me fakultete të kryera.

Të pakënaqur punëtorët, të pakënaqur fshatarët, i pakënaqur e i revoltuar i gjithë populli. Në një gjendje të tillë të padurueshme, ku populli është mbështetur për muri, e thika po e prek në asht, mjaftonte një shkëndijë e vogël që të merrte flakë e tërë Kosova. Këtë shkëndijë kaherë të pritur, e ndezën më 11 mars studentët trima të Universitetit të Kosovës. Ata kanë kërkuar shumë herë më parë në rrugë e në forma të ndryshme që të përmirësohet gjendja e tyre e mjeruar, por për ankesat e tyre nuk çau kokën askush. Të

ngopur me gënjeshtra e premtime boshe, studentët tanë nuk duruan më, por u bashkuan si një grusht dhe dolën e demonstruan nëpër rrugët e Prishtinës.

Edhe pse kërkesat dhe parullat e demonstratës së parë ishin kryesisht me karakter social dhe ekonomik, ajo u cilësua si armiqësore dhe jo vetëm që nuk u përfillën fare kërkesat e studentëve, jo vetëm që nuk u mor asnjë masë për përmirësimin e gjendjes së tyre, por ndaj demonstruesve u përdor dhuna policore. Kjo dhe arrestimet që u bënë, e shtuan edhe më shumë pakënaqësinë dhe revoltën e studentëve, e cila shpërtheu me forcë e vendosmëri edhe më të madhe në demonstratën e 26 marsit. Studentëve në këtë demonstratë iu bashkua edhe një numër jo i vogël i punëtorëve, nxënësve dhe qytetarëve të tjerë. Përveç parullave të mëparshme, në përgjithësi ekonomike e sociale, kësaj here u ngritën edhe kërkesa dhe parulla politike. Demonstrata e 26 marsit ishte më popullore dhe mori edhe më shumë karakter politik.

Krerët tradhtarë, duke u hequr se gjoja po bisedojnë dhe po merren vesh me studentët demonstrues, arritën t'i mashtrojnë ata dhe të fitojnë kohë për t'u përgatitur më mirë. Gjatë kësaj kohe u mobilizuan jo vetëm forcat e policisë dhe të sigurimit, por edhe ato të ushtrisë, u mbyllën me policë nëpër fabrika e shkolla punëtorët e nxënësit (edhe pse më parë u ishte thënë të dilnin për të "pritur" stafetën), kurse një kordon i fortë policësh dhe agjentësh të armatosur deri në dhëmbë, i rrethoi demonstruesit në lagjen e tyre dhe i ndau nga masat e tjera popullore që ishin gati t'u bashkohen.

Me t'i arritur këto qëllime, tradhtarët ndërruan fytyrën dhe filluan menjëherë sulmin e egër mbi demonstruesit. Krerëve tradhtarë të Kosovës iu dukën pak gjithë ajo mizëri e zezë policësh dhe agjentësh të armatosur që u hodhën mbi demonstrues, iu dukën pak edhe repartet e ushtrisë që ishin vënë në gatishmëri dhe kërcënonin demonstruesit edhe me aeroplanë, por thirrën edhe njësi të policisë speciale të Beogradit, për të shfryrë mllefin e tyre shovinist mbi rininë tonë, mbi vëllezërit dhe motrat tona. Dhe xhelatët "udbashë" të Rankoviçit e treguan veten dhe kënaqën jo vetëm vojvodët e tyre në Nish e Beograd, por edhe krerët kuislingë në Kosovë. Në mënyrë të poshtër e tinëzare, këta kriminelë sulmuan studentët tanë të pambrojtur, kur këta ishin shpërndarë dhe ishin kthyer në konvikte, u hodhën gazra lotsjellëse, trullosëse e helmuese, dhe pastaj u hodhën mbi ta si egërsira dhe bënë masakër të vërtetë. Xhandarët e Beogradit thyenin dyer e dritare të konvikteve, rrihnin egërsisht secilin që gjenin përpara (madje edhe ata pak studentë që nuk kishin mundur t'u bashkoheshin shokëve të tyre), fyenin e shanin në mënyrën më të poshtër jo vetëm motrat dhe vëllezërit tanë studentë, por fyenin e shanin gjithë popullin shqiptar, shanin nënën shqiptare...Rrugaçët e Beogradit shkuan deri atje sa të thyejnë dollapët dhe të plaçkitin edhe ato pak para e plaçka që kishin lënë studentët në dhomat e tyre. Qindra studentëve të gjymtuar e të lënduar rëndë, jo vetëm që nuk iu dha ndihma e nevojshme mjekësore, por ata u dërguan ashtu siç ishin drejt e në qeli, ku u rrahën e u torturuan përsëri në mënyrë shtazarake.

Paria tradhtare e Kosovës jo vetëm nuk bëri asgjë për ta penguar këtë masakër mizore jo vetëm nuk ngriti zërin kundër veprimeve kriminale të çetnikëve të Rankoviçit, por e kërcënoi rininë dhe popullin tonë me masa edhe më të ashpra, po qe se guxojnë e ngritën përsëri. Krerët revizionistë në Serbi e Jugosllavi dhe këlyshët e tyre në Kosovë e mburrën hapur dhunën dhe terrorin që përdorën dhe menduan se masat represive që ata ndërmorën do të ishin, siç thoshin, "një leksion i mirë" për rininë dhe gjithë popullin tonë.

Se sa u gabuan në vlerësimet e tyre, shovinistët jugosllavë dhe tradhtarët shqiptarë u bindën shumë shpejt. Dhuna dhe terrori i egër fashist jo vetëm nuk frikësoi rininë tonë të zjarrtë dhe popullin tonë trim, por përkundrazi, e shtuan edhe më shumë pezmin dhe urrejtjen e tyre ndaj armiqve dhe tradhtarëve. Benzina që iu hodh zjarrit që kishte

shpërthyer, sigurisht që nuk do ta shuante atë, por do ta shtonte edhe më tepër. Dhe kështu ndodhi. Kupa e pakënaqësisë dhe revoltës ishte mbushur edhe më parë, por tani, pas dhunës që u përdor ndaj rinisë, ajo nuk zinte më. Në këmbë u ngrit i gjithë populli. Demonstrata e greva të shumta shpërthyen anë e kënd Kosovës. Demonstruesit hodhën parullën: "PUNETORË, STUDENTË, FSHATARË, JEMI NJË E TË PANDARË!" dhe ashtu u bë. Dhjetëra mijëra punëtorë, fshatarë, studentë, nxënës, zejtarë e intelektualë u bashkuan si një trup i vetëm në një bllok të fuqishëm e të paparë. Edhe në përvojën tonë u vërtetua ajo që mëson marksizëm-leninizmi se, kur energjitë e pashtershme të rinisë bashkohen me luftën revolucionare të klasës punëtore dhe masave të tjera popullore, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtë luftën e tyre.

Me gjithë masat e jashtëzakonshme që ndërmorën dhe me gjithë mungesën e organizimit e përgatitjeve të nevojshme të demonstruesve, forcat policore nuk mundën ta ndalin armatën e madhe të popullit që mbushi rrugët e pothuajse të gjitha qyteteve të Kosovës.

Ditën e 1 prillit, nga të gjitha anët e Prishtinës, lumenj të mëdhenj demonstruesish, duke çarë përmes reve të gazit lotsjellës, plumbave dhe bajonetave, u derdhën në qendrën e qytetit, u bashkuan dhe formuan aty një det të madh e të paparë. Pamja që mori qendra e Prishtinës sonë heroike ishte vërtet madhështore. Nuk mund të shihej aty asgjë tjetër përveç kazmave, lopatave e çekanëve që ngriheshin kërcënueshëm para selisë së tradhtarëve të Kosovës, përveç grushteve të fuqishëm të më se 20 mijë demonstruesve të të gjitha moshave e profesioneve, që ishin bashkuar në një grusht të vetëm e kolosal. Nuk mund të dëgjohej aty asgjë tjetër përveç korit madhështor të popullit që kumbonte në të gjithë qytetin, përveç brohoritjeve të fuqishme:

"KUSHTE PËR STUDENTËT", "KUSHTE PËR PUNETORËT", "ÇMIMEVE, STOP", "DUAM PUNË", "KTHENI KURBETÇINJTË", "MJAFTË SHTYPJE E SHRYTEZIM", "POSHTË ROBERIA – RROFTË LIRIA", "LIRONANI SHOKËT", "KËRKOJMË LLOGARI", "TË BURGOSURIT KOSOVARË KTHENI NË KOSOVË", "TREPÇA ËSHTË JONA", "KOSOVA ËSHTË JONA", "KOSOVA - KOSOVARËVE", "KOSOVA - REPUBLIKË", "DUAM VETEVENDOSJE", "TË GJITHË SHQIPTARËT JEMI NJË", "JEMI SHQIPTARË, S'JEMI JUGOSLLAVË", "MARKSIZËM-LENINIZEM" etj., etj.

Grushti i fuqishëm i popullit dhe kërkesat e tij të drejta u kallën tmerrin armiqve dhe tradhtarëve, të cilët pa asnjë paralajmërim, pa asnjë përpjekje për t'u marrë vesh me popullin që kërkonte të drejtat e veta, por që kërkonte edhe llogari e përgjigje për ato që kishin ndodhur më parë, iu përgjigjën popullit me një sulm tjetër akoma më brutal e më çnjerëzor se ato të mëparshmet. Kundër popullit duarthatë e të pambrojtur, në mesin e të cilit kishte edhe gra, pleq e fëmijë, udhëheqja e Jugosllavisë "socialiste", "humane", e "demokratike" urdhëroi sulmin jo vetëm me kërbaç e gazëra lotsjellëse, trullosëse e helmuese, por edhe me armë të zjarrit. Gjatë tërë natës së 1 - 2 prillit, banorët e Prishtinës dhe të një sërë qytetesh të tjera, dëgjuan të shtëna të pandërprera armësh që zbrazeshin mbi trupat e njomë dhe të uritur të bijve e bijave të popullit. Rrugët e shumë qyteteve kosovare e skuqën me gjak, por populli ynë heroik nuk u frikësua. Ai i hapi dyert dhe i strehoi bijat e bijtë e tij luftëtarë, u dha bukë, kripë e zemër e ua lidhi plagët. Populli e kuptoi atë natë edhe më mirë se kush ishin armiqtë e tij të vërtetë dhe kush ishin bijtë e tij të vërtetë.

Krerët revizionistë në Beograd dhe sidomos hyzmeqarët e tyre në Kosovë e dinin mirë se ç' zihej atë natë në zemrën e popullit e dinin se pezmi dhe zemërimi i grumbulluar kaherë do të shpërthente të nesërmen me forcë edhe më të madhe, prandaj futën në lojë edhe kartën e tyre të fundit: vunë në veprim ushtrinë, tanket dhe aviacionin, shpallën gjendjen e jashtëzakonshme dhe vendosën orën policore. Jo vetëm burgjet, por edhe stadiumet u mbushën me të burgosur, kurse konviktet e nxënësve dhe të studentëve u mbushën plot e përplot policë të ardhur nga Serbia dhe viset e tjera të Jugosllavisë. Më shumë se kaq nuk mund të bënte Jugosllavia e Titos, nuk ka bërë as Jugosllavia e kralëve, nuk ka bërë as Gjermania e Hitlerit, nuk po bën as Kili i Pinoçetit. Por as këto masa fashiste nuk e trembën popullin e pamposhtur të Kosovës kreshnike dhe rininë e tij të kuqe. Ata që kishin menduar se me tanke e aeroplanë mund t'i frikësojnë bijtë e shqipes, u mashtruan keq. Ajo që ndodhi më 2 prill, duhet të jetë mësim i mirë për çdo armik dhe tradhtar. Në Prishtinë dhe në shumë qytete të Kosovës, atë ditë punëtorët nuk dolën në punë, nxënësit nuk shkuan në mësim por dolën masovikisht në demonstrata të reja, u ngritën barrikada forcave të ushtrisë dhe të policisë armike dhe u përleshën me to me heroizëm të paparë. Në këmbë ishte i madh e i vogël. Përballë tankeve e mitralozave, populli tundte grushtin e tij të fuqishëm. Pothuajse të gjitha dyert e shtëpive ishin të hapura për bijtë e nënave. Dora e madhe e popullit u sillte vazhdimisht bukë e ujë luftëtarëve të tij. Infermierë dhe mjekë mantel dhe zemërbardhë të spitalit të Prishtinës u sillnin pa ndërprerë ushqime, fashë e barëra demonstruesve, u mjekonin dhe u lidhnin plagët trimave dhe trimëreshave... Kishin arsye ata oficerë e ushtarë të huaj që kapnin kokën dhe fërkonin sytë. Bijat e bijtë e Kosovës kreshnike, duarthatë po zemër zjarrtë, ua hapnin gjoksin plumbave të armikut, hidheshin edhe mbi tanke. Djemtë petrita të Kosovës dhe vajzat e saj shqiponja, e veshën përsëri xhamadanin e Mic Sokolit, Selam Labit dhe Vojo Kushit, i treguan edhe një herë botës se vërtet të gjithë shqiptaret e shqiptarët janë Shotë Galica e Mic Sokola.

Demonstratat që shpërthyen anë e kënd Kosovës u shuan në gjak. Qindra bij e bija të popullit u vranë, u plagosën dhe u lënduan rëndë, por lufta e drejtë e popullit për të drejta e liri nuk u shua. Në përkrahje të kërkesave të drejta të popullit, në shumë qytete të Kosovës shpërthyen greva e demonstrata të tjera, kurse vëllezërit tanë në kurbet organizuan dhe po vazhdojnë të organizojnë demonstrata të fuqishme dhe mitingje të shumta proteste nëpër vendet e ndryshme të botës. Populli ynë po e vazhdon luftën e tij në forma të ndryshme, dhe do ta vazhdojë atë deri në realizimin e plotë të kërkesave dhe aspiratave të tij, deri në fitoren e tij të plotë.

JO RINIA, POR TRADHTARËT JANË PLEHU I KOSOVËS

Fytyrën e vërtetë të armiqve të tij, robëruesve revizionistë dhe shërbëtorëve të tyre shqiptarë, populli ynë e ka njohur edhe përpara, por ngjarjet e fundit në Kosovë e kanë bërë që t'i njohë ata edhe më mirë. Edhe ata që kanë qenë të mashtruar dhe kanë pasur ndonjë iluzion ndaj krerëve të Kosovës, tani e kanë kuptuar qartë se kush janë ata, kujt i shërbejnë dhe për kënd punojnë e luftojnë ata. Me qëndrimin e tyre frikacak, kapitullues dhe krejtësisht antipopullor e antishqiptar, krerët tradhtarë dëshmuan edhe një herë se ata mbrojnë interesat e armiqve të popullit, tek të cilët janë të shitur, dhe jo aspak interesat e popullit, të cilin e kanë tradhtuar dhe e kanë shitur.

Këta sahanlëpirës jo vetëm që nuk përkrahin luftën e drejtë të popullit, jo vetëm që nuk përkrahën asnjë nga kërkesat e tij të ligjshme, por përkundrazi, morën hapur anën e armiqve më të urryer të popullit tonë, u bënë bashkautorë të forcave më të zeza rankoviçiane në veprimet e tyre mizore.

Hyzmeqarët besnikë të të huajve dhe armiq si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli, Dushan Ristiqi, Ali Shukriu, Asllan Fazlija etj., jo vetëm që u dalluan në masat e egra që u ndërmorën kundër rinisë dhe popullit tonë, por po tregohen shumë të zellshëm edhe në fushatën propagandistike që revizionistët jugosllavë kanë shpërthyer në të gjithë Jugosllavinë për t'i dënuar demonstratat e Kosovës dhe kërkesat e tyre.

Të hutuar e të sekëlldisur, duke u djersitur e duke shkumbëzuar, këta altoparlantë të bindur të shovinistëve të Beogradit, në deklaratat dhe fjalimet e tyre të pafund, nuk lanë gjë pa thënë kundër rinisë sonë, sidomos asaj studenteske, që "me demonstratat e tyne armiqësore" paskan pasur për qëllim "me e damkosë popullin shqiptar", "me e prishë vllaznimin dhe bashkimin", "me thye izllogat e me vjedhë mallin"!!!

Këta prefektë anadollakë të tipit të Qazim Mulletit, me fjalimet e tyre gjysma shqip e gjysma serbokroatisht, akoma pa u tharë gjaku rinor që u derdh, akoma pa i varrosur dhjetëra djem e vajza që i vranë mizorisht, u munduan të na bindin se bijat e bijtë e popullit genkan "rrugaqë", "nacionalistë" e "reaksionarë", se ata qenkan "agenta të të tjerëve", se rinia e pastër e Kosovës qenka "plehu i Kosovës"!!

Jo, tradhtarë, i përgjigjemi ne, gjithë populli, Fadil Hoxhës dhe bandës së tij. Bijat dhe bijtë e Kosovës kreshnike nuk e kanë damkosur dhe nuk e damkosin as sot kombin e popullin shqiptar, ata nuk janë "huliganë" e agjentë të të huajve, por janë bijtë më të mirë e më besnikë të popullit, ata nuk janë plehu i Kosovës, por floriri i Kosovës, janë lulëkuqja më e bukur e Kosovës. Jo rinia, po tradhtarët e njollosin popullin shqiptar. Jo rinia, po tradhtarët janë agjentë të të huajve. Jo rinia, por tradhtarët janë plehu i Kosovës..

Më kot çirren dhe shkumbëzojnë tradhtarët duke thënë "rinia është e jona", "rinia do të jetë me ne" etj. Jo, rinia revolucionare e Kosovës kurrë nuk ka qenë e tradhtarëve dhe e armiqve të saj; kurrë nuk ka qenë me ta, nuk është sot dhe as që do të jetë ndonjëherë. Rinia e kuqe e Kosovës ka qenë, është dhe do të jetë e popullit dhe me popullin. Ajo ka zgjedhur rrugën e saj të vetme, rrugën që i tregon marksizëm-leninizmi, rrugën që i kanë lënë amanet mijëra yje të pashuar, që derdhën gjakun për liri e socializëm të vërtetë, rrugën që ia lanë amanet edhe dëshmorët e demonstratave të fundit, që ranë me heroizëm për të mos vdekur kurrë.

Nuk ka forcë në botë që mund ta largojë rininë e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare nga kjo rrugë e lavdishme.

DEMONSTRATAT E KOSOVËS JANË VEPËR E POPULLIT TË SAJ

Propaganda revizioniste në Jugosllavi dhe Kosovë mundohet t'i paraqesë demonstratat e grevat e Kosovës si gjoja "vepër diversioniste të forcave armiqësore të brendshme e të jashtme", të cilat "me organizim mjeshtëror" dhe "me parulla demagogjike" ia paskan arritur "t'i mashtrojnë masat dhe t'i hedhin në luftë"!

Në këtë mënyrë revizionistët jugosllavë e shërbëtorët e tyre shqiptarë duan t'i fshehin shkaqet e vërteta që e shtynë popullin të ngritet në greva e demonstrata. Ata e dinë mirë se këto shkaqe janë në pozitën e vështirë dhe të pabarabartë të Kosovës dhe popullit të saj, në shtypjen e shfrytëzimin e egër dhe të shumëfishtë që ushtrohet mbi masat e saj punonjëse, në mungesën e një sërë të drejtash dhe lirish kombëtare e demokratike, në pakënaqësinë e madhe që mbretëron kudo dhe që po shtohet çdo ditë, por i fshehin ato, sepse pikërisht ata dhe politika e tyre janë shkaktarë të një gjendjeje të këtillë dhe rrjedhimisht edhe të demonstratave e të grevave që u bënë në Kosovë. Po të mos ishte kjo gjendje kaq e vështirë dhe populli të jetonte vërtet i lirë e i lumtur, siç duan të thonë ata, atëherë asnjë forcë e brendshme as e jashtme nuk do të mund ta nxirrte popullin në rrugë, sado që të përdornin "parulla demagogjike". Përse nuk po bëhen greva e demonstrata në Shqipërinë socialiste, ku populli jeton vërtet i lirë dhe i lumtur, por

bëhen sidomos në vende të tilla borgjeze, fashiste ose revizioniste si Spanja, Italia, Jugosllavia, Turqia, Polonia etj.?

Në çdo fjalim e artikull rreth demonstratave thuhet se "masat u mashtruan nga parullat demagogjike që u hodhën", por nuk thuhet se pse ato parulla na qenkan "demagogji ke" dhe, deri sa qenkan të tilla, si u bë që populli të jetë aq "mendjelehtë" (siç e quajtën tradhtarët) sa jo vetëm që përkrahu që në fillim parullat e kërkesat e demonstruesve, por po i përkrah ato edhe tani, bile akoma më me forcë? Është interesant të dihet gjithashtu, përse krerët revizionistë e kalemxhinjtë e tyre nuk i zënë fare në gojë edhe parullat e tilla të demonstruesve si "DUAM PUNË", "KTHENI KURBETÇINJTË", "ÇMIMEVE, STOP", "LIRONANI SHOKËT", "TË BURGOSURIT KOSOVARË, KTHENI NË KOSOVË" etj.? Pse ata nuk po e shpjegojnë "karakterin demagogjik dhe armiqësor" edhe të këtyre parullave dhe pse nuk i zgjidhin këto probleme të mëdha, në mënyrë që "forcat armiqësore" të mos mund t'i "mashtronin" masat herëve të tjera?

Duke i paraqitur demonstratat dhe grevat e fundit në Kosovë si vepër të grupeve e forcave të ndryshme të organizuara, revizionistët u bëjnë atyre një nder të madh, e madje edhe të tepruar. Pararoja e organizuar në Kosovë, komunistët, revolucionarët dhe patriotët e vërtetë, pa dyshim që kanë luajtur rol të rëndësishëm në këtë lëvizje revolucionare, por, duhet thënë hapur se detyrën e saj në organizimin dhe udhëheqjen e masave, ajo ka qenë dashur dhe ka mundur ta kryente edhe më mirë. Grevat dhe demonstratat në Kosovë, më shumë se të organizuara ishin spontane. Ato nuk janë dhe nuk mund të ishin vepër e askujt tjetër, por e vetë popullit të saj heroik. Ai është iniciatori, udhëheqësi dhe organizatori kryesor.

Këtë të vërtetë të madhe e dinë mirë edhe revizionistët e tradhtarët, dhe pikërisht kjo i tmerron ata. Pikërisht këtë të vërtetë të rëndësishme duan ta fshehin ata, kur ngjarjet e fundit në Kosovë ua mveshin "forcave reaksionare, dogmatike e staliniste".

Është për t'u theksuar edhe qëllimi tjetër i poshtër i krerëve dhe kalemxhinjve revizionistë, të cilët, edhe pse e dinë mirë orientimin e shëndoshë marksist--leninist të rinisë dhe të demonstruesve, edhe pse e dinë sigurisht se gjatë gjithë demonstratave brohoritej pa ndërprerë e nga të gjithë për marksizëm-leninizmin, për socializmin e vërtetë dhe internacionalizmin proletar, mundohen t'i paraqesin demonstratat e Kosovës si vepër edhe të reaksionit antikomunist shqiptar. Duke qenë të bindur se mbeturinat e reaksionit zogist, ballist etj., nuk kanë pothuajse kurrfarë influence në popullin e sidomos në rininë e Kosovës dhe të viseve të tjera të banuara me shqiptarë, revizionistët mundohen ta bindin popullin tonë se pikërisht këta reaksionarë qëndronin në krye të demonstratave dhe jo bijtë e popullit, komunistët, revolucionarët dhe patriotët e vërtetë. Në këtë mënyrë ata orvaten t'i shkëpusin masat popullore nga pararoja e tyre komuniste dhe revolucionare që në të vërtetë, siç treguan ngjarjet e fundit, janë një dhe të pandarë. Propaganda e tillë e poshtër është edhe një shërbim i mirë i revizionistëve për reaksionin antikomunist shqiptar, i cili është shumë i interesuar për të krijuar bindjen se ai është akoma gjallë dhe se ka ende ndikim në popullin shqiptar.

Duke folur për demonstruesit, tradhtari Fadil Hoxha tha se i njeh ata që nga lufta, se gjatë luftës ata paskan qenë bashkëpunëtorë të okupatorit fashist, kurse pas luftës qenkan "agenta" të agjencive të huaja të spiunazhit, "armiq jo vetëm të Jugosllavisë por edhe të Shqipërisë" etj., etj. Lind pyetja: a thua nuk e di Fadil Hoxha se shumica e demonstruesve janë të rinj që kanë lindur pas luftës, prandaj s'ka pasur si t'i njohë në luftë, se edhe ata demonstrues që kanë qenë në luftë, nuk kanë qenë bashkëpunëtorë të okupatorit, por kanë qenë partizanë, ndoshta edhe në aradhën e Fadil Hoxhës? Paska

harruar vallë Fadil Hoxha se kriminelët dhe emigrantët që kanë ikur nga Shqipëria, e për të cilët flet ai, janë strehuar pikërisht në Kosovë, se pikërisht nga Kosova e Jugosllavia i kanë nisur ata Dushan Mugosha e Rankoviçi për të vrarë kuadro të Partisë, gra e fëmijë në Shqipërinë socialiste, në kohën kur në Kosovë UDB-ja famëkeqe bënte kërdinë mbi shqiptarët. Fadil Hoxha dhe shokët e tij këto edhe mund t'i "harrojnë", por populli nuk i harron kurrë. Prandaj populli nuk mashtrohet nga shpifjet dhe trillimet e tradhtarëve, sado që të hiqen ata si "luftëtarë" të rrallë dhe "burra të ngritun shyptarë".

Nuk pi ujë as përpjekja për t'i paraqitur ngjarjet e Kosovës si vepër të superfuqive imperialiste dhe demonstruesit si përkrahës të njërës apo tjetrës superfuqi. Agjentë të superfuqive janë revizionistët jugosllavë, që gjithmonë u kanë shërbyer atyre dhe po u shërbejnë edhe tani me propagandën që po bëjnë rreth demonstratave, dhe jo populli i Kosovës e bijtë e tij, të cilët jo vetëm s`kanë pasur as iluzionin më të vogël ndaj ty re, por i kanë konsideruar gjithmonë dhe i konsiderojnë edhe sot si armiq të tyre, si armiqtë më të mëdhenj të popujve, të revolucionit dhe të socializmit.

KUSH PO E NXITË NACIONALIZMIN?

Ajo që bie në sy më së shumti në fushatën e gjerë propagandistike që ka shpërthyer në të gjithë Jugosllavinë kundër demonstratave të Kosovës, kundër demonstruesve e madje edhe kundër të gjithë popullit tonë, janë akuzat e shumta për "nacionalizëm", "irredentizëm", "separatizëm" e madje edhe për "shovinizëm shqiptaromadh". Pa hyrë në argumentimin e asaj që thonë, revizionistë dhe tradhtarë të shumtë, që nga më të mëdhenjtë e deri te më të vegjlit, çirren me të madhe se gjoja demonstratat paskan pasur për qëllim të nxisin nacionalizmin dhe shovinizmin shqiptar, të mbjellin mosbesim, përçarje dhe urrejtje ndërnacionale në Kosovë dhe Jugosllavi, të prishin vëllazërimin e bashkimin e tyre dhe gati sa s'thonë se demonstruesit paskan dashur ta pushtojnë gjithë Jugosllavinë!!.

Po vallë, ç' nacionalizëm e ç' shovinizëm kishte në grevat dhe demonstratat që bëri populli ynë në Kosovë? Ç' nacionalizëm e ç' shovinizëm ka në parullat kundër papunësisë, kurbetit e ngritjes së çmimeve? Ç' kishte nacionaliste e shoviniste në kërkesën e drejtë për kthimin në Kosovë të të burgosurve kosovarë, ose në kërkesën gjithashtu të drejtë që Kosova dhe viset e tjera shqiptare të çlirohen nga zgjedha koloniale, që Krahinës së Kosovës t'i jepet statusi i Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave? Ç'e keqe u erdhi popujve jugosllavë në Kosovë e Jugosllavi nga demonstratat që u bënë dhe ç'të keqe do t'u sillte atyre realizimi i kërkesave të drejta të demonstruesve? Asnjë, absolutisht asnjë të keqe. Lufta e studentëve, e punëtorëve dhe e gjithë popullit të Kosovës për të drejta e liri, jo vetëm që nuk drejtohet aspak kundër popujve ,jugosllavë, jo vetëm që nuk u sjell atyre asgjë të keqe, po përkundrazi, ajo e ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë luftën që bëjnë edhe punëtorët dhe masat e tjera punonjëse jugosllave për të drejta e socializëm. Aq më shumë kjo vlen për pakicat serbe, malazeze, turke etj. në Kosovë, të cilat lirinë e tyre nuk mund ta shohin në shtypjen dhe robërimin e popullit shqiptar, por përkundrazi, në lirinë e tij të plotë.

Populli shqiptar, në historinë e tij të gjatë ka vuajtur shumë nga pushtuesit e huaj, gjithmonë ka luftuar kundër shovinistëve e zullumçarëve të huaj, por ai vetë kurrë nuk ka qenë pushtues, kurrë nuk ka qenë shovinist e zullumçar ndaj të tjerëve. Ai kurdoherë ka ditur të bëjë dallimin mes popujve të tjerë, me të cilët ka jetuar në miqësi e fqinjësi të mirë, dhe krerëve të tyre shovinistë, kundër të cilëve ka luftuar pa mëshirë. Jo vetëm në

Luftën Nacionalçlirimtare, por edhe në luftën patriotike të Azem Bejtës e Isa Boletinit, populli ka dënuar çdo lloj dhune e zullumi ndaj pjesëtarëve të pafajshëm të kombësive joshqiptare.

Shovinistë e zullumçarë nuk kanë qenë kurrë as të parët tanë, aq më pak mund të jenë bijtë e tyre që po rriten e edukohen me librat e Marksit dhe të Leninit në gji. Kjo u vërtetua edhe në ngjarjet e fundit në Kosovë. Gjatë demonstratave jo vetëm që nuk u hodh asnjë parullë kundër popujve të tjerë, po përkundrazi, më se një herë u theksua qartë dallimi mes popujve jugosllavë e krerëve të tyre shovinistë dhe revizionistë.

Gjatë demonstratave jo vetëm që nuk u dëm tua popullsia joshqiptare, por pati edhe serbë, malazez, turq, romë etj. që iu bashkuan grevave dhe demonstratave, ose u solidarizuan me to, strehuan demonstruesit, u dhanë bukë dhe ua lidhën plagët.

Populli shqiptar i Kosovës është patriot, por jo, kurrë, shovinist. Shovinistë janë ata që e kanë robëruar atë, e kanë copëtuar dhe e mbajnë me dhunë nën zgjedhë, e jo populli ynë që lufton për të drejtat dhe liri në e tij, pa u rënë më qafë të tjerëve. Shovinistë janë ata që sjellin polici, ushtri e tanke të huaja në Kosovë, ata që vrasin, gjymtojnë, rrahin e poshtërojnë popullin, e jo ata që ngrenë zërin dhe grushtet kundër një mizorie të tillë. Përçarjen dhe urrejtjen e rrezikshme ndërnacionale nuk e nxit populli i Kosovës dhe rinia e tij, por udhëheqja revizioniste në Jugosllavi e në Kosovë, e cila, duke shtrembëruar të vërtetën rreth Kosovës dhe luftës së saj të drejtë, orvatet të nxitë një frymë antishqiptare kudo në Jugosllavi. Jo ne, por revizionistët jugosllavë kanë nxitur dhe po nxisin konflikte ndërnacionale në mënyrë që t'i bëjnë masat punonjëse të harrojnë problemet e tyre të mëdha ekonomike e sociale, për të lënë në plan të dytë luftën e tyre klasore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist.

Por, popujt e Jugosllavisë dhe klasa e ty re punëtore nuk do të lejojnë të bien në kurthin ku duan t'i hedhin revizionistët. Armik i tyre nuk është dhe nuk do të jetë kurrë populli shqiptar që lufton për lirinë e tij, por borgjezia revizioniste që i shtyp e i shfrytëzon edhe ata egërsisht. Lirinë e socializmin e vërtetë, ata do t'i arrijnë vetëm nën parullën leniniste: "PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE DHE POPUJ TË SHTYPUR, BASHKOHUNI “.

RROFTË REPUBLIKA SOCIALISTE E KOSOVËS

Populli shqiptar në Jugosllavi edhe më parë, në forma e rrugë të ndryshme, ka kërkuar zgjidhje të drejtë të çështjes së tij kombëtare, ka kërkuar që atij t'i njihet e drejta për të vendosur vetë për fatin e tij.

Për këtë të drejtë ka luftuar me shekuj shqiptari. Populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara me shqiptarë u ngrit në Luftën antifashiste Nacionalçlirimtare, i bindur se pas fitores së saj, edhe ai do të fitonte të drejtën për të qenë i lirë dhe i pavarur. Udhëheqja e atëhershme e PKJ-së dhe vetë Titoja, më se një herë kishin shpallur se pas luftës do ju njihnin dhe garantonin lirinë të gjithë popujve brenda kufijve të Jugosllavisë së vjetër, edhe popullit shqiptar, të drejtën për vetëvendosje dhe shkëputje. Por, pas luftës, ata jo vetëm nuk e garantuan këtë të drejtë por e shkelën atë me gjak. Ata që guxuan ta kërkojnë këtë të drejtë të ligjshme dhe të premtuar, u shpallën armiq, u vranë, u ndoqën dhe u burgosën. Tjetërkush vendosi për fatin e popullit tonë të robëruar. Dihet botërisht se në Mbledhjen e AVNOJ-it, ku u vendos edhe për fatin e popullit shqiptar dhe të tokave të tij, që fuqitë e mëdha imperialiste padrejtësisht i kishin ndarë nga shteti shqip tar dhe i kishin lënë nën zgjedhën e Serbisë dhe Malit të Zi, nuk kishte asnjë delegat shqiptar.

Megjithëkëtë, revizionistët dhe tradhtarët thonë se populli ynë paska shprehur vetë vullnetin e tij që të jetë kështu siç është. Ç' vullnet i çuditshëm! Shqiptarët që rrojnë në tokat e tyre (dhe përbëjnë aty shumicën absolute të popullsisë) paskan dashur dhe paskan shprehur vullnetin (për hatër të Titos e Rankoviçit!) jo vetëm të mbeten në kuadrin e Jugosllavisë, por edhe të copëtohen një pjesë në Kosovën autonome, një pjesë në Maqedoni, një në Serbinë e ngushtë dhe një pjesë tjetër në Republikën e Malit të Zi'. (Mjerisht ishin larg Kosovës Kroacia e Sllovenia, se sigurisht edhe atyre "do t'u takonte" ndonjë copë toke shqiptare!)

Por vallë a mund t'u besojë kush përrallave të tilla, a mund të mashtrojnë kënd ato? Jo, ato jo vetëm nuk shiten tek asnjë shqiptar, por nuk shiten as te popujt jugosllavë dhe as te popujt e botës.

Nëse populli i Kosovës paska vendosur vetë që të jetë kështu si është dhe nëse ai e paska lidhur fatin e tij me Jugosllavinë me LKJ-në dhe me Titon, atëherë pse ai nuk gëzon të drejtën për vetëvendosje, që Kushtetuta e Jugosllavisë u siguron popujve të tjerë? Pse të mos i lejohet që të vendosë vetë për fatin e tij, kur ai, siç thonë revizionistët, "dashka të jetë kështu siç është" Është e qartë se të gjitha që thonë revizionistët jugosllavë për "vëllazërim-bashkimin", për "barazinë" e "bashkëjetesën", për "zgjidhjen e drejtë, bile ideale, të çështjes kombëtare" s' janë tjetër veçse demagogji, veçse një rrenë e madhe.

Thuhet se në Jugosllavi "çështja kombëtare është zgjidhur në mënyrë marksiste", bile kryerevizionisti Tito, për "kontributin e madh" që paska dhënë në këtë fushë, është shpallur edhe doktor nderi, për ironi, pikërisht në Universitetin e Kosovës! Por, vallë ç' ka marksiste në zgjidhjen që revizionistët i kanë bërë çështjes kombëtare në .Jugosllavi, zgjidhje që ndryshon fare pak nga "zgjidhja" që i kishin bërë asaj kralët e Jugosllavisë së vjetër.

"Gjithë kombeve, theksonte Lenini, duhet t'u njihet e drejta që të shkëputen lirisht dhe të formojnë një shtet të pavarur. Mohimi i kësaj të drejte dhe mos marrja masave që ta garantojnë zbatimin e saj në praktikë, do të thotë përkrahje e politikës së pushtimeve dhe të aneksimeve". (V. I. Lenin, Vepra të zgjedhura. Vëll. ll, f. 491)

Kështu thoshte Lenini i madh, por krejt ndryshe veprojnë revizionistët titistë, të cilët jo vetëm që nuk i lejojnë popullit shqiptar në Jugosllavi të drejtën për shkëputje, siç kishin premtuar gjatë luftës, por e shtypin me dhunë dhe tanke edhe kërkesën e tij të drejtë për të fituar republikën e tyre në kuadrin e Jugosllavisë.

Kërkesa e ligjshme e popullit tonë të robëruar për të dalë nga zgjedha e huaj dhe për të fituar statusin e republikës, u vlerësua nga udhëheqja revizioniste e Beogradit e nga sahanlëpirësit shqiptarë si "armiqësore" "nacionaliste" e "irredentiste", si "reaksionare" e "kundërrevolucionare". Por, vallë ku qëndron karakteri "armiqësor", "reaksionar" e "kundërrevolucionar" i kësaj kërkese të popullit? Shqiptarët në Jugosllavi jetojnë në tokat e tyre që janë një territor i përbashkët (pavarësisht se të tjerët e kanë ndarë atë siç kanë dashur) dhe përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë, ata kanë një gjuhë, një të kaluar historike, një formim shpirtëror; ata janë një popull dhe një komb. Për nga numri i popullsisë dhe madhësia e territorit ku ata jetojnë (dhe kanë jetuar brez pas brezi), shqiptarët në Jugosllavi bëjnë jo më pak por sa rreth 3 republika si ajo e Malit të Zi; pse atëherë, ata nuk paskan të drejtë të kenë Republikën e tyre të federuar ?

Propaganda revizioniste e akuzon parullën "Kosova - Republikë!" se gjoja ajo nxit nacionalizmin, separatizmin e shovinizmin, thua se në Jugosllavi nuk paska republika të tjera! Sipas kësaj del se të gjithë ata popuj që kërkojnë vetëvendosje, e të mos flasim për shkëputje, qenkan "nacionalistë" e "shovinistë", del se "nxitës" i nacionalizmit dhe shovinizmit paska qenë edhe Lenini i madh, i cili shkruante:

"Të akuzosh përkrahësit e lirisë së vetëvendosjes, domethënë të lirisë së shkëputjes, se inkurajojnë separatizmin, është po aq absurde dhe po aq hipokrite, si të akuzosh përkrahësit e lirisë së shkurorëzimit se inkurajojnë shkatërrimin e lidhjeve familjare. Ashtu si ngrihen në shoqërinë borgjeze kundër lirisë së shkurorëzimit mbrojtësit e privilegjeve dhe të shitjes së gruas, në të cilat mbështetet martesa borgjeze, po kështu edhe mohimi që i bëhet në një shtet kapitalist lirisë së vetëvendosjes, domethënë, lirisë së shkëputjes së kombeve, s'është veçse mbrojtje e privilegjeve të kombit sundues dhe e metodave policore të qeverisjes në dëm të metodave demokratike". (Po aty, faqe 108)

Krerë të ndryshëm e "teoricienë" jugosllavë dhe sidomos "politikanë" e "koka të mëdha të shkencës" në Kosovë, mundohen ta bindin me çdo mënyrë popullin tonë se ai është krejt i lirë, i barabartë, i pavarur dhe bile edhe i privilegjuar, se autonomia që ka Kosova, nuk ka kurrfarë dallimi nga republika etj., etj. Interesant popull ky yni! Jeton në "liri" e "barazi" të plotë dhe nuk i sheh ato! (Kështu nuk shihte ai as "lirinë" dhe "qytetërimin" që i kishte siguruar atij dikur fashizmi!) Jo, revizionistë, tradhtarë e kalemxhinj të tyre, kudo që të jeni! Populli ynë nuk është injorant, siç kujtoni ju, sa të gënje het aq lehtë sa që të zezës t'i thotë e bardhë, që robërisë, shtypjes e shfrytëzimit t'i thotë liri e barazi. Jo'. Populli ynë po e sheh gjendjen e tij të vërtetë, po e sheh shtypjen, shfrytëzimin dhe diskriminimin e egër që ushtrohet ndaj tij, po e sheh edhe mohimin e të drejtave më elementare kombëtare e demokratike, prandaj edhe po e ngrit grushtin. Revizionistët mund të thonë ç' të duan për lirinë, por, siç thoshte Lenini, nuk mund të ketë për një kombësi liri më të madhe sesa liria e shkëputjes, liria për të formuar një shtet kombëtar të pavarur. Edhe sikur gjithçka tjetër të ishte në rregull, mungesa e kësaj të drejte dhe lirie do të thotë edhe mungesë ose kufizim i të gjitha të drejtave dhe lirive të tjera.

Po të jetë se statusi i autonomisë qenka e njëjta gjë me statusin e Republikës, siç po thuhet shpesh, atëherë përse nuk realizohet kërkesa e popullit të Kosovës për Republikë, edhe pse për të po derdhet gjak? Se çfarë është, në të vërtetë, "autonomia" që ka Kosova, se sa është ajo në fakt subjekt i pavarur i Federatës dhe sa është në duart e kosovarëve, dëshmuan më së miri ngjarjet e fundit në Kosovë. Karakteri revolucionar ose reaksionar i një kërkese kombëtare, siç mëson marksizëm-leninizmi, qëndron në faktin nëse realizimi i saj do ta ndihmonte ose do ta pengonte zhvillimin e përgjithshëm të atij populli, nëse do ta ndihmonte ose do ta pengonte çështjen e revolucionit dhe të socializmit. Cili është ai që mund të thotë (dhe të mos gënjejë) se çlirimi nga zgjedha koloniale nuk do ta ndihmonte zhvillimin e përgjithshëm dhe çështjen e socializmit, jo vetëm në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, por edhe në të gjithë Jugosllavinë.

Duke u përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, Stane Dolanci tha në mes të tjerash, se Republika e Kosovës do të ishte shkatërrim i Jugosllavisë, dhe këtij avazi po i bihet edhe në shumë artikuj e fjalime të tjera, duke paraqitur shkatërrimin e Federatës Jugosllave edhe si qëllimin kryesor të demonstratave të Kosovës?

Pikëpamjet e këtilla rreth çështjes kombëtare Lenini në kohën e tij i hidhte poshtë me vendosmëri, kurse autorët e tyre i quante "maskarenj" dhe "socialshovinistë". Në veprën e tij "Mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje", Lenini u përgjigjej kështu pikëpamjeve të këtilla:

"Z. Kokoshkin kërkon të na bindë se njohja e se drejtës së shkëputjes shton rrezikun e "shkatërrimit të shtetit". "Kjo është pikëpamja e xhandarit Minrecov, me devizën e tij: 'Kape e mos e lësho'. Nga pikëpamja e demokracisë në përgjithësi ndodh

pikërisht e kundërta: njohja e së drejtës për shkëputje e pakëson rrezikun e shkatërrimit të shtetit ". (Po aty, faqe 107)

Shteti Jugosllav dhe çdo shtet tjetër shumëkombësh ka rrezik të shkatërrohet jo duke u dhënë popujve të shtypur lirinë, por duke ua mohuar atë, duke ua mohuar të drejtën që ata të vendosin vetë për fatin e tyre, duke u përpjekur për t'i mbajtur ata me dhunë në zgjedhën koloniale. Edhe sikur robëria e Kosovës të ishte shtylla që e mban Jugosllavi në dhe po të jetë se vënia në vend e padrejtësive që i janë bërë dhe po i bëhen popullit tonë do të thoshte shkatërrim i shtet it jugosllav, atëherë del se ky farë shteti do të shkatërrohet patjetër dhe do të duhej shkatërruar, pasi është ndërtuar keq, pasi është ngritur në dëm të lirisë së popujve të tjerë.

Duke i mbrojtur "zgjidhjet" që i kanë bërë çështjes kombëtare të Kosovës fuqitë e mëdha imperialiste dhe qarqet monarkiste të Serbisë e Malit të Zi, revizionistët jugosllavë shkelin me të dy këmbët mësimet e marksizëm-leninizmit mbi çështjen kombëtare. "Politika e Marksit dhe e Engelsit në çështjen irlandeze, thekson Lenini, ka dhënë shembullin më të madh që ka edhe sot një rëndësi praktike të pashoqe për mënyrën se si duhet të sillet proletariati i kombeve shtypëse kundrejt lëvizjeve kombëtare - ka dhënë një paralajmërim kundër "zellit servil" me të cilin mikroborgjezët e të gjitha vendeve, të të gjitha ngjyrave dhe të gjitha gjuhëve shpejtojnë ta cilësojnë si utopik çdo ndryshim të kufijve të shteteve që janë krijuar me anë të forcës dhe me anë të privilegjeve të çifligarëve dhe të borgjezisë së një kombi". (Po aty, faqe 128)

Me qëllim të armiqësimit të popujve jugosllavë me popullin tonë, klika shoviniste e Beogradit mundohet t'i paraqesë demonstratat e Kosovës dhe sidomos kërkesën për republikë si "sulm të drejtuar kundër popullit serb, malazez, maqedonas dhe popujve të tjerë të Jugosllavisë". Po për këtë qëllim, revizionistët kanë organizuar nëpër qytete të ndryshme të Jugosllavisë edhe tubime e protesta nën parullën shoviniste: "zhivot damo Kosovo ne damo!" (Jetën e japim - Kosovën s'e japim!). Por, kralët e rinj të Beogradit dhe ata që u shkojnë pas atyre duhet ta dinë mirë se Kosova nuk është çiflig i tyre dhe i askujt në botë. Kosova është e Kosovarëve dhe vetëm kosovarët kanë të drejtë të vendosin për fatin e saj.

Kërkesa e drejtë e popullit tonë për ta hequr qafe zgjedhën koloniale, jo vetëm që nuk drejtohet kundër interesave të masave popullore në Serbi, Maqedoni e Mal të Zi, po përkundrazi, ajo është edhe në interes të tyre, prandaj edhe duhet ta përkrahin. Robërimi i popullit tonë, jo vetëm nuk u sjell asgjë të mirë popujve jugosllavë, po përkundrazi, siç e ka shpjeguar Engelsi, është fatkeqësi e madhe për një popull robërimi, nga ana e borgjezisë së tij, i një populli tjetër.

"Krejt pavarësisht nga çdo frazeologji 'internacionaliste' dhe 'humanitare' për 'drejtësi kundrejt Irlandës' - shkruante Marksi, duke folur për dënimin që i sillte revolucionit në Angli robërimi i Irlandës, - interesi i drejtpërdrejtë absolut i klasës punëtore angleze kërkon prishjen e lidhjes së saj të tanishme me Irlandën". "Klasa punëtore angleze nuk do të mund të bëjë asgjë deri sa të mos ketë shpëtuar nga Irlanda... Reaksioni anglez në Angli, i ka rrënjët në robërimin e Irlandës". (Kursivi është i Marksit)

Këtë të vërtetë pa dyshim që do ta kuptojnë proletariati dhe popujt jugosllavë duke ndjekur traditat internacionaliste të Dimitrije Tucoviqit, Kosta Novakoviqit e Miladin Popoviqit, do të mbajnë qëndrim të drejtë ndaj luftës së drejtë të popullit tonë për liri, e nuk do të lejojnë që të mashtrohen dhe të bëhen rezervë e borgjezisë së tyre, të njohur për shovinizmin e saj të theksuar antishqiptar.

Parulla "RROFTË REBUBLIKA SOCIALISTE E KOSOVES" është e drejtë, prandaj edhe përkrahet nga çdo shqiptar i ndershëm. Kërkesën e tij të ligjshme për Republikë nuk mund t'ia shuajë popullit tonë asnjë lloj propagande e frazeologjie, sado e ashpër ose kërcënuese që të jetë, ashtu siç nuk mund t'ia shuajnë as masat e egra të dhunës e terrorit, as plumbat dhe tanket e diktaturës revizioniste. Për realizimin e kësaj të drejte të ligjshme, populli ynë trim e patriot do të luftojë pa marrë parasysh asnjë sakrificë, deri sa në Kushtetutë të shohë të shkruar: REPUBLIKA SOCIALISTE E KOSOVËS.

KRIMINELËT AKUZOJNË PËR VANDALIZËM

Me qëllim të diskreditimit të rinisë dhe të gjithë popullit tonë, propaganda revizioniste në Jugosllavi dhe në Kosovë nuk po lë gjë pa shpifur e trilluar kundër demonstruesve. Sipas asaj që thonë qarqet revizioniste, demonstratat nuk i bëri populli, po "nja 200-300 rrugaçe ,studentë të dobët e punëtorë të këqij", të cilët nuk paskan pasur asnjë qëllim tjetër, pos "të shkaktojnë incidente e gjakderdhje, të shkatërrojnë pronën shoqërore, të thyejnë shitoret dhe të vjedhin mallin". Ata jo vetëm që i paskan "detyruar njerëzit me dhunë që të dilnin në demonstrata", por edhe paskan "vënë përpara fëmijë me qëllim që organet policore të mos mund të shtien mbi ta"!!! Ç`shpifje e ç' trillime të poshtra! Me qëllim që ta fshehin të vërtetën që po i tmerron, udhëheqja më e lartë revizioniste në Jugosllavi e Kosovë detyrohet, të shpifë në mënyrë kaq naive e të paskrupullt, të gënjejë kaq hapur e për qielli sa vërtet bëhet jo vetëm idiote, por edhe qesharake. Në këtë mënyrë revizionistët përpiqen të gënjejnë të tjerët, por gënjejnë veten. Gënjeshtrat e tyre janë aq naive e fëmijërore, sa nuk mund ta mashtrojnë askënd.

Jo vetëm populli i Kosovës që e ka parë e njeh mirë të vërtetën, por edhe çdo i huaj që kurrë nuk ka dëgjuar për Kosovën dhe nuk ka asnjë ide për popullin dhe rininë e saj, nuk mund të besojë shpifje e trillime të tilla. Çdokush mund të bëjë pyetje: Si është e mundur që disa qindra "huliganë" të bëjnë, gjatë një muaji rresht, greva e demonstrata të njëpasnjëshme, bile në të gjithë Kosovën? Si ia arritën disa "rrugaqë" që të nxjerrin "me dhunë" masat në demonstrata, kurse revizionistët, me gjithë dhunën e presionet që vërtet ushtrojnë mbi masat, me gjithë organet e shumta që kanë dhe me gjithë demagogjinë e tyre të njohur, nuk ia arritën të nxjerrin popullin në mitingjet që organizoheshin (me një numër të vogël filloristësh) për të "pritur" stafetën, pikërisht ato ditë kur bëheshin edhe demonstratat?

Meqë shumica dërmuese e demonstruesve paskan qenë të mashtruar dhe meqë rinia dhe gjithë populli i Kosovës qenka me krerët "politiçarë" të Kosovës, atëherë, përse nuk dolën këta "burra" që t'i bindin masat se janë mashtruar dhe të "demaskonin" karakterin "armiqësor" dhe "kundërrevolucionar" të demonstratave dhe parullave të tyre, por dhanë urdhër që të grihen me automatikë edhe njerëzit që paskan qenë "të mashtruar"? Si nuk u mjaftoi krerëve kosovarë gjithë ajo polici, gjithë ai sigurim e gjithë ai sistem i "vetëmbrojtjes shoqërore", për të qetësuar "një grusht demonstruesish" (aq më tepër kur populli, siç thonë ata, jo vetëm që nuk i paska përkrahur, por edhe i paska "pështyrë" dhe iu paska "kundërvënë edhe fizikisht" !? Si nuk u mjaftoi as gjithë ajo polici që sollën nga Serbia, por u detyruan të fusin në veprim edhe ushtrinë me tanke e avionë, të shpallin gjendjen e jashtëzakonshme dhe të vendosin orën policore?! Si ndodhi që demonstruesit të shtien në njësitë e policisë dhe policia të mos shtjerë në demonstrues, e megjithatë nga demonstruesit të mbesin shumë të vrarë e të plagosur me armë të policisë?...

Është e qartë se demonstratat ishin popullore, se me demonstruesit ishte i gjithë populli, se populli kishte dalë të kërkonte në mënyrë paqësore të drejtat e tij, ndryshe nuk

do të ndaheshin aq lehtë armiqtë që guxuan ta sulmojnë me armë popullin e paarmatosur. Gjithkush e sheh se me zhurmën e ma dhe që bëhet rreth gjoja brutalitetit dhe vandalizmit të demonstruesve, bëhen përpjekje për të fshehur brutalitetin dhe vandalizmin më shumë se fashist të diktaturës revizioniste, për t'ua hedhur demonstruesve fajin e përgjegjësinë për dhunën e paparë që përdor, për gjakun që u derdh.

Natyrisht, në demonstrata të tilla të mëdha popullore, ndodh të bëhet edhe ndonjë veprim i nxituar, i pamatur dhe i panevojshëm. Edhe në demonstratat e fundit, nuk përjashtohet të jetë bërë ndonjë veprim i tillë, por karakteristikë e përgjithshme e demonstratave të Kosovës ishte rregulli, durimi, pjekuria dhe gjakftohtësia shembullore. Populli kishte dalë në demonstratë dhe jo në kryengritje, ai kërkonte të drejta e liri, dhe jo gjakderdhje, prandaj ai edhe ngri ti parullën "PA DEMTIME!", "PA INCIDENTE!", dhe vërtet, pothuajse asnjë dëm, asnjë incident nuk u bë nga ana e demonstruesve para se të sulmoheshin nga policia. Nuk do të bëheshin kurrë dëmet që u bënë, nuk do të derdhej as gjaku që u derdh, sikur ndaj popullit demonstrues të mos përdorej që në fillim dhuna policore dhe, sidomos, sikur të mos ndërhynte policia e huaj, e cila me veprimet e saj shoviniste të padëgjuara bëri që jo vetëm populli, por edhe policët kosovarë të përlesheshin me ta.

Është e vërtetë se në demonstrata dhe sidomos në ato të fundit, kishin dalë edhe një numër i madh fëmijësh, por ky fakt nuk i pengoi aspak korbat gjakatarë që të derdhin mbi ta breshëri plumbash e bombash trullosë se dhe lotsjellëse. Këto veprime çnjerëzore e kriminale, të denja vetëm për fashistët gjakatarë, propaganda revizioniste, tani po mundohet t'i arsyetojë duke shpifur në mënyrë të poshtër sikur demonstruesit gjoja i paskan nxjerrë me dhunë fëmijët në demonstrata, me qëllim që të fshihen pas tyre edhe kështu të mbrohen nga plumbat e policisë jugosllave! Edhe sikur kjo të ishte e vërtetë përsëri nuk mund të arsyetohet vrasja masive e popullit, por, në të vërtetë, të gjitha ato që thuhen rreth mbrojtjes me fëmijë janë gënjeshtra, shpifje e trillime të udhëheqjes revizioniste në Jugosllavi e në Kosovë.

Revizionistët dhe tradhtarët shpresuan se me këtë shpifje të ulët i ranë shejit, por, as kjo nuk u ndezi. Populli ynë e di mirë se demonstruesit, jo vetëm që nuk i nxorën fëmijët me dhunë në demonstrata, por përkundrazi, ata ishin në hall se si t'i ndalnin fëmijët e tyre që u hidheshin në grykë mitralozëve dhe tankeve të armikut, që i gjuanin ata me gurë dhe u ngritnin barrikada, edhe pse përreth tyre vërshëllenin plumbat. Bijtë e Kosovës trime jo vetëm nuk u mbrojtën me trupa fëmijësh, po përkundrazi, u hapën gjoksin plumbave të armikut dhe ranë duke mbrojtur gratë, fëmijët, popullin me heroizëm të paparë. Ata që e kanë parë këtë heroizëm dhe solidaritet të pashembullt të rinisë sonë të kuqe, nuk mund të mos kenë thënë: "Lumë Kosova ç'brez po rrit!"

Vandalistë e brutal, mizor e kriminal, në të vërtetë, ishin veprimet e policisë fashiste dhe të UDB-së rankoviçiane, që ushtruan mbi popullin tonë gjithë atë dhunë e terror të paparë. Përgjegjës për atë që ndodhi në Kosovë janë ata krerë revizionistë e tradhtarë, qofshin në Beograd apo në Kosovë qofshin shqiptarë ose joshqiptarë, që urdhëruan shuarjen me gjak të demonstratave, ata që sollën në Kosovë policinë e Serbisë e të Jugosllavisë për të gjakosur, rrahur e poshtëruar popullin tonë, ata armiq e tradhtarë që sollën në Kosovë ushtrinë, tanket dhe aviacionin e luftës për të shtruar popullin tonë, për të tmerruar edhe foshnjat në djep për të shkretuar rrugët dhe arat tona ata që e bënë Salvador të dytë Kosovën tonë të bukur. Ata janë përgjegjës për të gjitha ato që kanë ndodhur dhe po ndodhin në Kosovë ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh, dhe pa dyshim për këtë, një ditë, do të japin llogari para popullit.

Revizionistët titistë bënë shumë zhurmë kundër socialimperialistëve sovjetikë kur ata dërguan ushtri dhe tanke gjoja për "ndihmë internacionaliste", në Çekoslllovaki e Afganistan dhe po bëjnë edhe tani kundër planeve të tij për të ndërhyrë në Poloni, duke u çjerrë me të madhe për "të drejtën e secilit popull që t'i zgjidhë vetë problemet e veta, pa asnjë ndërhyrje e përzierje të të tjerëve. Pse, tani, këta "njerëz të paqes" dhe "kundërshtarë të dhunës e agresionit" nuk e lanë popullin e Kosovës t'i zgjidhte vetë problemet e veta, por u shpejtuan të sjellin këtu tanket dhe ushtrinë e tyre? Përgjigjja është e thjeshtë: sepse edhe këta, si carët e Kremlinit, janë agresorë e hegjemonistë, kurse ajo që flasin është thjeshtë një demagogji. Dhe për të qenë ironia edhe më e madhe, pikërisht këta gjakatarë e akuzojnë popullin dhe rininë kosovare për brutalitet, dhunë e vandalizëm !!

ZËRI I POPULLIT ZËRI I SË VËRTETËS

Në kohën kur propaganda revizioniste dhe një pjesë e shtypit reaksionar botëror kishin shpërthyer një fushatë të paparë shpifjesh, trillimesh e dezinformimesh të paskrupullta rreth Kosovës dhe demonstratave të saj, "Zëri i Popullit", organ i Komitetit Qendror të Partisë së Punës, botoi artikullin: "Pse u përdor dhuna policore e tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?", i cili me argumente të shumta dhe të pakundërshtueshme, hidhte dritë mbi të vërtetën rreth ngjarjeve të fundit në Kosovë, rreth shkaqeve të vërteta që detyruan popullin tonë të robëruar të ngrihet në greva e demonstrata, rreth qëllimeve e kërkesave të vërteta të tyre. Me anë të këtij artikulli, Shqipëria socialiste ngriti fuqishëm zërin në mbrojtje të popullit tonë të robëruar e të luftës së tij të drejtë, dënoi ashpër dhunën dhe terrorin barbar që u ushtrua mbi ne dhe riafirmoi edhe një herë qëndrimin e saj të drejtë marksist-leninist si ndaj popullit shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, ashtu edhe ndaj popujve të Jugosllavisë.

Jehona që pati ky artikull në popullin tonë ishte e jashtëzakonshme dhe e paparë ndonjëherë. Pothuaj se s'ka mbetur shqiptar që të mos e ketë lexuar ose dëgjuar fjalën e ngrohtë të Nënës Shqipëri dhe të mos ketë thirrur nga zemra: "Të falemnderit, Nënë!"

Populli ynë u bind edhe një herë se "Zëri i popullit" është vërtet zë i popullit, se ai është edhe zëri i tij, se zëri i Shqipërisë Socialiste është zëri i së vërtetës.

Revizionistët jugosllavë gjithmonë janë munduar që për luftën e drejtë që bën populli shqiptar në Jugosllavi për të drejta e liri, ta fajësojnë, padrejtësisht, Shqipërinë socialiste dhe Partinë e saj të Punës. Në se këtë ata nuk e thoshin drejtpërsëdrejti, publikisht, e kanë thënë vazhdimisht në mënyrë të tërthortë dhe, sidomos, e thoshin hapur nëpër mbledhjet e shumta që organizonin në popull. Tani, pas grushtit dërmues, që u dha atyre artikulli i "Zërit të popullit", revizionistët dhe tradhtarët dolën edhe hapur dhe publikisht. Gjithë makina propagandistike e Jugosllavisë u angazhua në fushatën kundër "Zërit të popullit" e nëpërmjet tij, kundër Shqipërisë dhe Partisë së Punës. Artikuj e komente të shumta janë botuar dhe emituar në mjetet revizioniste të informimit, si "përgjigje" ndaj artikullit të "Zërit të popullit", kurse në mbledhjet e shumta të të gjitha niveleve, revizionistë dhe tradhtarë të ndryshëm po vazhdojnë të dërdëllisin e të lehin kundër tij.

Në mënyrë që t'u kishte sukses propaganda telallët revizionistë e kanë shoqëruar atë edhe me shpifje e trillime të nxjerra nga arsenali i propagandës antishqiptare të kohës së Rankoviçit.

Si duket, revizionistët dhe tradhtarët po mendojnë se janë ende në vitet pesëdhjetë, kur njerëzit, duke mos e njohur sa duhet as Shqipërinë socialiste dhe as klikën revizioniste të Beogradit, edhe mund të mashtroheshin dhe t'u besonin shpifjeve e trillimeve të poshtra të Titos e Rankoviçit dhe të këlyshëve të tyre. Esat Toptanët dhe Mustafë Merlikët e

Kosovës, të mbyllur nëpër mbledhje, bare e sallone bixhozi, duke pirë, siç thonë edhe vetë, "ujë të Savës" janë larguar aq shumë nga populli sa nuk e njohin atë fare dhe prandaj e mendojnë popullin aq naiv, aq injorant, sa të luajnë me të ashtu si duan ata! Por, edhe këtu ata mashtrohen keq.

Populli ynë e njeh sot fare mirë Shqipërinë kuqe të Enver Hoxhës, e njeh jetën e lumtur socialiste që lulëzon atje, e njeh politikën e saj të kristaltë marksiste-leniniste e i njeh edhe ata që dërdëllisin kundër saj. Prandaj nuk mashtrohet nga të lehurat e tyre. Gjithë ai që e ka lexuar apo dëgjuar artikullin e "Zërit të popullit" ose që e njeh sadopak Shqipërinë socialiste dhe politikën e saj, nuk mund të mos shohë se ato që llomotisin armiqtë dhe tradhtarët kundër Shqipërisë, nuk janë tjetër veçse trillime shpifje të poshtra dhe naive.

Vetëm renegatë si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli, Ali Shukriu etj. mund ta quajnë ndihmën dhe përkrahjen e sinqertë të Shqipërisë socialiste për popullin tonë në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare si "sulm", "ndërhyrje", "shovinizëm" e "paternalizëm", kurse ndërhyrjen me ushtri tanke e bajoneta të Serbisë, ta quajnë "ndihmë" e "përkrahje internacionaliste e vëllazërore" Vetëm plehra si ata mund ta quajnë ideologjinë marksiste-leniniste të Shqipërisë si "reaksionare", "aventuriste" e "luftënxitëse" dhe të llomotisin se ajo u shërbeka blloqeve e superfuqive imperialiste!!! Blofe të tilla kundër Shqipërisë nuk bëjnë as qarqet më reaksionare të botës.

Klouni Xhavit Nimani në një fjalim të tij duke përsëritur si papagall ato që i kishin thënë padronët e tij në Beograd, e akuzoi "udhëheqsijen e Shypnisë" se gjoja ajo po i fut në një thes të gjithë shqiptarët e po i quan "vëllezër shqiptarë" edhe forcat më reaksionare të popullit shqiptar! Kështu flet ky sharlatan, por me siguri që kështu nuk mendon as ai. Nuk mund të mos e dijë Xhavit Nimani dhe shokët e tij se, kur flitet për "vëllezërit shqiptarë", bëhet fjalë për popullin, për njerëzit e ndershëm, dhe jo aspak për tradhtarët e shitur, qofshin këta ballistë e zogistë apo revizionistë si ai. Tradhtari mund të jetë gjithçka, por vëlla nuk mund të jetë kurrë.

Veçanërisht e poshtër dhe cinike është orvatja që, duke falsifikuar dhe shtrembëruar haptazi dhe në mënyrën më të palejueshme artikullin e "Zërit të popullit", të bindet opinioni (sidomos ai jugosllav) se Shqipëria për ngjarjet në Kosovë gjoja "fajëson popullin serb" dhe se gjoja ajo "nxit urrejtje e konflikte në mes tij dhe popullit shqiptar" Në këtë mënyrë, propaganda revizioniste për piqet ta diskreditojë në sytë e popujve jugosllavë politikën e drejtë marksiste-leniniste dhe konsekuente internacionaliste të Partisë së Punës ndaj popujve të Jugosllavi së dhe të gjithë botës. Qëndrimin e saj të papajtueshëm me udhëheqjen revizioniste të Jugosllavisë, Partia e Punës e Shqipërisë e ka theksuar qartë, hapur dhe vazhdimisht, po as në artikullin e "Zërit të popullit" të 8 prillit dhe askund tjetër nuk mund të gjendet asnjë fjalë kundër p o p u j v e të Jugosllavisë, asnjë identifikim dhe përzierje e popujve të Jugosllavisë dhe krerëve të tyre revizionistë e shovinistë.

Vetëm njerëz të pafytyrë si Dragosavci e Fadil Hoxha, si Vidiçi e Mahmut Bakalli, si Dushan Ristiçi e Xhavit Nimani mund ta akuzojnë udhëheqjen e lavdishme të Partisë së Punës për mungesë të internacionalizmit, edhe pse e dinë mirë se ishte pikërisht kjo udhëheqje, ishte pikërisht shoku Enver Hoxha që kishte urdhëruar divizionet partizane shqiptare të vinin e të luftonin jo vetëm për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, por edhe të popujve të Serbisë, Bosnjës e Malit të Zi. Qëndrimin e saj internacionalist ndaj popujve jugosllavë Partia e Punës e ka dëshmuar me gjakun e derdhur të qindra partizanëve të pavdekshëm, që ranë për çlirimin e popujve jugosllavë,

po e dëshmon edhe sot kur atyre, si pasojë e politikës tradhtare e antipopullore të udhëheqjes jugosllave, po u kanoset rreziku i ndër hyrjes së superfuqive imperialiste.

Në propagandën e tyre të poshtër kundër Shqipërisë, revizionistët jugosllavë dhe tradhtarët shqiptarë kanë shkuar aq larg sa ta përdorin si "argument" edhe çështjen e fesë me qëllim që t'i nxisin kundër Shqipërisë besimtarët e ndershëm nga radhët e popullit tonë. Kështu vepronin armiqtë e popullit edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, që, me anë të fesë, u munduan ta ndajnë e ta përçajnë popullin tonë. Nga kjo lodër e poshtër, populli ynë nuk u mashtrua as në të kaluarën dhe aq më pak mund të mashtrohet sot kur ndërgjegjja e tij klasore e patriotike është ngritur dhe po ngritet vazhdimisht. Besimtarët e ndershëm e dinë se ata që po flasin e "merakosen" për fenë në Shqipëri, jo vetëm që vetë nuk njohin fe, por ata nuk dinë e nuk njohin as komb e atdhe. Shqiptarët kurrë nuk e kanë vënë çështjen e fesë mbi çështjen e vatanit, nuk kanë lejuar që feja të bëhet pengesë për lirinë dhe përparimin e atdheut. Mbi gjithçka, për popullin tonë ka qenë dhe është çështja e atdheut, prandaj ai edhe thotë se "FEJA E SHQIPTARIT ËSHTË SHQI PTARIA".

Tanimë është bërë e qartë se, me propagandën e tyre kundër Shqipërisë, revizionistët dhe tradhtarët synojnë, përveç të tjerash, edhe t'i armiqësojnë popujt e Jugosllavisë, dhe sidomos popullin tonë, me Shqipërinë socialiste dhe me Partinë heroike të Punës. Por, përpjekjet e tilla kurdoherë kanë dështuar dhe do të dështojnë me turp. Dashuria e popullit tonë të robëruar ndaj Nënës Shqipëri, Partisë së saj sokoleshë dhe marksist-leninistit të madh, birit më të dashur e më të lavdishëm të popullit shqiptar shokut Enver Hoxha, ka qenë kurdoherë e madhe dhe e paluhatshme. Vetë do t'ia paguajnë tatimin budallallëkut e poshtërsisë së tyre ata që do t'u shkojë mendja se artikulli i "Zërit të popullit" e mungon këtë dashuri. Përkundrazi, ai na e ka shtuar atë.

Shqipëria ka qenë kurdoherë Atdhe i gjithë shqiptarëve, po sot ajo është bërë edhe Atdhe i të gjithë komunistëve të vërtetë dhe të gjithë proletarëve të botës. Prandaj për popullin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, ajo është dy herë atdhe. Këtë duhet ta kenë të qartë dhe ta mbajnë mirë parasysh të gjithë, sidomos ata që "nuk mund të qëndrojnë indiferentë ndaj asaj që po ndodh në Shqipëri". Revizionistët jugosllavë dhe këlyshët e tyre në Kosovë, jo vetëm që nuk kanë qenë kurrë "indiferentë ndaj Shqipërisë, po përkundrazi, ata kanë qenë shumë të interesuar dhe kanë bërë çdo përpjekje që atje të ndodhë ajo që kanë dashur ata. Nëse edhe pas dështimeve të vazhdueshme e të turpshme që kanë pësuar nuk kanë nxjerrë mësimet e nevojshme (siç po lënë të kuptohet), atëherë duhet ta kenë parasysh edhe këtë të vërtetë: Mbrojtja e Shqipërisë socialiste është detyra më e lartë patriotike për çdo shqiptar të ndershëm, kudo që të ndodhet. Çdo përpjekje e kujtdo qoftë që, nga Jugosllavia, ta rrezikojë në çfarëdo mënyre Shqipërinë, do të hasë së pari në qëndresën e vendosur të dy milionë shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi, që për të mbrojtur Atdheun e tyre socialist, bëhen të gjithë Mic Sokola.

POPULLI YNË KËRKON LIRI E JO LUFTË

Në përpjekjet e vazhdueshme për ta mbajtur popullin tonë nën thundër, vojvodët e rinj të Beogradit dhe veglat e tyre e kanë përdorur gjithmonë edhe shantazhin e rrezikut të shpërthimit të ndonjë konflikti të madh në Ballkan dhe të ndërhyrjes së superfuqive imperialiste. Këtë kartë, ata po e përdorin edhe tani në fushatën propagandistike kundër popullit tonë. Duke i akuzuar demonstruesit dhe përkrahësit e tyre si "luftënxitës dhe prishës të paqes e të stabilitetit në Ballkan", ata kërkojnë hapur nga populli ynë që të rrijë urtë e të mos bëjë zë edhe kur ai shtypet dhe shfrytëzohet nga të tjerët. Sepse, në të

kundërtën, po të ngrihet e të kërkojë ndonjë të drejtë a liri, bëhet shkaktar i prishjes së paqes dhe stabilitetit dhe i ndërhyrjes së superfuqive në Jugosllavi, bile edhe në Shqipëri!

Populli shqiptar ka luftuar në shekuj për liri. Por, ai kurrë nuk e ka dashur luftën, kurrë nuk ka qenë luftënxitës. Luftërat atij ia kanë imponuar kurdoherë të tjerët, ata që i shkelnin në vatër dhe ia rrëmbenin lirinë Ai kurrë s'ka pranuar të bëhet mish për top dhe objekt manipulimi i fuqive të mëdha. Ai kurdoherë luftën e ka bërë me forcat e veta dhe kurrë në dëm të popujve të tjerë. I tillë ka qenë populli ynë ndër shekuj, dhe i tillë është ai edhe sot.

Populli shqiptar në Jugosllavi dëshiron paqe dhe jo luftë. Por, paqja nuk mund të sigurohet kurrë duke i mbajtur popujt nën zgjedhë e robëri. Vetëm duke qenë plotësisht të lirë, popujt e Ballkanit dhe të gjithë botës mund të jetojnë në paqe, miqësi e rehati të plotë. Vetëm në këtë mënyrë mund t'i mbyllet rruga edhe përzierjes së superfuqive dhe agresionit të tyre imperialist.

Të akuzosh popullin c robëruar të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare si paqëprishës dhe luftënxitës, është njësoj sikur ta akuzosh popullin liridashës palestinez se po e prish paqen dhe po e nxit luftën në Lindjen e Mesme, ta akuzosh atë se gjoja po i hap rrugë ndërhyrjes së fuqive të mëdha imperialiste! Akuzat e tilla, që mund t'i bëjnë vetëm qarqet më reaksionare, agresive, raciste e cioniste, vështirë se mund të mashtrojnë njeri.

Populli ynë nuk dëshiron luftë e gjakderdhje. Prandaj, kërkesat e tij i bëri në rrugë paqësore. Por, udhëheqja shoviniste e Beogradit me qëllim që ta frikësojë atë, këtyre kërkesave iu përgjigj me dhunën dhe terrorin më të egër fashist. Por, ajo duhet ta dijë mirë dhe ta mbajë parasysh se masat e dhunës policore dhe ushtarake që u ndërmorën e po vazhdojnë akoma, vrasjet, burgosjet masive dhe torturat çnjerëzore, kërcënimet e vazhdueshme me tanke, aeroplanë e masa të ashpra ligjore, jo vetëm që nuk e frikësojnë popullin tonë, por e zemërojnë dhe e egërsojnë atë edhe më shumë, jo vetëm që nuk mund ta qetësojnë, por e detyrojnë që, për realizimin e kërkesave (nga të cilat nuk lëvizi dot), të mendojë edhe në rrugë dhe me mjete të tjera.

Mënyra e vetme për ta qetësuar popullin e revoltuar është realizimi i menjëhershëm i kërkesave të tij të drejta, heqja e gjendjes së jashtëzakonshme, lirimi i të të gjithë të burgosurve, dënimi i atyre që urdhëruan ndërmarrjen e masave të përgjakshme ndaj popullit etj. Në të kundërtën, zjarri do të rritet edhe më shumë, e përgjegjësia për pasojat që mund të rrjedhin bie vetëm mbi udhëheqjen revizioniste jugosllave.

VETËM MARKSIZËM-LENINIZMI TREGON RRUGËN E VËRTETË TË LIRISË

Populli ynë heroik, gjatë gjithë historisë së tij të lavdishme, ka luftuar me heroizëm për lirinë 'dhe të drejtat e veta. Kurrë ai nuk u është frikësuar e përkulur armiqve sado të shumtë e të egër që kanë qenë ata, por u ka hapur kurdoherë gjoksin dhe u ka treguar grushtin e vet të fuqishëm. Vala e grevave dhe demonstratave që shpërthyen anë e kënd Kosovës, është vazhdim i natyrshëm i luftës shekullore të popullit tonë për liri Nuk ka forcë në botë që mund ta shuajë këtë luftë të drejtë të popullit tonë të pamposhtur. Atë nuk mund ta shuajnë as plumbat, tanket e aeroplanët e armiqve, dhe as propaganda dhe demagogjia e tyre. Populli ynë liridashës është i bindur në drejtësinë e luftës së tij dhe nuk do ta pushojë atë deri në kurorëzimin e saj me fitore. Këtë e dëshmon qartë lufta që populli ynë po bën edhe tani në forma të ndryshme, e dëshmon edhe qëndrimi burrëror që po mban ai ndaj fushatës së gjerë propagandistike që kanë ndërmarrë revizionistët dhe tradhtarët. Populli ynë patriot, punëtorët, fshatarët, rinia shkollore e studenteske,

inteligjencia jonë revolucionare etj., jo vetëm që nuk po u tremben presioneve, shantazhit e kërcënimeve, jo vetëm që nuk po i dënojnë demonstratat që i bënë vetë dhe as artikullin e "Zërit të popullit", po përkundrazi, po e ngrejnë zërin po i mbrojnë e përkrahin ato, po dënojnë hapur dhe me guxim dhunën dhe terrorin e egër të diktaturës revizioniste jugosllave.

Ngjarjet e fundit në Kosovë dhe situata e krijuar janë edhe një mësim i madh për popullin tonë të robëruar. Ai po e sheh qartë se kush janë armiqtë e tij të vërtetë dhe kush janë bijtë e tij të vërtetë, kush po e shtyp dhe shfrytëzon atë kaq egërsisht, dhe kush po lufton me vendosmëri për çlirimin e tij kombëtar dhe shoqëror.

Në këto momente historike, çdo shqiptar i ndershëm, çdo punëtor, fshatar, student, nxënës, intelektual etj., duhet të mendojë thellë dhe me përgjegjësinë më të madhe për fatet e popullit dhe për qëndrimin e tij në këtë situatë.

Armiqtë e urryer, që e kanë robëruar e copëtuar popullin tonë, jo vetëm po na i plaçkitin pasuritë tona të mëdha e po na thith in gjakun dhe djersën tonë, jo vetëm po na mbajnë në varfëri, skamje, papunësi, kurbet e mjerim... por po mundohen edhe të na shuajnë edhe ndjenjat tona patriotike e revolucionare. Ata vranë mizorisht, në lulen e rinisë, shumë vajza e djem nga më të mirët të popullit, vranë motrat dhe vëllezërit tanë të shtrenjtë, që kërkonin të drejta e liri për popullin. Ata plagosën e gjymtuan qindra bija e bij të popullit, kurse qindra të tjerë i kanë përplasur burgjeve dhe po ua nxjerrin shpirtin, duke ushtruar mbi ta mundime e tortura çnjerëzore. Armiqtë tanë të egër e mbuluan me polici, ushtri, tanke e aeroplanë, Kosovën tonë të dashur. Ata e rrahën, e shanë dhe e poshtëruan popullin tonë kurse tani, kundër tij po vjellin vrer të paparë shovinist...

Në kushte të këtilla të dhunës dhe terrorit të egër që po ushtrohet mbi ne e që nuk është parë as në kohën e zezë rankoviçiane, secili e sheh qartë fytyrën e vërtetë gjakatare dhe antishqiptare të udhëheqjes shoviniste jugosllave dhe zagarëve të saj, pra çështja shtrohet prerë: O me popullin o me armiqtë e tij; me popullin ose me ata që e vrasin, burgosin, torturojnë e poshtërojnë bijat e bijtë tanë më të mirë; me popullin ose me shovinistët rankoviçianë dhe këlyshët e tyre shqiptarë. Kështu duhet të gjykojnë edhe bijtë e ndershëm të popullit në organet e ndryshme të pushtetit, e edhe ata që për të siguruar kafshatën e gojës, ose edhe të mashtruar, janë detyruar t'ia vënë vetes emrin e urryer të agjentit e të policit. Ata nuk duhet ta lejojnë veten të bëhen mashë në duart e armiqve dhe, për hir të "udbashëve" çetnikë të Nishit e Beogradit, të vrasin, gjymtojnë e torturojnë vëllezërit e motrat e veta, bijat dhe bijtë më të mirë të popullit.

Grevat dhe demonstratat heroike në Kosovë treguan edhe një herë se ç'forcë e madhe e pathyeshme është populli i bashkuar si një trup i vetëm në luftë për të drejta e liri. Edhe një herë u pa se vetëm të bashkuar, klasa jonë punëtore, fshatarësia jonë patriote gruaja revolucionare dhe rinia jonë e zjarrtë, mund të luftojnë me sukses për interesat e tyre dhe të të gjithë popullit.

Populli ynë po e sheh se bijtë e tij më të mirë, komunistët e vërtetë, revolucionarët dhe patriotët e vërtetë,- po luftojnë, po vriten, po burgosen e po gjymtohen për të mirën e tij, për të mirën e kësaj toke, prandaj edhe po e përkrah me forcë luftën e ty re, po solidarizohet me ta, po i mbështet e po i ndihmon ata me të gjitha mënyrat, po bashkohet gjithnjë e më shumë me luftën e tyre të drejtë. "Bashkimi bën fuqinë", thotë populli, prandaj bashkimi i paparë i popullit tonë, që u arrit gjatë grevave dhe demonstratave të fundit, duhet të forcohet dhe të çelnikoset edhe më shumë, duke lënë anash (si në kohë lufte) çdo ndasi fetare, sociale e regjionale, çdo mosmarrëveshje, mëri e hasmëri; çdo gjë që dobëson unitetin e popullit. Të bashkuar dhe të lidhur si vëllau me vëllanë, ne jemi më

të fortë se të gjithë armiqtë dhe tradhtarët, të bashkuar ne jemi të pamposhtur, të bashkuar ne do të fitojmë të drejtat tona, lirinë tonë.

Gjatë historisë së tij të lavdishme, populli ynë kurrë nuk ua ka shtrirë dorën armiqve të tij. Të drejtat dhe lirinë e tij ai kurrë nuk i ka kërkuar si lëmoshë nga armiqtë e urryer, por kurdoherë ka qenë i bindur se "liria nuk falet, por fitohet me gjak dhe sakrifica". Edhe ato pak të drejta që ka populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, s'ia ka falur askush, por i ka fituar me luftën e tij të vendosur, me gjakun e bijve të tij më të mirë. Ai, as tani nuk pret që të drejtat dhe lirinë t'ia falin shovinistët e Beogradit. Populli ynë është i vendosur të luftojë me vendosmëri deri në realizimin e plotë të kërkesave të tij, është i gatshëm të bëjë për to çdo sakrificë e therori.

Populli ynë kurrë nuk i ka dëgjuar, e nuk i dëgjon as sot, ata frikacakë e kapitullantë që e "këshillojnë" ta pushojë luftën e t'u përulet dhe nënshtrohet armiqve të tij. Por, populli ynë, gjithashtu, nuk lejon të bjerë në gabimin tjetër që të hidhet në veprime të pamatura, të nxituara e të parakohshme. Përvoja e gjatë luftarake e ka mësuar atë të jetë i vendosur dhe i patrembur në luftë, por edhe i pjekur, gjakftohtë e i përmbajtur. Lufta jonë do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Ajo duhet të jetë e guximshme, por edhe e gjithanshme, e përgatitur dhe e organizuar mirë.

Lufta për liri është detyrë dhe nder për çdo shqiptar të ndershëm. Por, populli ynë siç ka ditur në të kaluarën, do të dijë edhe tash të bëjë dallimin mes atyre që vërtet luftojnë për interesat e tij dhe atyre që orvaten ta keqpërdorin e ta shfrytëzojnë luftën e tij të drejtë për qëllimet e tyre të errëta. Populli nuk ka asgjë të përbashkët me ato forca reaksionare zogiste e balliste që mundohen të përzihen në luftën e popullit tonë dhe hiqen sikur edhe ato po luftojnë për çlirimin e Kosovës. Në të vërtetë qëllimi i tyre i fundit nuk është çlirimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, por lufta kundër socializmit të vërtetë, që po ndërtohet në Shqipëri. Nuk mund të jenë kurrë me popullin e Kosovës kriminelët që kanë vrarë patriotë të mëdhenj si Bajram Currin e Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën e Avni Rustemin, ata që kanë vrarë "yjet e Vigut", Tefik Çangën, Bardhok Bibën, Ndrec Ndue Gjokën e Heroinat Mirditore. Nuk mund të jenë kurrë me Kosovën ata që lidhen e bashkëpunojnë me CIA-në, me çetnikët, ustashët apo me UDB-në e Jugosllavisë titiste për të luftuar kundër Shqipërisë socialiste. Kush lufton kundër Shqipërisë së kuqe të Enver Hoxhës, ai është edhe kundër popullit të Kosovës, ai është kundër gjithë popullit shqiptar. Rrugën e vërtetë drejt lirisë dhe përparimit, popullit tonë të robëruar nuk ia tregojnë as revizionistët titistë, as tradhtarët sahanlëpirës në Kosovë dhe as ballistët e zogistët në shërbim të imperializmit. Vetëm nën flamurin e kuq të marksizëm-leninizmit, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe pararojës së saj marksiste-leniniste, populli ynë do ta arrijë çlirimin e vërtetë kombëtar dhe shoqëror. Populli i Kosovës, që kurrë në historinë e tij nuk u ka rënë në qafë popujve të tjerë, as tani nuk do të lejojë asnjë shfaqje të nacionalizmit e shovinizmit ndaj popullsive joshqiptare në Kosovë. Atë që mund ta bëjnë të tjerët, nuk e bën kurrë shqiptari. Lufta jonë drejtohet kundër atyre që na shtypin e shfrytëzojnë, kundër shovinistëve robërues të Jugosllavisë e tradhtarëve shqiptarë të Kosovës, dhe jo, kurrsesi, kundër popujve jugosllavë, kundër punëtorëve e fshatarëve jugosllavë, të cilët, sikurse edhe ne, shtypen e shfrytëzohen nga borgjezia e re jugosllave. Patriot i vërtetë shqiptar është jo ai që sillet keq e bën zullume në njerëzit e pafajshëm të kombësive të tjera, por ai që lufton pa mëshirë kundër regjimit gjakatar të revizionistëve jugosllavë, e në të njëjtën kohë shkon mirë me fqinjtë e vet joshqiptarë dhe i bind edhe ata për drejtësinë dhe pastërtinë e luftës çlirimtare të popullit tonë.

Ashtu siç ka thënë shoku Enver Hoxha, populli shqiptar kurdoherë e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Në luftën e tij' të lavdishme për liri, ai kurdoherë është mbështetur në forcat e veta dhe kurrë në "ndihmën" a "përkrahjen" e fuqive të mëdha agresive. As tani ai nuk ka as iluzionin më të vogël ndaj asnjë fuqie a superfuqie imperialiste. Çlirimin e tij, populli i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara me shqiptarë, nuk e pret si peshqesh as nga imperializmi amerikan, as nga socialimperializmi sovjetik, as nga maoistët kinezë dhe as nga titistët jugosllavë.

Lirinë e ëndërruar në shekuj, populli ynë do ta fitojë vetëm me punën dhe luftën e pa' mposhtur të tij, vetëm me vuajtjet, sakrificat dhe gjakun e bijave e të bijve të tij., Por, në luftën e tij të lavdishme, megjithatë, nuk është vetëm. Me të janë dhe do të je në të gjithë popujt liridashës, proletariati, komunistët dhe revolucionarët e vërtetë' të të gjithë botës.

Lufta e popullit tonë është e drejtë, dhe patjetër do të triumfojë!
(LIRIA, maj 1981, faqe 1-9)

3-2. TRADHTARËT SHQIPTARË MBROJNË INTERESAT E PUSHTUESVE

Nga Mehmet Hajrizi

Revizionistët shovinistë të Jugosllavisë, për të kënaqur ndjenjat e tyre grabitçare, të trashëguara nga kralët e vjetër të borgjezisë jugosllave, përdorën mjete dhe metoda ndër më të ndryshmet për të vënë nën sundimin e tyre popullin tonë dhe ta përjetësojnë në tokat tona këtë sundim të egër.

Për nënshtrimin e Kosovës, revizionistët jugosllavë vunë në zbatim dy format e njohura, të nënshtrimit, dhunës e shtypjes, dhe atë të demagogjisë e mashtrimit. Ata vranë me tradhti kuadro të njohur partizanësh shqiptarë, udhëheqës të popullit në luftë për liri, torturuan dhe gjymtuan komunistë dhe patriotë shqiptarë, terrorizuan popullin e, nga ana tjetër, korruptuan ndonjë nga ato kuadro të luftës dhe zgjodhën nga llymi i popullit tonë njerëz të poshtër për të vënë firmën e tradhtisë në mbledhjen famëkeqe të Prizrenit më 1945. Që atë ditë, ajo mbledhje trumbetohet nga revizionistët si "shprehje e vullnetit të lirë të popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje". Ndërsa ai grusht tradhtarësh u vu në shërbim të pushtuesve revizionist dhe mbeti shërbëtor i bindur i tyre.

Historia afro 40 vjeçare e sundimit, shtypjes e shfrytëzimit të egër, që i bëri e po i bën klika revizioniste e Titos popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, ka treguar më së miri natyrën fashiste grabitçare të kësaj klike.

Historia pas Luftës së Dytë Botërore e popullit tonë martir ka treguar edhe një herë qëndresën heroike dhe vendosmërinë e popullit tonë të robëruar për të luftuar kundër çdo armiku, sado i egër qoftë ai, dhe për të jetuar i lirë, ka treguar dashurinë që ka ai për Atdheun e tij të lashtë. Kjo luftë, nga ana tjetër, tregon se vullneti i kujt ishte shprehur në mbledhjen e Prizrenit.

Tradhtarët shqiptarë janë reklamuar vazhdimisht nga revizionistët jugosllavë si "përfaqësues të popullit të Kosovës", të cilët flisnin atëherë dhe flitkan tani "në emër të popullit të Kosovës". Në fakt ata, si atëherë, edhe sot s'janë gjë tjetër pos kuislingë të pushtuesit. Ata jo vetëm nuk ngritën zërin kundër të gjitha këtyre tragjedive që u luajtën

në kurriz të popullit shqiptar të Kosovës, por morën pjesë aktive në të gjitha masat antishqiptare që ndërmori regjimi.

Detyrat që u ka besuar dhe ngarkuar regjimi i Titos tradhtarëve shqiptarë në Kosovë, janë të shumta dhe të ndryshme. Sot, madje edhe në krye të organeve sunduese e shtypëse në Kosovë, revizionistët kanë vënë tradhtarët shqiptarë. Ata kanë krijuar edhe një kastë të tërë aristokrate e burokratike në administratë dhe kulakë në fhat sikrah e mbështetje e tradhtarëve për të zbatuar me besnikëri politikën kolonialiste të shovinistëve titistë dhe politikën borgjezo-revizioniste në përgjithësi. Revizionistët menduar se me futjen e ndonjë tradhtari shqiptar në organet e tyre të ndryshme të partisë e të pushtetit, kanë krijuar terren për të bërë zhurmën e "të drejtave të plota" të popullsisë shqiptare në Kosovë, që ata i paskan dhënë etj. Por populli ynë e njeh mirë armikun e tij dhe dredhitë që përgatitë ai, e njeh gjithashtu edhe bandë tradhtare të Fadil Hoxhës e Xhavit Nimanit, Ali Shukriut e Veli Devës, të mahmutëve e të ilazëve, që po shajnë e po lehin sot poshtë e lartë nëpër Kosovë. Për të fituar besimin e plotë të regjimit titist, lakejt e tij në Kosovë shpesh herë zbatojnë metoda terrori e shtypjeje akoma më të egra që porosisin padronët e tyre në Beograd. Angazhimi dhe bashkëpunimi i tyre i ngushtë me policinë fashiste serbe në masakrat që u bën kohëve të fundit, flet më së miri për këtë. Ata janë faktor i rëndësishëm i revizionistëve jugosllavë për sundimin, shtypjen, shfrytëzimin e varfërimin e popullit tonë të shumëvuajtur në Kosovë.

Si eksponentë të regjimit titist, ata janë njëkohësisht edhe altoparlantë e interpretues injorantë të demagogjisë së këtij regjimi në Kosovë. Ata janë caktuar që gjithë jetën e tyre t'i bëjnë aureolë regjimit shtypës dhe shfrytëzues në fuqi dhe me kujdes të veçantë kryexhelatit të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe të popujve të Jugosllavisë, J. B. Titos.

Fadil Hoxha dhe kompania e tij në Kosovë janë sot luftëtarët më të zellshëm kundër marksistë-leninistëve të vërtetë të Kosovës dhe kundër çdo lëvizjeje patriotike e revolucionare. Ata, tokë me revizionistët jugosllavë, luftojnë kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe aktualisht kanë shpallur një fushatë të tërbuar shpifjesh e trillimesh kundër saj. Bile ata u hynë edhe aventurave donkishotiane të armiqësimit të popullit tonë në Kosovë me Shqipërinë socialiste dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë. Por, qëllimet e tyre të mbrapshta nuk do të realizohen kurrë.

Fjalët e zgjedhura e të bujshme të tradhtarëve për të ardhshmen e "bukur", që ata i përgatitkan popullit tonë, nuk mund ta fshehin gjendjen e sotme kaq të rëndë të popullit shqiptar në Kosovë dhe aq më pak ta mashtrojnë atë. Populli ynë e di se liria nuk mund të vijë nga tradhtarët dhe regjimi në fuqi. Zhurma e madhe që bëhet rreth "reformave" ekonomike e shoqërore, "autonomisë" së Kosovës, "vetëvendosjes së marrëdhënieve të reja ndërnacionale" etj., janë bllofe me të cilat armiqtë duan ta vënë në gjumë ndjenjën kombëtare e klasore, luftën e popullit për çlirim. Populli ynë, nën sundimin e revizionistëve jugosllavë, nuk e ndanë luftën kundër pushtuesve revizionistë nga ajo kundër tradhtarëve të shitur te ta. Klika tradhtare e Kosovës ka shitur interesat kombëtare të popullit tonë në Kosovë te pushtuesit dhe është vënë në shërbim të tyre këmbë e kokë, prandaj është armik i papajtueshëm me interesat dhe aspiratat e popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Ajo është bashkëfajtore tok me revizionistët jugosllavë për gjendjen s sotme të popullit shqiptar në Kosovë, është bashkëfajtore për tragjedinë që po përjeton sot populli ynë, dhe dënimin e fundit do ta marrë nga populli ashtu si dhe armiku kryesor klika revizioniste e Beogradit. Populli ynë kurrë në historinë e tij nuk është mashtruar. Pushtimi i Kosovës nga policia e ushtria fashiste serbe, nuk mund të përjetësohet. Çfarëdo qofshin masat e revizionistëve dhe të tradhtarëve, ata nuk mund ta shuajnë luftën e popullit tonë, nuk mund ta mashtrojnë atë. Përballë pak tradhtarëve,

populli ynë ka shumë bija e bij trima, të gatshëm për të bërë sakrificën supreme për lirinë e popullit e që dinë të dalin fitimtarë mbi bajoneta e tanke.
(LIRIA, maj 1981, faqe 9)

3-3. 1 MAJI I KËTIJ VITI E GJETI KOSOVËN NË LLOGORE LUFTE

Nga Kadri Zeka

Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni! Lart solidariteti ndërkombëtar!

Në kushtrimin e këtyre thirrjeve luftarake bashkohen në barrikada klasore miliona proletarë në mbarë botën dhe godasin fuqishëm sistemin e kalbur borgjezo-revizionist, godasin shtypjen e shfrytëzimin e egër që ushtrohet mbi ta. Edhe 1 Maji i këtij viti ishte dita kur proletariati botëror tregoi forcën e vet dhe vendosmërinë revolucionare në luftën e tij të drejtë për t'u çliruar nga prangat kapitaliste.

Sistemi borgjezo-revizionist është në kalbëzim dhe po përjeton momente të vështira. Rënia e prodhimit, inflacioni, papunësia, ngritja e çmimeve, ulja e pagave e plagë të tjera të këtij sistemi, kanë keqësuar shumë jetën e masave punonjëse. Në këtë gjendje, borgjezia e reaksioni përpiqen që nga njëra anë të hedhin barrën e kësaj krize mbi kurrizin e masave punonjëse, kurse nga ana tjetër të shtojnë sa më shumë fitimet e veta. Proletariati e masat punonjëse në botë po e kuptojnë çdo ditë e më mirë se shpëtimi i tyre mund të vijë vetëm nga lufta për shkatërrimin e sistemit të shtypjes e të shfrytëzimit. Ata po e kuptojnë se çlirimi i tyre arrihet vetëm duke shtrënguar radhët, duke forcuar unitetin e revolucionarëve në luftë kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, regjimeve antipopullore, fashizmit e reaksionit. Imperializmi e reaksioni u gabuan rëndë kur kujtuan se bashkë me tradhtinë revizioniste, i ka ardhur fundi edhe Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, se ka marrë fund edhe ideologjia e tyre – marksizëm-leninizmi. Por ata u bindën shpejt për të kundërtën dhe sot po e shohin me sytë e tyre se kjo ideologji rron e gjallë në zemrat e proletarëve të mbarë botës, dhe i udhëheq ata në betejat e përditshme të luftës klasore. Çdo vit me dhjetëra miliona punëtorë hudhen në greva e dhjetëra të tjerë çdo ditë dalin në demonstrata dhe përleshen me policinë e ushtrinë borgjezo-revizioniste.

Marksizëm-leninizmi është i gjallë e jeton kudo në botë, flamuri i tij valvitet krenar në Atdheun tonë të dashur, Shqipërinë socialiste. Dhe për këtë Shqipëria është aq e dashur dhe e respektuar nga të gjithë komunistët, proletariati ndërkombëtar si dhe revolucionarët e njerëzit përparimtarë kudo që ndodhen. Ideologjia e mësuesve të mëdhenj të proletariatit botëror, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, ka bërë fole edhe në zemrat e masave punonjëse dhe të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi. Ishte madhështore brohoritja për marksizëm-leninizmin e mbi 20 mijë vetave në demonstratat e fundit që u zhvilluan në Kosovë. Restaurimi i plotë i kapitalizmit në Jugosllavi si dhe shtypja e shfrytëzimi që ushtron regjimi titist mbi masat punonjëse, kanë bërë që edhe në Jugosllavi të zhvillohet një luftë e ashpër klasore. Pos formave tjera të luftës proletariati jugosllav çdo vit bën mbi 2000 greva. Në mënyrë të veçantë lufta klasore në Kosovë ka marrë hov të madh, sepse këtu masat punonjëse i shtrohen një shtypje e shfrytëzimi të paskrupullt. Punonjësit kosovarë kanë nivelin më të ulët të jetesës në të gjithë Evropën, marrin paga shumë të ulëta, pothuajse nuk kanë kurrfarë mbrojtjeje e sigurie në punë.

"Me një gjë, cok, s'mund të pajtohemi: rrogat janë tepër të vogla... s'marrim më shumë se 1500 dinarë. A do të na dalin këto vetëm për bukë e duhan, si thua?" pyet një minator i Novobërdës, kurse shoku i tij shprehet kështu: "E sheh në ç'kushte punojmë dhe ç'thua, sa fitojmë në muaj... Neve xehtarëve, në vend që të na paguajnë aq sa meritojmë, na japin aq sa për të blerë nuk e duhan, kurse në shtëpi kam gjashtë fëmijë, gruan dhe

prindërit... Unë vëlla, s'marr vesh ç'po bëhet, veç një gjë e di: se s'po shpërblehemi sipas punës..." (Biseda është nxjerrë nga "Rilindja")

Kështu flasin punëtorët e Novobërdës e këso fjalësh dëgjon kudo edhe prej punëtorëve të tjerë në Kosovë. Kjo gjendje e rëndë dhe ky shfrytëzim i pashoq, kanë ngritur ndërgjegjen e masave dhe kanë ashpërsuar në kulm kontradiktat klasore. Shprehje e kësaj gjendjeje të padurueshme, janë edhe demonstratat e fundit që përfshinë Kosovën e në të cilat punëtorët kanë zënë një vend nga më kryesorët. Këtë fakt nuk mund ta fshehin as revizionistët titistë e tradhtarët shqiptarë. Në demonstratat e 1, 2 dhe 3 prillit, që u zhvilluan në Prishtinë, morën pjesë mijëra punëtorë dhe u qëndruan heroikisht të gjitha lajkave mashtruese dhe terrorit policor të titistëve. Edhe në qendra të tjera të Krahinës, punëtorët qenë forcë e madhe në demonstrata dhe tani, pa iu trembur syri, kanë lënë punën dhe janë hedhur në greva. Kjo po i kall tmerrin regjimit. Punëtorët kosovarë e pritën 1 Majin ashtu si u ka hije, në llogore lufte, e pritën me demonstrata e greva me parullat luftarake: "DUAM PUNË!", "DUAM NGRITJE PAGASH!", "ÇMIMET STOP!", POSHTË REVIZIONIZMI!", "RROFTË MARKSIZËM-LENINIZMI!", "LART SOLIDARITETI NDËRKOMBËTAR!"...

Edhe punëtorët kosovarë që punojnë në botën e jashtme, 1 Maji, Ditën e solidaritetit ndërkombëtar të punëtorëve, në shumë qytete e festuan me demonstrata e manifestime të tjera krah për krahu me vëllezërit punëtorë të vendeve të tjera.

RROFTË 1 MAJI, DITA E LUFTËS DHE SOLIDARITETIT NDËRKOMBËTAR TË PUNËTORËVE! (LIRIA, maj 1981, faqe 10)

Shoku Enver Hoxha për Kosovën:
3-4. GRUPI TITIST ËSHTË NJË GRUP TROCKISTËSH DHE RENEGATËSH
-Pjesë nga fjala në mbledhjen e 81 partive në Kremlin -

Grupi titist është një grup trockistësh dhe renegatësh prej shumë kohësh. Të paktën për Partinë e Punës të Shqipërisë ai është i tillë që prej vitit 1942, domethënë 18 vjet më parë.

Që në vitin 1942 kur lufta e popullit shqiptar mori një hov të madh, grupi trockist i Beogradit, nën maskën e miqësisë dhe në mirëbesimin tonë, u përpoq me të gjitha mjetet të pengonte zhvillimin e luftës sonë të armatosur, u përpoq të pengonte krijimin e reparteve të fuqishme sulmuese partizane shqiptare dhe, në pamundësi t'i ndalonte, u përpoq të merrte drejtpërdrejt drejtimin e tyre politik dhe ushtarak. Ai tentoi që çdo gjë të varej nga Beogradi dhe Partia jonë, ushtria jonë partizane të ishin apendise të thjeshta të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të Ushtrisë Nacionalçlimtare Jugosllave.

Partia jonë duke ruajtur miqësinë me partizanët jugosllavë, u bëri ballë me sukses këtyre qëllimeve djallëzore. Që në atë kohë grupi titist përpiqej të vinte themelet e Federatës Ballkanike, nën drejtimin e titistëve të Beogradit, të lidhte partitë komuniste pas qerres së Partisë Komuniste Jugosllave, të bënte që ushtritë partizane të popujve të Ballkanit të ishin nën vartësinë e shtabit titist jugosllav. Për këtë qëllim ai, dakord që në atë kohë me anglezet, u përpoq të krijonte shtabin ballkanik dhe ta lidhte e ta vinte atë, domethënë ushtritë tona, nën drejtimin e anglo-amerikanëve. Partia jonë u rezistoi me sukses këtyre planeve djallëzore. Dhe kur valoi Flamuri i Çlirimit në Tiranë, banda titiste e Beogradit u dha urdhër agjentëve të saj në Shqipëri të diskreditonin suksesin e Partisë

Komuniste Shqiptare dhe të organizonin puçin për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë, atë që organizoi Partinë, që udhëhoqi Luftën Nacionalçlirimtare dhe që e çoi popullin shqiptar në fitore. Dhe puçi i parë u organizua nga Titoja, tok me agjentët e tij të fshehtë në Partinë tonë. Por komplotin e Titos e shkatërroi Partia Komuniste Shqiptare.

Komplotistët e Beogradit s'i hodhën armët dhe tok me kryeagjentin e tyre në Partinë tonë, tradhtarin Koçi Xoxe, vazhduan riorganizimin e komplotit kundër Shqipërisë së re me forma të tjera, me forma të reja. Qëllimi ishte: Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë.

Në një kohë kur vendi ishte i shkatërruar dhe i djegur e duhej rindërtuar nga e para, kur populli ishte pa bukë e pa strehë, por me një moral të lartë, kur popull e ushtri me armë në dorë bënin roje vigjilente kundër komploteve të reaksionit që organizoheshin nga misionet anglo-amerikane dhe që e kërcënonin Shqipërinë e re me invazione të reja, kur një pjesë e madhe e Ushtrisë Partizane Shqiptare kapërceu kufirin e atdheut dhe u vajti në ndihmë vëllezërve jugosllavë, luftonte krah për krah me ta, komplotistët e Beogradit kurdisnin plane për të robëruar Shqipërinë.

Por Partia jonë u bëri ballë heroikisht këtyre agjentëve të fshehur nën maskën e komunistit. Kur panë trockistët e Beogradit se e humbën davanë, se komplotet po ua shkatërronte Partia jonë, provuan kartën e fundit: Të invadonin Shqipërinë me ushtritë e tyre, të mbytnin rezistencën, të arrestonin udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar, dhe ta deklaronin Shqipërinë republikë të shtatë të tyre. Partia e prishi edhe këtë plan djallëzor të tyre. Ndihma dhe ndërhyrja e J. V. Stalinit në ato çaste qe vendimtare për Partinë tonë dhe për lirinë e popullit shqiptar.

Ishte tamam koha e demaskimit të klikës së Titos nga Informbyroja. Byroja Informative bëri të dështojnë veprimet komplotiste të klikës së Titos jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Renegati dhe agjenti i imperializmit, Titoja dhe banda e tij, duke vepruar nën maskën e komunistëve, u përpoqën të shkëputnin vendet e demokracisë popullore të Ballkanit dhe të Evropës Qendrore nga miqësia dhe nga aleanca e luftës me Bashkimin Sovjetik, të shkatërronin partitë komuniste dhe punëtore të vendeve tona dhe t'i shndërronin shtetet tona në rezervë të imperializmit anglo-amerikan.

Ata që s'deshën t'i shihnin e t'i kuptonin këto veprime të kësaj bande provuan për të dytën herë me kundërrevolucionin në Hungari dhe me komplotet e pareshtura në Shqipëri se ujku qimen ndërron, por prapë ujk mbetet, se Titoja dhe banda e tij mund të bëjnë dredhira, mund të vënë maska, por prapë tradhtarë dhe agjentë të imperializmit, vrasës së komunistëve heroikë internacionalistë jugosllavë mbeten, verpojnë dhe kështu do të jenë, derisa të zhduken.

Partia e Punës e Shqipërisë ishte, nga ana tjetër, dakord që me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë të vendoste marrëdhënie shtetërore të fqinjësisë së mirë, marrëdhënie tregtare dhe kulturore, në rast se respektoheshin normat e bashkekzistencës paqësore në mes të shteteve me regjime të ndryshme, pse për Partinë e Punës të Shqipërisë Jugosllavia titiste s'ka qenë, s'është dhe s'do të jetë kurrë një vend socialist, derisa të ketë në krye grupin renegat dhe agjent të imperializmit.

Në Shqipëri titistëve u hasi sharra në gozhdë, ose, si thotë Titoja, "Shqipëria iu bë ferrë në këmbë" dhe natyrisht grupi tradhtar titist e vazhdoi luftën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe mendonte se na demaskonte duke na cilësuar "stalinistë".

Grupi i Beogradit s'na luftoi vetëm me propagandë, por ai vazhdoi spiunazhin, diversionin, komplotet, dërgimin e bandave të armatosura në vendin tonë dhe vepronte

më fort se para vitit 1948. Këto janë të faktuara. Por tragjedia qëndron këtu, që Partia e Punës e Shqipërisë, nga një anë, ishte në mbrojtje kundër sulmeve të ashpra dhe të paprera të revizionistëve jugosllavë, nga ana tjetër, qëndrimi i patundur, parimor, marksist-leninist i Partisë sonë ishte në kundërshtim me qëndrimet pajtuese që mbaheshin ndaj revizionistëve jugosllavë nga ana e udhëheqësve sovjetikë dhe e disa partive të tjera komuniste e punëtore.

Grupi tradhtar i Beogradit filloi organizimin e kundërrevolucionit edhe në Shqipëri . Sikur Partia jonë të kishte bërë gabimin e futjes në "vallen e pajtimit" me revizionistët jugosllavë, siç predikohej pas vitit 1955, atëherë demokracinë popullore të Shqipërisë do ta kishte marrë lumi. Ne, shqiptarët, nuk do të ishim sot këtu në këtë sallë, po do të luftonim ende nëpër male.

Partia dhe populli, në një unitet të çeliktë, qëndronin shumë vigjilentë dhe zbuluan e demaskuan spiunët e Titos në Komitetin tonë Qendror, që punonin në bashkëpunim me legatën jugosllave në Tiranë. Titoja u dërgoi lajm këtyre tradhtarëve, duke u thënë se ishin ngutur, se duhej të kishin pritur udhëzimet e tij. Këta spiunë e tradhtarë i dërguan letër edhe shokut Hrushov që të ndërhynte kundër Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këto janë të faktuara me dokumente. Qëllimi i Titos ishte që kundërrevolucioni në Shqipëri të koordinohej me atë në Hungari.

Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të mbahej Kongresi ynë III. Agjentura jugosllave mendoi se kishte ardhur çasti ta rrëzonte udhëheqjen "kokëforte dhe staliniste shqiptare" dhe organizoi komplotin, i cili u zbulua dhe u dërrmua në Konferencën e Partisë në Tiranë, në prill 1956. Komplotistët morën dënimin e rreptë të merituar.

Agjentët e tjerë të rrezikshëm të Titos në Shqipëri, Dali Ndreu dhe Liri Gega, morën urdhër nga Titoja të arratiseshin në Jugosllavi se "ishin në rrezik" dhe se veprimet kundër Partisë sonë "duheshin organizuar nga territori jugosllav". Partia ishte plotësisht në dijeni të veprimtarisë dhe të urdhrit sekret të Titos. Ajo ishte vigjilente dhe i kapi tradhtarët mu në kufi, kur tentonin të arratiseshin. Agjenti tjetër jugosllav dhe tradhtari i Partisë së Punës të Shqipërisë e i popullit shqiptar, Panajot Plaku, u arratis në Jugosllavi, u vu në shërbim të jugosllavëve. Ai organizonte emisionet armiqësore të radiostacionit të ashtuquajtur "Shqipëria socialiste". Ky tradhtar i shkroi letër renegatit Tito dhe shokut Hrushov dhe i kërkonte këtij të fundit që me autoritetin e tij ta likuidonte udhëheqjen e Shqipërisë, me Enver Hoxhën në krye për arsye se ne qenkemi "antimarksistë", "stalinistë".

Ne na çuditë dhe bëjmë pyetjen legjitime: Pse shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë shumë herë shkuan në Brioni për të biseduar me renegatin Tito për çështjen e Hungarisë. Në qoftë se shokët sovjetik kishin dijeni se titistët po përgatitnin kundërrevolucionin në një vend të kampit tonë, a u lejohet udhëheqësve të Bashkimit Sovjetik të venë të bisedojnë me një armik, që organizon komplote dhe kundërrevolucione në vendet socialiste?

Disa shokë mendojnë gabim, pretendojnë se ne mbajmë këto qëndrime ndaj titistëve, ngaqë gjoja dashkemi të mbajmë flamurin e luftës kundër revizionizmit, ose ngaqë e shohim këtë problem ngushtë, nga pikëpamja thjeshtë nacionale, prandaj qenkemi futur, në mos në "rrugën shoviniste", të paktën në atë të "nacionalizmit të ngushtë". Partia e Punës e Shqipërisë çështjen e revizionizmit jugosllav e ka parë dhe e sheh nën prizmin e marksizëm-leninizmit, e ka parë, e sheh dhe e lufton si rrezikun kryesor për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si rrezik për unitetin e kampit socialist.

Por ne, duke qenë internacionalistë, jemi njëkohësisht edhe komunistë të një vendi të caktuar, të Shqipërisë. Ne, komunistët shqiptarë, nuk do të quheshim komunistë, nëqoftëse nuk do të mbronim me konsekuencë dhe me vendosmëri lirinë e atdheut tonë

të shtrenjtë nga komplotet dhe sulmet diversioniste të klikës revizioniste të Titos, të cilat synojnë invadimin e Shqipërisë dhe që tashmë njihen mirë nga të gjithë. A mundet dhe a është e lejueshme që ne, komunistët shqiptarë, ta lëmë vendin tonë që të bëhet gjahu i Titos, i amerikanëve, i grekëve, apo i italianëve? Jo kurrë!

Jugosllavët na akuzojnë se gjoja jemi "shovinistë, ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme dhe kërkojmë rektifikimin e kufijve shqiptaro-jugosllavë". Mjaft nga miqtë tanë mendojnë dhe lënë të kuptohet se ne, komunistët shqiptarë, jemi në këto ujëra. Ne u themi miqve që mendojnë kështu se gabohen rëndë. Ne s'jemi shovinistë, ne as kemi kërkuar dhe as kërkojmë rektifikim kufijsh. Por ajo që ne kërkojmë dhe do të kërkojmë vazhdimisht nga titistët dhe për të cilën do t'i demaskojmë ata deri në fund është të heqin dorë nga krimi i gjenocidit kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, të heqin dorë nga terrori i bardhë kundër shqiptarëve të Kosovës, të heqin dorë nga dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre dhe dërgimi në masë i shqiptarëve në Turqi; ne kërkojmë që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i njihen të drejtat në bazë të kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Shoviniste është kjo kërkesë apo marksiste?

Këto janë pozitat tona në këtë çështje. Por në rast se titistët, nga njëra anë, flasin për bashkekzistencën, për paqen, për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe, nga ana tjetër, organizojnë komplote, organizojnë ushtri mercenarësh dhe fashistësh në Jugosllavi për të sulmuar kufijtë tanë dhe për të copëtuar së toku me Greqinë monarko-fashiste Shqipërinë tonë socialiste, atëherë të jeni të bindur se jo vetëm populli shqiptar i Shqipërisë së re do të ngrihet me armë në dorë, por me armë në dorë do të ngrihen edhe një milion shqiptarë që jetojnë nën robërinë titiste, për t'i ndalur dorën kriminelit. Dhe kjo është marksiste dhe kështu do të bëhet, po të ngjasë gjëkafshë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk lejon kërkend të luajë ose të bëjë politikë me të drejtat e popullit shqiptar.

Ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të të tjerëve, por, kur, si rezultat i zbutjes së luftës kundër revizionistëve jugosllavë, arrin puna që në një vend mik si Bullgaria të shtypet harta e Ballkanit, duke përfshirë Shqipërinë brenda kufijve të Jugosllavisë Federative, nuk mund të rrimë pa folur. Na thuhet se kjo ndodhi për gabimin teknik të një nëpunësi, po pse këto nuk ndodhën më parë?

(LIRIA, maj 1981, faqe 11-12)

3-5. AI RA PËR TË MOS VDEKUR KURRË

Më maj u mbushën 39 vjet nga rënia heroike e udhëheqësit të parë të Rinisë Komuniste Shqiptare, Heroit të Popullit Qemal Stafa.

Qemali lindi më 1920 në Shkodër, në një familje me tradita të njohura patriotike. Qysh i ri, ai u brumos nga i ati, e sidomos nga vëllau i madh Veliu, me një patriotizëm të madh, me një dashuri të thellë për popullin që jetonte në skamje, injorancë e varfëri e me një urrejtje të papërmbajtur ndaj armiqve dhe tradhtarëve.

Në fëmijërinë e hershme, Qemali fillon të lexojë literaturën përparimtare të kohës e të lidhet me njerëz revolucionarë e antizogistë. Përmes Veliut, ai arrinë të njihet edhe me poetin revolucionar Migjenin, të cilin e adhuronte. Më vonë e gjejmë njërin ndër nxënësit më revolucionarë në gjimnazin e atëhershëm të Shkodrës. Aty ai ra në kontakt edhe me literaturën komuniste që asaj kohe sigurohej me vështirësi në Shqipërinë e sunduar nga satrapi Zog. Aty ai pati rastin të njihej edhe me shumë revolucionarë të tjerë si Emin Duraku, Nazmi Rushiti etj. Gjatë kësaj kohe, Qemali dallohet si për zgjuarsinë e kulturën e gjerë të tij, ashtu edhe në aktivitetet e shumta letrare që organizonte rinia e gjimnazit. Si i ri revolucionar, Qemali më vonë pranohet anëtar i Grupit Komunist të

Shkodrës dhe zhvillon një aktivitet të gjerë për përhapjen e ideve komuniste në masën e rinisë.

Idetë e mëdha të komunizmit kishin forcuar mendjen e zemrën e Qemalit. Nuk kishte më shumë se 15-16 vjet kur shkruante: "E vjetra po shembet, një jetë e re po lulëzon gërmadhash, jetë për të cilën shqiptari nuk tutet se vdes, mjafton që vdekja të jetë e ndershme, të jetë vdekje burrash, vdekje për Atdhe."

Në hartimet e tij të kësaj kohe nuk gjejmë shkrime as për cicërimën e zogjve, as për aromën e luleve, po vetëm tinguj lufte, dufe kryengritëse, optimizëm mbi gërmadha e varfëri. Aktiviteti i tij prej komunisti e militanti të vendosur bie në sy të policisë mbretërore dhe, pak ditë para pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, Qemalin e arrestojnë. Në qelitë e errëta e të ftohta të burgut, ai mendonte për ditë të bardha e të lumtura për popullin e vet, të cilin ai aq shumë e donte. Mundimet e torturat nuk mundën ta mposhtin trupin e tij të njomë, shpirtin e tij revolucionar. Zëri i tij gjëmoi krenar përballë trupi gjykues: "Jam komunist i bindun dhe i deklaruem, dhe vetëm bolshevizmi do ta shpëtojë masën e punëtorisë që ndodhet e shtypun." Dhe kjo nuk ishte vetëm një deklaratë e një komunisti, por ajo ishte deklaratë e gjithë një populli, që po i shpallte luftë mbretërisë, fashizmit, shtypjes dhe shfrytëzimit. Më 7 prill 1939, ditën që hordhitë fashiste të Musolinit sulmuan Shqipërinë, Qemali, i arratisur nga qelia shpejton bashkë me shokë rrugëve e rrugicave. Pushtim, – dëgjohet zëri i tij, dhe ky kushtrim bëri vend në mendjen e zemrën e popullit. Fashizmi përdor të gjitha mjetet e dhunës e të demagogjisë për ta shtypur e mashtruar popullin tonë, ai i bënte thirrje rinisë shqiptare të vishej në rrobat e zeza të fashizmit, por Qemali nxitonte kalldrëmeve, ulet e ngrihet pranë vatrave të ndezura të Tiranës së kuqe, deri sa arrinë në 8 nëntorin e asaj vjeshte historike, kur themelohet Partia Komuniste Shqiptare, shpëtimtarja e vërtetë për popullin fukara.

Qemali dha një kontribut të veçantë e shumë të madh në themelimin e Partisë dhe në mbledhjen themeluese qëndronte përkrah shokut Enver, si shok e bashkëluftëtar besnik i tij. Ai, ndonëse shumë i ri, u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror dhe më vonë luajti një rol të madh në konsolidimin e forcimin e Partisë. Ato ditë ishin ditë të mëdha, ditë që do të rrezatonin në historinë e kombit, ditë që do të nisnin një epokë të re në historinë e Shqipërisë.

Pak ditë më vonë u themelua Organizata e Rinisë Komuniste Shqiptare e Qemali u zgjodh sekretar politik i saj. Ai, në ato ditë fortune, u vu në krye të djalërisë shqiptare. Shoku Enver në kujtimet e tij nga themelimi i Rinisë Komuniste Shqiptare shkruan: "Zgjedhja e Qemalit, anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, si sekretar politik të Organizatës Komuniste të Rinisë, ishte një garanci e madhe për Partinë dhe Organizatën e Rinisë, pse Qemali ishte një shok me cilësi të rralla për moshën e tij të re. Ai ishte shumë i ri, por ishte i pjekur, ai ishte i thellë e serioz në mendime dhe diskutime."

Themelimi i Partisë dhe Rinisë Komuniste Shqiptare e kishte mbushur plot optimizëm e i kishte dhënë forca të reja komunistit zemërzjarr, udhëheqësit e organizatorit të shquar të Partisë e rinisë shqiptare. Nxitonte Qemali sypatrembur ku e kërkonte nevoja e atdheut, derisa arriti në 5 majin e vitit 1942, ditën që ra heroikisht dhe thirrja e fundit e tij ishte: "Rroftë komunizmi!" Një natë më parë, ai kishte ndenjur me një minder pranë e pranë me shokun Enver, ishin çmallur e kishin biseduar për hallet e luftës. Shoku Enver kujton: "Si mund ta mendoja unë se puthja e shtrëngoja për herë të fundit në kraharorin tim shokun nga më të mirët e Partisë, shokun dhe bashkëluftëtarin tim më të dashur, Qemal Stafën."

Rënia e tij heroike u bë një shembull i lartë frymëzimi për të gjithë Partinë e Rininë Komuniste Shqiptare, ndezi zjarr zemrat e luftëtarëve të lirisë në luftë kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit. Ai ra për lirinë e popullit, për komunizmin, ra për të mos

vdekur kurrë. Dhe populli sot e kujton dhe nderon me respektin më të madh si birin dhe luftëtarin e tij të shtrenjtë. Atë e kujton me respekt e dashuri të madhe edhe populli e rinia revolucionare e Kosovës, që sot ndodhet nën robërinë fashiste jugosllave. Dita e 5 majit, kur ra Qemali në përleshje me forcat fashiste, nga populli ynë u shpall Ditë e Dëshmorëve. (LIRIA, maj 1981, faqe 12-13)

3-6. PUNËTORËT KOSOVARË NË PERËNDIM SHPALOSIN FLAMURIN E LUFTËS

Nga Kadri Zeka

Ngjarjet tragjike që po përjeton Kosova i kanë bërë të ndërgjegjshëm punëtorët kosovarë në mërgim se edhe ata, si pjesë e pandarë e popullit shqiptar, në këto momente të vështira që po kalon Atdheu, duhet të ngrehin lart flamurin e luftës. Shtypja e shfrytëzimi, si dhe malli për Atdhenë e popullin që i ka lindur, kanë grumbulluar një pezëm e zemërim të papërshkruar në zemrat e tyre. Kjo urrejtje ndaj shfrytëzuesve e shtypësve gjakatarë titistë po shprehet më së miri këto ditë me një hov të papërmbajtur në demonstratat, mitingjet e protestat e shumta që po organizojnë ata në botën e jashtme. Punëtorët tanë, nga skamja e mjerimi, nga presionet që u bën regjimi titist, janë detyruar t'ua kthejnë shpinën familjes e fëmijëve të tyre, vatrave ku kanë lindur dhe çdo gjëje të dashur për ta. Punëtorët kosovarë sot janë më të bashkuar e më të vendosur se kurdoherë më parë në luftën e tyre të drejtë. Këtë e dëshmojnë demonstratat dhe mitingjet protestuese të njëpasnjëshme që janë zhvilluar deri më tash. Më 11 prill u grumbulluan mbi 400 kosovarë, në Bernë të Zvicrës dhe, me flamuj e parulla të shkruara, demonstronin rrugëve të qytetit, duke shprehur solidaritetin e tyre me luftën e vëllezërve dhe të motrave në Kosovë si dhe urrejtjen për gjakpirësit titistë. Më pas, punëtorët u drejtuan për në përfaqësinë diplomatike të Jugosllavisë në Bernë, ku organizuan një miting protestues, në të cilin ngritën zërin e protestës për terrorin e masakrat që po bëjnë ushtria e policia fashiste në Kosovë.

Demonstratën e Bernit e pasoi ajo e Cyrihut të Zvicrës, që u zhvillua më 18 prill, e në të cilën morën pjesë mbi 700 punëtorë kosovarë. Ata marshuan qytetit, duke brohoritur për të drejtat e popullit tonë.

Pos këtyre, demonstrata nga punëtorët tanë janë zhvilluar edhe në Shtutgart e në Dyseldorf të Gjermanisë Perëndimore. Në të parën ishin të pranishëm rreth 500 manifestues, kurse në të dytën mbi 800 veta.

Në të gjitha këto demonstrata, si dhe në manifestime të tjera, zotëronte një shpirt i lartë luftarak dhe një vendosmëri e pashoqe për të luftuar pushtuesit titistë dhe tradhtarët e vendit. Punëtorët tanë në mërgim organizuan demonstrata të shumta edhe me rastin e 1 Majit, ku bashkë me punëtorë e proletarë të vendeve të tjera, treguan para armiqve forcën dhe unitetin e tyre luftarak.

Lufta e hapur e kosovarëve në mërgim demaskon më së miri shpifjet e telegrameve të konsullatave jugosllave, që dërguan në emër të punëtorëve kosovarë, ku gjoja ata dënojnë luftën e demonstratat e popullit tonë në Kosovë. Punëtorët, me parullat e tyre luftarake: "KOSOVË-REPUBLIKË!", "REPUBLIKË-VETËVENDOSJE!", "JA VDEKJE.JA LIRI!", "DUAM LIRIMIN E SHOKËVE!" LUFTË, LUFTË NATË E DITË, QË TË SHOHIM PAKËZ DRITË!", "LART SOLIDARITETI NDËRKOMBËTAR!", "MARKSIZËM-LENINIZËM!", "POSHTË TERRORI E DHUNA NË KOSOVË", "POSHTË UDB-ja FASHISTE JUGOSLLAVE!", "POSHTË

TITIZMI!", "TITIZMI ËSHTË FASHIZËM!"... u treguan jo vetëm armiqëve titistë por gjithë botës se janë të vendosur në luftën e tyre dhe se kjo luftë nuk do të pushojë deri në realizimin e të gjitha kërkesave të drejta të popullit tonë. Ata gjithashtu treguan se nuk mund t'i përçajë e frikësojë asnjë demagogji e presion i armikut.

Në fund të të gjitha demonstratave u organizuan mitingje protestuese dhe u shpallën kërkesat para përfaqësive diplomatike jugosllave. Kërkesat e punëtorëve tanë në botën e jashtme ishin plotësisht identike me ato, që paraqitën edhe demonstrantët në Kosovë.

Me luftën e popullit tonë është solidarizuar edhe opinioni përparimtar ndërkombëtar i cili dënon në mënyrën më të rreptë masakrat e krimet çnjerëzore të regjimit titist në Kosovë. Me demonstratat që u zhvilluan jashtë, u bashkuan edhe shumë antifashistë, demokratë e miq të popullit tonë dhe po shprehin indinjatën e tyre të thellë për ngjarjet tragjike që po përjeton populli ynë. Ngjarjet e hidhura të Kosovës kanë zënë një vend të mirë edhe në shtypin përparimtar botëror dhe në mjete të tjera të informimit.

Pjesë nga fjala e një motre kosovare mbajtur në mitingun protestues në Dyseldorf të Gjermanisë

Të dashur bashkatdhetarë,

Tani e dimë se jo vetëm shqiptarët por tërë botën e kanë tronditur ngjarjet tragjike që po ndodhin në Kosovë. Populli ynë punëtor, trim, paqedashës e i etur për liri dhe pavarësi, në një gjendje shumë të vështirë ekonomike dhe politike, gjeti rrugën më të përshtatshme për t'i kërkuar të drejtat e veta (borxhin e vjetër) nga qeveria jugosllave.

Qeveria jugosllave, që popullin kosovar e ka mbajtur dhe e mban në shënjestër, nxitoi me tanke e helikopterë, vrau, burgosi e theri lulen më të bukur – rininë e Kosovës. Kështu udhëheqësit jugosllavë e treguan edhe njëherë fytyrën e tyre të vërtetë të pushtuesit, vrasësit, e fashistit gjakatar.

Tani kjo udhëheqësi kot përpiqet me fraza të thata, me shpifje e trillime, t'i mashtroj popujt e botës për krimet që po bën mbi popullin tonë në Kosovë. Turp i botës, tragjedi e shekullit. Një qeveri evropiane e shekullit XX, e vetëquajtur socialiste, të lëshohet mbi një popull të shtypur me shekuj si bishë e çartur, ta vrasë, ta dhunojë, e më në fund edhe ta akuzojë.

Ne jemi një popull i vogël përballë një bishe të madhe, por jemi të fortë e të pamposhtur, sepse në zemrat tona kemi indinjatë e urrejtje të thellë për ata që na i shkelin vatrat dhe na i grabitin pasuritë.

Klika revizioniste jugosllave gjithmonë na ka dënuar e vrarë, por kurrë s'na ka mposhtur. Kjo klikë renegatësh e preku popullin tonë në gjërat më të shenjta e më të shtrenjta. Ajo në të kaluarën e afërt (në kohën e gjakpirësit Rankoviç) vrau e zhduku mijëra shqiptarë, dhe jo vetëm kaq. I emigroi, u hyri në familje, cënoi me dhunë moralin e gruas shqiptare, pse ajo kishte qëndisur një shami kuq e zi, apo pse në pajën e saj kishte punëdore me ngjyra simbolike. Pra edhe paja e vajzave shqiptare i hynte në "politikë" renegatit Tito, Rankoviç e Kolishevski, të cilët edhe sot po e tregojnë hijen e vet dhe hujin e ujkut të etshëm për gjak shqiptari. Edhe sot bota me të drejtë e quajti Kosovën "Shtëpinë e varfër të Evropës" të cilën udhëheqja jugosllave e la të tillë me qëllim dhe tani kërkon t'ia shtjerë flakën dhe dëshiron ta djegë me fëmijë në djep, me të rinj e të reja, me gra e burra. Por, s'e djeg dot.

Kosova prapë do të ketë fëmijë, prapë do të ketë rini, sepse vetë është e re. Kosova do të ketë liri, se për të po lufton e po derdh gjak sot. Ne gratë shqiptare nuk i lindim fëmijët në epruveta, nuk ua lëmë mbiemrin tonë, ne lindim shqiptarë me armë në brez, ne do të lindim e do të rrisim gjithmonë nipa e mbesa të Shotës dhe të Azemit, Isa Boletinit e Bajram Currit, të Emin Durakut e Çerçiz Topullit. Dhe do të mburremi para botës dhe brezave të ardhshëm me historinë tonë. Çfarë u prishim punë revizionistëve jugosllavë pse jemi popull patriot?... Çfarë mëkati bëri populli ynë që e kërkoi statusin e republikës? Kush janë irredentistët? Po pushtuesit? Kush kujt ia turbullon ujtë? E kush mundohet ta lërë dike pa ujë?

Ne do të fitojmë. Por, fitoret arrihen e mbrohen me përpjekje e sakrifica. Me luftë e djersë. Betohemi me mendje, me zemër e grushta të bashkuar për tokën, popullin, gjakun e derdhur e lirinë. I dënojmë armiqtë e popullit shqiptar, i thërrasim popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe të botës që të ecin rrugës së sigurtë të solidaritetit e të marksizëm-leninizmit, me protesta kundër shtypësve kriminelë.

"POSHTË TRADHTARËT E ATDHEUT!" "NUK DUAM JETË PA LIRI!" "LAVDI DËSHMORËVE TË RËNË PËR ATDHEUN!" "I QOFSHIM FALË ATDHEUT TONË TË DASHUR, KOSOVËS TONË TË SHTRENJTË!" (LIRIA, maj 1981, faqe 13)

3-7. REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË U BË NËN HIJEN E TANKEVE

Nga Jusuf Gërvalla

Lidhur me regjistrimin aktual të popullsisë, revizionistët jugosllavë kanë zhvilluar me kohë një fushatë sa të ethshme aq edhe perfide të propagandës dhe të agjitacionit në dëm të disa popullsive. Pas qerres së revizionistëve, me një paturpësi që shkon deri te tradhtia e hapët kombëtare, janë lidhur me zell të madh edhe renegatët shqiptarë në pushtet. Fushata është zhvilluar në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë ka qenë propaganda dhe agjitacioni i organizuar shtetëror në disa pjesë t'i quajmë skajore të popullsisë shqiptare, në të cilat socialshovinistët jugosllavë ia kanë dalë të ushtrojnë edhe më përpara njëfarë ndikimi çkombëtarizues e asimilues, siç janë të ashtuquajturit "torbeshë" apo "maqedonas muslimanë" në Maqedoninë perëndimore dhe të ashtuquajturit "muslimanë" të viseve shqiptare të Malit të Zi. Të mos flasim pastaj për popullsinë shqiptare të viseve të Sanxhakut, te e cila socialshovinistët e Beogradit kanë arritur ta shtypin pa mëshirë ndjenjën kombëtare dhe ta çrrënjosin në masë të madhe gjuhën amtare shqipe. Ndërkaq, drejtimi i dytë ishte ai i frenimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve, kudo që të jenë ata, me presione të gjithanshme politike etj.

Ja disa nga aksionet e shumta në shkallë shtetërore, të realizuara me anën e mjeteve publike të informimit, siç janë shtypi e televizioni.

Thirrjet për vampirizëm të "teorive" borgjeze shoviniste

Qysh para tri vjetësh, më 1978, një ekip i Televizionit të Beogradit, në krye me poetin dhe gazetarin serb Lubivoje Rshumoviq, realizoi në Maqedoninë perëndimore një serial televiziv "dokumentar", të përbërë prej dymbëdhjetë emisionesh njëorëshe. Duke vajtur nga fshati në fshat, si misionarët e dikurshëm të krishterimit, ky gazetar zhvilloi me atë rast biseda të pafundme me të ashtuquajtur "torbeshë" apo "maqedonas muslimanë". Bisedat, duke u sjellë gjoja në mënyrë spontane dhe duke u "përpunuar" pastaj në redaksi me mjete dhe metoda "shkencore", zhvilloheshin rreth adeteve e

zakoneve, rreth të kaluarës "historike" të "torbeshëve", rreth emrave "karakteristikë" të personave e të vendeve, siç janë shtigjet e ndryshme, fushat e arat, burimet e krojet etj. Me një fjalë emisionet ngulnin këmbë që të nxirrej antroponimia dhe mikrotoponimia sllave e kësaj pjese të popullsisë shqiptare dhe të viseve thjesht shqiptare

Ky ishte një qëllim i tejdukshëm që, me anën e mjeteve dhe metodave të njohura shoviniste të "shkencëtarëve" të dikurshëm sllavë si Cvijiqi e Gjorgjeviqi, te kjo pjesë e popullsisë shqiptare të thellohet edhe më tej apolitizmi, pacifizmi dhe asimilimi, duke ia ngulitur asaj në kokë mendimin se më parë mund të jetë gjithçka tjetër sesa popullsi shqiptare.

Renegatët shqiptarë në pushtet, qoftë në Kosovë a në Maqedoni, siç është e natyrshme për ta, e bënë syrin qorr e veshin shurdh e nuk e panë të udhës ta thonin asnjë fjalë lidhur me atë fushatë të ndyrë shoviniste, e cila është në kundërshtim edhe me dispozitat kushtetutare të Jugosllavisë, që kanë të bëjnë me përcaktimin e lirë kombëtar dhe që gjoja para shikojnë dënime të rrepta për çdo agjitacion në këtë drejtim.

Por, egërsia dhe guximi karakteristik i socialshovinistëve jugosllavë në diskriminimin e një populli të tërë, shpërtheu haptasi vitin e kaluar në gazetën "Veçer" të Shkupit. Nga 25 shtatori deri më 21 tetor, kjo gazetë e shovinistëve maqedonas botoi në 23 vazhdime serinë e artikujve të Nijazi Limanovit me titull "Islamizimi i Maqedonisë". Duke u përpjekur gjoja për t'u dalë zot "torbeshëve" apo "maqedonasve muslimanë", siç quhet këtu me kohë një pjesë e popullsisë shqiptare pjesërisht e asimiluar, gazeta në fjalë doli me sulme të hapëta shoviniste, të padëgjuara deri më tash, kundër popullit shqiptar. Sipas të vjellave të Limanovit, një gazetar gjysmanalfabet dhe psikopat nga rrethi i Dibrës, populli shqiptar e paskësh pranuar në të kaluarën me gjithë dëshirë fenë muslimane, me qëllim që pastaj, me një "agresivitet" të paparë prej "pushtuesi" të egër, t'i islamizojë edhe popullsitë sllave përreth. Në marifetin e tij të bukur, morri Nijazi Limanov – edhe vetë një shqiptar i asimiluar - shkon aq larg sa jo vetëm i thërret të vampirizohen të gjitha forcat e errëta "shkencore" të borgjezisë sllavomadhe serbe, por atyre u siguron edhe "lëndë" të re lidhur me "agresivitetin", "dhunën" dhe përgjithësisht "egërsinë" e "pushtuesve" shqiptarë.

Përsëri renegatët shqiptarë bënë gjumin e tyre të ëmbël të tradhtisë dhe të moskokëçarjes për çkado që nuk e rrezikon pozitën e tyre të mjerë në aparatin revizionist jugosllav.

Doli dhe reagoi, vërtet pesë para dymbëdhjetëve por në mënyrë të thuktë shkencore, akademiku Dr. Ali Hadri.

Duhej që renegatët shqiptarë, siç u jepte mundësi Kushtetuta për të cilën ata kapen aq fortë kur ua do nevoja, t'ia ngjitnin për veshi Limanovit e "Veçerit" dhe ta ndërprenin që me artikullin e parë serinë e atyre shkrimeve me përmbajtje thellësisht antishqiptare. Ata, pra, janë aq energjikë e të papërtueshëm kur kanë të bëjnë, qoftë edhe me një fjalë të vetme të autorëve shqiptarë.

Tragjedia në popull – farsa në pushtet

Siç thamë në fillim, drejtimi i dytë nga do të dëmtohej popullsia shqiptare në regjistrimin aktual të popullsisë, ishte shtrëngimi dhe presioni i gjithanshëm politik mbi shqiptarët. Ky shtrëngim u realizua në radhë të parë me burgosjet masive të djalërisë përparimtare të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare. Për një libër, një broshurë, gazetë apo trakt, madje për një fjalë goje të thënë në rrugë, qindra e mijëra shqiptarë u privuan lirie dhe i mbushën burgjet e Kosovës dhe të Jugosllavisë në një periudhë fare të shkurtër kohore. Sikur të mos u mjaftonte kjo, plangprishësit shqiptarë, këta tradhtarë të regjur,

morën flamurin e turpit në dorë dhe u byritën para mikrofonave e kamerave, në faqet e shtypit revizionist, duke iu kërcënuar në një mijë mënyra popullit shqiptar dhe djalërisë së tij përparimtare, me aq pasion të egër, sa të ta mbushin mendjen se i ke hyrë deri në fyt borxh djallit po more guxim qoftë edhe të marrësh frymë shqip.

Që efekti të jetë sa më i madh, revizionistët dhe sahanlëpirësit shqiptarë, pasi bënë punën e tyre djallëzore, iu dhanë edhe më me pasion kërcënimeve për ata shqiptarë, që do të guxonin të bënin agjitacion lidhur me deklarimin e kombësisë.

Askujt s'ka mundur t'i shkojë as mendja se regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të vazhdonte edhe në kushtet e tmerrshme që u krijuan pas demonstratave të fundit. Në një kohë kur rrugët, sheshet dhe vatrat tona binin erë gjaku, zhurmë tankesh e aeroplanësh dhe shkëlqim barbar të bajonetës së ngopur me gjakun e rinisë sonë ; në një shtrëngim të tillë hekuri, siç është rrethimi i plotë i qyteteve dhe fshatrave tona, ora policore e ndalimi i çdo grumbullimi të njerëzve; mbyllja e Universitetit dhe e të gjitha shkollave, mbyllja e ndërmarrjeve, fabrikave dhe uzinave – në një kohë të tillë, pra, një çështje siç është regjistrimi i popullsisë s'kishte gjë tjetër për qëllim, pos sadizmin e pamatë të shovinistëve revizionistë të Beogradit, që deshën ta provonin në praktikë se a rrëzohet deveja e stërngarkuar për një lëkurë lepuri më shumë.

Shtypi, radioja e televizioni revizionist zunë të krekoseshin si mburravecët e fundit të kësaj bote sesi, megjithë situatën e krijuar në Kosovë, ata gjoja s'e kanë humbur pushtetin dhe regjistrimin e parashikuar të popullsisë po e vazhdonin në kushtet dhe në mënyrën më "normale". Si vazhdimisht që 69 vjet e këtej, forcat e errëta borgjeze jugosllave deshën edhe kësaj radhe të përfitonin nga mjegulla dhe të mjegullonin statistikat e tyre të mjegullta dhe të zvogëlonin numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë.

Sa i dënueshëm është ky akt kaq barbar i atyre forcave të errëta jugosllave në pushtet, të cilave u ka krijuar klimë shumë të favorshme për manifestimin e fshehtë dhe të hapët të shovinizmit pikërisht revizionizmi në pushtet, do të shihet me kalimin e kohës atëherë kur do të shihet edhe dëmi që i është shkaktuar në këtë mënyrë evidentimit statistikor të popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Por, kjo nuk i bën nder qeverisë jugosllave. Dhe aq më pak do t'i sjellë dobi. Sepse populli ynë, ndonëse kësaj radhe ishte i zënë me punë më të ngutshme, me varrimin e bijave dhe bijve të vet, me mjekimin e plagëve që morën ata nga ushtria dhe milicia jugosllave, me burgimet e rënda, është absurd të mendohet që e ka harruar edhe rëndësinë e regjistrimeve të popullsisë. Populli ynë ka një shpirt të madh. Ai e përballoi burrërisht e heroikisht tragjedinë. Do ta përballojë edhe këtë regjistrim të popullsisë që u bë nën hijen e tankeve dhe nën zhurmën kërcënuese të aeroplanëve.

Për falsifikimet që borgjezia jugosllave ka bërë prej motesh lidhur me numrin e shqiptarëve, populli ynë gjithmonë e ka pasur të gatshme përgjigjen : Jemi shqiptarë, shqiptarë lindim dhe shqiptarë vdesim! Këtë përgjigje ka pasur kurdoherë në gojë populli ynë, edhe kur u është vënë zjarri shtëpive, fshatrave e lagjeve tona; kur xhandari serb na ka dërmuar pse i kemi thënë ose nuk i kemi thënë "mirëmëngjesi"; edhe kur na kanë shkelur flamurin, na kanë plaçkitur kokrrën e fundit të misrit nga drithnikët...Edhe kur na e kanë zbritur deri në baltë dinjitetin kombëtar, duke na kërkuar armën që s'e kemi pasur; edhe kur na e kanë ndaluar gjuhën tonë të ëmbël.

Ç'është më e çuditshme, ne nuk ligemi nga punët dhe fjalët e armikut. Sepse e dimë se çdo fjalë e tij është vetëm një farsë. Por, as armiku të mos mendojë se e mashtron lehtë këtë popull, i cili po e përjeton tragjedinë e madhe ku e katandisi shovinizmi jugosllav, por i cili ka vendosur me të gjitha forcat e veta t'ia vërë atij pushkën në gjoks.

Kësaj të vërtete do t'i dalë zot shqiptari sidomos sot, që armiku hoqi maskën e tij të urryer dhe doli me fytyrën e tij të vërtetë dhe më të urryer, me fytyrën e kriminelit gjakpirës. (LIRIA, maj 1981, faqe 14)

3-8. KOSOVË, SA HIJE TË KA XHAMADANI I TRIMËRISË!

Nga Jusuf Gërvalla

Këtu e njëqind vjet më parë kishte ndodhur një nga përleshjet më të pabesueshme në historinë e njerëzimit. Fshatari shqiptar me emrin Mic Sokoli ishte kapur fyt a fyt me topin bajloz turk. Kjo përleshje e madhërishme e njeriut me çelikun i kishte thyer të gjitha përmasat e deriatëhershme të përfytyrimit njerëzor mbi heroizmin. Në përleshje me Micin, topin e thau vera dhe u rrokullis thepinës tatëpjetë në një hon të Grykës së Carralevës. Nga shqiptari Mic mbeti xhamadani i trimërisë, i skuqur me gjak, i cili iu vesh trollit si farë e trimërisë së përjetësuar të shqiptarit. Dhe mbeti edhe kënga epike :

Mic Sokoli nji fjalë p'e flet,
I thotë nanës "Tymermeç!",
Pa u faru Malsia krejt.
K'tu nuk hyn as krajl as mret!

Atëhere nuk ishte Shqipëria. Në të vërtetë Shqipëri kishte, por atë e kishte kapur për fyti dhe ia kishte zënë diellin gjysmëhëna e verdhë turke. Fatosat pasardhës të Micit, duke vënë gjakun e tyre të shtrenjtë në themelet e tokës nënë, e bënë edhe Shqipërinë, duke ngulur në 1912 në Vlorën heroike flamurin e kuq me shkabën dykrenare, simbol i lirisë, shtetësisë dhe pavarësisë shqiptare.

Por, fuqitë imperialiste të kohës jo vetëm që trupin e Shqipërisë e shtrinë në sallën e operacionit të tyre të egër, duke ia hequr asaj, si me brisk pjesët gati më vitale, por dhanë edhe shenja të qarta se nuk do ta lenin as shqiptarin brenda kufijve kombëtarë ta gëzonte i qetë jetën në atdheun e lirë, të krijuar me mundime mbinjerëzore në luftë me shtatë krajlitë. Kurse fuqitë shoviniste të Ballkanit, si Serbia, nuk kënaqeshin vetëm me pushtimin e Kosovës, por përpiqeshin të hidhnin hapin deri në Shkumbin. U desh heroizmi i lumjanëve për t'i dhënë një mësim dhelprës plakë të Shumadisë. Dhe, mësimi i doli tepër i hidhur asaj, pasi iu desh të lente 12 mijë vojnikë në malet e Lumës.

Dhe më pas doli, kësaj radhe nga deti, një armik tjetër që mori në sy rrugën e robërimit të Shqipërisë, u desh që kundër këtij armiku të vishej edhe një herë xhamadani i Mic Sokolit. Doli dhe e veshi pa përtesë, në Vlorë më 1920, Selam Musai, duke iu hedhur edhe ai në grykë topit italian. I tmerruar nga trimëria shqiptare, edhe ky armik i ri, ndonëse kishte forca të pamata numerike e teknike, u detyrua të kthehej nga kish ardhur, matanë detit, duke lënë prapa lakminë e papërmbajtur për brigjet shqiptare dhe për pasuritë e mëdha të Atdheut tonë, si një mundësi të kthimit të sërishëm në to.

Erdhi viti 1939 dhe me të këmishëzinjtë e Duçes, Musolinit, e pastaj edhe ata të Hitlerit, që deshën ta shtronin përdhe Shqipërinë. Por, tashmë ishte bërë fare e qartë se në çdo rrebesh që egërsohej mbi tokat shqiptare, i delte i zoti edhe xhamadanit të trimërisë shqiptare. Kësaj radhe, ai u vesh nga komunisti Vojo Kushi, në Kodër të Kuqe të Tiranës, duke iu hedhur në grykë tanksit gjerman, për ta bërë atë të belbëzojë dhe të mos t'i kthehet kurrë më goja e zjarrtë në Shqipërinë e përskuqur nga komunizmi.

Kjo është me pak fjalë historia e xhamadanit të trimërisë, historia e një populli të tërë, i cili, përballë armikut kurdoherë më të fuqishëm në numër dhe në përgatitjen teknike ushtarake, përballë lakmisë së armiqve zullumqarë të largët e të afërt, u detyrua të futet në luftëra të pareshtura, madje, me një armë të vetme; me gatishmërinë e flijimit për nderin e atdheut dhe me trimërinë e tij karakteristike që zëvendëson çdo armë të armikut.

Dhe vërtet shekujt, në ndërrimin e tyre, shkundën rrebeshe të mëdha mbi kokën e shqiptarit. Shpesh koha e zuri ngushtë shqiptarin për një kafshatë bukë, por jo edhe për sofrën bujare që i shtrohet me zemër mikut; koha e zuri shpesh ngushtë shqiptarin me robëri, skamje dhe mjerim, por asnjëherë të përkulur e të nënshtruar; gjithmonë shqiptari u tregua dorëlirë për të ta lënë në dorë pa të pyetur fare gjënë e vetme që kishte – jetën e tij, kurdo që këtë e kërkoi nderi i fisit dhe nevoja e atdheut.

Një histori e tillë ngjalli kurdoherë admirimin e miqve dhe tmerrin e armiqve. Kurse bota përreth, e ballafaquar me një trimëri kaq të materializuar, pa pasur mundësi ta shqyrtojë e ta definojë saktësisht, bënte seir dhe mbetej me gojë hapur, e çuditur nga një armë e tillë – gatishmëria mbinjerëzore për flijim dhe trimëria e pashembullt.

Bota, e cila dikur çuditej se ku e gjente shqipja gjithë atë forcë kur matej me shtatë krajlitë, sot po çuditet, ç'e gjeti kështu shqiptarin e Kosovës të rebelohet "brenda natës" dhe si po i bën ballë me muaj të tërë rrethimit të egër me tanke e bajoneta, ushtri e polici; si i bën ballë tërbimit të zhurmshëm kërcënues të aeroplanëve mbi kokat e popullsisë duarthatë e të paarmatosur.

Populli shqiptar i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të robëruara nga Jugosllavia nuk u rebeluan "brenda natës" . Rebelimi i tij u përgatit për afro dyzet vjet të vështira jete në kuadër të Jugosllavisë revizioniste titiste, e cila për popullsinë shqiptare, përballë propagandës lidhur me mirëqenien, barazinë ekonomike, politike e shoqërore me kombet dhe kombësitë e tjera, lidhur me gjoja vëllazërim bashkimin, s'pati gjë tjetër pos shtypjes kombëtare e shoqërore, pas diskriminimit social e kulturor, pos shfrytëzimit të egër të pasurive të tyre natyrore dhe zbatimit të mjeteve të gjenocidit.

I durueshëm sa s'bën më deri më sot, populli ynë, duke arritur në shkallën e një mjerimi të tillë që kufizohet me vdekjen nga uria, i ndodhur përballë një propagande të rënduar tuç nga demagogjia, e cila ka për qëllim të mbytë gjithë ç'ka shpëtuar ende nga skamja e mjerimi; i ndodhur edhe përballë qëndrimit diskriminues ndaj kombësisë sonë nga ana e regjimit antipopullor dhe sidomos antishqiptar të qeverisë së Beogradit, e pa të arsyeshme të ngrinte zërin e saj të fuqishëm dhe të kërkonte të drejta e liri në një rrugë paqësore, përveç demonstratave. Po kur në vend të të drejtave dhe lirive, mori përgjigjen me tanke, aeroplanë, me kërbaç, gazëra lotsjellëse e helmuese, dhe më në fund edhe me plumbin e shovinistëve, vendosi ta nxjerrë pallën sheshit dhe t'i dalë sypatrembur përballë armikut, me ato mjete që pati në dorë. Dhe mjetet e tij ishin më të fuqishme se tanku e aeroplani, më të fuqishme se plumbi i armikut. Në anën e tij ishin drejtësia dhe trimëria, përballë synimeve grabitqare e shoviniste të armikut, në anën e tij ishin detyra dhe nderi për mbrojtjen e pasurive dhe të jetës, përballë sulmeve të të huajit mbi këto pasuri dhe mbi jetën e njerëzve të robëruar e të skamnuar.

Në një situatë të tillë, tërbimi i armikut e shtyri edhe një herë shqiptarin ta veshë xhamadanin e trimërisë. Si dikur Mic Sokoli, Selam Labi e Vojo Kushi, djalëria patriotike e revolucionare, e mbrujtur edhe me idealet e larta marksiste-leniniste, doli sypatrembur para tankut të ushtrisë së revizionistëve jugosllavë.

Edhe kur shtrohet çështja e armëve, Kosova këto i ka me bollëk, dhe bile të gjitha llojet e tyre. Ato i sollën me vete armiqtë e shumtë për ta robëruar e plaçkitur, por, bashkë me kokën e tyre lanë në Kosovë edhe armët që kishin sjellë me vete. Kaluan mbi tokën tonë shumë pushtues: romaku, bizanti dhe turku, greku dhe bullgari, serbi e malazezi, austriaku e francezi, italiani e gjermani, bile shumë prej tyre nga dy e tri herë. Që të gjithë

ata, me forcën e armëve të tyre, mendonin se do t'i përjetësonin stemat dhe flamujt e tyre mbi fushën e gjerë të Kosovës. Por, stemat dhe flamujt iu shkelën me këmbë, populli ynë mbeti kryelartë dhe e pasuroi arsenalin e armëve.

Petritat e Podujevës, me një çifte gjahu, çarmatosën dy autobusë me policë të specializuar që kishin ardhur nga Beogradi, ua kallën automjetet, dhe me armët e rrëmbyera formuan në qytetin e tyre të dytën "Arbëri të vogël". Në Prizren, motrat tona, me emrin e Shotë Galicës në gojë, sulmuan mbi hordhitë e urryera të xhandarmërisë serbe. Kurse në Prishtinë, studenti sypatrembur i doli përpara tankut, shpalosi gjoksin dhe bërtiti si sokol mali : "Shtjer, bishë fashiste, se s'e tremb dot komunistin shqiptar!"

Ata që kanë dyshuar në fjalët e marksist-leninistit të madh të ditëve tona dhe prijësit të lavdishëm shqiptar, shokut Enver Hoxha, kur thoshte se s'duhet zemëruar shqiptarin, sepse," kur zemërohet shqiptari, merr flakë e zjarr edhe stralli", e patën rastin të binden gjatë demonstratave të fundit në Kosovë, kur ngjau ajo që s'kish ngjarë gjetiu tjetërherë: kur fëmijët, të kapur dorë për dorë, u dolën përpara sypatrembur tankeve dhe armëve të shovinistëve jugosllavë.

Një çudi e madhe ndodhi para pak kohësh në Pejë: armiku titist, i cili kishte vënë re femrën kosovare me kësulë, tirq e xhamadanë shqiptarë, u tmerrua dhe ua vuri dryrin dyqaneve ku enden veshjet tona kombëtare. Po ai e kishte kuptuar në mënyrë banale çështjen e xhamadanit të trimërisë. Sepse, nuk është zhguni mbi gjokset shqiptare që atyre ua sjell trimërinë, por është zemra e tyre e brumosur me dashurinë e pamatë për tokën mëmë dhe kombin e drejtësisë.

Kosovë, hije të ka xhamadani i trimërisë! (Liria, maj 1981, faqe 15)

3-9. JEHONA E NGJARJEVE TË KOSOVËS NË SHTYPIN E HUAJ

Nga Kadri Zeka

Dhuna e terrori i ushtruar nga milicia e ushtria jugosllave në Kosovë si dhe kërkesat e drejta të popullit shqiptar në Jugosllavi, po gjejnë një pasqyrim të gjerë edhe në shtypin botëror. Me qëllim që të njihen lexuesit tanë, në këtë numër po sjellim pjesë artikujsh të gazetave të ndryshme që u kushtohen ngjarjeve të Kosovës.

Në arikullin me titull "Mosbesimi në Kosovë është i thellë", gazeta gjermanoperëdimore "Frankfurter Algemaine" e datës 9.4.1981, ndër të tjera shkruan: "Kur u vjen uji deri në fyt, diktaturat fashiste të Anerikës Latine, vetadministrimi jugosllav reagon siç duket në mënyrë bukur të ngjashme. Gjëja e parë është fajësimi i "armikut të jashtëm". Sipas Dolancit, është gjë kundërrevolucionare, nëse Krahina Autonome e Kosovës, që tani ndodhet në Serbi, të shndërrohet në republikë të shtatë të Jugosllavisë. Sepse kjo, sipas tij, qenka në kundërshtim me Kushtetutën. Mirëpo është një parim i pranuar nga të gjitha kushtetutat e civilizuara që në bazë të procedurës legale këto gjëra mund të ndryshohen. Edhe Kushtetuta Jugosllave parashikon një mundësi të tillë. Sipas deklaratave të Dolancit e të Bakallit, shihet qartë se ata nuk janë të gatshëm t'i analizojnë shkaqet e vërteta të turbullirave në Kosovë dhe të mirren me masa preventive politike, pos represaljeve."

Më poshtë, gazeta, duke folur për kërkesat e shqiptarëve, thotë se "nuk doli vetëm kërkesa për shndërrimin e Kosovës në republikë, por edhe për bashkimin e të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi brenda një republike të tillë." E njëjta gazetë, në numrin e datës 30 prill 1981, duke folur për falsifikimin e fakteve nga qarqet zyrtare jugosllave, shkruan: "Sot në disa pjesë të gazetave jugosllave si në "Politika", "Nin" dhe

"Politika ekspres", thuhet hapur se udhëheqja nuk e ka thënë të vërtetën mbi përmasat e ngjarjeve në Kosovë, as para gazetarëve të brendshëm as para atyre të jashtëm... Në kritikën e gazetave thuhet se shtypu jugosllav u pengua nga qarqet zyrtare të politikës informative që të shkruaj për përmasat e vërteta të revoltës së shqiptarëve. Politika informative në përgjithësi ndjek një rrugë të dyshimitë."

Përpjekjet e revizionistëve titistë e të tradhtarëve shqiptarë që mundohen ta paraqesin gjendjen sikur lufta e popullit të Kosovës drejtohet kundër popujve jugosllavë dhe pakicës serbe në Kosovë, kjo gazetë në artikullin e 27 prillit i mohon kështu: "Të gjithë vrojtuesit vërtetojnë se demonstratat e shqiptarëve, përkundër karakterit nacional, nuk janë të drejtuara kundër pakicës serbe.

Gazeta suedeze "Sundsvalstidning", në një artikull me titull "Ngjarjet në Kosovë shqetësojnë shumë udhëheqësit e Beogradit", bën këtë përshkrim të ngjarjeve: "Demonstratat u përhapën në të gjithë Krahinën, ku pjesën më të madhe të popullsisë e përbëjnë shqiptarët. Demonstruesit kritikonin shtypjen që u bëhet shqiptarëve në Jugosllavi. Ata kërkonin liri fjale e shtypi, si dhe Krahina e Kosovës të shpallet republikë, Kosova që është zona më e varfër e vendit, është krahinë autonome por që bën pjesë në republikën më të madhe jugosllave, në atë të Serbisë. Autoritetet jugosllave i quajtën demonstruesit nacionalistë, separatistë dhe kundërrevolucionarë. Papunësia në Kosovë është shumë e madhe. Produktiviteti dhe rrogat janë më të ulëtat në gjithë Jugosllavinë. Qarqet zyrtare vazhdojnë t'i shpjegojnë turbullirat dhe demonstratat e Kosovës si veprime të kryera prej grupesh të ndryshme nacionaliste dhe theksojnë se çdo shenjë e nacionalizmit do të dënohet rëndë. Megjithatë, kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për republikë duhet të shikohet nga autoritetet e larta jugosllave në atë mënyrë që të zgjidhet drejt."

Nga plenumet e udhëheqjes më të lartë jugosllave dëgjohen thirrjet histerike që u drejtohen atyre kriminelëve serbë e malazezë, që e kanë gjakosur 40 vjet popullin tonë dhe që gjatë demonstratave shtien me armë mbi demonstrues, që të tregojnë "patriotizëm" dhe të mos e lëshojnë Kosovën. Kjo sipas shovinistëve jugosllavë, nuk është nacionalizëm. Por, kur një popull i tërë kërkon të drejtat e tij elementare, cilësohet si nacionalist e kundërrevolucionar.

Edhe gazeta amerikane "Nju-Jork Tajms" e 27 prillit, pasi thotë se situata me sa duket mbetet e pastabilizuar, meqë përforcimet e ushtrisë dhe të policisë ndodhen akoma në Kosovë dhe tubimet politike janë të ndaluara, shtron pyetjen: "Shteti federativ i Jugosllavisë tashmë ka 6 republika. Çfarë ndryshimi do të sillte edhe një republikë më shumë? Pse Kosova të mos jetë republikë, kur 85 për qind të banorëve të saj (1,5 milionë) janë shqiptarë etnikë?"

Nga ana e saj gazeta greke "Tovina" bën këtë koment mbi ngjarjet në Kosovë: "Nuk duhet ta pakësojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin prej shumë javësh në rajonin autonom të Kosovës, në kufi me Shqipërinë, edhe në qoftë se kriza mytet. Fakt është se autoritetet jugosllave nuk i kursejnë mjetet e tyre mbytëse. Këto telashe përbëjnë paralajmërim serioz."

Gazeta zvicërane "Noje Cyrher" e 25 prillit shkruan: "Informacionet jozyrtare flasin për qindra viktima, ndërsa ato zyrtare për nëntë" dhe kështu vënë në dyshim ashtu si shumë gazeta të tjera numrin e viktimave të dhënë nga autoritetet zyrtare, dhe vazhdon: "Pakënaqësia e shqiptarëve në Kosovë nuk shprehet nga grupet më militante shqiptare, të cilat kërkojnë një republikë shqiptare në Kosovë, por ajo shtrihet edhe në 300 mijë vetë që banojnë në Maqedoni e 50 mijë të tjerë në Mal të Zi."

Në disa gazeta të Gjermanisë Perëndimore u botua artikulli i korrespondentit gjerman në Vjenë Volfgang Liman, me titull: "Qetësi varri në Kosovë" në të cilin thuhet: "Kosova e ndien veten të shtypur nga shteti jugosllav. Kjo është e qartë. Rritja e prodhimit shoqëror në fund të vitit 1970 ishte sa gjysma e mesatares së Federatës. Më 1978 për çdo 1000 banorë në Kosovë ishin të punësuar vetëm 107, ndërsa mesatarja e Jugosllavisë ishte 254. Nga ana tjetër, Kosova është e pasur me lëndë të para dhe ka një industri të mirë nxjerrëse, por i mungon industria përpunuese. Në Serinë mbretërore dhe në Jugosllavinë e paraluftës, shqiptarët shtypeshin, por shtypja vazhdon edhe në Jugosllavinë e sotme, pavarësisht nga parullat "vëllazërim-bashkim".

Gazeta gjermanoperëndimore "Zyd Kurir" në artikullin me titull "Arsyet e turbullirave në Kosovë, shqiptarët e ndiejnë veten të nënvleftësuar", pohon: "Harresat e politikës së Jugosllavisë socialiste, e cila flet me qejf për të drejtat dhe barazitë e kombeve dhe të kombësive në Kosovë, është zor të mohohen. Përveç kësaj, është edhe situata kritike ekonomike në vend e cila duket jashtëzakonisht e qartë në Kosovën e pazhvilluar. Edhe sikur turbullirat e fundit të jenë vënë nën kontroll, Beogradi duhet të gjejë një zgjidhje politike, e cila për Kosovën ka qenë e domosdoshme."

Edhe shtypi spanjoll nga ana e tij i ka kushtuar shumë vend ngjarjeve në Kosovë. Gazeta "Avoi" e Barcelonës shkruan se "Kosova është rajoni më i prapambetur në Jugosllavi dhe gati në gjithë Evropën. Shqiptarët që banojnë aty konsiderohen qytetarë të dorës së dytë, pavarësisht nga përparimi që kanë pasur gjatë këtyre 35 vjetëve të fundit."

Në një koment të gjatë me titull "Kosova e varfër dhe e diskriminuar", gazetari spanjoll Torro Riesko shkruan: "Shqiptarët e Kosovës konsiderohen njerëz të përbuzur në Jugosllavi. Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë dhe e gjithë Evropës. Ekziston një pabarazi e dukshme midis Kosovës, dhe krahinave të tjera. Kosova është një vend i pasur me minerale. Atje nxirret më shumë se gjysma e qymyrgurit të Jugosllavisë. Ajo është e pasur me drithëra etj. Që nga mbarimi i Luftës, represaljet atje kanë qenë të egra.

Nga ana e saj, gazeta italiane "Koriere dela sera", duke folur për shkaqet e ngjarjeve në Kosovë, Krahinën e cilëson si rajonin më të prapambetur në Jugosllavi. Kurse gazeta amerikane "Herald Tribjun" shkruan: "Kosova, në Jugosllavinë e botës së tretë, është pjesa më e varfër, me një hendek që rritet mes varfërisë dhe luksit realtiv të republikës më të pasur, Sllovenisë."

Gazeta austriake "Kurir" e 22 prillit, në artikullin me titull: "Kosovë: a erdhi ushtria vetëm me një tufë dafinesh?", ndër të tjera shkruan: "Ku qëndron e vërteta?", pyet në mënyrë kritike gazeta e Beogradit, duke transmetuar në mënyrë të zbutur informatat kontradiktore të Jugosllavisë lidhur turbullirat në provincën e Kosovës të banuar me shqiptarë. Dhe ky informacion është aq kontradiktor sa njeriu duhet t'u besoj rrenave, si bie fjala: më 6 prill Stane Dolanci e përmendi numrin e 11 të vrarëve dhe 57 të plagosurve.

Mahmut Bakalli në konferencën e shtypit në Prishtinë e dha numrin 9 të vrarë dhe 260 të plagosur. Kjo sipas tij, ishte shifra "ekzakte". Më 16 prill, si njofton TANJUG-u, sekretari i Kryesisë së LKJ Dushan Dragosavac tha se "armiku e ka realizuar qëllimin në kolektivet punonjëse të Krahinës, me parulla armiqësore ia doli të mashtroj një numër të madh punëtorësh". Një ditë më vonë, Mahmut Bakalli thoshte se "fabrikat nuk e kanë ndërprerë për asnjë çast prodhimin dhe nuk është vënë re kurrfarë turbullire mes punëtorëve. Sipas Bakallit, mes të plagosurve 55 kanë marrë lëndime nga plumbat, por Bakalli thotë njëkohësisht se ushtria nuk ka shtënë asnjëherë mbi njerëzit. Plagët e

plumbave janë mistike, ose janë shkaktuar nga gjahu i arinjve. Ose ushtria jugosllave, e cila sipas të dhënave zyrtare, erdhi në Kosovë natën e 1 prillit në të gëdhirë të 2 prillit, dhe vërshoi tërë Krahinën, mos erdhi ajo vetëm me gjethe dafinesh në dorë? Gjendja e jashtëzakonshme, e vendosur më 2 prill, zyrtarisht, thonë, u hoq më 20 prill. Po TANJUG-u njoftonte se gjendja e jashtëzakonshme ishte hequr që më 9 prill në Prishtinë, Podujevë dhe Gllogovc e Lipjan. Ka mundësi që e hequra të hiqet edhe një herë!"

Në mënyrë të ngjashme komentojnë edhe gazeta të tjera të botës, të cilat shprehin mosbesim ndaj të gjitha informatave që japin qarqet zyrtare jugosllave dhe dënojnë dhunën e terrorin e pashoq të titistëve në Kosovë. (LIRIA, maj 1981, faqe 16)

3-10. KLUBET E SHQIPTARËVE KALOJNË NË DUART E TË ZOTËVE

Nga Jusuf Gërvalla

Në valën e furisë revolucionare, punëtorët kosovarë të qyteteve gjermanopërndimore Dyseldorf e Bilifeld, morën në dorë klubet e punëtorëve kosovarë në këto dy qytete. Ata ndërruan udhëheqjen e klubeve e përzunë të dërguarit e konsullatave jugosllave, për shkak se siç dihet botërisht, deri më tani këto klube ishin kthyer në çerdhe të spiunazhit prej udbashëve të konsullatave dhe ishin bërë vatra të rrezikshme antishqiptare.

"Liria" e përshëndet këtë iniciativë dhe shpreson se shembullin e këtyre punëtorëve do ta ndjekin edhe bashkatdhetarët në qytete tjera. (LIRIA, maj 1981, faqe 16)

==========

ATJE KU DUKET SE KA PASUR PASIVITET OSE HARRESË

Kadri Rexha: *"Së pari kishte ndërprerë daljen e revistës "Lajmëtari i lirisë" dhe me të gjitha forcat e veta ishte përqendruar në botimin e revistës "Liria" dhe në organizimin e demonstratave të përbashkëta. Më në fund, po për këtë qëllim ai e kishte hedhur poshtë edhe idenë e formimit të komiteteve për Kosovën në botën e jashtme. Lidhur me disa punë që në atë kohë Jusuf Gërvalla autorizohej t'i kryente, ai vazhdimisht përmes përfaqësuesit të degës "Hasan Prishtina" i këshillonte shokët që para se të shtronin detyra përkatëse ta kishin parasysh edhe nevojën e bashkimit: "**Edhe kjo punë mund të vazhdojë po e patë ju të arsyeshme – u drejtohej shokëve të vetë Jusuf Gërvalla - por mendoj se kur merrni vendime për çështje të tilla, duhet ta mbani parasysh edhe rrethanën e nevojës së madhe të bashkimit, duke u prirë nga mendimi se me bashkim nënkuptohet bashkimi i mendimeve, i pikëpamjeve dhe i punëve të përafërta a identike të dy a më shumë organizatave. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë nga unë, atje kryesisht ka qenë vendimtar ky parim dhe më pak harresa ose pasivizimi**."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 202)



Haxhi Berisha nga fshati Prapaqan

Haxhi Berisha, nga fshati Prapaqan i Komunës së Deçanit, është personi kryesor dhe vendimtar që e ka bërë dërgimin e numrave 3 dhe 4-5, do me thënë të 60% të vëllimit - të tekstit total të "LIRISË", në Kosovë, në maj dhe gusht 1981. Këtë punë, këtë detyrë e ka kryer në bazë të porosive të Jusuf Gërvallës.

TITULLI DUHET NDËRRUAR

Jusuf Gërvalla*: "Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:*

1) A e aprovon ardhjen time bashkë me atë shokun, lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon.

2) Pas "pështjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? ***Unë mendoj se titulli duhet ndërruar****.*

3) A duhet të pranojmë edhe ne, sikundër ata të "Lirisë", solucionin e republikës vetëm për territorin e sotëm të Krahinës së Kosovës?

4) A mendon se duhet edhe më tutje, pas këtyre njoftimeve, ta vazhdoj bashkëpunimin me shokun (Kadri Zekën - shën. i Xh. D.) në fjalë, apo të punoj vetëm, duke iu kushtuar kryekëput punëve të LNÇKVSH dhe të organit të saj të ardhshëm?

Të lutem t'i analizoni hollësisht këto çështje me shokë dhe të më përgjigjeni sa më parë që të jetë e mundshme." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

==========

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

Gusht 1981 Nr. 4-5

PËRPARA DREJT FITORES!

LIRIA

Nr. 4-5, Gusht 1981

4-5-1.PËRPARA DREJT FITORES!
4-5-2. JEMI PATRIOTË, S'JEMI SHOVINISTË
4-5-3. POPULLI SHQIPTAR NË JUGOSLLAVI ASNJËHERË NUK VENDOSI PËR FATIN E TIJ
4-5-4. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ
4-5-5.JUGOSLLAVËT TË VRASIN NATËN E TË QAJNË DITËN
4-5-6. DËSHMI TË KALBËZIMIT TË VETADMINISTRIMIT" TITIST
4-5-7. THELLOHET KRIZA EKONOMIKE NË KOSOVË
4-5-8. SUKSESE DHE PERSPEKTIVA MADHËSHTORE
4-5-9. ZEMRA SPECIALE
4-5-10. Të gjithë shqiptarët – Mic Sokola
4-5-11. ATENTAT KUNDËR PERANDORIT
4-5-12. LETËR E HAPUR PUNËTORËVE KOSOVARË NË MËRGIM
4-5-13. SHQIPJA BËN EDHE PA GJËMË, I MJAFTON LAVDIA
4-5-14. NDIHMA PËR KOSOVËN
4-5-15. Njoftim

4-5-1. PËRPARA DREJT FITORES!

Nga Mehmet Hajrizi
Popull shqiptar i Kosovës kreshnike,

Forcat ushtarake policore-fashiste të borgjezisë serbe mbuluan sërish me zjarr e hekur Kosovën tonë të shtrenjtë. Dhjetëra mijëra shovinistë të tërbuar kanë shkelur në trojet tona të lashta për të na shtypur dhe nënshtruar.

Krajlët e rinj gjakpirës serbomëdhenj e kthyen edhe një herë Kosovën në një burg e kasaphanë të madhe fashiste. Ata nuk u mjaftuan me gjakun e bijave dhe bijve tanë më të mirë që lau rrugët e qyteteve të Kosovës në masakrën e përgjakshme të marsit e të prillit, por mbushën edhe burgjet e tyre famëkeqe me mijëra petrita e sokolesha shqiptare dhe po ushtrojnë një dhunë e terror të paparë mbi gjithë popullsinë shqiptare në Kosovë e Jugosllavi.

Etja e çmendur për gjak shqiptari, shovinistët rankoviçistë i çoi deri atje sa të përdorin mjete e metoda dhune, nga të cilat ishin përmbajtur edhe nazi-fashistët hitlerianë.

Ata menduan se me një sulm të rrufeshëm, të egër dhe të gjithanshëm mbi Kosovën, të planifikuar me kohë nga Rankoviçi dhe klika e tij në pushtet, do të na frikësonin dhe të na nënshtronin shpejt. Kështu do të krijohej një terren i lirë për të realizuar në Kosovë politikën shoviniste të Çubriloviçit e të Rankoviçit me shokë, që janë bërë sot qëllime jetësore të pasuesve të tyre, klikës serbe në Beograd. Këto qëllime të bijve të sotëm të Karagjorgjeviçëve nuk janë më sekrete për askënd në botë, ata i kanë nxjerrë ato sheshit, me bishtë e me brirë, duke treguar hapur se duan të na i marrin edhe ato pak të drejta që fituam me gjak, duan ta fusin Kosovën në një sundim edhe më të egër, ta shtypin e shfrytëzojnë barbarisht, ta shndërrojnë atë përjetësisht në një tokë serbe, ta zhdukin gjuhën, kulturën, artin, letërsinë, këngët, simbolet tona kombëtare, të na bëjnë të harrojmë historinë tonë të lavdishme dhe të na i shkelin e poshtërojnë, të na i fashitin njëherë e përgjithmonë ndjenjat tona të zjarrta e të pashuara të lirisë dhe patriotizmit, idealet tona të shenjta.

Ky sulm i ri shovinist mbi Kosovën tonë martire nuk është vetëm një represion i egër ndaj kërkesave tona krejt të drejta e të ligjshme, të shprehura në demonstratat heroike popullore në Kosovë, por pjesë e planit të përgjithshëm strategjik serbomadh të shtrirjes së hegjemonizmit dhe sundimit të tij mbi gjithë Jugosllavinë e të sulmit, në bashkëveprim me socialimperialistët sovjetikë, edhe kundër Shqipërisë dhe më gjerë.

Gjendja e rëndë dhe e padurueshme e krijuar në Kosovë, sidomos këta muajt e fundit, nga dhuna e terrori shovinist, shtypja kombëtare e shoqërore dhe shfrytëzimi i egër kolonial, represioni fashist e persekutimi në masë gjithnjë në shkallëzim, kanë bërë të domosdoshme organizimin e një rezistence të fuqishme popullore kundër këtyre valëve të tërbuara shoveno-fashiste e të vazhdimit të intensifikimit të luftës për të drejtat tona të mohuara me zjarr e barot dhjetëra vite me radhë nga revizionistët barbarë të Beogradit.

Popull shqiptar,

Ne, bijtë e tu besnikë deri në vdekje, komunistët marksistë-leninistë të Kosovës, bëjmë thirrje që lufta për të drejtat tona të ligjshme, lufta kundër masave të egra shoviniste antishqiptare të organizohet me guxim e heroizëm, të rritet e zgjerohet dhe të vazhdohet me vendosmëri deri në realizimin e plotë të kërkesave tona të drejta. Rruga e rezistencës, e luftës së vendosur, është rruga e vetme e shpëtimit, rruga e vetme e fitores, rruga e vetme e realizimit të të drejtave tona.

Ne kërkuam të drejtat tona, kërkuam republikën për shqiptarët në Jugosllavi, e drejtë kombëtare kjo që e kanë të gjithë popujt e federatës jugosllave. Shovinistët serbomëdhenj, të prekur në interesat e tyre grabitçare, duke mos pasur asnjë argument, asnjë bazë të shëndoshë për t'i mohuar kërkesat tona krejt të ligjshme, thirrën me lehtësi: "Kundërrevolucion"!, "u prish federata jugosllave"! e plotë blofe si këto, dhe menjëherë dërguan në Kosovë hordhitë barbare të ushtruara për gjenocid e terror mesjetar me qëllim që të na nënshtrojnë. Por, llogaritë nuk u dolën si menduan. Ata, vërtet, vranë e plagosën,

gjymtuan e burgosën mijëra djem e vajza trime shqiptare, por nuk arritën ta frikësojnë e nënshtrojnë asnjë, populli heroik i Kosovës qëndroi dhe po qëndron në këmbë i paluhatshëm, i papërkulur. Dëshmorët tanë të lavdishëm dhanë jetën në demonstrata duke thirrur: "Rroftë republika!", "Rroftë populli shqiptar!", "Rroftë republika jonë!", "Rroftë liria!", "Rroftë komunizmi!", "Përpara drejt fitores!" Ky heroizëm i bijave e bijve tanë revolucionarë do të jetë patjetër shembull i edukimit patriotik për rininë tonë të kuqe.

Pavijonet, korridoret dhe qelitë e errëta të burgjeve fashiste në Kosovë, ku po torturohen çnjerëzisht patriotë e revolucionarë shqiptarë, po ushtojnë nga thirrjet protestuese dhe këngët patriotike të korit madhështor të të burgosurve të panënshtruar. Bijtë dhe bijat trime të Kosovës, edhe në pranga, të lidhur e të dërmuar, po i fusin tmerrin armikut me qëndresën heroike të tyre, me vendosmërinë e tyre revolucionare.

Duke mos pasur mundësi që i gjithë populli të futet në burg, armiqtë tanë të egër kanë organizuar dhe po vënë në zbatim një proces të gjatë e të pandërprerë persekutimi në gjithë popullin, nëpërmjet të ashtuquajturit "diferencim politik" të masave popullore, i cili ka për qëllim që një për një të merret në pyetje çdo shqiptar dhe, nën presionin shovinist serb, t'i dënojë demonstratat dhe kërkesat e tyre, të përshëndesë pushtuesit e dhunën fashiste që po ushtrohet në Kosovë, të përçahet me vëllezërit e tij dhe të nënshtrohet plotësisht para armikut. Por duhet theksuar këtu se ky "diferencim" në të shumtën e rasteve në popull, tek punëtorët, në rini e madje edhe në disa instanca udhëheqëse, është sabotuar e ka dështuar plotësisht, ose është kthyer në manifestim proteste kundër regjimit shtypës.

Në të vërtetë, i gjithë populli ishte në demonstrata dhe s'kishte si të hiqte dorë nga kërkesat e veta. Të diferencuar nga kërkesat tona, nga populli, mbetën vetëm një grusht tradhtarësh të mjerë shqiptarë, që me kohë kanë qenë kundër popullit dhe interesave të tij.

Edhe në të ardhmen duhet të sabotohet dhe të dështojë çdo përpjekje e armikut për të na nënshtruar dhe për të na vënë kundër njëri-tjetrit. Vetëm të bashkuar, të lidhur sup më sup, duke lënë anash çdo hasmëri personale, si vëllau me vëllanë, në ndërmarrje, në fshat, në shkollë, kolektiv e kudo, ne mund të mbrohemi, të sabotojmë aksionet e armikut, të ngritemi e të protestojmë hapur, siç tregojnë shumë shembuj të tillë të guximshëm gjatë këtyre muajve të fundit. Le të mbrojmë me çdo kusht edhe ne në çdo mënyrë kërkesat tona të drejta! Bijtë dhe bijat tona dhanë jetën për to, si mund të shkelim mbi gjakun e tyre, mbi gjakun tonë?!

As plumbat, as tanket e aeroplanët, as dhuna e terrori, as presioni e torturat, sado të egra qofshin, nuk mund të na nënshtrojnë kurrë.

Punëtorë të Kosovës,

Pasojat e politikës revizioniste të shtypjes e shfrytëzimit që po ushtrohet në Kosovë, më shumë se kudo, bien mbi supet tuaja. Grabitësit tanë të egër, me krahët tuaj, me forcën tuaj punëtore, me gjakun e djersën tuaj, rrëmbejnë pasuritë tona të shumta. Nga gjithë puna dërmuese që bëni natë e ditë, ju mezi fitoni kafshatën e bukës për vete dhe fëmijët tuaj.

Lufta greviste e klasës punëtore, si në gjithë Jugosllavinë, edhe në Kosovë po rritet çdo vit më shumë. Kërkesat e vendosura të punëtorëve për kushte më të mira pune, paga më të larta, të drejta politike etj., i kanë vënë në pozitë të vështirë shtypësit e shfrytëzuesit tanë dhe janë detyruar t'i plotësojnë, ku më shumë e ku më pak ato, pa marrë parasysh gjendjen e vështirë në të cilën ndodhen. Por, nuk kanë munguar asnjëherë edhe mjetet e dhunës e demagogjisë për t'i shtypur ato kërkesa, vetë lëvizjen punëtore.

Në demonstratat masive të pranverës së përgjakshme të këtij viti, bashkimi i radhëve të punëtorëve, lidhja e gjokseve tuaja si një barrikadë e pashpërthyer çeliku, i

tmerroi armiqtë. Ngjarjet e përgjakshme të marsit dhe prillit në Kosovë, ishin një provë e vështirë, por, shumë e suksesshme, e bashkimit jo vetëm e klasës punëtore por e të gjithë popullit në rezistencën e përbashkët për interesat tona të përbashkëta.

Armiqtë shovinistë kanë shpërthyer një fushatë të egër kundër klasës punëtore në Kosovë. Aktualisht, tehu i këtij sulmi është drejtuar veçanërisht kundër punëtorëve heroikë në kombinatin "Ramiz Sadiku", në kombinatin "Kosova" të Obiliqit, Fabrikën e amortizatorëve, në "Kosovën" e Vuçiternës, në Kombinatin e drurit në Ferizaj, në Fabrikën e akumulatorëve në Mitrovicë, në Metalikun e Gjakovës etj. Qëllimi i këtyre sulmeve të poshtra është që ta frikësojnë e ta përçajnë klasën tonë punëtore, ta godasin atë, që ajo të ulë kokën e të nënshtrohet, ta pengojnë bashkimin e saj në luftë kundër regjimit shtypës e shfrytëzues. Armiku i klasës sonë punëtore dhe i gjithë popullit, mendon se ka gjetur rastin dhe kohën të shtypë, jo vetëm kërkesat tona kombëtare, por edhe lëvizjen punëtore që po rritet nga dita në ditë. Ky objektiv i duhet atij që të hap rrugën e zbatimit të politikës së të ashtuquajturit "stabilizim ekonomik", që nuk është gjë tjetër veçse hedhje e pasojave të krizës së rëndë kapitaliste që ka mbërthyer gjithë Jugosllavinë, mbi klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse.

Revizionistët duan, kështu, të sigurojnë një sundim të qetë e të rehatshëm e pa shqetësime mbi klasën punëtore dhe mbi gjithë popullin. Ata duan të na përçajnë dhe të na vënë njërin kundër tjetrit. Por, ju, shokë punëtorë, duhet të keni besim të plotë te njëri-tjetri. Në qoftë se sot, për shembull, minatorët e "Trepçës" ose të ndonjë kolektivi tjetër nuk arritën të dalin masivisht në demonstrata, se ishin të rrethuar me hekur e zjarr, nesër me siguri që ata do ta shpërthejnë atë dhe do ta tregojnë veten edhe ata, sepse edhe ata janë trima e revolucionarë si gjithë të tjerët.

Armiku ynë goditi për vdekje qindra punëtorë trima, arrestoi dhe përjashtoi nga puna, ndau nga radhët shokët tanë të dashur. Nëse ne do të ishim indiferentë ndaj këtyre veprimeve të egra, ai do të na sulmojë një nga një të gjithëve. Prandaj është e domosdoshme që të organizojmë rezistencën e përbashkët kundër shtypjes, për interesat tona të përbashkëta, sepse gjendjen tonë të rëndë mund dhe duhet ta përmirësojmë vetëm me përpjekjet tona të përbashkëta. Nëse viteve të kaluara në Kosovë klasa punëtore organizoi dhjetëra greva e protesta, tani ato duhet të jenë me qindra. Të kundërshtohet me to me forcë e këmbëngulje shtypja e shfrytëzimi i klasës punëtore, të kërkohet kudo rritje e pagave, të cilat, në gjendjen e tanishme, nuk sigurojnë as bukën për familjet tona, të kërkohet kthimi i shokëve në punë, lirimi i tyre nga burgjet, pushimi i ndjekjeve dhe persekutimeve ndaj punëtorëve në të ashtuquajturat "diferencime", të kërkohen kushte më të mira të punës, jetesë, banimit, të mbrojtjes shëndetësore etj. Në kushtet e mohimit të egër të të drejtave tona kombëtare, lëvizja popullore në Kosovë do të vazhdojë e patundur dhe me vendosmëri deri në realizimin e plotë të tyre. Klasa punëtore, si klasa më revolucionare dhe më e organizuara në këtë lëvizje, ka rol të veçantë, ka barrën kryesore. Ajo duhet të jetë në ballë të kësaj lufte.

Por, që ta arrijë këtë, ajo duhet të jetë e organizuar më mirë dhe e bashkuar si një trup i vetëm. Prandaj, ne i bëjmë thirrje gjithë klasës punëtore të Kosovës që t'i organizojë radhët e veta në çdo ndërmarrje, çdo repart, çdo brigadë e çdo njësi punonjëse, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj nëpërmjet luftës së përditshme klasore, të zhvillimit të vazhdueshëm të kësaj lufte për kërkesa ekonomike e politike. Të lidhemi me besa-besë me njëri-tjetrin që, bashkërisht, të mbrohemi dhe të luftojmë për të drejtat tona.

Fshatarë të Kosovës,

Kërkesa e të gjithë popullit tonë për republikë, është kërkesa për shpëtimin tonë nga sundimi i egër serb, i cili, në bashkëpunim me shovinizmin malazez dhe maqedonas, shtyp dhe shfrytëzon edhe vëllezërit tanë në Maqedoni e Mal të Zi, është kërkesë kundër

grabitjes së pasurive të tokës sonë, për të cilën fshatari patriot shqiptar ka luftuar me shekuj, është kërkesë kundër rrëmbimit të drithit të arave tona, bukës sonë, bagëtive tona. Është kërkesë për një jetë më të mirë e më të lirë, për shkolla shqipe, për kulturën tonë, për rrugë e ambulanca në fshatrat tona, kërkesë për zhdukjen e varfërisë së mjerueshme dhe kurbetit të hidhur, papunësisë e analfabetizmit, kërkesë për të qenë zotër në trojet tona. Bashkë me bijat dhe bijtë tuaj, me punëtorët, studentët, me nxënësit e intelektualët, me këto kërkesa në gojë dhe në zemrat që ndizeshin flakë, u derdhët edhe ju rrugëve e shesheve të Kosovës, u gjakosët me heroizëm me xhelatët fashistë.

Për kërkesa të këtilla populli ynë, dhe jo "kundër popullit serb e popujve të tjerë të Jugosllavisë", siç mundohen të gënjejnë armiqtë tanë të pafytyrë e të poshtër, do të luftojë deri në fitore.

Në kohën kur shovinizmi serb po digjte e masakronte fshatra të tëra shqiptare, në mënyrën më barbare, kur Kosova po vërshohej nga kolonët serbë e malazezë, Azem Galica, trimi legjendar i bjeshkëve të Drenicës, thërriste për luftë të pamëshirshme kundër ushtrisë dhe xhandarmërisë shoviniste serbe, po njëkohësisht porosiste popullin: "asnjë dëm fqinjve serbë e malazezë!" Dhe ashtu ndodhi sepse populli ynë dhe udhëheqësit e tij nuk ishin shovinistë. Edhe sot ne i bëjmë thirrje gjithë popullit tonë që të trajtojë mirë popullsinë serbe e malazeze në Kosovë, sot e në të ardhmen, megjithqë shfaqje të shovinizmit shqiptar në Kosovë nuk ka. Atë e ka trilluar shovinizmi serb për të diskreditуar në sytë e të tjerëve luftën tonë burrërore, për t'i armiqësuar me ne popujt e Jugosllavisë. Por, përpjekjet e armiqve për të na izoluar nga popujt e Jugosllavisë dhe përkrahja nga ana e tyre e luftës sonë të drejtë, shpejt do të treten si vesa në rreze.

Në historinë e popullit tonë janë të njohura luftërat dhe përpjekjet heroike të fshatarësisë për të drejta e liri, për bashkim kombëtar. Ky patriotizëm revolucionar i pasuruar në traditën luftarake të popullit tonë, arrin deri në ditët tona më i pasur se kurrë, më i zjarrtë se kurrë. Prandaj, në luftën e popullit tonë për të drejta dhe liri, fshatarësia patriote shqiptare e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, përbën forcën më të madhe, e cila, bashkë me gjithë popullin dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe pararojës së saj marksiste-leniniste, do të marshojë drejt fitores së sigurt.

Por kjo forcë e madhe e fshatarësisë duhet të organizohet e të bashkohet me luftën e përditshme të fshatarëve për përmirësimin e kushteve të jetesës, për rrugë, ambulancë e shkollë, për tokën e bukës, për dritën e drejtësinë, kundër taksave e tatimeve, kundër dhunës e presionit fashist, që sidomos tani pas demonstratave po manifestohet brutalisht edhe në fshat.

Cili fshatar i ndershëm shqiptar duron t'i shahen në sytë e tij bijtë e bijat që ranë në fushën e nderit, në ngjarjet heroike të marsit dhe prillit, t'i shahen e t'i njollosen ata mijëra bij e bija që po dergjen burgjeve të errëta, t'i shahet e njolloset vetë lufta e popullit tonë për të drejtat e tij të ligjshme, t'i shahet historia e tij, kultura, gjuha, flamuri e nëna shqiptare? A ka gjë më të tmerrshme e më të rëndë për fshatarin tonë të ndershëm e patriot, me dinjitet burri shqiptar, sesa të të poshtërohet ditë e natë, të bastiset e kontrollohet nga banditët shovinistë dhe t'i shkilet nderi i shtëpisë dhe kombit?

Armiqtë tanë kanë shpërthyer një fushatë të fëlliqur donkishoteske kundër Shqipërisë së kuqe të Enver Hoxhës. Ata mendojnë se mund ta diskreditojnë e ta rrezikojnë atë, por të lehura qensh në hënë janë sulmet e tyre. Ata mundohen të na armiqësojnë ne shqiptarët me vëllezërit tanë, me atdheun tonë të dashur, por harrojnë se të parët tanë, edhe baballarët e vëllezërit tanë kanë dhënë jetën për Shqipërinë e Kosovën pa dallim, dhe ne sot jemi gati si një të gjithë të vdesim me nder për këtë Shqipëri socialiste. Le të mos e varin kurrë shpresën shovinistët serbomëdhenj, as aleatët e tyre, se do të na gjejnë të përçarë e të armiqësuar ndonjëherë ne shqiptarët, kudo që të jemi.

Është mjaft domethënës për armiqtë tanë fakti se që më 1 e 2 prill, kur shpërthyen demonstratat e mëdha popullore, dhjetëra familje shqiptare, të gjakosura më parë mes veti, falën gjaqet dhe u përqafuan vëllazërisht për interesin e përgjithshëm, për hir të bashkimit. Ky nuk ishte një fenomen, por një proçes që po vazhdon edhe sot. Ne përshëndesim nga zemra këto familje dhe thërrasim të gjitha familjet e tjera që akoma janë në hasmëri, të veprojnë sipas këtyre shembujve të trimërisë së vërtetë. Apo të marrim një fakt tjetër: Vëllezërit tanë në kurbet të hidhur, kudo që u ndodhën, me të dëgjuar ç'ndodhi në Kosovë, u hodhën edhe ata në demonstratat e shumta dhe në protesta, duke u bashkuar kështu me luftën tonë të drejtë. Edhe larg Kosovës ata jetojnë me Kosovën dhe për Kosovën e tyre të shtrenjtë.

Rini e kuqe e Kosovës,

Rini studentore, fshatare, shkollore e studenteske e Kosovës trime, rini e barrikadave dhe aksioneve heroike revolucionare, ti i vure gjoksin e para tiranëve shtypës e gjakatarë, ti e para derdhe gjakun rinor në përleshjet e përgjithshme me armikun.

Dhjetëra vite me radhë armiqtë u munduan, me çdo mjet e me çdo formë, të të degjenerojnë, të të fusin në një jetë të shthurur, pa ideale e pa kuptim, po ti ruajte me besnikëri traditën e të parëve, trimërinë e baballarëve, idealin e aspiratat e popullit që të lindi, dhe në ngjarjet e fundit shembe për tokë gjithë ato përpjekje të ethshme e të vazhdueshme të armikut kundër teje, i tregove gjithë botës se: në Kosovë po rritet e ngritet një rini e madhe, e fortë, e bashkuar, trime dhe e vendosur, që nuk do ta durojë më shtypjen dhe robërinë. Ja për se, shovinistët e tërbuar kanë drejtuar pikërisht kundër rinisë gjithë atë forcë sulmesh barbare. Ata vranë e plagosën qindra të rinj, arrestuan mijëra të tjerë, që ta frikësojnë rininë tonë, mbyllën Universitetin dhe shkollat, arrestuan dhe përjashtuan nga puna arsimtarët patriotë e revolucionarë shqiptarë kudo në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, zvogëluan numrin e nxënësve e të studentëve duke lënë në rrugë mijëra djem e vajza shkollare, na ndanë nga profesorët e dashur të Universitetit të Tiranës për t'i zëvendësuar ata me serbomëdhenj nga Nishi, dhe tani po bëjnë plane për shkapërderdhjen e Universitetit tonë dhe për largimin e studentëve shqiptarë edhe nëpër universitete jugosllave dhe, më në fund, ndryshimin e të gjitha planprogrameve mësimore, duke filluar nga klasët më të ulëta të shkollës fillore e deri te universiteti, duke hequr prej tyre edhe ato pak elemente që mund t'i edukonin të rinjtë tanë me ndjenjës kombëtare e patriotike shqiptare.

Shokë studentë e nxënës,

Protestoni në mënyrë të organizuar dhe me forcë kundër organeve qeveritare që duan të lënë rrugëve, jashtë universitetit e shkollave shokët tuaj!

– Kërkoni me këmbëngulje që të kthehen në radhët tuaja shokët dhe shoqet e përjashtuara nga shkollat dhe fakultetet!

– Kërkoni që t'u lejohet vazhdimi i studimeve në gjuhën shqipe vëllezërve tanë nga Maqedoni dhe Mali i Zi!

– Protestoni kundër ndjekjes e persekutimit që po ushtrohet ndaj studentëve, nxënësve e profesorëve të ndershëm!

– Protestoni kundër hallakatjes e shkapërderdhjes së Universitetit dhe studentëve!

– Protestoni kundër censurës shoviniste në planprogramet mësimore, në historinë tonë kombëtare, gjuhën, letërsinë e kulturën tonë!

– Kërkoni që profesorët nga Universiteti shtetëror i Tiranës të vazhdojnë ligjëratat në Universitetin tonë!

– Vazhdoni kërkesat tuaja të drejta për kushte shkollimi e studimi!

– Organizoni në fakultete e shkolla shokë e shoqe me besnikë, të vendosur për të luftuar me çdo sakrificë për të drejtat tuaja e për t'u bashkuar me luftën e të gjithë popullit për të drejta e liri!

Vetëm kështu mund të quheni bij e bija të popullit tonë trim e patriot, që na lindi e na rriti, na edukoi e kaliti si thesarin e tij më të çmuar, lulen e tij më të bukur, si trima e heronj, luftëtarë të lavdishëm të betejave revolucionare.

Nuk ka mjet as metodë degjenerimi, dhune e terrori, demagogji e mashtrim që mund ta largojë rininë tonë nga rruga e luftës për të drejta të ligjshme të popullit tonë.

Gra dhe vajza heroike të Kosovës,

Asnjëherë në historinë e Kosovës nuk është parë një pjesëmarrje aktive kaq e gjerë e gruas shqiptare në lëvizjet popullore si kjo, në ngjarjet e fundit historike të popullit tonë të robëruar.

Për kë të flasësh më parë? Për ato mijëra vajza trimëresha, që qëndronin në ballë të demonstratave popullore, bile shpesh edhe në udhëheqjen e tyre, për ato mijëra Shotë Galica, Margarita Tutulane, Bule Naibe e Ganimete të gjalla, apo për ato gra trimëresha të qyteteve dhe fshatrave të Kosovës që gatuan bukë për demonstruesit, i strehuan ata, ua lidhën plagët e i mjekuan, për ato gra e vajza që u përplasin shqiptarçe gjithë urrejtjen e indinjatën e tyre armiqve në tubimet "diferencuese", që po organizojnë ata kudo edhe për gratë, apo për nënat tona të forta e heroike, që bijat e bijtë e tyre të dashur, lulet e tyre të jetës i përcollën duke thënë: "Hajt zemra e nënës, edhe po të mos kthehesh, nga shokët mos u ndaj, mos na turpëro...!"

Ju, nëna të dashura, që u ndatë nga bijtë e bijat tuaja të pavdekshme, nuk keni mbetur të vetmuara. Ju keni sot qindra mijëra djem e vajza të popullit, që ju thërrasin nënë, ju keni dashurinë dhe respektin e gjithë popullit tonë patriot e luftarak, i cili përulet para bijave dhe bijve tuaj, duke thirrur: "Lavdi e përjetshme dëshmorëve të lirisë!"

Vazhdoni, ju nëna të dashura shqiptare, të rrisni e edukoni djem e vajza të tilla, se sot më shumë se kurrë i duhen ata Kosovës sonë të robëruar! Falë i qofshim të gjithë atdheut e lirisë!

Vazhdoni, gra e vajza trimëresha, të luftoni krah për krah me vëllezërit tuaj, në çdo betejë për të drejtat tuaja, të drejtat e popullit, pse vetëm kështu mund të dilni nga robëria e dyfishtë që po jua zë frymën!

Ju përbëni gjysmën e popullit dhe forca juaj është e madhe, e tmerrshme për armikun. Organizoni këtë forcë, radhët tuaja, dhe shpërtheni zjarrin e urrejtjes e të zemërimit që ju zjen në zemrat tuaja heroike!

I gjithë populli shqiptar në Jugosllavi shtypet e shfrytëzohet, por akoma më shumë gruaja shqiptare, e cila nuk ka pothuajse asnjë të drejtë në jetën shoqërore, politike e ekonomike. Sistemi revizionist dhe zakonet e egra prapanike, që ruhen nga ai të gjalla, kanë bërë që gratë të lidhen në pranga vetëm në rritjen e fëmijëve dhe të mbyllura në burgun shtëpiak, në një errësirë të prapambetur mesjetare. Pa luftë e përpjekje nuk mund të dilet nga gjendja e rëndë në të cilën ndodhet sot gruaja shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë.

Intelektualë patriotë e revolucionarë,

Si bij besnikë të popullit, nga gjiri i të cilit keni dalë, juve ju bie një barrë e rëndë dhe e vështirë e luftës dhe përpjekjeve të popullit tonë të shumëvuajtur për të drejta e liri.

Mijëra intelektualë patriotë e revolucionarë shqiptarë në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e Serbi, mësues, arsimtarë, profesorë, nëpunës, mjekë, artistë, shkrimtarë, këngëtarë e punëtorë të shquar të shkencës e kulturës e kanë kuptuar drejt detyrën e tyre dhe me vetëmohim janë bërë shërbëtorë të denjë të popullit, të interesave të tij të mëdha.

Armiku ynë barbar e ka vënë në shënjestër inteligjencien tonë popullore e revolucionare, duke përdorur mjete dhune, terrori e presioni kundër saj, kulturën, shkencën, gjuhën, letërsinë, historinë tonë të lashtë, duke zbatuar kundër tyre një inkuizicion të tmerrshëm shovinist.

Por, ne do t'i mbrojmë ato me guxim. Gjuha e kultura jonë u kanë rezistuar shekujve plotë rrebeshe, aq më pak sot ato mund të sakatohen e të zhduken.

Prishjet e kontratave të lidhjeve tona me Shqipërinë, në fushën e kulturës, arsimit, shkencës etj., nuk mund t'i shembin kurrë lidhjet tona të zemrës me Shqipërinë e kuqe.

Censura e egër shoviniste ndaj krijimtarisë letrare e artistike, shkencore, publicistike etj., që është vendosur në Kosovë, nuk mund t'ua mbyllë gojën intelektualëve revolucionarë të Kosovës. Ashtu sikurse librat, nga Shqipëria që po qarkullojnë ilegalisht në Kosovë, jashtë censurës, do të qarkullojnë fshehurazi dorë më dorë. Kështu na kanë mësuar intelektualët patriotë të Rilindjes sonë kombëtare.

– Shfrytëzoni të gjitha format dhe mundësitë në veprimtarinë tuaj krijuese shkencore, kulturore, arsimore, edukative, letrare e artistike, duke hedhur tej kocenptet borgjeze e shoviniste.

– Edukoni fëmijët, rininë dhe popullin në frymë patriotike, kudo që të veproni, pa përfillur presionin e egër shovinist.

– Luftoni bashkë me popullin për të drejtat e tij, për një jetë të tij të lirë.

– Luftoni për të drejtën e fjalës e të shtypit, për krijimtari pa censurë të egër shoviniste.

Popull shqiptar i Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi,

Republika shqiptare në federatën jugosllave, që do të përfshinte në vete të gjitha viset shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, do të ishte njësoj si republikat serbe, kroate, maqedonase, malazeze etj. Kërkesa e shqiptarëve në Jugosllavi për republikë nuk ka asgjë nacionaliste e shoviniste, por është kërkesë për një të drejtë kombëtare, që do të duhej ta kishim me kohë. Kërkesa jonë për republikë nuk do të thotë aspak dëbim për pakicat serbe, malazeze dhe maqedonase, siç na akuzojnë shovinistët.

Shovinistët revizionistë jugosllavë padrejtësisht na kanë copëtuar ne shqiptarët, që jemi një popull i vetëm me truall unik e të pandashëm. Asnjë popull në Jugosllavi, shumë prej të cilëve janë më të vegjël se yni, nuk është ndarë e copëtuar kështu.

Edhe shqiptarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi, gjatë gjithë sundimit revizionist në Jugosllavi, i janë ekspozuar një shtypjeje të egër shoviniste, gjenocidit në masë dhe shfrytëzimit barbar, duke qenë të detyruar shpeshherë të lënë edhe vatrat e tyre njëherë e përgjithmonë, për të marrë në sy rrugët e botës, si refugjatë të përjetshëm.

Sot, kur i gjithë populli ynë i shtypur e i sunduar u ngrit në këmbë, shovinistët, si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, po ushtrojnë një dhunë e presion fashist të paparë. Edhe ato pak të drejta elementare që kishin shqiptarët e këtyre viseve, tash po u hiqen nga shovinistët barbarë.

Por, ne do të vazhdojmë të gjithë së bashku luftën për të drejtat tona të ligjshme, deri në realizimin e plotë të tyre. Me shqiptarët trima të Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi, bashkë me vëllezërit kosovarë, nuk do të kursejmë as gjakun, as jetën tonë për fitoren e kësaj të drejte.

Popull serb e malazez në Kosovë,

Armiku ynë i përbashkët po mundohet t'i gënjejë popujt e Jugosllavisë se gjoja shqiptarët janë ngritur në luftë kundër tyre, e jo kundër regjimit shtypës e shfrytëzues të Beogradit, që është edhe armiku i popujve të tjerë në Jugosllavi. Ju, serbët e malazezët e

ndershëm në Kosovë, e dini më së miri të vërtetën mbi luftën e popullit shqiptar për të drejtat e tij të ligjshme. Ne nuk duam të luftojmë me asnjë popull të Jugosllavisë, as me popullin serb e as me popullsitë serbe e malazeze në Kosovë. Këtë e dinë armiqtë tanë shovinistë dhe duhet ta dinë edhe të gjithë popujt e Jugosllavisë.

Ne themi se Kosova shtypet e shfrytëzohet nga klika shoviniste serbe e Beogradit, kurse nga revizionistët jugosllavë shtypet dhe shfrytëzohet jo vetëm populli shqiptar, por edhe ai serbo-malazez në Kosovë, sepse nuk i shfrytëzojnë vetë pasuritë e vendit ku jetojnë, nuk i gëzojnë as të drejtat e tyre të "garantuara" me kushtetutë.

Popullit të ndershëm serb dhe popujve të tjerë jugosllavë nuk u vjen asnjë e mirë nga ky trajtim i Kosovës dhe popullsisë shqiptare, serbe, malazeze etj., që jetojnë në të.

Lufta për të drejtat e Kosovës, lufta e saj për shkëputje nga vargonjtë shtypës dhe shfrytëzues, është për të drejtat e serbëve dhe malazezëve në Kosovë, është edhe në të mirë të tyre, sepse edhe ata jetojnë në varfëri, nga e cila shpesh detyrohen të ikin, duke braktisur Kosovën. Ky dhe vetëm ky është ai "presioni shovinist" që ka bërë të shpërngulen familjet serbo-malazeze nga Kosova. Por, nga ky "presion" i kanë braktisur vatrat e veta akoma më shumë familje shqiptare. Ky fakt është tashmë i njohur prej të gjithëve.

Klika shoviniste serbe në Beograd dhe shërbëtorët e saj serb në Kosovë, nuk mund të jenë mbrojtës të interesave të popullit serb, ashtu sikurse nuk është dhe nuk mund të jetë mbrojtëse e interesave të popullit shqiptar klika tradhtare shqiptare, në krye me Fadil Hoxhën e pasuesit e tij. Shovinistët serbomëdhenj në Beograd flasin shpesh në emër të interesave të popullit serb, ashtu siç fliste Hitleri në emër të interesave të popullit gjerman. Ata janë antishqiptarë të tërbuar dhe po bëjnë çdo përpjekje për të armiqësuar të gjithë popujt jugosllav me popullin shqiptar, por edhe patriotë serbë s'janë e as mund të jenë kurrë, ata janë armiq të popullit të vet dhe luftojnë kundër interesave të tij.

Ata, që sigurojnë sundimin e tyre jo vetëm mbi popullin serb por edhe mbi gjithë popujt e Jugosllavisë, po përgatisin komplotin e fshehtë në bashkëveprim me socialimperialistët sovjetikë. Kjo politikë është thellësisht antipopullore dhe antikombëtare, është shitje e interesave të vendit, është përsëritje e historisë së 1941-ës. Populli serb duhet ta dijë se agresioni eventual sovjetik në Jugosllavi, Shqipëri e gjetkë, do të sillte një robërim të egër edhe për vetë serbët. Mjafton të përkujtojmë Çekosllovakinë dhe Afganistanin.

Ne me të drejtë presim dhe shpresojmë që serbët dhe malazezët e ndershëm në Kosovë do të luftojnë së bashku me shqiptarët për të drejtat e tyre, që populli i Serbisë dhe popujt e tjerë të Jugosllavisë do të na përkrahin, të na mbështesin në luftën tonë të drejtë. Çdo armiqësi mes nesh është në interes të armiqve tanë, kundër të cilëve një ditë do të ngritemi domosdo të gjithë së bashku.

Komunistë e revolucionarë shqiptarë në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi!

Populli ynë i robëruar po kalon çaste të vështira. Një rrezik akoma më i madh, që po i kanoset nga shovinizmi i shfrenuar dhe agresioni i ri fashist i socialimperialistëve është iminent.

Nevoja e organizimit të forcave popullore në një front të vetëm për t'u bërë ballë këtyre stuhive të tërbuara, është bërë nevojë dite dhe krejt e domosdoshme. Të organizojmë radhët tona, të rrisim e forcojmë lëvizjen komuniste, duke shkrirë idetë e marksizëm-leninizmit, socializmin shkencor, me lëvizjen e gjerë popullore!

Të punojmë me popullin duke u lidhur ngushtë me të, që bashkë me popullin e në ballë të tij, të luftojmë për të drejtat e tij, lirinë e popullit!

Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe e ligjshme. Atë po e përkrah sot gjithë opinioni përparimtar ndërkombëtar.

Luftë pa sakrifica nuk ka. Shumë komunistë, revolucionarë e patriotë, na i rrëmbeu armiku këto kohët e fundit. Por, të tillë populli ynë ka plot. Më kot armiqtë tanë përpiqen të na nënshtrojnë, ne dhe popullin tonë trim.

Ne jemi gjallë dhe kurrë nuk do të zhdukemi, nga asnjë armik, sado i fuqishëm e barbar të jetë ai.

Luftën tonë nuk do ta ndalim kurrë, deri në fitore!

Përpara, pra, drejt fitores sonë të sigurt!

RROFTË REPUBLIKA SOCIALISTE E KOSOVËS!

JASHTË NGA TOKAT TONA POLICIA FASHISTE JUGOSLLAVE!

LAVDI MARKSIZËM-LENINIZMIT FITIMTAR!

LAVDI INTERNACIONALIZMIT PROLETAR!

(LIRIA, gusht 1981, faqe 1-4)

4-5-2. JEMI PATRIOTË, S'JEMI SHOVINISTË

Nga Hydajet Hyseni

Shovinistët serbomëdhenj kanë shpërthyer këto kohët e fundit një fushatë të egër dhe të paparë antishqiptare. Në emër të luftës gjoja kundër "nacionalizmit", "irredentizmit" e "shovinizmit shqiptaromadh", po sulmohet me egërsi jo vetëm populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, por edhe i gjithë populli ynë, kudo që të ndodhet, po sulmohet kultura dhe historia e tij e lavdishme, po sulmohen traditat, zakonet dhe virtytet e tij më të larta, po sulmohen librat, këngët dhe simbolet e tij kombëtare, po sulmohen, me një fjalë, gjithçka që është shqiptare.

Me anë të britmave histerike kundër "nacionalizmit" e "shovinizmit" të trilluar shqiptar, vojvodët e rinj të Beogradit po mundohen të fshehin shovinizmin e tyre të egër antishqiptar, të justifikojnë masakrën e tyre të përgjakshme, që bënë gjatë kësaj pranvere në Kosovë, të arsyetojnë masat e papara të dhunës, terrorit e gjenocidit, që u ndërmorën dhe po vazhdojnë të ndërmirren kundër popullit tonë liridashës. Duke sulmuar me të gjitha mjetet popullin tonë dhe çdo gjë të tij, duke e fshehur dhe shtrembëruar të vërtetën rreth gjendjes së tij të padurueshme, rreth aspiratave dhe qëllimeve të luftës së tij të drejtë, ata po orvaten t'i nxisin kundër popullit tonë edhe popujt e Jugosllavisë, t'i përçajnë e armiqësojnë ata në mes veti, në mënyrë që kështu t'i largojnë ata nga lufta kundër regjimit titist dhe t'i sundojnë më lehtë në këtë situatë të vështirë që po kalon Jugosllavia revizioniste.

Por, misioni që i kanë parashtruar vetes këta revizionistë shovenë është tepër e vështirë dhe e destinuar të dështojë me turp. Nuk është leht të akuzosh një popull të tërë, një histori e një kulturë të tërë. Për ta bërë këtë, duhen fakte e argumente të forta, e ato revizionistët nuk mund t'i gjejnë kurrë te populli ynë, sado që t'i kërkojnë edhe me mikroskop. Kjo mungesë faktesh nuk mund të kompensohet me akuza, sharje dhe etiketime, me shpifje, gënjeshtra e trillime, sado "ustallarë" të mbaruar e me përvojë që të jenë për këtë autorët e tyre, dhe as me "fakte" e "argumente" të sajuara e të kurdisura nga vetë revizionistët, të atilla si dëmtimi i monumenteve dhe varrezave serbe në Kosovë, shpërndarja e të ashtuquajturës "hartë e Shqipërisë etnike", vendosja e eksplozivit në ambasadën jugosllave në Tiranë e të tjera veprime si këto, të kryera nga vetë revizionistët me qëllim jo vetëm "nacionalistë", "shovinistë", e "ekspansionistë", por edhe të egër, kriminelë e terroristë! "Fakte" e "argumente" të tilla, autorëve të tyre mund edhe t'u duken edhe "të mençura" e "dërmuese", por në të vërtetë, ato janë aq naïve e primitive sa

jo vetëm nuk mund të mashtrojnë askënd, por, përkundrazi u ndihmojnë njerëzve që ta identifikojnë kriminelin që ka drejtuar duart e përgjakura në drejtim të viktimës dhe çirret me të madhe: "Kapeni vrasësin!"

Shqiptarët kurrë nuk kanë qenë shovinistë

Le t'i kthehen sa të duan, revizionistët të kaluarës sonë të lavdishme për të kërkuar edhe atje "shovinizmin shqiptaromadh", le të shfletojnë ata sa të duan libra, kronika e dokumenta të së kaluarës. Atje, ata mund të gjejnë sa të duan luftë për liri, se të parët tanë nga një luftë e bënin përvjet, po ata nuk mund të gjejnë kurrë luftë shqiptare për robërimin e të tjerëve, mund të gjejnë ata sa të duan vetëmohimin e qëndresës heroike, mund të gjejnë sa të duan xhamadanë trimërie nëpër termopilet e shumta shqiptare, por ata nuk mund të gjejnë kurrë shovinizëm, terror e zullum shqiptar.

Në historinë tonë, revizionistët do të gjejnë Skënderbenë, vëllezërit Frashëri e Mic Sokolin, Ismail Qemalin e Isa Boletini, Çerçiz Topullin e Bajram Currin, Azem Bejtën e Shote Galicën, Qemal Stafën e Emin Durakun, do të gjejnë shumë trima shqiptarë, që luftuan për lirinë e popujve të tjerë, do të gjejnë shumë luftëtarë të Spanjës republikane, do të gjejnë mijëra partizanë, komisarë e komandantë të lavdishëm, që derdhën gjakun e tyre në Sanxhak e Vishegrad…por ata nuk do të gjejnë atje Karagjorgjeviçe e Obrenoviçë, Mark Milanë e Veshoviçë, Krëstë Peçanër e Kërstë Miliçë, nuk mund të gjejnë Nikolla Pashiçë e Drazha Mihajloviçë, Jovan Cvijiçë e Cubriloviçë dhe as satrapë Tito e Rankoviçë.

Populli ynë liridashës, gjatë gjithë historisë së tij shumëshekullore, ka luftuar me heroizëm kundër shovinistëve të huaj, e pra edhe kundër atyre serbë e malazezë, por, me përjashtim të revizionistëve titistë, askush nuk ka folur ndonjëherë për "nacionalizëm", "shovinizëm" dhe "ekspansionizëm shqiptaromadh".

Kurrë populli shqiptar nuk ka lënguar nga kjo sëmundje e rrezikshme, gjatë historisë së vet shumëshekullore, nga kjo sëmundje aq më pak lëngon sot që është bashkuar si kurrë ndonjëherë më parë rreth flamurit të kuq të marksizëm-leninizmit. Sëmundjen shovinizëm nuk e gjen jo vetëm në Shqipërinë socialiste që është i vetmi vend i vërtetë socialist, por atë nuk mund ta gjesh as në popullin tonë të robëruar nga shovinistët jugosllavë.

Le të çirren këlyshët e Rankoviçit në Jugosllavi e Kosovë kundër "nacionalizmit shqiptar", le të vrapojnë ata, si të çmendur, në çdo qytet, fshat e kolektiv kosovar, për ta gjuajtur "shovinizmin shqiptaromadh"! Frymë të lartë e të shëndoshë patriotike revolucionare e komuniste, ata mund të gjejnë gjithkund, madje edhe më shumë se ajo që panë në grevat dhe demonstratat e fundit. Por "shovinizmin shqiptaromadh", që aq shumë po e kërkojnë, ata mund ta gjejnë vetëm në shkrimet e fjalimet e tyre më shumë se shoviniste.

Për shovinistët rankoviçistë, gjithçka që është shqiptare, gjithë ç'është patriotike e revolucionare, gjithçka që nuk u pëlqen atyre ose që ua prish planet e tyre të përbindshme, është "nacionalist" e "shovinist" dhe "iredentist", "reaksionar" e "kundërrevolucionar". Dhe, meqenëse gjithë populli ynë, kudo që të jetë, është shqiptar (dhe jo jugosllav, siç u pëlqen shovinistëve serbomëdhenj), meqenëse gjithë populli shqiptar është patriot (pikërisht patriot shqiptar e jo "patriot jugosllav", siç dëshirojnë ata) dhe meqenëse si i tillë populli ynë po ua prish atyre planet e çmendura, atëherë, për ta, me përjashtim të ndonjë zagari, gjithë populli shqiptar është "nacionalist", "shovinist", "iredentist", "kundërrevolucionar" e gjithçka tjetër.

Me qëllim që të diskreditojnë popullin tonë dhe aspiratat e tij të drejta në sytë e popujve të tjerë, sidomos të atyre jugosllavë, shovinistët serbomëdhenj po mundohen ta

paraqesin gjithë luftën çlirimtare të popullit tonë dhe në mënyrë të veçantë grevat e demonstratat e mëdha të këtij viti, si luftë të drejtuar kundër popujve të Jugosllavisë! Në këtë mënyrë, ata jo vetëm shtrembërojnë karakterin e vërtetë të luftës sonë, por mundohen të identifikohen me popujt që ata shtypin e shfrytëzojnë. Por, një identifikim të tillë, sigurisht që nuk e bëjnë popujt e Jugosllavisë, e atë nuk e ka bërë dhe nuk e bën as populli ynë.

Kundër zaptuesve shovinistë serbo-malazezë, populli shqiptar ka luftuar pa mëshirë, por lufta e tij nuk ka qenë e drejtuar kurrë kundër popujve të Serbisë e të Malit të Zi. Luftërat e tij të mëdha çlirimtare, populli ynë gjithmonë i ka bërë në tokën e vet, dhe kurrë në tokë të huaj. Ai ka qenë gjithmonë i pushtuar, po kurrë pushtues. Luftërat e tij jo vetëm nuk drejtoheshin kundër popujve të tjerë jashtë trojeve shqiptare, po as kundër pakicave joshqiptare që jetonin në tokat e tij, qofshin këta kolonë të hershëm apo të mëvonshëm. Është fakt i njohur dhe i pranuar se gjatë periudhës së luftës antifashiste nacionalçlirimtare, edhe më parë, popullsia serbe e malazeze në Kosovë është dëmtuar shumë më pak sesa popullsitë e tyre motra në Serbi e Mal të Zi. Lufta që populli shqiptar ka bërë në shekuj për lirinë e tij jo vetëm që nuk i ka dëmtuar popujt fqinjë, po përkundrazi, ajo ka qenë kurdoherë edhe në interes të lirisë së tyre të vërtetë.

Lufta jonë nuk drejtohet kundër popujve, po kundër shovinistëve jugosllavë

Popujt jugosllavë dhe sundimtarët e tyre shovinistë, nuk janë një. Prandaj, edhe populli ynë ata nuk i ka futur dhe nuk i fut as sot në një thes. Lufta që po bën populli ynë i robëruar për të drejta e liri, jo vetëm që nuk drejtohet kundër proletariatit e popujve jugosllavë në Kosovë e jashtë saj, por, përkundrazi, ajo është edhe në interes të tyre. Prandaj, në mos sot, nesër me siguri që do të fitojë edhe përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

Llomotitjet e pandërprera të shovinistëve jugosllavë se gjoja grevat dhe demonstratat e Kosovës ishin të drejtuara kundër popujve jugosllavë, kundër unitetit dhe federatës së tyre, sado u bënë nën parulla të tilla, si: "kundër serbëve", "të gjithë serbët të dëbohen nga Kosova", "për Shqipërinë e madhe", "për Kosovën e pastër etnike" etj., janë vetëm shpifje të poshtra. Qëllime e kërkesa të tilla nuk kanë pasur demonstruesit. Ato po i trillojnë e po i përhapin vetë shovinistët serbomëdhenj dhe lakejt e tyre shqiptarë, duke treguar në këtë mënyrë se sa ua duan ato të mirën edhe popujve jugosllavë.

Gjatë grevave dhe demonstratave të tij heroike, populli ynë kërkoi kushte më të mira të jetesës, kërkoi punë, kërkoi kthimin e kurbetçinjve e ndalimin e ngritjes së çmimeve, kërkoi që bijtë e tij të burgosur të ktheheshin në Kosovë, kurse të pafajshmit të lirohen, kërkoi që pasuritë e shumta të Kosovës të shfrytëzohen nga vetë kosovarët, kërkoi që t'i jepet fund trajtimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare si koloni e thjeshtë e republikave jugosllave, që popullit shqiptar në Jugosllavi t'i njihet e drejta e tij e ligjshme për vetëvendosje (të cilën kushtetuta jugosllave ua njeh popujve të tjerë edhe më të vegjël se yni), që Kosova të fitojë statusin e republikës së federuar. Këto kërkesa të drejta jo vetëm që s'janë kundër popujve të tjerë në Kosovë e në viset e tjera shqiptare, por, përkundrazi, ato janë edhe kërkesa të tyre, sepse, ndonëse jo sa shqiptarët, edhe ata shtypen e shfrytëzohen nga sunduesit e tyre revizionistë, edhe ata janë të pakënaqur me kushtet e tyre të jetesës gjithnjë e më të vështira, edhe ata vuajnë nga papunësia, kurbeti, ngritja e përditshme e çmimeve, edhe ata mbajnë mbi kurriz pasojat e shfrytëzimit kolonial të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare.

Populli ynë gjatë demonstratave të tij, s'kërkoi dëbimin e serbëve, malazezëve e maqedonasve nga tokat shqiptare, nuk kërkoi kurrfarë kufinjsh të pastër etnikë, siç po

shpifin revizionistët. Ai kërkoi vetëm që të çlirohet nga robëria kolonialiste dhe të bëhet zot i vetvetes, kërkon republikën e tij ku do të jetonte i lirë e i pavarur, në barazi, harmoni e bashkëjetesë të vërtetë me pakicat joshqiptare dhe njëkohësisht në marrëdhënie të sinqerta vëllazërore me popujt e Jugosllavisë dhe ata të Ballkanit, prandaj kërkesa për Republikën e Kosovës, ashtu si edhe kërkesat e tjera, nuk ka asgjë shoviniste. Republika e Kosovës jo vetëm që nuk do të ishte robërim për popullsinë joshqiptare në Kosovë, siç po çirren revizionistët, por përkundrazi, ajo do të jetë fitore e madhe edhe për ta.

Parulla "Kosova-republikë" nuk drejtohet as kundër popujve të Maqedonisë e Malit të Zi. Republika e Kosovës do të jetë grusht i rëndë për borgjezinë shoviniste jugosllave, por ajo nuk do t'u sjellë asnjë të keqe proletariatit dhe popujve të Jugosllavisë. Nga shfrytëzimi kolonial i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare përfiton borgjezia e Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi, dhe jo aspak masat punonjëse të këtyre republikave, të cilat gjithashtu shtypen e shfrytëzohen egërsisht. Sa më i madh të jetë shfrytëzimi kolonial i popullit shqiptar nga borgjezia jugosllave, aq më e vështirë është gjendja e klasës punëtore dhe masave të tjera punonjëse të Jugosllavisë. Robërimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nuk i sjell asgjë të mirë proletariatit jugosllav por e vështirëson edhe më shumë gjendjen e tij, e vështirëson luftën e tij për të drejta e socializëm të vërtetë.

Për ta bindur opinion jugosllav dhe atë botëror gjoja për rrezikun që iu kanoska serbëve dhe Serbisë nga populli "shovinist" shqiptar, (ashtu siç i kanoset), ujkut nga qengji në përrallën e La Fontenit), shovinistët serbomëdhenj po ngrenë shumë re pluhuri, për gjoja dhunën e terrorin që paskan ushtruar shqiptarët e Kosovës gjatë demonstratave të tyre të fundit ndaj "serbëve e malazezëve të pafajshëm". Sipas asaj që thonë ata del se të gjithë serbët dhe malazezët, jo vetëm në Kosovë por edhe në Beograd e Gjenevë, paskan qenë në rrezik të madh! Demonstruesit e "egër", "vandalistë", "terroristë", i paskan ndjekur, i paskan rrahur e kërcënuar, u paskan hyrë brenda, u paskan djegur pasurinë dhe shtëpitë… Për t'i bërë sa më të besueshëm akuzat e tyre, kalemxhinjtë revizionistë po mbushin faqet e gazetave dhe revistave me "rrëfime", "deklarata","tronditëse" të "viktimave", me fotografi dritaresh të thyera e shtëpish të djegura. Çerdhe çetnikësh e kriminelësh si familja Delibashiç janë bërë heronj të ditës dhe fotografitë e tyre i gjen në çdo gazetë e revistë të Beogradit. Heronj të ditës janë bërë kriminelët çetnikë, që kishin lyer duart me gjak shqiptari, para e gjatë luftës, ata këlyshë të Rankoviçit, që kishin gjakosur popullin tonë gjatë aksionit famëkeq të armëve, ato gjakatarë që tani, ashtu si edhe në 1968, qëllonin tinëzisht me armë zjarri mbi turmat e paarmatosura të demonstruesve shqiptarë, të cilat nga ana tjetër qëlloheshin nga milicia serbe me bomba e mitraloza. Ishin këta kriminelë, që, si kundërveprim, u qëlluan me gurë e shishe nga demonstruesit, e jo aspak njerëzit e pafajshëm serbë e malazezë. Në rrugën e Sremit, kishte edhe familje të tjera serbe, por populli demonstrues e qëlloi me gurë dhe i vuri flakën vetëm shtëpisë së Delibashiçëve, dhe vetëm atëherë, kur prej dritareve dhe pullazit të saj u vranë njeri pas tjetrit shtatë demonstrues. Këtë të vërtetë, që po mundohen ta fshehin shovinistët dhe propaganda e tyre, e dinë mirë dhe e kanë parë jo vetëm demonstruesit por edhe shumë banorë të asaj lagjeje, që jo vetëm nuk sulmoheshin nga demonstruesit, por u dërgonin atyre sa mundnin fasho, ujë e ushqim. Kështu kishte ndodhur në rrugën e Sremit dhe kështu kudo tjetër, ku shovinistët serbo-malazezë qëllonin mbi popullin demonstrues.

Jo vetëm shqiptarët, por, edhe çdo serb e malazez i ndershëm i dënon veprimet e tilla të çetnikëve, që në mënyrë tinëzare e qëllonin prapa shpine me armë e snajperë popullin tonë duarthatë, që kërkonte të drejtat e tij duke brohoritur për marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar.

Pse shpërngulen nga Kosova, serbët dhe malazezët?

Një zhurmë e madhe po bëhet kudo në Jugosllavi edhe rreth shpërnguljes së serbëve e malazezëve nga Kosova, gjë që serbomëdhenjtë po mundohen ta paraqesin si pasojë gjoja të "presionit", që ushtroheshka mbi ta nga ana e shqiptarëve "nacionalistë" e "shovinistë" që nga viti 1966 e këtej, dhe sidomos pas demonstratave që u bënë në Kosovë. Kjo çështje është bërë temë e preferuar dhe e përhershme në faqet e gazetave e revistave të Beogradit, si dhe në fjalimet e krerëve nga më kryesorët në Kosovë, Serbi e Jugosllavi. Për hulumtimin e kësaj "dukurie" jo vetëm që janë angazhuar gati gjysma e gazetarëve të Serbisë, por, edhe janë formuar komisione të posaçme, të cilat gjatë "punës" së tyre të madhe hetuese po :zbulojnë" plot "fakte" të tilla "presioni", si pyetjet: " A po e shet shtëpinë?", "shkelje të arave me biçikletë" (!), pemët e rrëzuara, kafshët e ngordhura, disa gurë "të hedhur" në ballkon gjetja e ndonjë kafshe në të lashta, kryqat e thyer në varreza, zjarri i shpërthyer në një pjesë të Patrikanës së Pejës etj., etj.

Fajtore për të gjitha këto dhe shumë veprime të tjera "rrënqethëse" si këto, sipas asaj që thuhet, qenkemi ne, "nacionalistët" shqiptarë?. Ne jemi "fajtorë" për çdo gjë të keqe që u ndodh serbo-malazezëve, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Serbi e Mal të Zi! S'është çudi që një ditë të na fajësojnë edhe për vërshimet e vjetra në Serbi apo për tërmetin që e pat goditur Malin e Zi!

Me "fakte" të këtilla. Shovinistët serbomëdhenj po mundohen të "argumentojnë" "presionin" që gjoja po e detyron popullsinë serbo-malazeze ta lëshojë Kosovën, por, "faktet" e tyre janë aq të poshtra, naive e qesharake, sa vështirë mund të gënjejnë njeri. Shovinistët rankoviçistë mundohen të paraqiten mbrojtës të serbëve e malazezëve të Kosovës, por në të vërtetë në këtë mënyrë ata ua bëjnë të keqen atyre, i nxisin të shpërngulen nga Kosova, i armiqësojnë me fqinjët e tyre shqiptarë dhe, në të njëjtën kohë, nxisin kundër serbëve e malazezëve edhe ndonjë shqiptar të papjekur.

Zjarrin në Patrikanën e Pejës nuk e shkaktuan "nacionalistët" shqiptarë, por, siç vërtetuan edhe ekspertët serbë, ai shpërtheu së brendi nga dhoma ku, siç u vërtetua më vonë, po ngrohej një "mysafir" serb i Patrikanës, për të cilin as sot nuk dihet gjë. Është krejt e sigurt që "mysafir" të tillë misteriozë, të jenë ndodhur edhe në Bresje, natën që u dëmtuan kryqet dhe gurët e varrezave të këtij fshati. Metodat e tilla të luftës, që "udbashët" e Rankoviçit i kanë mësuar prej të parëve të tyre shovinistë, të cilët të veshur si shqiptarë plaçkitnin e terrorizonin popullin e pastaj për këtë akuzonin luftëtarët e Azem Galicës, atyre mund t'u duken ende të vlefshme. Por, në të vërtetë, atyre tani u ka dalë boja. Me këto metoda shoviniste jo vetëm po bëhen qesharakë, por edhe po e vrasin vetveten.

Është e vërtetë se ka serbë e malazezë që shpërngulen nga Kosova. Ashtu siç shpërngulen edhe më shumë shqiptarët. Është e vërtetë që ndonjëherë mund të ndodhë edhe ndonjë zënkë e mosmarrëveshje mes fqinjëve shqiptarë e serbë, ashtu siç ndodhin edhe mes shqiptarëve apo mes serbëve. Por, të nxjerrësh konkluzionin se kjo shpërngulje e serbëve është pasojë e "presionit" të shqiptarëve të robëruar, këtë mund ta bëjnë vetëm shovinistët serbomëdhenj. Shkaqet e vërteta të shpërnguljes së serbëve e malazezëve nga Kosova, ashtu si dhe të shqiptarëve, janë kushtet e vështira të jetesës, skamja, papunësia e mjerimi i madh, që janë rrjedhim i drejtpërdrejtë i marrëdhënieve kapitaliste në prodhim dhe i shfrytëzimit kolonial të Kosovës. Kjo është e vërtetë dhe këtë po e thonë hapur edhe qindra e qindra serbë e malazezë të shpërngulur ose jo të shpërngulur , që po hedhin poshtë shpifjet shoviniste për gjoja "presionin" e shqiptarëve. Statistikat flasin se

popullsia serbe po shpërngulet edhe nga komuna e Leposaviqit dhe nga viset periferike të Serbisë, ku ka pak ose aspak shqiptarë. Mos vallë edhe atje serbët po i nxjerrin tabelat "Kuca na prodaju" (shtëpi në shitje) për shkak të "presionit" të "nacionalistëve shqiptarë"?!

Të gjithë shovinistët serbë, malazezë dhe maqedonas, të gjallë e të vdekur, janë ngritur në këmbë, pse disa serbë e malazezë e kanë lëshuar Kosovën për punë, shkollim ose kushte më të mira të jetesës, kurse për shpërnguljet masive, vërtet të dhunshme ,të qindra mijëra shqiptarëve nga Kosova e nga viset e tjera shqiptare për në Jugosllavi, Turqi, Amerikë e Australi, nuk thuhet asnjë fjalë e vetme. Po ata shovinistët e tradhtarët, po ata Kolishevskë, po ata Stamboliçë e Ristiçë, po ata Markoviçë e po ata viça shqiptarë që dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve e quanin liri për të lëvizur e banuar si pas dëshirës së secilit, tani lëvizjen vërtet vullnetare të serbëve e malazezëve po e quajnë pasojë të gjoja presionit të shqiptarëve.

Vetëm shovinistët mund të bëjnë gjithë atë zhurmë për katër gurë të hedhur në ballkon, për ndonjë kafshë të gjetur në ara, apo për zjarrin e dëmtime të nxituara e të shkaktuara nga vetë ata, në një kohë që rrugët e qyteteve tona skuqeshin me gjakun e bijve e të bijave më të mira të popullit, kur i gjithë populli ndiqej, rrihej e poshtërohej nga policia serbe, kur bandat shoviniste serbe, malazeze e maqedonase, me uniformë e pa uniformë, rrahin e masakrojnë në mënyrë shtazarake njerëzit tanë të pafajshëm, kur monumente të kulturës sonë të lashtë rrafshohen me eskavatorë, kur varrezat shqiptare lëvrohen me zingjirët e tankeve serbe… Jo vetëm ne shqiptarët, por edhe të tjerët nuk e kanë vështirë të shohin se cila është e vërteta rreth presionit të vërtetë dhe presionit të trilluar në Kosovë, se kush po e bën presionin dhe kush është nën presion. Kthimi aq i shpeshtë i shovinistëve serbomëdhenj në vitin për ta tragjik 1966, është mjaft domethënës e kuptimplotë.

Kultura shqiptare dhe inkuizicioni revizionist

Për të justifikuar masat e papara, që po ndërmarrin kundër ndërgjegjes kombëtare të popullit tonë, shovinistët serbomëdhenj po sulmojnë të gjithë kulturën, arsimin, shkencën, artin dhe letërsinë shqiptare, e deri edhe simbolet e veshjet tona kombëtare. Sipas tyre, gjithë kjo kulturë shqiptare qenka e ngarkuar me "historicizëm" e "romantizëm nacional", me "mite", "shpirtra të vdekur" e me "ideale të tejkaluara", dhe, si e tillë, ajo paska bërë që rinia të edukohet "keq", të hutohet e të mashtrohet aq shumë, sa të ngrihet në greva e demonstrata aq të mëdha. Që të mos përsëritet ajo që ndodhi, shovinistët e Beogradit i kanë hyrë punës për ta "shkarkuar" kulturën kosovare nga fryma kombëtare "e tejkaluar" dhe për ta shndërruar atë në një kulturë "vetadministruese", në një kulturë që kultivon jo "nacionalizmin shqiptar" por të ashtuquajturin patriotizëm jugosllav! Për t'ia arritur këtij qëllimi, shovinistët kanë vënë në shënjestër të gjitha institucionet e arsimit e të kulturës si Universiteti, Akademia e Shkencave dhe Arteve, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, shoqatat e shkrimtarëve, kompozitorëve, artistëve figurativë e të gazetarëve, shkollat , shoqëritë kulturo- artistike e deri te ato çerdhe të pakta të fëmijëve që ekzistojnë në Kosovë. Të gjitha këto po cilësohen si "vatra të nacionalizmit e të kundërrevolucionit" dhe po sulmohen nga të gjitha anët e me të gjitha mjetet.

Shovinistët jugosllavë i kanë hyrë edhe një herë rivlerësimit të historisë sonë kombëtare, gjoja për të çliruar historiografinë tonë nga "historicizmi", "glorifikimi", "dogmatizmi" e "nacionalizmi romantik". Sipas këtij vlerësimi "të ri" (që nuk ndryshon aspak nga ai i paraluftës), Skënderbeu legjendar – të cilin dikur bënin çmos që të na e merrnin – na delka një "person jo negativ" dhe asgjë më tepër, ose barazohet me Car

Lazarin e me kralët e tjerë të Serbisë, Ismail Qemali quhet një agjent i Austrisë, Isa Boletini "një bashibozuk turkofil", Azem Galica – "një vrasës i serbëve të pafajshëm" e të mos flasim për udhëheqësit e lavdishëm të Shqipërisë socialiste, kundër të cilëve nuk lënë gjë pa shpifur e trilluar. Sipas këtij vlerësimi "marksist", gjithë lufta e popullit shqiptar për liri e pavarësi del nxitje dhe vepër e forcave të ndryshme nga jashtë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit quhet "krijesë e sulltanëve të Turqisë", Kryengritja e vitit 1912 si "luftë fanatikësh e bashibozukësh" që gjoja drejtohet kundër popujve të Serbisë , Malit të Zi dhe ushtrive të tyre çlirimtare, formimi i Partisë Komuniste Shqiptare dhe gjithë revolucioni në Shqipëri na dalin vepër e meritë e "komunistëve" jugosllavë dhe agjentëve të tyre si Koçi Xoxe etj. etj. Ja çfarë historie "kombëtare" dëshirojnë shovinistët që të mësohet në shkollat tona! Ja ku qëndron "ngarkimi" i saj me "romantizëm nacional", "dogmatizëm" e "historicizëm"!

Kështu po veprojnë shovinistët edhe me letërsinë, artin dhe muzikën tonë. Çdo vlerë e vërtetë me sado pak frymë kombëtare po kualifikohet si "nacionaliste" e "armiqësore" dhe inkuizitorët revizionistë po i heqin nga vitrinat e librarive dhe bibliotekave, nga programet e shkollave e të televizionit, kurse autorët e shumtë kosovarë janë jo vetëm objekt kritike e presioni, por edhe janë përplasur burgjeve. Si "të papërshtatshëm", "nacionalistë", e "armiqësorë" po cilësohen jo vetëm veprat e mëdha të letërsisë dhe artit të realizmit socialist (kundër të cilit po flitet krejt hapur), por edhe atë të rilindasve tanë , edhe veprat e De Radës, veprat e Naimit tonë të madh! Po ndalohen e po sulmohen si "nacionaliste" e "armiqësore" jo vetëm këngët e produksionit të Tiranës, që u kushtohen ngjarjeve të mëdha e figurave të ndritura të së kaluarës sonë të lavdishme, por edhe këngët lirike si ajo "Kam qëndisur një shami" etj. etj.

Aq hapur kanë dalë shovinistët rankoviçistë sa të kërkojnë edhe mbylljen e Universitetit tonë, mbylljen e shkollave dhe shoqërive të ndryshme, të kërkojnë ndërprerjen e çdo lloj komunikimi dhe kontakti me vëllezërit në Shqipërinë socialiste, të kërkojnë që veprat e shkrimtarëve tanë, që po ndalohen, të zëvendësohen me "vepra" të antishqiptarëve të tërbuar si Cosiçi, Andriçi, Dedijeri, Tempo e Laliçi, për filmat shqiptarë, që janë hequr nga repertori, të zëvendësohen me filma kaubojsh, kriminelësh e prostitutash, që këngët dhe vallet e bukura të zëvendësohen me britmat dhe lëvizjet e çmendura të psikopatëve e hipive të droguar të Beogradit e Perëndimit, që në të njëjtën mbledhje, të kritikohet si "nacionalizëm" e "pabarazi" mbajtja e ligjëratave për studentët serbë e malazezë, edhe pse ata i mbanin në gjuhën serbokroate, dhe në të njëjtën kohë, të njëjtët shovinistë të kërkojnë që në vend të profesorëve tiranas, studentëve shqiptarë t'u mbajnë ligjërata në gjuhën serbokroate profesorë nga Nishi e Beogradi, që, në emër të unitetit të fëmijëve dhe "edukimit" të tyre të përbashkët, të kërkohet edhe heqja e mësimit në gjuhën shqipe nëpër shkolla! Aq larg kanë shkuar shovinistët jugosllavë në revanin e tyre të çmendur antishqiptar, sa t'i sulmojnë si "nacionalistë", "iredentistë", "armiqësorë" e "antijugosllave" edhe gjuhën tonë të njësuar, veshjet tona kombëtare, plisin e bardhë dhe flamurin tonë të lavdishëm!!!

Për të qenë ironia edhe më e madhe, gjithë kjo "hajkë" e paparë kundër ndërgjegjes sonë kombëtare, gjithë kjo luftë kundër shovinizmit të paqenë shqiptar, bëhet në një kohë kur shovinizmi serbomadh është bërë me mjekër, kur po ringjallen si asnjëherë më parë çetnikët më të zi të luftës e të pasluftës, kur letërsinë dhe shtypin serb e përshkon si një fill i zi unitarizmi e hegjemonizmi serbomadh, kur portreti i Karagjorgjeviçit po shtypet edhe në monedhat e arit, kurse uniformat e ushtrisë pushtuese serbe botohen gati në çdo numër të gazetave dhe revistave të Beogradit.

Balta revizioniste nuk mund ta njollosë diellin e socializmit

Në fushatën e tyre të egër antishqiptare, revizionistët jugosllavë një vëmendje të veçantë po i kushtojnë luftës kundër Shqipërisë socialiste dhe politikës së saj të drejtë marksiste-leniniste e konsekuente internacionaliste.

Me qëllim të njollosjes së emrit të Shqipërisë dhe uljes së prestigjit të saj të madh në botë, e njëkohësisht me qëllim të nxitjes kundër saj të popujve të Jugosllavisë dhe sidomos të popullit shqiptar, revizionistët po mundohen ta paraqesin me çdo kusht jo vetëm politikën e Partisë së Punës, por edhe kulturën, shkencën, artin dhe letërsinë e realizmit socialist, që po lulëzon atje, si "nacionaliste" e "shoviniste", "iredentiste","paternaliste", e "luftënxitëse"! Askush deri më tash nuk ka bërë kundër Shqipërisë akuza, shpifje e trillime të tilla të poshtra si ato që po bëjnë revizionistët shovenë të Jugosllavisë. Propagandë të tillë të hapët e të theksuar antikomuniste, nuk bëjnë sot as vendet më fashiste dhe as Vatikani.

Vetëm shovinistët nuk mund t'i quajnë "ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë" artikujt e "Zërit të popullit", që dënuan dhunën e terrorin e pashembullt të ushtruara mbi popullin e Kosovës dhe që përkrahën kërkesat më se të drejta, ashtu siç bëri edhe i gjithë opinioni përparimtar botëror. Vetëm shovinistët mund ta quajnë "shovinist" e "antijugosllav" qëndrimin kurdoherë të drejtë e internacionalist të Partisë së Punës ndaj popujve të Jugosllavisë, vetëm ata mund të shpifin sikur Shqipëria po na nxit ne, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera, të luftojmë kundër popujve jugosllavë, se ajo po bën politikën e superfuqive e absurditete të tjera si këto. Vetëm shovinistë të urryer, si Herleviçi e Ristiçi, dhe ndonjë këlysh i tyre shqiptar, mosmirënjohës, mund të akuzojnë për "ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë" profesorët e respektuar të Universitetit të Tiranës, të cilët, siç po pranojnë edhe vetë revizionistët, gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, kanë qenë të ndjekur e të kontrolluar në çdo hap! Vetëm shovinistët dhe tradhtarët mund t'i akuzojnë shkrimtarët, këngëtarët, valltarët, artistët dhe sportistët e pakët që kanë ardhur nga Shqipëria, se gjoja me veprat, këngët, vallet dhe lojën e tyre, paskan rrezikuar sovranitetin dhe integritetin e Jugosllavisë.

Aq larg kanë shkuar revizionistët në përpjekjet e tyre për ta diskredituar Shqipërinë, sa jo vetëm të mbushin eterin, shtypin e libra të tërë me sharje, shpifje, gënjeshtra e trillime nga më të poshtrat e më të padëgjuarat, por edhe ta akuzojnë udhëheqjen shqiptare edhe për të ashtuquajturën "hartë të Shqipërisë së madhe", të përpiluar e të shpërndarë nga emigracioni reaksionar shqiptar (i cili shumë shpesh është në shërbim të klikës titiste), apo për eksplozivin, që ata e vendosën vetë në ambasadën jugosllave në Tiranë.

Me metoda të tilla, revizionistët po mundohen ta diskreditojnë Shqipërinë, po në të vërtetë ata po demaskojnë kështu dhe po diskreditojnë vetveten. Balta, me të cilën revizionistët po mundohen ta njollosin diellin e socializmit, po u bie revizionistëve fytyrës. E famshmja "hartë e Shqipërisë së madhe", pas së cilës u kapën aq fort revizionistët, me shpresë se kështu do ta nxitnin kundër Shqipërisë edhe popullin grek, tashmë u bë copë-copë, e pas saj popujt e Ballkanit panë fytyrën e vërtetë luftënxitëse të krajlëve të rinj serbomëdhenj, kurse eksplozivi që u vendos në Tiranë, u nxori sytë "ustallarëve" të tyre në Beograd. E vërteta marksiste-leniniste po i bën pluhur e hi dërdëllisjet bajate e banale të revizionistëve dhe intrigat e manovrat e tyre të poshtra.

Cilët janë shovinistët e vërtetë

Gjithë kjo fushatë e egër, e paparë, kundër popullit tonë dhe gjithçkaje që është shqiptare, është vazhdim i drejtpërdrejtë i politikës së egër antishqiptare të krajlëve të Beogradit, është shprehje e procesit të rankoviçizmit të mëtejshëm të Jugosllavisë revizioniste, rrezikun e ringjalljes së të cilit, shoku Enver Hoxha e ka theksuar qysh në Kongresin e 7-të të Partisë, para 5 vitesh. Zhurma shurdhuese që po bëhet kundër nacionalizmit e shovinizmit të trilluar shqiptar, s'është gjë tjetër pos përpjekje për ta fshehur shovinizmin e hegjemonizmin e vërtetë rankoviçian. Por, shovinizmi serbomadh ashtu si dhe ai malazez e maqedonas, është aq i zi e i dukshëm sa nuk mund të mbulohet me kurrfarë "potere" kundër gjoja nacionalizmit të shqiptarëve të robëruar dhe as me fraza e parulla boshe dhe monotone për "vëllazërim-bashkimin". Nuk është vështirë për askënd që të dallojë se kush janë shovinistët e vërtetë dhe kush është preja e tyre, se kush janë ujqit e kush qengji, që po ua turbullon atyre ujët!

Shovinistët janë ata që e kanë robëruar, e kanë ndarë e copëtuar me bajoneta popullin tonë liridashës, ata që nën parullën e "Serbisë së madhe" të Car Dushanit e të "pastërtisë së saj etnike", i kanë dëbuar me dhunë nga trojet tona qindra mijëra shqiptarë, ata që kanë vrarë, prerë, djegur e masakruar me dhjetëra mijëra burra, gra, pleq e fëmijë të pafajshëm shqiptarë para, gjatë dhe pas luftës, ata që bënë masakrat e tmerrshme të Drenicës, Gjilanit e Tivarit, janë ata që rrahën e poshtëruan gati të gjithë burrat kosovarë gjatë aksionit famëkeq të armëve, ata që sollën në tokën tonë gjysmën e ushtrisë dhe policisë jugosllave, gjysmën e tankeve, avionëve e mitralozave, për të na mbytur në gjak popullin tonë të paarmatosur, që kërkonte të drejtat e veta të ligjshme, ata që na i vranë, na i plagosën e gjymtuan qindra motra e vëllezër nga më të mirët, vetëm e vetëm pse kërkonin bukë e liri për popullin, ata që na e burgosën dhe po vazhdojnë të na e burgosin, rrahin e torturojnë ajkën e popullit tonë, ata që po mundohen të na i frikësojnë fëmijët me tanke, avionë e me topa. Shovinistët janë ata që po na i plaçkisin pasuritë tona të mëdha, ata që na e mbyllën para kohe Universitetin dhe shkollat tona, ata që po mundohen të na ndajnë, izolojnë e armiqësojnë me vëllezërit tanë të një gjuhe e të një gjaku, me Shqipërinë socialiste, ata që po botojnë libra "të bardhë", "të kaltër" e lloj-lloj librash të tjera të zeza, antishqiptare, ata që po na i sulmojnë e mohojnë heronjtë tanë të pavdekshëm, historinë, kulturën dhe gjithë trashëgiminë tonë, ata që po na i sulmojnë e ndalojnë këngët, librat, veshjet e simbolet tona kombëtare, janë ata që po bëjnë çmos për ta penguar shtimin e popullit tonë, ata që duan "ta lërojnë tokën tonë me plug e me pushkë". Shovinistët janë ata që godasin e rrëzojnë shtëpitë tona edhe me helikopterë e artileri, ata që nuk ua japin familjeve tona bijat e bijtë e tyre të vrarë, ata që vrasin edhe të plagosurit e zhvarrosin edhe të varrosurit. Shovinistët janë atë që kanë hapur dosje për të gjithë popullin tonë, ata që i urdhërojnë njerëzit për t'i mbajtur të hapura dyert me qëllim që të bastisin e kontrollojnë më leht, ata që po burgosin, ndjekin e maltretojnë njerëzit e ndershëm, vetëm pse u kanë dhënë ndihmë mjekësore demonstruesve të plagosur, pse kanë kërkuar shkollë në gjuhën shqipe, pse nuk u kanë duartrokitur fjalimeve të tradhtarëve, pse para dhjetë vjetësh kanë shkruar ndonjë reagim a artikull, apo pse e kanë përmendur fjalën masakër në ndonjë fjalëkryq të gazetës!!!

Këto janë shovinistët dhe populli ynë i shumëvuajtur që lufton për lirinë dhe të drejtat e tij të ligjshme, pa u rënë në qafë popujve të tjerë dhe pa u bërë atyre asnjë të keqe. Ky është shovinizmi i vërtetë në Kosovë dhe kundër tij mund të mos jetë vetëm ndonjë bastard "shqiptar", ndonjë sahanlëpirës i rrallë, që është zhytur aq thellë në lumin e ndyrë të tradhtisë, sa të mos i vij ndot e trishtim që të gëlltisë gjithë atë vrer të neveritshëm antishqiptar, që po vjellin padronët e tyre rankoviçianë. Kundër

këtij shovinizmi është ngritur sot populli ynë liridashës dhe jo aspak kundër njerëzve të pafajshëm të popujve të tjerë.

Ne, shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi, kemi luftuar e do të luftojmë me vetëmohim e heroizëm deri në fitoren kundër armiqve tanë shovinistë, por ne nuk kemi qenë dhe nuk do të lejojmë kurrë që të biem në ujërat e ndyta të shovinizmit. Ne jemi patriotë, e s'jemi shovinistë. Qëndrimi ynë ka qenë e është: NDAJ POPUJVE ASNJË DËM – NDAJ SHOVINISTËVE, ASNJË MËSHIRË! Prandaj, ne i bëjmë përsëri thirrje popullit tonë që, krahas intensifikimit të mëtejshëm të luftës së gjithanshme kundër regjimit robërues të shovinistëve jugosllavë, ashtu si edhe deri tash, të mos lejojë asnjë dëm, asnjë presion e zullum ndaj njerëzve të pafajshëm serbë e malazezë. Veprime të tilla jo vetëm që janë në kundërshtim me karakterin e luftës sonë, por janë edhe shërbim i madh për shovinistët serbomëdhenj, të cilët po bëjnë çmos me qëllim që ta njollosin e diskreditojnë luftën tonë të drejtë. Shovinizmit të armiqve tanë ne nuk i kundërvëmë shovinizmin, por grushtin popullor, revolucionin. Luftën tonë çlirimtare ne do ta bëjmë kurdoherë me flamurin e kuq të marksizëm-leninizmit në ballë, me tingujt e Internacionales në gojë, me parullën e pavdekshme leniniste :"PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE DHE POPUJ TË SHTYPUR, BASHKOHUNI"! (LIRIA, gusht 1981, faqe 5-8)

4-5-3. POPULLI SHQIPTAR NË JUGOSLLAVI ASNJËHERË NUK VENDOSI PËR FATIN E TIJ

Nga Berat Luzha

KOSOVA - REPUBLIKË! Kjo ishte kërkesa që dominoi në demonstratat historike që u bënë gjatë pranverës së këtij viti - anë e mbanë Kosovës dhe në shumë vende të botës. Këtë kërkesë të drejtë po e shprehë sot populli ynë në mbledhjet e shumta që po organizon armiku, në traktet që po shpërndahen gjithë kund apo në parullat e panumërta që po skuqin rrugët, muret e ndërtesave dhe lëndinat tona.

Çizmja e rëndë fashiste u mundua ta shkelë dhe të na mbysë këtë kërkesë të ligjshme, të na e mbyllë gojën njëherë e përgjithmonë. Duke u munduar ta kompromet ojnë e denigrojnë popullin shqiptar në Jugosllavi përpara opinionit jugosllav dhe atij ndërkombëtar, aparati borgjez shovinist serbomadh, këtë kërkesë si dhe të tjerat e quajti sipas konvenimit të tij si "reaksionare" "kundërrevolucionare", "irredentiste" "shoviniste" e "nacionaliste" etj. Shovinistët jugosllavë mundohen tua mbushin mendjen popujve jugosllavë se gjoja kërkesa e popullit të Kosovës drejtohet kundër popullit serb, atij maqedonas e malazez dhe kundër integritetit territorial të republikave përkatëse dhe të vetë Jugosllavisë, se na qenka kundër rregullimit kushtetutar të RSFJ dhe, po të realizohet, do ta shkatërronte atë! Në adresë të popullit tonë nga revizionistët ka vetëm mallkime, kërcënime, fyerje e sharje nga më të poshtrat por, në qarqet udhëheqëse të revizionistëve asnjëherë nuk pati arsye e gjakftohtësi në vlerësimin e kësaj kërkese të drejtë të popullit tonë.

Duke mos pasur asnjë arsye bindëse për ta hedhur poshtë kërkesën tonë të ligjshme për Republikë, revizionistët po mundohen të spekulojnë jo vetëm me të sotmen, por edhe me të kaluarën e ndritshme të popullit tonë. Duke e mohuar, falsifikuar e shtrembëruar në mënyrë të palejueshme të vërtetën historike armiqtë tanë të urryer dhe

shërbëtorët e tyre po mundohen të na bindin se gjoja vetë populli ynë paska vendosur të jetë kështu, siç është, në zgjedhën e huaj shoviniste, të jetë i robëruar, i ndarë e i copëtuar!

SI MBETI KOSOVA NËN SUNDIMIN E SERBISË

Copëtimi dhe nxjerrja në ankand e trojeve shqiptare, filloi para një shekulli, kur fuqitë e atëhershme të mëdha dhe shtetet shoviniste fqinje nisën thurjen e komploteve në dëm të popullit shqiptar. Pazarllëqet më serioze në trojet shqiptare filluan me të ashtuquajturin Traktat i Shën Stefanit, që u bë në mars të vitit 1878 në mes të Rusisë dhe Turqisë. Sipas këtij traktati famëkeq, Bullgarisë, përveç krahinave të tjera në Ballkan i jepeshin edhe tokat shqiptare që shkonin deri në malet e Voskopojës. (Shovinistët bullgarë i ëndërrojnë edhe sot e kësaj dite tokat që dikur ua kishte dhuruar Rusia Cariste). Ndërkaq Malit ë Zi traktati i njihte sovranitetin mbi Ulqinin Krajën, Anamalin, Hotin, Grudën, Kelmendin, Vermoshin, Plavën, Gucnë e Rugovën, kurse Serbia zgjerohej në Sanxhakun e Prishtinës dhe në një pjesë të rrethit të Mitrovicës.

Meqenëse vendimet e traktatit të Shën Stefanit nuk u pranuan nga fuqitë e mëdha të kohës, sepse ishin të njëanshme dhe të diktuara arbitrarisht nga Rusia Cariste; për t'i rishikuar ato u thirr Kongresi i Berlinit. Vendimet kryesore të këtij kongresi që filloi punën më 13 qershor 1878, ishin marrë qysh më parë në bisedime të fshehta. Serbia dhe Mali i Zi, nëpërmjet Rusisë kishin fituar pozita të mira për të aneksuar territore shqiptare. Fuqitë e Mëdha e mohuan në tërësi çështjen shqiptare, kurse Shqipërinë e quajtën "shprehje gjeografike". Delegacionit shqiptar i kryesuar nga Abdyl Frashëri u refuzua të merrte pjesë në Kongres, ku vendosej për fatet e Shqipërisë. Në këto rrethana copëtimi i atdheut tonë u bë fakt i kryer.

Kundër copëtimit të tokave shqiptare, i bashkuar si një trup i vetëm, qe ngritur gjithë populli shqiptar, në të gjitha vilajetet. Më 10 qershor 1878, në Prizren themelohet Lidhja Shqiptare e cila shënon faqe të lavdishme të historisë shekullore të popullit tonë. Me heroizëm të pashoq të ushtrisë së Lidhjes, vullnetarëve dhe të vet banorëve, u mbrojtën me sukses Plava e Gucia, Hoti e Gruda që i ishin caktuar për aneksim Malit të Zi. Vetëm në nëntor të vitit 1880 ushtria turke mundi t'ua merrte nga duart kryengritësve qytetin e Ulqinit dhe t'ia dorëzonte ushtrisë malazeze. Po Mali i Zi nuk mjaftohej me kaq, por donte me çdo kusht edhe Shkodrën dhe territore të tjera shqiptare, deri në lumin Drin, në jug, dhe deri në Gjakovë - në lindje. Çarqet shoviniste serbe nga ana e tyre, i kishin vënë syrin tërë Kosovës Dibrës, Shqipërisë së Veriut, me një dalje në det etj.

Për këto kërkesa, në mungesë të argumenteve të tjera, shovinistët serbë bazoheshin në "argumente" gjoja historike, sepse prej shekullit XIII - XV në këto krahina kishte sunduar Serbia e këto "argumente", krerët e Beogradit i përdorin edhe sot për të mbrojtur "Kosovën serbe" si, "djepin e Serbisë". Pa fije turpi, revizionistët e sotëm mbrojnë hapur dhe vazhdojnë politikën serbomadhe të obrenoviçëve, karagjorgjeviçëve, stojadinoviçëve, pashiçëve dhe rankoviçëve.

Politika pushtuese ndaj tokave shqiptare, e filluar nga kryeministri serb Garashanin, qysh në vitin 1847 ka vazhduar duke përdorur kurdoherë kundër popullsisë së pafajshme shqiptare dhunën dhe terrorin më të egër. Politika shfarosëse si ajo e Knjaz Milanit, i cili bashkë me urdhrat ushtarëve të tij u jepte edhe porosinë: "Sa më shumë shqiptarë të shpërngulen, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut", vazhdoi edhe në Jugosllavinë e re të Titos, gjë që u vërtetua edhe gjatë ngjarjeve të fundit në Kosovë. Politika shoviniste kërkonte kthimin e përbërjes etnike të krahinave të pushtuara në favor të elementit sllav. Prandaj, përveç shfarosjes përmes terrorit e masakrimit u

aplikua edhe dëbimi i dhunshëm i shqiptarëve jashtë trojeve të tyre. Por, megjithatë Kosova dhe krahinat tjera shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal e të Zi mbetën dhe do të mbesin gjithmonë shqiptare.

Lufta e pandërprerë e popullit shqiptar për liri e pavarësi, u kurorëzua më 28 Nëntorin historik të vitit 1912, kur Plaku i urtë Ismail Qemali e ngriti, pas afër pesë shekuj robërie Flamurin e lavdishëm të Skënderbeut. Vendimi i 28 Nëntorit kishte rëndësi edhe më të madhe pasi drejtohej kundër interesave të fuqive të mëdha imperialiste dhe synimeve të poshtra të monarkive të Ballkanit.

Lëvizjen Kombëtare shqiptare, të mbushur përplot luftëra të gjata e të përgjakshme për liri e vetëvendosje, historiografia borgjeze u mundua ta paraqesë sikur ajo paska qenë reaksionare, primitive, e drejtuar kundër reformave "përparimtare" turke, kundër ushtrive, "çlirimtare" të shteteve fqinje dhe e quan atë vepër të të huajve apo të një grushti njerëzish, bile agjentësh të huaj. Shpallja e Pavarësisë nuk ishte vepër e të huajve as një grupi të veçantë patriotësh, por vepër e një kuvendi kombëtar, me përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, që erdhi pas luftës dhe përpjekjeve më se shtatëdhjetëvjeçare. Kosovën në këtë kuvend e përfaqësonte trimi i madh Isa Boletini. Pavarësia u shpall njëkohësisht për të gjitha krahinat me popullsi etnike shqiptare. Por, që të fitohej pavarësia e vërtetë popullit tonë do t'i duhej të bëjë edhe shumë luftëra të tjera, do t'i duhej të derdh gjak të bijve të tij më të mirë.

THIKA E DIPLOMACISË EVROPIANE COPËTON ATDHEUN TONË

Vetëm 19 ditë pas shpalljes së Pavarësisë në Londër u mblodh Konferenca e Ambasadorëve. Ajo u mblodh gjoja për të caktuar kufijtë e Shqipërisë. Por në të vërtetë qëllimi i saj ishte ndarja e tokave tona që "kishin mbetur pa zot" pas mundjes së Turqisë nga aleanca ballkanike. Pa pritur vendimet e konferencës, ushtritë e shteteve shoviniste fqinje vërshuan në trojet shqiptare, duke shfrytëzuar kështu paaftësinë e Qeverisë së Vlorës të sapoformuar, e cila ende nuk kishte konsoliduar, si dhe lodhjen e popullit shqiptar nga luftërat e mëdha me pushtuesit turq. Ushtria serbe pushtoi Kosovën, Shqipërinë e Mesme e kishte dalë në Durrës. Ndërkaq Mali i Zi po bënte çmos që ta pushtonte Shkodrën e pamposhtur. Luma, nga ana tjetër kacafytej me hordhitë e panumërta të ushtrisë serbe dhe, siç thotë kënga popullore "ia mbushte asaj shpinën plot me plumba".

Me gjithë luftërat e mëdha, rezistuese ndaj ushtrive serbe e malazeze, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe krahinat shqiptare në Maqedoninë e sotme t'i jepeshin Serbisë dhe shumë krahina rreth kufirit malazez t'i njiheshin Malit të Zi.

Me copëtimin e tokave shqiptare, populli shqiptar nuk u pajtua kurrë. Vendimet e padrejta të kësaj konference, patriotët tanë të mëdhenj si Ismail Qemali, Isa Boletini e Luigj Gurakuqi i hodhën poshtë që në Londër.

Nën udhëheqjen e Isa Boletinit, Bajrarn Currit, Hasan Prishtinës etj., në Kosovë filloi organizimi i kryengritjes për çlirim nga zgjedha e re, që ishte edhe më e rëndë se ajo turke. Më 22 shtator 1913, populli i Dibrës i dëboi pushtuesit serbë dhe në qytet ngriti flamurin kombëtar. Trupat serbe u dëbuan edhe nga Struga e Ohri, ndërsa vullnetarët shqiptarë sulmuan Tetovën e Gostivarin, e më vonë edhe Gjakovën. Mirëpo, me anën e një, ofensive kundër kryengritësve dhe popullit, ushtria serbe, pas luftimesh të ashpra i shkel ato përsëri, duke masakruar barbarisht popullsinë e duke lënë pas vetes vetëm gërmadha. Një ushtarak serb, në një letër të botuar në gazetën socialiste "Radniçke novine" (22 tetor 1913) shkruante: "...Mund të them se këtu po bëhen gjëra të tmerrshme.

Jam i tmerruar dhe pyes gjithnjë se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë për të kryer të tilla mizori... mund të them që Luma... nuk ekziston më. Nuk ka veçse kufoma, pluhur e hi." Socialdemokrati serb Dimitrije Tucoviq dhe gazeta e tij "Radniçke novine" e dënuan borgjezinë serbe për këto ndërmarrje pushtuese, ndërsa "Raboteniçeski vesnik",organ i socialistëve bullgarë ato ditë shkruante: "Serbia mobilizoi përsëri ushtrinë për ta goditur Shqipërinë, e cila kërkon çlirimin kombëtar dhe vetëvendosjen." Ndërkaq, Lenini i madh, duke e gjykuar copëtimin e popullit shqiptar nga Konferenca e Londrës i dha përkrahje të plotë lëvizjes kombëtare të shqiptarëve kundër mbretërisë së Serbisë dhe më vonë kundër Jugosllavisë borgjeze.

Edhe pas rënies së Kosovës dhe krahinave tjera shqiptare nën sundimin serbo-malazez, rezistenca dhe lëvizja kundër regjimit të ri nuk pushoi kurrë asnjëherë. Çetat të shumta patriotike si ajo e Azem Galicës organizohen në krahina të ndryshme, si në Drenicë, Moravë, Llap etj. Për të organizuar më mire këtë luftë formohet më 1918 në Shkodër Komiteti "Mbrojta Kombëtare e Kosovës".

Një pazarllëk tjetër i fuqive të mëdha me tokat shqiptare u bë në vitin 1915, kur u nënshkrua Traktati i Fshehtë i Londrës. Sipas këtij traktati Shqipëria duhej të copëtohej mes Italisë, Malit të Zi, Serbisë e Greqisë. Traktati i Londrës ishte një traktat imperialist, i cili shkelte në mënyrë brutale pavarësinë dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë dhe merrte nëpër këmbë të drejtat sovrane të popullit shqiptar.

Mirëpo, qeveria sovjetike me Leninin e madh në krye, duke botuar traktate të fshehta të fuqive imperialiste që ndanin botën midis tyre,nxori në dritë edhe përmbajtjen e Traktatit të Fshehtë të Londrës, që u cilësua si "Qefini i Shqipërisë". Populli shqiptar i kuptoi planet e vërteta të fuqive të mëdha e të shteteve fqinje kundër atdheut. Në saje të zbulimit dhe të demaskimit nga ana e Leninit të këtyre planeve të rrezikshme antishqiptare, atdheu ynë shpëtoi nga një copëtim i ri, kurse botimin e traktatit populli ynë e quajti "sy për të verbërit e vesh për të shurdhërit".

Çështja e kufijve të Shqipërisë u shtrua edhe më 1919 në Konferencën e Paqes në Paris ("Paqja e Versajes"), e cila filloi punimet më 18 janar të atij viti. Kjo konferencë në vend që t'i rishikonte vendimet e padrejta të konferencave dhe traktateve të mëparshme, i ri konfirmoi ato, bile mori edhe vendime për një ri copëtim të ri të Shqipërisë. Planet djallëzore të Konferencës së Paqes për copëtimin e atdheut tonë i hodhi poshtë populli shqiptar nëpërmjet të Kongresit të Lushnjës të vitit 1920. Ky kongres shpallte se shqiptarët ishin të gatshëm të bënin të gjitha sakrificat dhe të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut kundër çdo vendimi që vinte në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e atdheut. Më tutje ky kongres shpallte se "shqiptarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë te tjetra si tufë delesh e të bëhen plaçkë e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Evropës". Megjithëkëtë, në një konferencë të mëvonshme të ambasadorëve të organizuar nga fuqitë imperialiste, në vitin 1921, u mor edhe një vendim që i shkëpuste atdheut një pjesë të krahinës së Lumës, Hasit dhe Gollobërdës. Në një protestë të kohës thuhej: "Mjerisht, po bahet e treta herë që thika e ftohtë e diplomacisë po pret në mish të gjallë të atdheut tonë e që po na këputen vise të çmueshme, të cilat, nga çdo pikëpamje që të vështrohen, nuk mund t'i mohohen kurrsesi Shqipnisë, kështu, që të ndamet e tyre prej trupit të saj formon patjetër një padrejtësi të haptë".

Edhe më vonë politika pushtuese e çarqeve shoviniste të Serbisë ndaj Shqipërisë nuk pushoi asnjëherë. Është i njohur intervenimi jugosllav i vitit 1924, për përmbysjen e qeverisë demokratike të Fan Nolit dhe kthimit në pushtet të satrapit Ahmet Zogu . "Kthesa kundërrevolucionare e Ahmet Zogut në Shqipëri, shkruante aso kohe Gjergj Dimitrovi, e

kryer me ndihmën e Jugosllavisë dhe me forcat e saja të armatosura, zgjeroi frontin e reaksionit ballkanik deri në detin Adriatik,.."

Bashkë me Italinë, e cila po përgatitej të pushtonte Shqipërinë, ortake në këtë ndërmarrje donte të bëhej edhe Jugosllavia e Stojadinoviçit dbe,.kral Aleksandrit. Mirëpo Italia nuk pranonte ortak në Shqipëri, sepse konsideronte ta ketë një koloni për vete.

Gjatë gjithë sundimit të regjimit borgjez të Jugosllavisë së vjetër, krahinat e banuara me shqiptarë, si Kosova, Maqedonia Perëndimore, një pjesë e Malit të Zi, Krahinat e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës, dhe Peshteri bënin pjesë në viset më të pazhvilluara dhe më të prapambetura të Jugosllavisë, si nga aspekti ekonomik, ashtu edhe nga ai kulturor, arsimor etj. Kjo gjendje, para së gjithash, ishte pasojë e politikës shtypëse dhe shfrytëzuese të borgjezisë serbo-malazeze. Duke bërë plane të poshtra jo vetëm për shfrytëzimin e tyre, por edhe për asimilimin dhe dëbimin e popullit shqiptar, Nikola Pashiçi planifikonte që për 20-30 ditë popullin shqiptar ta asimilojë në pikëpamje kulturore e kombëtare. Sipas tij " Shkrirja e këtyre viseve në Serbi duhej të kryhej në mënyrë të plotë siç janë shkrirë pas 1878 Nishi, Leskovci dhe Vranja". Duke zbatuar planet e saj të poshtra, qeveria shoviniste jugosllave shpërnguli për në Turqi dhe vende tjera qindra mijëra shqiptarë, e në vend të tyre solli kolonistë të elementit sllav.

Por, politika e këtillë shoviniste s'mbeti pa rezistencë e kundërshtim të organizuar të popullit shqiptar. Lufta e shqiptarëve duhej t'u shërbente çarqeve serbe si mësim " se janë vjetruar metodat e Milloshit të vitit 1883 dhe ato të Ristiçit të viteve 1878-1879 për Maqedoninë dhe Kosovën".

Ndërkohë, krahinat shqiptare në Mbretërinë jugosllave ishin përfshirë prej kohësh nga veprimet dhe luftimet e çetave kryengritëse (komitave), të cilat sulmonin niësi dhe reparte të ushtrisë dhe të policisë armike.

Si Shqipëria, ashtu edhe Jugosllavia, gjatë Luftës së Dytë Botërore u sulmuan dhe u pushtuan nga fuqitë e atëhershme nazifashiste . Popujt e këtyre dy shteteve fqinje u hodhën në luftën Nacionalçlirimtare, krah për krah njëri -tjetrit, kundër armikut të përbashkët, mirëpo, qysh gjatë luftës, në udhëheqjen e PKJ-së u vërejtën shenja të shovinizmit dhe të mendjemadhësisë. (...)

SI E SHIHTE PARTIA KOMUNISTE E JUGOSLLAVISË TË DREJTËN PËR VETËVENDOSJE, PARA DHE GJATË LUFTËS ?

Në kundërshtim me borgjezinë shoviniste serbe, e cila kishte aspirata të vazhdueshme dhe përpiqej me të gjitha forcat për të aneksuar sa më shumë territore shqiptare, Parti Socialdemokrate e Serbisë mbajti qëndrim afirmativ ndaj luftës së popullit shqiptar për liri dhe bashkim kombëtar. Udhëheqësi i kësaj partie, D. Tucoviq, ishte kundër aneksimit të Kosovës nga Serbia dhe e dënoi borgjezinë serbomadhe për ndërmarrjet pushtuese në krahinat shqiptare.

Edhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, më vonë, mbajti gjithashtu qëndrim pozitiv ndaj të drejtës së popullit shqiptar në Jugosllavi për vetëvendosje në Konferencën e saj të 3-të ajo dënoi borgjezinë serbe për " politikën pushtuese dhe koloniale në Maqedoni dhe kundër Shqipërisë". Ajo kërkoi që " t'i njihet çdo populli e drejta e sovranitetit në caktimin e marrëdhënieve të veta, prandaj edhe e drejta e shkëputjes së lirë dhe e formimit të shteteve të tyre, respektivisht e bashkimit me shtetet e tyre amë". Nga ana tjetër, Kongresi i 4-të i PKJ-së, mes tjerash, thërret klasën punëtore jugosllave që "ta ndihmojë nga të

gjitha anët luftën e popullit shqiptar të copëtuar dhe të shtypur, për një Shqipëri të pavarur dhe të njësuar" (" Kosova" 2,1973).

Duke dhënë iniciativën për rregullimin e ardhshëm federativ, PKJ vendosi që më 1937 të formojë komitetet qendrore për Sllovenínë e Kroacinë dhe Komitetin Krahinor për Kosovën, e cila prej vitit 1940 lidhet drejtpërdrejtë me KQ të PKJ dhe kishte të gjitha të drejtat dhe atributet që kishin edhe komitetet e organizatave partiake të Maqedonisë, Serbisë, Malit të Z etj. Në këtë mënyrë ishte i lidhur gjatë luftës edhe Shtabi UNÇ për Kosovë e Metohi. " Gjatë LNC-së, shqiptarët në Jugosllavi kanë pasur trajtim të njëjtë në çdo pikëpamje e edhe sa i përket të drejtës për vetëvendosje, sikur të gjithë popujt e Jugosllavisë" ("Kosova", 2,1973).

Lidhur me çështjen e vetëvendosjes së kombeve në një artikull programatik në gazetën " Proleter" nr.16, 1942, vetë Tito shkruante se " Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës dhe Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Serbisë, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnjës e Hercegovinës, do të zgjidhen lehtë, duke i kënaqur të gjithë". Gjatë luftës, duke folur për çështjen e vetëvendosjes së kombeve të veçanta, pas çlirimit Tito deklaron: Populli rnaqedonas ka të drejtë të vetëvendos, e madje edhe të shkëputet... Por, populli maqedonas, sovran në të drejtat e veta, ka të drejtë edhe të bashkohet në bashkësinë federative edhe të popujve tjerë...Në mënyrë të ngjashme duhet shtruar edhe çështja e Kosovës dhe Metohisë". (letër e Titos dërguar V. Tempos, 1943).

Kështu e shtronin atëherë çështjen kombëtare krerët revizionistë të PKJ-së, por praktika tregoi se ata nuk mendonin kështu. Ata përpiqeshin të krijonin përshtypjen se kishin qëndrim të drejtë ndaj çështjes së pazgjidhur kombëtare në Jugosllavi, por në të vërtetë ata zbatonin qëndrimet e hershme të Simiqit me shokë të cilët ishin kritikuar ashpër nga Kominterni dhe Stalini, si qëndrime që s'kishin asgjë të përbashkët me zgjidhjen marksiste-leniniste të çështjes kombëtare.

ÇKA U VENDOS NË AVNOJ DHE ÇKA NË BUJAN ?

Qëndrimi i vërtetë i PKJ-së rreth çështjes kombëtare, e sidomos rreth asaj shqiptare, del në shesh edhe me ndërhyrjet brutale në punët e brendshme të Partisë Komuniste Shqiptare, e sidomos gjen shprehje në Mbledhjen e Avnojit. Në këtë mbledhje, populli ynë, edhe pa asnjë delegat shqiptar, " vendosi dhe shprehu vullnetin e tij të lirë" që të mbetet ashtu siç ishte më parë!

Edhe pse populli shqiptar në Jugosllavi, ishte si për nga numri ashtu edhe për nga territori, më i madh se disa kombe jugosllave që fituan të drejtën për republikë, ai u desh të "kënaqej" vetëm me konstatimin demagogjik të pakicave nacionale u janë njohur të gjitha të drejtat nacionale. Duke u klasifikuar si " pakicë kombëtare", ose "popullsi" ("narodnost"!), populli shqiptar u zhvesh nga shumë të drejta të tij të ligjshme, të cilat i ishin premtuar me kohë nga udhëheqja e Partisë Komuniste jugosllave.

Populli shqiptar në Jugosllavi u privua nga e drejta që të vendosë vetë për fatin e tij.

Në zjarrin e luftës, kur popujt e Jugosllavisë dhe të botës vendosnin për fatin e tyre dhe formonin organet e tyre të pushtetit popullor, më 31.12.1943, u mblodhën në Bujan të Malësisë së Gjakovës, përfaqësuesit e .popullit të Kosovës, në Konferencën e Parë të Këshillit Nacional çlirimtar Konferenca, në të cilën merrnin pjesë 49 delegatë, përfaqësues të popullit dhe njësive partizane (nga të cilët 6 ishin serbë e malazez), në Rezolutën që u aprovua, konkludoi se 'Kosova e Metohija asht regjion në të cilin jeton, në pjesën më të madhe, populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipninë, prandaj ndjejmë për detyrë të vëmë në dukje rrugën e drejtë të cilën duhet ndjekur populli shqiptar, që shqiptarët e Kosovës e Metohisë të bashkohen

me Shqipninë, kjo asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë, kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtoreve të tij të vendit sepse kjo asht e vetmja rrugë që të fitohet liria kur të gjithë popujt - prandaj, edhe shqiptarët - do të shprehen për fatin e tyne me të drejtë të vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për të gjitha këto janë UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇ e Shqipnisë, me të cilën asht e lidhun ngushtë. Përveç kësaj, janë garanci aleatët tanë të mëdhej: Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit).” (“Kosova" nr. 2, 1943).

Edhe pse ky vendim ishte i drejtë, ishte shprehje e lirë e fatit të popullit tonë, e në përputhje me dokumentet e PKJ-së për vetëvendosje, ky u kundërshtua dhe u kritikua nga udhëheqja e partisë jugosllave dhe nga vetë Tito, si "vendim që është në ku ndërshtim me vendimet e AVNOJ-it".

Në një letër dërguar Komitetit Krahinor Tito ua tërheq vërejtjen komunistëve kosovarë se "sot nuk është fjala për caktimin e kufijve në mes të Shqipërisë e të Jugosllavisë të dyja ende të pushtuara por, për çlirimin e tyre me luftë të armatosur.

Pra, sot do të ishte krejt gabim të parashtrohen dhe të zgjidhen çfarëdo çështjesh kontestuese. Këto mund të zgjidhen në mënyrë të drejtë vetëm nga ana e popujve të lirë". Kështu, kur ia donte puna, Tito me demagogji deklaronte se "punët që sot nuk po mund t'i zgjidhim, do t'i zgjidhim nesër, pas lufte”. Duke iu kundërvënë vendosjes së pushtetit popullor me kompetenca të plota për qeverisjen në Kosovë Tito i porositë "shokët" kosovarë se "nuk duhet ta krijoni komitetin provincial, për shkak se krahina nuk është një çark kompakt i veçantë (!).Ky Këshill mund të jetë vetëm iniciator, vetëm organ i unitetit politik të masave, por nuk duhet t'i japim atij karakter pushteti" (!) etj.

Derisa organet partiake jugosllave ose heshtnin, ose e përcillni punën "për nesër", populli kosovar, komunistët dhe simpatizuesit e LNÇ-së kërkonin qëndrim të prerë për fatin e shqiptarëve. Komiteti i Partisë për rrethin e Prizrenit në një letër dërguar Komitetit Krahinor, vë në dukje se simpatizuesit e LNÇ-së nuk e kuptojnë çështjen e vetëvendosjes ashtu si e shpjegojnë ata dhe thonë: ne u flasim se vetë populli do të vendosë për fatin e vet, por atyre u duket e çuditshme kjo përgjigje, sepse kërkojnë që t'u thuhet se a do t'i bashkohet Kosova Shqipërisë në kohën e pasluftës". Edhe Milladin Popoviçi, qysh në vitin 1943 i dërgoi një letër Komitetit Qendror të PKJ-së ku kërkonte që të përcaktohej përmbajtja konkrete e vetëvendosjes dhe mënyra se si të zbatohej ky parim te shqiptarët e Kosovës. "Ne kemi theksuar gjithnjë parullën e vetëvendosjes, për nesër. Në këtë mënyrë nuk ka mundur të mobilizohet populli shqiptar kundër pushtuesit". Më vonë, Milladin Popoviçi kërkon që KQ i PKJ-së të mbajë një qëndrim konkret dhe të përcaktojë formën e vetëvendosjes së shqiptarëve në Jugosllavi.

Megjithëse çështja e Kosovës ishte ende e pazgjidhur, kosovarët e vazhduan luftën, duke shpresuar që së paku pas lufte do t'i fitonin të drejtat e veta kombëtare. Lufta po intensifikohej gjithnjë e më tepër dhe nga fundi i saj formacionet luftarake ne Kosovë numëronin rreth 50 mijë luftëtarë që luftonin deri në krahinën më të largët të Jugosllavisë. Kosova, luftës i dha nja 6000 dëshmorë, por kur i shtojmë edhe ata mijëra të tjerë të vrarë nga ushtria "e re" jugosllave, ky numër shumëfishohet. Derisa brigadat kosovare luftonin anembanë Jugosllavisë, në Kosovë, gjatë vitit 1945, u vërsulën divizionet serbe, malazeze e maqedonase, që vranë dhe masakruan popullsinë shqiptare.

PAS "ÇLIRIMIT", KOSOVA PËRSËRI NË ANKAND

Derisa në Kosovë ishte vendosur sundimi i egër i administratës ushtarake jugosllave, në Beograd ishte vënë në ankand e tërë Kosova dhe krahinat e tjera shqiptare në Jugosllavi. Kujt do t'i takonin krahinat shqiptare? Ishte udhëheqja "e re" e Jugosllavisë

"socialiste" ajo që e shtronte tani këtë pyetje, që e kishin shtruar sa e sa herë ujqërit shovinistë e imperialistë.

Në Jugosllavi kishte edhe probleme të tjera të pazgjidhura, por pazarllëqet më të mëdha u bënë, si zakonisht, rreth tokave shqiptare, dhe pikërisht rreth Kosovës, pasi që krahinat e tjera, pa diskutim u ndanë mes tri republikave të sapoformuara jugosllave, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Varianti i parë që u propozua në udhëheqjen jugosllave ishte se Kosova duhej ndarë në mes tri republikave, që e rrethonin. Ndërkohë, pas një konsultimi me Titon, rrjedh vendimi se Kosova duhet ta gëzojë statusin e autonomisë në kuadër të Federatës jugosllave, por megjithatë , kjo autonomi do të ishte gjysmake, pasi Kosova duhej t'i bashkohej si njësi autonome njërës nga njësitë federale - republikave. Por, cilës republikë t'i bashkohej? Ishte pyetja tjetër që u shtrua në Beograd.

Ka pasur mendime (kuptohet te udhëheqësit jugosllavë) se Kosova duhet t'i bashkohet Malit të Zi, me arsye se kishte një traditë të lidhjes së Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi me Komitetin provincial të Malit të Zi, Bokës dhe Sanxhakut, prej vitit 1937, deri më 1940, si dhe për shkak të "mentalitetit të ngjashëm të popullit shqiptar dhe atij malazez "!

Kanë ekzistuar mendime për bashkimin e Kosovës me Maqedoninë, sepse populli shqiptar dhe ai maqedonas, sipas udhëheqjes jugosllave, janë të ngjashëm për nga numri, se në të kaluarën kanë pasur fat të ngjashëm dhe se ekziston lidhshmëria e Kosovës me Maqedoni!

Kosova, sipas disa mendimeve, duhej t'i bashkohej Serbisë. Si arsyetim u morën një 'mori "faktesh": se në Kosovë rreth 20 % ishte popullsi serbe, që synon të jetë në kuadrin e Serbisë; se Vojvodina duhej t'i takonte Serbisë për shkak të përbërjes nacionale, prandaj të dy autonomitë duhej të ishin në kuadrin e një njësie federale; se Kosova ishte më e pazhvilluara në Jugosllavi, e Serbia njësia më e madhe, kështu që do të mund të jepte "ndihmë të rëndësishme ekonomike" për zhvillimin e shpejtuar të Kosovës; sepse, "nga motivet e internacionalistëve dhe komunistëve të nacionalitetit shqiptar dhe të atij serb për bashkim me njësinë federale, kishte nevojë që me anën e një jete të përbashkët, të afrohen populli shqiptar dhe ai serb, të cilët në të kaluarën, për shkak të politikës së çarqeve sunduese kanë vepruar kundër njëri-tjetrit! Nga ana tjetër, bashkimi me Serbinë federale "ka qenë deri diku (sic!) **kompromis ndaj paragjykimeve të vjetra për Kosovën serbe me të cilat kanë qenë të ngarkuar jo vetëm disa shtresa sociale të Serbisë, por edhe një numër komunistësh dhe njerëzish udhëheqës të kësaj njësie federale**" (nënvizimi është i "Lirisë"). (Shih "Kosova" nr.2. 1973).

Kështu, në bazë të të gjitha këtyre "argumenteve" e "fakteve", në favorin e Serbisë nuk pat se si mos të fitojë propozimi i tretë që Kosova t'i bashkëngjitej Serbisë. Aneksimi arbitrar i Kosovës, i vendosur nga çarqet e larta udhëheqëse të partisë dhe të shtetit jugosllav, ishte plotësim i aspiratave shoviniste serbomëdha. Vetë A. Rankoviçi, i cili ishte edhe autori kryesor i këtij aneksimi, në prill të vitit 1945, deklaronte me mburrje se "ky aneksim është përgjigja më e mirë për ata që trumbetojnë rrezikun e copëtimit të tokave serbe, që akuzojnë LNÇ sikur do f i dobësojë serbët për llogari të kroatëve e të tjerëve".

Aneksimi dhe shitja e Kosovës te shovinistët serbë ishte edhe një vepër e një grushti tradhtarësh të Kosovës, si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Ali Shukrija etj., të cilët, ashtu si Koçi Xoxe me shokë ishin vënë në shërbim të plotë të klikës Tito-Rankoviç.

Populli i Kosovës, gjatë pranverës së vitit 1945 nuk dinte se ç'po bëhej me fatin e tij në Beograd. Në prill të këtij vitit D. Mugosha, që atëherë ishte sekretar i Komitetit Krahinor të Partisë, shprehë " dëshirën" e Këshillit Nacionaçlirimtar për Kosovë dhe

Metohi, që edhe "ne, popujt e Kosovës dhe Metohisë t'i aneksohemi Serbisë federative motër". Kjo deklaratë e një shovinisti të tërbuar në Mbledhjen e Këshillit Antifashist të Serbisë më vonë u bë "shprehje e vullnetit të lirë dhe e vetëvendosjes së popujve të Kosovës". Më 9 prill 1945, gazeta "Barba" njoftonte se "Mbledhja e Këshillit Antifashist të popullit të Serbisë pranoi dëshirën e popullit të Kosovë e Metohisë për bashkim me Serbinë federale". Mirëpo kjo gazetë, duke harruar se ç' tha një herë botoi më 30 qershor 1945 vazhdimin e fjalës së Dushan Mugoshës, ku ky zbulonte se Kosova nuk kishte bërë asnjë kërkesë dhe nuk kishte marrë asnjë vendim në kuvendin tonë sepse në Kosovë e Metohi vepron pushteti ushtarak. Në rastin e parë, sapo të hiqet pushteti ushtarak në Kosovë e Metohi, ne do të vendosim në kuvendin tonë ti aneksohemi Serbisë federative"..

Kështu, pra, siç shihet, për Kosovën më parë u vendos në Beograd. Por, çka mbeti të mbetet në Kosovë?

Në bazë të dallavereve nga më të ndryshmet, nga të cilat ishte vendosur që Kosova të mbetej nën Serbi u bë edhe Konferenca e Dytë e Këshillit Antifashist të Kosovë e Metohisë rreth përcaktimit të fatit të Kosovës, vetëm sa për t'i bërë "amini" asaj që ishte vendosur në Beograd. Dhe populli ynë e di mirë se në çfarë rrethanash u zhvillua kjo konferencë, (Konferenca e Prizrenit), ku delegatët hapur u kërcënuan nga njerëzit e OZNA-s se, po të mos deklarohen "pro", nuk do të kthehen më në shtëpitë e tyre dhe, vërtetë shumë delegatë që votuan kundër vendimeve të Beogradit, nuk u kthyen më kurrë nga andej. Vendimi "historik" i kësaj konference propagandohet sot nga tradhtarët si "shprehje e vullnetit dhe e dëshirës së popullit të Kosovës që ta lidhë fatin e vetë me Serbinë dhe në kuadër të saj - me Jugosllavinë"!

Nga të gjitha që u thanë dhe u vendosën për Kosovën, asnjëherë nuk doli në shesh, arsyeja, nuk u fol për të drejtën e popullit të Kosovës për të vetëvendosur për fatin e tij, që Kosova kishte të drejtë edhe të shkëputej, edhe të mbetej në kuadër të Federatës jugosllave, me të drejta të barabarta me popujt e tjerë të kësaj Federate.

Këto të drejta ia presupozonte popullit tonë gjaku i mijëra dëshmorëve i derdhur para dhe gjatë LNÇ-së, ia garantonte marksizëm-leninizmi, ia premtonte edhe vetë udhëheqja e PKJ -së. Sa për krahinat tjera shqiptare jashtë Kosovës në udhëheqjen jugosllave as që u fol, por, arbitrarisht u vendos që ato të ndahen në mes tri republikave jugosllave. Edhe vetë Kosova pothuajse nuk fitoi gjë; ajo mbeti një "oblast" i Republikës së Serbisë dhe asgjë më tepër.

KËRKESA PËR REPUBLIKË ËSHTË E DREJTË DHE DO TË TRIUMFOJË!

Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi me shekuj ka luftuar për lirinë e tij, për të drejtat që i takonin. Nga këto aspirata ai nuk hoqi dorë kurrë pa marrë parasysh se me kë kishte të bënte. Edhe pas Luftës Nacionalçlirimtare, populli ynë nuk u mashtrua me regjimin e ri, që ishte po aq i egër e i urryer sa edhe ai i Pashiçit, por e vazhdoi luftën për të drejtat e tij, pra edhe për të drejtën e vetëvendosjes. Pa marrë parasysh kushtet e rënda të sundimit revizionist, si dhuna dhe terrori, dëbimi i dhunshëm, prapambetja e theksuar ekonomike, prapambetja arsimore e kulturore, populli shqiptar asnjëherë nuk pushoi së kërkuari të drejtat e tij të ligjshme, statusin e Republikës në kuadër të Jugosllavisë etj.

Çështja e statusit të Republikës u shtrua sidomos në vitin 1968, me rastin e përgatitjeve të disa amandamenteve të Kushtetutës së Jugosllavisë. Përveçse në shumë

tubime, këtë kërkesë ia paraqiti Titos edhe një delegacion krahinor. Por Tito refuzoi t'i përgjigjej një kërkese të tillë, duke u arsyetuar se "republika nuk është faktor i vetëm i cili i zgjidhë të gjitha problemet" ("Rilindja", 4. XI. 1968). Ishte e qartë se udhëheqja jugosllave nuk kishte ndërmend të përgjigjej në kërkesën e kosovarëve. Prandaj, në nëntor të vitit 1968 shpërthyen demonstratat e mëdha të rinisë dhe popullit. Demonstruesit, pos të drejtës për vetëvendosje, kërkuan edhe njohjen e statusit të Republikës, barazinë e përdorimit të gjuhës shqipe me ate serbokroate, hapjen e Universitetit të Kosovës etj. Demonstratat u shuan me gjak nga forcat policore. Por, pas tyre, udhëheqja jugosllave u detyrua të plotësonte disa nga kërkesat, si lejimin e përdorimit të Flamurit Kombëtar, barazinë e gjuhëve, hapjen e Universitetit, por kërkesa për Republikë nuk u pranua, veçse, si satisfaksion, u forcua statusi i autonomisë dhe, nga një "oblast", Kosova u shndërrua në një Krahinë Autonome dhe u bë element konstituiv i Federatës.

Kosova fitoi "autonominë", por, megjithatë, ajo mbeti një koloni e thjeshtë e Serbisë dhe e republikave të tjera, kurse pozita e shqiptarëve në republikat e tjera pothuajse nuk ndryshoi fare. Mbi popullin tonë vazhduan shtypja dhe shfrytëzimi i egër kapitalist e kolonial.

Miliona e miliarda tonelata xehe plumbi, zinku, ari e argjendi që ka nëntoka e pasur kosovare, drejtohet në Serbi dhe në republika të tjera jugosllave, ose marrin rrugën e kontinenteve. Se ç bëhet me xehen gjysmë të përpunuar të "Trepçës" tashmë po e dinë si minatorët e këtij gjiganti, ashtu edhe populli i Kosovës; se ajo merret me çmim shumë të ulët se sa çmimi ekonomik dhe ai ndërkombëtar, se shkon si xehe gjysmë e përpunuar se shkon për t'i mbuluar borxhet e shumta të regjimit jugosllav te kapitalistët ndërkombëtar etj. Rrugë të njëjtë ndjek edhe thëngjilli (ari i zi i Kosovës), rryma elektrike, bereqeti i arave tona, mishi i bagëtisë sonë,.. Një trajtim i tillë ka bërë që Kosova, edh pse është më e pasura me begatitë natyrore, të jetë të vërtetë krahina më e varfër dhe më e pazhvilluar në Federatën jugosllave!

Populli shqiptar në Jugosllavi dhe rinia e tij heroike, nuk janë pajtuar dhe nuk pajtohen kurrë me një pozitë dhe trajtim të tillë të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. Prandaj, ai nuk e ka pushuar asnjëherë luftën e tij për të drejta e liri. Kjo është edhe arsyeja që populli ynë, i bashkuar si një trup i vetëm, gjatë pranverës që shkoi , vërshoi rrugëve të qyteteve dhe të fshatrave të Kosovës duke brohoritur: 'Kosova është jona! "Trepça është jona! ", "Kosova-kosovarëve! ", 'Mjaft më shtypje e shfrytëzim! " "Kosova Republikë! ", 'Republikë, Republikë ". Me këto parulla në gojë populli ynë u përlesh heroikisht me kordonë policësh serbë, u përlesh me ushtrinë fashiste të Jugosllavisë e me tanket e tyre.

Kërkesa e popullit shqiptar në Jugosllavi për vetëvendosje e Republikë, është e drejtë dhe krejt e ligjshme. Për këtë të drejtë populli ynë ka luftuar shekuj me radhë, për të lufton edhe sot dhe do të luftojë pa marrë parasysh asnjë sakrificë, deri në realizimin e saj të plotë, derisa ai të bëhet zot i tokës dhe fatit të tij.

Kosova dhe tokat tjera shqiptare në Jugosllavi janë të atyre që jetojnë në to, dhe vetëm ata kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre! (LIRIA, gusht 1981, faqe 8-12)

4-5-4. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ

Nga Jusuf Gërvalla

Çdo pushtues, për të bërë zap popullsinë e pushtuar, rekruton në organet e pushtetit të vet një numër vendësish, të cilët bëhen përçues të politikës, të ideologjisë dhe të urdhrave të atij pushteti.

Nga viti 1912, kur tokat shqiptare në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe ato në Serbinë e sotme të ngushtë iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar dhe hynë nën zgjedhën e egër serbomalazeze, në shërbim të pushtetit të huaj hynë edhe njerëz nga radhët e popullsisë vendëse shqiptare, që nga "poverenikët" më të thjeshtë e deri te deputetët në parlament.

Përfaqësues tipikë të indigjenëve të rekrutuar në aparatin shtetëror të pushtuesve jugosllavë ishin dikur Dragajt e Mitrovicës, Begollët e Pejës, Kryezitë e Gjakovës etj., dhe më pastaj, në aparatin revizionist titist- Fadilj Hodzët, Dzavid Nimanët, Mahmud Bakalët etj.

Në kohën e Jugosllavisë së vjetër kishte ndodhur që populli shqiptar, duke u nisur nga të drejtat formale që garantonte kushtetuta e atëhershme, bënte edhe përpjekje për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organet e pushtetit (rasti i Zef Lush Markut, Lufta e Baranit e 1937-ës) dhe, për ta realizuar këtë të drejtë, ishte përgjakur sa e sa herë me pushtetin shovinist. Ndërkaq, në Jugosllavinë e Titos, pushteti e ka kursyer popullin; ai është kujdesur vetë për njerëzit që do të zgjidhen në organet shtetërore. "Poverenikët" dhe deputetët shqiptarë në "parlamentin" titist i gjejmë në një pozitë më të mirë se ata në Jugosllavinë mbretërore; këta s'kanë nevojë as të luajnë veshin për të bërë çka don për popullin në mënyrë që të fitojë simpatinë e tij. Mjafton që t'u përgjigjen kërkesave të pushtuesit dhe e kanë të siguruar kolltukun e butë. Vullneti i popullit përjashtohet fare, sepse, në vendet udhëheqëse (qoftë edhe për një drejtor të thjeshtë) funksionarët nuk zgjidhen , por emërohen nga forumet e larta lokale dhe qendrore. Pasi t'i ketë zgjedhur për qejfi, pushteti i quan këta njerëz – përfaqësues të popullit. Po edhe populli, logjikisht, ata i quan – tradhtarë të popullit. Sepse, sipas praktikës së deritanishme, është dashur të japësh provime të shumta të gatishmërisë për të bërë politikë antishqiptare, ani pastaj të të emërojë pushteti në ndonjë organ lokal apo qendror.

S'ka tjetër emër për këta sahanlëpirës që i shërbyen me besnikërinë e qenit, jo popullit, nga gjiri i të cilit kanë dalë, po regjimit të egër antipopullor e antishqiptar, te i cili janë shitur badihava. Ata u bënë thjeshtë një vegël e verbër në realizimin e politikës shoviniste dhe të gjenocidit mbi shqiptarët.

Me pajtimin e plotë të këtyre tradhtarëve u masakrua, më 1945, popullsia shqiptare në Drenicë e Gjilan, në Tetovë e gjetkë. Me heshtjen e tyre aprovuese u likuiduan dhjetëra mijëra partizanë shqiptarë në Tivar, në Srem e Slloveni, ku kishin vajtur për t'u dalë në ndihmë popujve fqinjë jugosllavë në dëbimin e çizmes fashiste. "Poverenikët" dhe funksionarët titistë ishin kokë e këmbë të pranishëm kur u shkel me të dy këmbët vullneti i popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, i shprehur në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, më 1943, e cila shqiptarëve u garantonte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, e që ishte aspiratë e natyrshme shekullore e popullit tonë të martirizuar. Në vend që të viheshin me guxim në ballë të popullit tonë të shkretë e të dërmuar luftërash, masakrimesh e skamjeje, t'i prinin atij në rrugën e mëtejshme të çlirimit kombëtar dhe klasor (kur Jugosllavia shkeli të drejtat e premtuara, për të cilat populli ynë pat derdhur pa kursim gjakun e bijve

të vet të shtrenjtë), tradhtarët Fadilj Hodza e Dzavid Nimani me shokë, parapëlqyen qyqarinë dhe pajtimin në heshtje me të gjitha të zezat që kishte përgatitur për shqiptarët klika titiste. Ata ishin këtu edhe kur zbriti dhe u shkel për më se 20 vjet flamuri shqiptar. (të verbrit: Pse edhe ata nuk kërkuan të ndaloheshin flamujt e kombeve të tjera në Jugosllavi – në emër të "internacionalizmit proletar" – siç bënë jugosllavët me shkabën tonë dykrenare?!) Ata nuk paraqitën kundërshtimin më të vogël as më 1947, ku u zbrazën drithnikët e Kosovës dhe populli ynë i uritur u detyrua të ushqehej me barishte, se kopallat e demagogjitë revizioniste nuk jepnin bukë. Për më tepër, tradhtari Xhevdet Hamza u ndodh në krye të detyrës për realizimin e aksionit famëkeq të armëve, më 1956, kur populli shqiptar u masakrua, kur dinjiteti i popullit tonë u kërcënua të ulej deri në baltë nga zullumet e gjakpirësve titistë-rankoviçistë. Qyqarinë e tyre nuk e preku as vajtimi i djepeve shqiptare, loti i nënave as malli i burrave shqiptarë, që u dëbuan nga vatrat stërgjyshore dhe morën në sy shkretëtirat e Anadollit. Tradhtarët ishin gjithnjë këtu, të pranishëm kudo, si biberi në tavë dhe bënin jetën e tyre të rehatshme në kushtet e "vëllazërim-bashkimit" të xhelatit me viktimën. Dhe për këtë merrnin shpërblim racionin e turpshëm prej sahanlëpirësish; së pari në triska të majme për ushqim e veshmbathje, pastaj në shtëpi të mëdha e apartamente, e më pastaj në vila e vetura.

Kur krimet individuale e masive të ushtruara nga klika titiste mbi popullin tonë, s'e prekën dot atë lëkurë bualli-mamuth të renegatëve shqiptarë, marrëzia më e madhe është të pritësh prej tyre që të preken nga pabarazitë ekonomike, shoqërore e kulturore nën regjimin titist. Në qoftë se të ardhurat kombëtare në Kosovë janë gjashtë herë më të vogla se ato në Slloveni, kurse zhvillimi i Kosovës bëhet me një ritëm 106 për qind në zotimet e jugosllavëve, në qoftë se papunësia te ne është njëzet herë më e madhe se ajo në Slloveni dhe krahu i lirë i punës derdhet varë-darë nga Kosova nëpër republikat e Jugosllavisë dhe në shtetet Perëndimore. Në qoftë se në Kosovë punohet në zhvillimin e një industrie nxjerrëse, që e pasuron Beogradin dhe jo të një industrie përpunuese – që do të pasuronte Kosovën, nëse fshatarësia kosovare është varfëruar deri në kufirin e zisë së bukës dhe rënkon në kushtet e një jete asociale, në qoftë se gruaja shqiptare ka mbetur edhe në fund të shekullit XX në errësirën mesjetare, e diskriminuar nga aspekti shoqëror dhe familjar, në qoftë se, më në fund, ky mjerim përjetohet në përmasa të shumëfishuara në viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, ç'kanë të bëjnë të gjitha këto me renegatët shqiptarë!!! Ata e kanë kolltukun e tyre, kanë pallatet dhe veturat, kanë rrogat e tyre të majme, si gjithë funksionarët dhe borgjezia jugosllave. Dhe, mbi të gjitha – nëse popullit i ka ardhur shpirti në fyt dhe ngre zërin e tij të fuqishëm për të kërkuar bukë, të drejta e liri, kushte të njëjta a të përafërta me popujt e tjerë të mozaikut jugosllav, me të cilët e lidhin "vëllazërimi" e "bashkimi" – tradhtarët e kanë në dorë milicinë dhe ushtrinë. Natyrisht, jo për të për të përkrahur interesat e kërkesat e popullit, po për t'i shtypur në gjak ato. Dhe, kur të mos u mjaftojnë milicia e ushtria e stacionuar në tokat shqiptare të robëruara, ata mund ta thërrasin edhe milicinë dhe ushtrinë e Beogradit. E dinë se, për të bërë zap shqiptarët, Beogradi nuk kursen ushtri as milici. Tanke as avionë. Helikopterë as municion.

Kjo gjë, ç'është e vërteta, dihej mirëfilli. Ishte parë në ngjarjet e 1945-ës e në ato të 1968-ës. U pa edhe në tragjedinë më të re të Kosovës, në mars e prill.

Por, nuk dihej një gjë tjetër. Megjithë besnikërinë e tyre të pashoqe ndaj Beogradit, tradhtarët shqiptarë si Dzavid e Mahmudi, a e meritonin ata që Beogradi t'i nxirrte në rrugën e madhe? Dyzet vjet luftë antishqiptare të shkurtabiqit-bullafiq Dzavid Nimani nuk i siguruan atij as një pensionim të rehatshëm nga gospodari! Si qen i zgjebosur e i shogur i stanit, të cilit i janë rralluar të lehurat dhe i është dobësuar nuhatja, ai u detyrua të lërë stanin e kaçorren, të lërë koritën dhe qullin e përbashkët me qentë e tjerë të gospodarit. Ç'mund të bënte për Beogradin më shumë seç ka bërë, i shkreti

Dzavid! Stazhi më se 10 vjeçar i shërbimit të Mahmudit qe vërtet më i shkurtër, po ky ishte një qen me dresurë dhe shërbimi i tij – shumë më intensiv e efektiv. Megjithatë, edhe Mahmudin e hodhi në shportë Beogradi si lëvoren e limonit të shtrydhur.

Po pse?

Edhe budalla e di se ajo që kërkon aktualisht prej tyre Beogradi, nuk është më fare në mundësinë e tyre. Populli i robëruar shqiptar kishte nevojë të madhe t'ia qanin hallet e t'ia mjekonin plagët e mëdha, që ishin pezmatuar sa s'bën më. Kurse Beogradi kërkon që renegatët shqiptarë t'i flasin këtij populli ashtu si i kanë folur qe 40 vjet, me demagogji, frikësime e shantazhe, Kërkon që ata të injektojnë edhe më në popullin shqiptar po ato mendime që kanë Beogradi, Mahmudi e Fadilji. Por, kjo është e kotë. Aq e kotë , sa do të kish qenë e kotë sikur shqiptarët të kërkonin nga Beogradi që ky t'ua japë falas ato të drejta e liri, të cilat s'fitohen veçse me luftë këmbëngulëse e me gjak.

Duhet të jesh i verbër fare nëse nuk sheh se s'qitet më në krye me shqiptarin. Ka ndodhur diçka e re me të. Ai gjithmonë e ka urryer regjimin antipopullor jugosllav, i cili mban nën thundrën e vet të përgjakshme edhe popujt e tjerë të këtij mozaiku artificial, por dëmton veçanërisht shqiptarin. Po sot kjo urrejtje ka dalë haptazi dhe është bërë mur i pakapërcyeshëm për pushtuesin dhe tradhtarët e vendit. Në ngjarjet e marsit e të prillit, populli ynë tha njëherë dhe përfundimisht: Jo! Kjo i kushtoi gjak. Ndërmjet nesh dhe qeverisë së Beogradit tani ka hyrë gjaku i bijve të shtrenjtë të popullit tonë. Dhe ky gjak është ai që i fshin të gjitha perspektivat e kthimit në gjendjen e mëparshme. Beogradi kërcënohet haptazi me gjakderdhje të re. Por s'i bën dobi. "Zemra jonë ka gjak sa gurra". Dhe mbi gjakun e derdhur forcohen edhe më shumë themelet e vetëdijes kombëtare e klasore të shqiptarit të robëruar. Ndjenja e fuqishme e lirisë e ka bashkuar popullin tonë trim si një trup të vetëm. Me tanket e aeroplanët, me helikopterët e mitralozët, me ushtrinë e milicinë speciale, Beogradi s'bëri gjë tjetër pos që dogji etapat e luftës sonë të pashmangshme dhe na ndihmoi shumë në afrimin sa më të shpejtë kah dita e fitores së sigurt.

E di mirë Beogradi se nuk gjendet dot ilaç për ta shëruar te populli ynë kujtimin e vrasjeve e të plagosjeve, as akullin e burgjeve të kësaj pranvere.

Por, këtë sikur nuk po e dinë ca tradhtarë të rinj që pushteti i ka futur në lojë si kartën e fundit. Kryesia e Serbisë e pat thënë që në fillim të prillit se disa udhëheqës vasalë kosovarë si Fadilji, Dzavidi e Mahmudi "janë të pjekur për t'u larguar nga skena politike". Kjo i gjeti tashmë Dzavidin e Mahmudin, pritet të gjejë edhe Fadiljin. Nga ana tjetër, kur populli shqiptar shtroi çështjen e republikës së federuar të Kosovës, ishte e vetëkuptueshme që, kur të shpallej republika, nga postet e tyre duhej të binin dhe të merrnin nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës e kriminelë kosovarë e jugosllavë, që aprovuan apo urdhëruan gjakderdhjen në Kosovë. (Si mund të jetojë shqiptari nën shkopin dirigjues të atij që i vrau, i plagosi e i burgosi bijtë më të shtrenjtë?) Tani plaga po pezmatohet gjithnjë e më shumë, sepse Beogradi, i vetëdijshëm për krimet e deritanishme dhe për rrugën e krimeve më të mëdha që ka ndër mend, emëroi në vende kyçe të pushtetit krahinor renegatë të rinj shqiptarë me kondicion edhe më të madh për tradhti të reja. Garnitura e vjetër e tradhtarëve të urryer u zëvendësua këmbadoras me një garniturë findo të re tradhtarësh që çirren si të flamosur, duke pandehur se do ta frikësojnë e ta përulin një popull që kurrë s'është përulur, e përulet aq më pak sot që ka vendosur të luftojë pa u zmbrapsur për të drejtat dhe liritë e veta.

Tash që s'ka bukë, dhe shteti ka hartuar plane për një "otkup" të ri, këta renegatë të rinj thërresin: "Mirëqenia", "Begatia"! Kur populli kërkon me të drejtë, republikën që e kanë të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, ata thërresin: "E kemi republikën – Serbinë". Kur begatitë tona plaçkiten pa mëshirë dhe marrin rrugën e Beogradit, ata thërresin: "Vëllazërim-bashkim"!. Kur ushtria e milicia fashiste mbulojnë në gjak Kosovën, duke

shkelur mbi popullsinë e pambrojtur, ata çirren: “Të distancohemi nga nacionalistët, shovinistët, reaksionarët e kundërrevolucionarët shqiptarë, që duan të rrezikojnë revolucionin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë”! Me një fjalë, ata thërresin si qyqarët më të mëdhenj të kësaj bote për një nënshtrim akoma më të madh të popullit tonë, për t’u pajtuar me humbjen edhe atyre pak të drejtave formale që kishin deri më tash në Serbinë. Ata e thërresin kështu popullin shqiptar që ky, me sy në ballë, t’ia hapë vetvetes me duart e veta varrin e sigurt.

Ku e shohin vallë perspektivën këta renegatë të rinj? Ata s’e kanë as përvojën e paraardhësve të tyre, e kushtet kur u ngjitën në skenë janë pakrahasueshëm më të ndërlikuara se ato kur mbretëronin renegatët e vjetër. . Për pushtuesit jugosllavë, shërbime më të mëdha se Fadilji, Dzavidi e Mahmudi nuk mund që nuk mund të bëjnë. Kurse populli shqiptar jo vetëm nuk po frikësohet nga shantazhet e tyre, po përditë po i konsolidon më shumë radhët e veta, po e forcon frontin e luftës e të hakmarrjes së madhe popullore.

U mbetet një mundësi e vetme tradhtarëve të çirren e të përpëliten si peshku në zall, e kur t’i shtrydhë deri në fund pushtuesi e t’i hedhë në rrugë, atje t’i presë dora hakmarrëse e popullit.

Të mjerët tradhtarë, ç’po u përgatit populli! (Liria" nr.4-5 gusht 1981, faqe 12 dhe 17)

(Shënim i Xhafer Durmishit: Në librin e Mehmet Hajrizit, HISTORI E NJË ORGANIZATE POLITIKE dhe DEMONSTRATAT E VITIT 1981, Tiranë 2008, në faqe 130, si autor i këtij artikulli figuron emri i Mehmet Hajrizit. Por ai figurim nuk e paraqet të vërtetën. Pra artikulli *Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj*, është i Jusuf Gërvallës dhe askujt tjetër.)

Jusuf Gërvalla: *"Mendoj se ky numër duhet të përmbajë një fjalë hyrëse të redaksisë. Që të mos na përvidhet ndonjë lëshim, mendoj se këtë fjalë, së paku në pika të shkurta, duhet ta përpilosh ti me shokët dhe pastaj të më tregoni edhe autorizimet e mia lidhur me të, përkatësisht në ç’shkallë mund të intervenoj unë në të.*

Tash për tash, unë kam parashikuar, globalisht, këto tema:

1) kryeartikulli. Në pika të shkurtra të përfshihen kushtet objektive që u paraprinë ngjarjeve të Kosovës. Vetë ngjarjet e Kosovës nga aspekte të ndryshme. ...

4) ***Renegatët e vjetër dhe renegatët e rinj*** (Është fjala për artikullin që u botua në revistën Liria, nr. 4-5, gusht 1981 me titull "Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj" - shën. i Xhafer Durmishit)

... Nuk mund të them gjë prerazi lidhur me afatin kur mund të kryhet nga ana ime puna e daljes së gazetës, por shpresoj se nuk do të më marrë më shumë se 20 ditë."
(Letër Sabri Novosellës, 21 korrik 1981)

Shoku Enver Hoxha për Kosovën

4-5-5. JUGOSLLAVËT TË VRASIN NATËN E TË QAJNË DITËN

Në Konferencë iu dha fjala edhe Bllazho Jovanoviçit, të deleguarit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ai tha se sillte përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, të të gjithë popujve të Jugosllavisë, që luftonin kundër okupatorëve, sillte solidaritetin e tyre me Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe me luftën

heroike të popullit tonë. Ai, gjithashtu, shprehu gëzimin për njohjen e Partisë sonë nga Kominterni.

Bllazho Jovanoviçi në fjalimin e tij përshëndeti luftën dhe sukseset e Partisë sonë. Ai çmoi luftën që kishte bërë Partia jonë kundër elementëve grupashë, i theksoi këta si të rrezikshëm për unitetin e Partisë dhe pastaj tregoi shkurtimisht eksperiencën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në zhvillimin e luftës dhe në organizimin e saj.

Në Konferencë e mori, gjithashtu, fjalën edhe shoku ynë i shtrenjtë, internacionalisti jugosllav, Miladin Popoviçi. Diskutimi që bëri në Konferencën e Parë të Vendit ishte i pjekur dhe mendimet e tij ishin të drejta. Me vlerësimin e lartë që i bëri në Konferencë punës së Partisë sonë, ashtu si edhe më parë e më pas, ai e tregoi veten se qe një komunist i vërtetë internacionalist, një mik i dashur e i sinqertë i Partisë e i popullit tonë.

Midis të tjerash, në mendje më ka mbetur edhe një moment tjetër gjatë Konferencës që tregon më së miri se kush qe Miladin Popoviçi. Në përshëndetjen e tij Bllazho Jovanoviçi, pasi vlerësoi punën dhe veprimtarinë e Partisë sonë Komuniste, foli edhe për Miladinin e Dushan Mugoshën dhe në njëfarë mënyrë bëri aluzion se këta ishin «krijuesit» (!) e Partisë sonë. Miladini, si internacionalist, duke qenë kundër pikëpamjeve të tilla, në ndërhyrjen e tij, theksoi:

- Askujt nuk duhet t'i shkojë ndër mend se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kemi krijuar ne, dy të dërguar të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Jo, e vërteta është se Partinë Komuniste të Shqipërisë e krijuat vetë ju, komunistët shqiptarë dhe, nëse duhet folur për rolin tim, ose të çdokujt tjetër të jashtëm ky rol s'është gjë tjetër veçse ajo që në marrëdhëniet midis partive motra quhet ndihmë e përkrahje internacionaliste, vëllazërore. Partinë tuaj Komuniste ju do ta krijonit siç e krijuat, edhe sikur të mos vinim ne këtu.

I tillë qe Miladin Popoviçi prandaj ne e nderonim dhe e respektonim atë për cilësitë e tij të larta dhe për mirëkuptimin që arrinim, kur bisedonim për njërin apo për tjetrin problem. Siç thashë, në ato vite, ne qemë njohur edhe me Dushan Mugoshën dhe në prag e gjatë punimeve të Konferencës, edhe me Bllazho Jovanoviçin. Dushani qëndroi në Shqipëri pothuaj deri në prag të Çlirimit, por nuk i afrohej Miladinit as nga kapaciteti, as nga kultura, as nga bonsensi e thellësia e mendimit dhe as nga karakteri. Miladini ishte i çiltër, i dashur me shokë, i rreptë me armiqtë, njeri me kulturë e me horizont të gjerë, komunist nga zemra e nga botëkuptimi, kurse Dushani, pa ia mohuar që ishte trim e punëtor, ishte i ngushtë, sektar, i përciptë, i nxituar dhe që me intrigat e tij, çorientoi e dëmtoi shumë organizata e kuadro. Por fytyrën e tij të ndyrë prej shovinisti e titisti, të një agjenti të ulët të Rankoviçit e armiku të betuar kundër shqiptarëve të Kosovës, ai e tregoi më mirë kur Partia Bolshevike e Stalini i madh dhe, pas saj, Partia jonë demaskuan klikën trockiste të Titos.

Gjatë ditëve që ishte në Shqipëri, siç thashë, ne njohëm edhe Bllazho Jovanoviçin.

Në një nga bisedat që patëm me të ky «shfaqi mendimin» se në ndonjë rast Partia jonë kishte rënë në «sektarizëm» (e kishte fjalën për konsiderimin e gabuar të ndonjë çete partizane si «çeta e partisë», gjë që ne vetë e kishim kritikuar qysh më parë dhe e kritikuam edhe në Konferencë); gjithashtu, siç përmenda më lart, në Konferencë, «lëshoi» për herë të parë aluzionin se Partinë tonë e kishin krijuar jugosllavët.

Ne ia kundërshtuam me forcë Bllazho Jovanoviçit thëniet e tij, argumentuam se si qëndronte e vërteta mbi të ashtuquajturat çeta të partisë dhe u duk se ky ra dakord me ne. Më pas, mbaj mend që as unë, as Miladini nuk patëm me të ndonjë fërkim a mosmarrëveshje, ai qëndroi brenda funksioneve të tij, bile megjithëse ishte anëtar i KQ të PK të Jugosllavisë, ai dëgjonte me vëmendje bisedat, argumentet, raportimet etj., të Miladinit se e shihte që ky e njihte mirë gjendjen e Partisë e të luftës në Shqipëri dhe, siç thashë, në përshëndetjen që i bëri Konferencës së Parë të Vendit, vlerësoi lart realizimet

që ishin arritur nga Partia jonë e re, si në ngritjen e forcimin e saj, ashtu dhe në zhvillimin e luftës antifashiste të popullit shqiptar.

Është e çuditshme se si pak kohë pas Konferencës së Parë të Vendit erdhi S. V. Tempoja, dhe, me një arrogancë e prepotencë të paparë, deshi të hidhte poshtë gjithë vijën e Partisë sonë. Si duket, udhëheqja e PKJ nuk ishte kënaqur ngaqë Bllazho Jovanoviçi nuk mundi ta kryejë si deshën ata rolin që i kishin ngarkuar, prandaj dërguan Tempon me «vërejtje» e «kritikë», me plane për «Shtabin ballkanik», për të futur në një thes «federativ» Shqipërinë, Bullgarinë e Greqinë. Vërejtjet e propozimet e tij absurde e arrogante nuk mund t'i pranonim dhe u grindëm e u ndamë keq me të si unë dhe Miladini. Që në këtë kohë ai përpunoi Koçi Xoxen dhe e nxiti për prapaskena kundër udhëheqjes së shëndoshë të Partisë sonë, por Tempoja s'kishte kohë të ndalej shumë në Shqipëri, se kishte plane «të mëdha» dhe me komunistët grekë e bullgarë.

Pikërisht në këtë periudhë nisi të shfaqej konflikti i ashpër midis nesh dhe udhëheqjes së PKJ e që më pas erdhi gjithnjë duke u acaruar. Ky konflikt në fillim dukej sikur shkaktohej nga personat e dërguar, siç qe rasti i Tempos në verën e 1943-së apo i Velimir Stojniçit e Nijaz Dizdareviçit në verën e vjeshtën e 1944-ës, por koha do të vërtetonte se rrënjët dhe synimet e konfliktit ishin shumë më të thella, të paramenduara prej kohësh e tepër armiqësore. Lufta jonë e vazhdueshme me elementët që përmenda më lart si dhe me pjesëtarët e tjerë të klanit të tyre, si Dushan Mugosha, Velimir Stojniçi, Nijaz Dizdareviçi, Josip Gjergja, Boris Kidriçi, Savo Zllatiçi, Sergei Kraiger, gjenerali Kupreshanin, Serzhentiçi e të tjerë, të cilët gjatë viteve të luftës, por edhe pas Çlirimit erdhën në Shqipëri të dërguar nga KQ i PKJ, na bindi se konflikti që shpërtheu mes nesh nuk vinte nga «gabime» të njërit apo të tjetrit të dërguar, por e kishte burimin e vërtetë te vija dhe te synimet antimarksiste e antishqiptare të vetë udhëheqjes jugosllave me në krye Titon.

Në dokumente të shumta të Partisë sonë e në mjaft shkrime të miat janë pasqyruar gjerësisht qëndrimet e drejta dhe lufta jonë e ashpër dhe parimore me të dërguarit e Titos në Shqipëri (për të gjithë këta kam hedhur në letër, gjithashtu, një cikël kujtimesh), por këtu, meqë është rasti, dëshiroj të ritheksoj dy-tri momente:

Ashtu si Miladin Popoviçin edhe të dërguarit e tjerë të Jugosllavisë, që erdhën në Shqipëri në vitet e rënda të luftës (bile edhe në vitet e para pas luftës), ne i kemi pritur kurdoherë me zemër të hapur, pa prapamendime; i kemi pritur si komunistë, si vëllezër idealesh dhe nga ana jonë kemi bërë gjithçka që t'i respektonim si të tillë e të na respektonin si të tillë. Ardhjen e tyre në Shqipëri ne e çmonim si një ndihmë e përkrahje internacionaliste që na jepte një parti motër, anëtare e Kominternit, dhe jo si një ndihmë që na e jepte ky apo ai person i veçantë, qoftë ky edhe Titoja. Atëherë ne qemë të rinj, shumë gjëra edhe s'i dinim, por ama, si komunistë, ne e dinim mirë se çështjet më kardinale, më thelbësore të Shqipërisë na takonte t'i zgjidhnim e t'i vendosnim vetë ne e, me luftë e përpjekje, me mund e sakrifica, i zgjidhëm e i vendosëm vetë ne, komunistët shqiptarë. Por edhe eksperiencën e një partie motër qemë të gatshëm ta pranonim me gjithë zemër.

Për problemet e ndryshme të punës e të ndërtimit të Partisë ne kishim një mendim tonin, kishim një përvojë të fituar nga studimi i literaturës marksiste, përvojën sado fillestare të kohës së grupeve etj. Por me vëmendje e respekt dëgjonim edhe fjalën e miqve, në rastin konkret të të dërguarve të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Kur ajo që na thoshin ata na dukej me vend, ne e aprovonim dhe për këtë s'kishte si të mos i falënderonim.

Kur jeta, praktika e justifikonte atë që na kishin sugjeruar ata, ne, si komunistë e si shqiptarë nuk e kursenim shprehjen e mirënjohjes më të thellë. Por kur jeta nuk e justifikonte atë që na thoshin, atëherë ne vetë vendosnim dhe gjenim një formë apo një

rrugë më të përshtatshme. Gjer këtu s'kishte asnjë të keqe. As ne s'kishte pse të zemëroheshim me miqtë, por as ata s'kishte pse të zemëroheshin me ne, meqë s'doli e tyrja. Në procesin e luftës e të punës të tilla fenomene s'ka si të mos ndodhin. Mjaft që gjithçka të jetë e sinqertë dhe e ndershme, mjaft që gjithçka të jetë thënë apo sugjeruar me pastërti komuniste, me synimin për të mirën e çështjes. Kështu e shihnim ne, komunistët shqiptarë, eksperiencën që na jepnin të dërguarit e PKJ, dhe pikërisht se e shihnim kështu, prandaj dhe i çmonim ata, i nderonim, e në shumë raste u jepnim më tepër, bile shumë më tepër se ç'u takonte. Si komunistë mendonim se dashuria, shpesh e tepruar, që u shfaqnim miqve, nuk sillte ndonjë të keqe midis komunistësh vëllezër; si shqiptarë kështu na thoshte të vepronim tradita e lashtë e nderimit të mikut që të ka ardhur në vatër.

Por kur «miqtë» e viteve të para, apo «miqtë» e dekadave më vonë abuzuan me ne e synuan të bëhen «zotër» të shtëpisë, ne ditëm t'i bindim se shtëpia jonë përveç vatrës së ngrohtë ka dhe një derë, bile dhe penxhere...

Por nuk i shihnin kështu, nuk niseshin nga këto pozita marksiste shumica, për të mos thënë të gjithë të dërguarit e Titos, me përjashtim të Miladin Popoviçit. Të rëndë e «seriozë të mëdhenj», kush me poza «strategu» e kush me fraza «mendimtari», me presione, intriga e me hipokrizi, hap pas hapi ata filluan ta shfaqnin qartë thelbin e tyre. Akademi e kurse speciale partie ne s'kishim bërë, por që ata blofonin, që ata shpesh ngatërronin më tepër sesa ndihmonin, këtë nisëm ta vëmë re. Me këta të dërguar kemi pasur fërkime e kundërshtime për çështje parimore, për probleme vije: duhej të ndërtonim këshillat apo sovjetët; brigadat duhej t'i quanim «brigada sulmuese» apo «brigada proletare»; shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë duhej të luftonin sipas pikëpamjes sonë marksiste-leniniste, apo sipas pikëpamjes shoviniste të Vukmanoviç Tempos; duhej ta fshihnim Partinë nën maskën e Frontit dhe ta mbanim në gjendje pak a shumë ilegaliteti edhe pas Çlirimit, apo Partia të qëndronte në ballë, flamur, siç donim ne dhe jo siç pretendonte i dërguari i Titos, Velimir Stojniçi. Ky Stojniçi, me një pretendim të çmendur dhe kriminal, kërkonte të na imponontë atë vijë likuidatore që Partia nuk e kishte pranuar as në kohën e luftës. Dhe kur e kërkonte këtë? Pikërisht kur Partia, vija e saj e drejtë, kishte fituar dhe kur duhej grumbulluar gjithë populli në luftën e ardhshme për rindërtimin dhe për zhvillimin socialist të vendit.

Mblidheshim tok me Miladinin dhe rrinim me net të tëra pa gjumë, duke diskutuar për t'u rezistuar në mënyrë luftarake këtyre elementëve, me të cilët, edhe pse i njihnim si shokë, nuk bashkoheshim në çështje vije. Ç'është e vërteta edhe Miladini, edhe unë, edhe shokët e tjerë, fillimisht, pa e njohur, kishim besim te Titoja. Kur bisedonim të dy, thoshim se nuk mund të mendojë Titoja kështu, por janë këta njerëz që gabojnë.

- Miladin, - i thosha unë, - ne nuk gabojmë. Situatën e vendit tonë, mentalitetin e popullit tonë i njohim ne dhe jo ata, prandaj nuk mund të dalim kurrsesi me parulla të majta, duke u nisur nga fakti që në Jugosllavi u krijuan brigada proletare. Vija e PKSH nuk është oportuniste, siç pretendon Tempoja kur u grindëm me të në Kucakë, dhe as sektare, siç pretendon Velimir Stojniçi.

- Jam dakord me ty, Taras, - më thoshte Miladini, - ju keni të drejtë që nuk lëvizni nga mendimet tuaja. Ata le të mendojnë çfarë të duan.

- Fundi i fundit, - i thosha «Ahut» (këtë pseudonim i kishim vënë Miladinit), - ne, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë, jemi të vetmit përgjegjës përpara Partisë dhe përpara popullit tonë.

Këto kundërshtime parimore zhvilloheshin shumë më përpara se të demaskohej grupi i Titos si renegat e tradhtar i marksizëm-leninizmit dhe, siç thashë edhe më lart, Miladin Popoviçi jo vetëm s'kishte asnjë kundërshtim me vijën e ndjekur nga Komiteti Qendror i Partisë sonë, por edhe ndihmonte që kjo vijë të zbatohej e të mbrohej. Por

ndihma dhe sinqeriteti i tij komunist binin në kundërshtim me planet djallëzore të Titos ndaj nesh, prandaj Miladini u thirr në mënyrë të hapur armiqësore nga Titoja, që të gjykohej për veprimtarinë e tij «armiqësore» dhe për t'i lëne dorë të lirë Velimir Stojniçit, i cili kishte ardhur ato kohë në Shqipëri, si përfaqësues dhe «instruktor» i PK të Jugosllavisë dhe i dërguar i Titos dhe që më 1944 organizoi prapaskenën e Beratit kundër Partisë sonë heroike, kundër vijës së saj të drejtë dhe të pamposhtur marksiste-leniniste, kundër Partisë që i ngriti masat në këmbë dhe i organizoi e i çoi në fitore. Ai luftoi me porosi të Titos edhe kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Titoja synonte të dobësonte e më në fund të likuidonte Partinë tonë, të dobësonte vendin akoma më shumë në pragun e fitores dhe, me anë të klikës së Koçi Xoxes, ta bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë.

Më kujtohet si sot që, në kohën kur Miladini u urdhërua të kthehej ne Kosovë, para se të ndahej nga ne, duke shëtitur unë dhe ai u ngjitëm në kodrat e Odriçanit, e, duke biseduar, ai më tha:

- Taras, dëgjo! Këta, Stojniçi dhe Dizdareviçi, janë armiq. Vetëm në mos u pjeksha dot me Titon, se këta dhe të gjithë ata që i kemi luftuar së bashku, do t'i demaskoj.

Por shpejt ne do të bindeshim që vetë udhëheqja jugosllave, me Titon e Rankoviçin në krye, ishte dora që i kishte përgatitur e i kishte dërguar te ne, për veprimtari antiparti e antishqiptare, Mugoshët, Vukmanoviçët, Stojniçët e të tjerë. Dhe më pas, kur tradhtia e tyre doli sheshit, fabrikuan «libra të bardhë» e broshura, artikuj e «kujtime», një propagande të terë false e të ndyrë për të detyruar opinionin që të besojë se ata kane krijuar këtë e atë, se ata e bënë këte e atë, shkurt, ata na e paskan bërë diellin të dalë mëngjeseve në Shqipëri!

Këta flasin shumë për të dërguarit jugosllavë, të cilët erdhën për here të parë nga Kosova në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1941, por nuk përmendin një fakt real: qysh në pranverën e 1939-s e më 1940, por sidomos pas prillit 1941, kur hynë italianët në Kosovë, nga Shqipëria u dërguan në Kosovë një numër komunistësh, me origjinë nga ato anë, por që prej kohësh ishin bërë këtu komunistë e vepronin këtu si komunistë. Ata dhanë atje kontributin e tyre për organizimin e Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë e gjetkë, shumë prej tyre dhanë jetën në zjarrin e luftës.

Po kështu në vitin 1941, por edhe më pas, nga Shqipëria shkuan në Kosovë e në krahina të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, dhjetëra e dhjetëra mësues shqiptarë. Ne, komunistët e atëhershëm, duke shfrytëzuar këtë rast legal, u përpoqëm dhe mundem të futnim në përbërjen e atyre që u dërguan me punë në Kosovë elementë patriotë e revolucionarë, shumë nga shokët, miqtë e simpatizantët e grupeve tona komuniste, e më pas, të Partisë Komuniste që krijuam. Ata me porosinë tonë dhanë atje një kontribut të ndjeshëm, duke përkrahur e duke u hedhur aktivisht në luftën antifashiste të popullit trim kosovar, vëllezërve tanë të një gjaku.

Dihet edhe kjo e vërtetë: njësi të tëra të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me urdhër të Shtabit tonë të Përgjithshëm, që në ditët e para të tetorit 1944, kur akoma s'qe çliruar plotësisht Shqipëria, vazhduan luftën heroikisht në Kosovë, kurse pas Clirimit të vendit, brigada të tjera të ushtrisë sonë (dy divizione: V dhe VI), vazhduan luftën edhe në vise të tjera të Jugosllavisë, krah për krah me njësitet e partizanëve kosovarë e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Disa qindra prej partizanëve tanë dhanë jetën në Kosovë, në Malin e Zi, në Sanxhak e në Bosnjë ku luftuan.

Pa qenë nevoja të rreshtojmë fakte të tjera, le të bëjmë pyetjen: Sikur të ndiqnim edhe ne logjikën e Tempove mbi rolin e «të dërguarve», atëherë në ç'konkluzione duhej të arrinim e ç'pretendime duhej të paraqitnim, të paktën për zonat ku shkuan e luftuan jo më 5 a 6 «të dërguar» me çanta në sup, por qindra e mijëra veta me armë në duar?!

Historia, koha e kanë thënë e do ta thonë fjalën e vet të padiskutueshme, kurse shpifjet e pafund të Tempove me kompani do të mbeten shpifje që s'qëndrojnë në këmbë. Por ata neve s'kanë ç'na bëjnë tjetër, le të vazhdojnë të fabrikojnë shpifje, «kurora dafine» për «lavdinë» e tyre aspak të lavdishme.

Terrenin e falsifikimeve të ardhshme ata e përgatitën qysh më 1945. Jo shumë kohë pas çlirimit të Kosovës Miladin Popoviçin e vranë prapa krahëve njerëzit e UDB-së, sepse ishte shprehur për të drejtën e popullsisë shqiptare të Kosovës për vetëvendosje. Për këtë kemi bindje të plotë jo vetëm nga bisedat që bënim me Miladinin, kur ishte në Shqipëri, por në Arkivin e Komitetit Qendror të Partisë sonë kemi dokumente që flasin qartë për këto pikëpamje të komunistit internacionalist, Miladin Popoviçit. Pas kësaj njerëzit e Titos trumbetuan se vrasjen gjoja e paskësh bërë një shqiptar kosovar! Dhe ku? Mu në tavolinën e tij të punës, në shtëpinë që ruhej nga partizanë jugosllavë! E gjithë kjo farsë kriminale qe organizuar, pra, me cinizmin më të madh nga Titoja me Rankoviçin e njerëzit e tyre, në mes të të cilëve edhe Dushan Mugosha, për të fshehur gjurmët e tradhtisë së tyre karshi nesh. Njeriut, që ata e urrenin dhe e vranë, sepse ai s'mund të pajtohej me veprën e tyre armiqësore ndaj komunizmit, i vunë dekoratën e heroit të popujve të Jugosllavisë. Ky veprim u shkon vetëm banditëve të tillë, për të cilët populli ynë thotë: «Të vrasin natën e të qajnë ditën».

Më kujtohet se, kur vajta për herë të parë në Jugosllavi, as Titoja dhe askush tjetër nuk më tha fjalën më të vogël për Miladin Popoviçin. Vetëm në një miting m'u afrua një plakë e thinjur, e cila, duke më puthur e përqafuar, më pëshpëriti: «Jam nëna e Miladinit dhe e Mihajllos, që luftuan tok me ty, djali im Enver Hoxha». E shtrëngova fort në kraharor, po m'u zu fjala në grykë dhe m'u mbushën sytë me lot për kujtimin e shokut tim të dashur, Miladin Popoviçit. Nuk mund të duroja të heshtja dhe në fjalën time atje fola për Miladinin fjalët më të mira e më të ngrohta që ai i meritonte.

Shpejt do të vinte dita t'i thoshim edhe për të tjerët ato që meritonin, do të vinte, pra, dita kur ne, hapur e botërisht, do të denonconim e do të demaskonim veprimtarinë antimarksiste e antishqiptare të udhëheqjes së PKJ me Titon në krye. Në këtë kuadër do të flisnim edhe për të vërtetën mbi veprimtarinë antishqiptare të të dërguarve jugosllavë në Shqipëri, veprimtari e cila filloi të shtohej e të egërsohej pas Konferencës së Parë të Vendit të PKSH. (LIRIA, gusht 1981, faqe 13-14)

Kongresi i 2-të i "vetadministruesve":

4-5-6. DËSHMI TË KALBËZIMIT TË "VETADMINISTRIMIT" TITIST

Ka kohë që propaganda revizioniste në Jugosllavi po bën një zhurmë shurdhuese rreth Kongresit të ashtuquajtur të "vetadministruesve", që u mbajt këto kohët e fundit në Beograd. Në fjalimet e krerëve revizionistë si dhe në komentet e shumta që kanë mbushur faqet e shtypit jugosllav, po ngritet në qiell "rëndësia e madhe" e këtij kongresi, i cili po cilësohet si "ngjarje e madhe", "e jashtëzakonshme", bile edhe "historike"! Si zakonisht në raste të tilla, kjo zhurmë po shoqërohet edhe me himne e ditirambe plot absurditet e monotoni kushtuar Titos e "vetadministrimit", "vëllazërim-bashkimi" e "mosangazhimit" etj., etj.

Në gjendjen ku është katandisur Jugosllavia, revizionistët e thirrën këtë kongres me qëllim që t'i vënë ndonjë shtyllë sistemit të tyre të kalbur, që t'i bindin masat punonjëse se nuk është sistemi kapitalist i "vetadministrimit" shkaktar i gjendjes së tyre të rëndë, por fjator qenka moszbatimi i tij në praktikë, se udhëheqja jugosllave gjoja shqetësohet

jo vetëm për gjendjen e vështirë të masave, por edhe "lufton" e "punon" për përmirësimin e saj.

Në këtë mënyrë po mundohen revizionistët të mashtrojnë proletariatin dhe popujt jugosllavë, duke u bërë atyre petulla me ujë. Po opinioni jugosllav është mësuar me propagandën e tillë mashtruese, dhe nuk gënjehet leht. Po këto fraza stereotipe, po këto lavdata, gënjeshtra e premtime boshe kanë dëgjuar punonjësit jugosllavë edhe në dy kongreset e mëparshme, nga të cilat atyre s'u erdhi asnjë e mirë. Prandaj, janë të paktë naivët që mund të varin ende ndonjë shpresë te ky kongres apo te farsat e tjera të ngjashme, që inskenojnë revizionistët.

Si në rezolutë, ashtu edhe në referatet që u paraqitën në Kongres, flitet për "suksese të mëdha" e "përparime të papara" që qenkan arritur në periudhën mes dy kongreseve. Por, se çfarë janë në të vërtetë këto "rezultate" tregon më së miri gjendja e tanishme, të cilën edhe vetë revizionistët po e vlerësojnë "gjendje shumë e rëndë dhe e ndërlikuar".

Kriza e rëndë dhe e gjithanshme që e ka mbërthyer ekonominë jugosllave sa vjen e thellohet. Ritmet e ngadalësuara të prodhimit, e në shumë degë të rëndësishme edhe rënia e tij, humbjet gjithnjë më të mëdha financiare, aftësia akumuluese gjithnjë në rënie, defiçiti i madh tregtar, borxhet e shumta, rritja e pafrenueshme e çmimeve, inflacionit dhe kostos së jetesës, kaosi, konkurrenca e anarkia në treg, e kanë sjellë atë në një gjendje kritike të pashërueshme.

Gjatë vitit 1980, çmimet shënuan rritjen e tyre më të madhe në 15 vjetët e fundit, dhe në maj të këtij viti ato ishin jo më pak se 52,6 për qind më të mëdha se në majin e vitit të mëparshëm. Vetëm gjatë muajve të parë të këtij viti inflacioni, sipas të dhënave që japin vetë revizionistët, arriti në nivelin rekord – 53 për qind, që është jo vetëm niveli më i lartë në Evropë, por edhe ndër më të lartët në botë. Për pasojë, çdo ditë shtrenjtohet edhe kostoja e jetesës, e cila në maj të këtij viti ishte 53,4 % më e shtrenjtë se një vit më parë, kurse të ardhurat reale të punëtorëve gjatë tre muajve të parë të këtij viti – 11% më të vogla se gjatë të së njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm.

Për vite me radhë, në Jugosllavinë revizioniste pothuaj se asku nuk arrihen rezultatet e planifikuara. Në dekadën e kaluar, shkruante gazeta "Komunist", vetëm një objekt i madh u ndërtua në afat, dhe ajo pikërisht një urë që lidhë pjesën kontinentale me ujdhesën Kërkë. Vetëm tejkalimet në investime gjatë gjysmës së parë të këtij viti arrinin në rreth 500 miliardë dinarë, që është sa gati tri buxhete të federatës, kurse gjatë tre muajve të parë të këtij viti humbjet u shtuan për jo më pak se 63 %.

Borxhet e jashtme të Jugosllavisë, që më 1976 silleshin rreth 8 miliardë dollarë, tani, sipas të dhënave të vetë revizionistëve, po i afrohen shumë prej 20 miliardë dollarësh. Se çfarë barre janë këto borxhe, flet më së miri e dhëna se gjatë këtij viti vetëm për kamatat e kredive të marra, Jugosllavia do t'i paguaj kapitalit të huaj 1,55 miliardë dollarë, që është rreth 3% e të ardhurës së përgjithshme kombëtare, ose sa e tërë rritja e saj vjetore. Gjendjen e rëndon edhe më shumë defiçiti i madh tregtar, i cili në vitin 1980 kapte shumën prej 2,30 miliardë dollarësh, kurse vetëm gjatë pesë muajve të parë të këtij viti ai arriti në mbi 3,5 miliardë.

Këto dhe plagë të tjera, që po e brejnë ekonominë kapitaliste të Jugosllavisë, janë aq të mëdha e të dukshme sa nuk mund të fshehen, prandaj ato po detyrohen t'i pranojnë edhe vetë krerët revizionistë. Ato që ata po mundohen t'i fshehin me çdo kusht janë shkaqet e vërteta që çuan në këtë gjendje kaq të rëndë. Në rezolutën dhe në referatet e këtij kongresi bëhen përpjekje që gjendja e vështirë, në të cilën ndodhet ekonomia jugosllave, të paraqitet jo si pasojë e sistemit kapitalist të ashtuquajtur "vetadministrues", por gjoja si pasojë e krizës ekonomike ndërkombëtare, e cila, sipas tyre ka përfshirë të

gjitha vendet e botës. Kështu mundohen revizionistët të arsyetojnë disi rezultatet e palakmueshme të sistemit të tyre. Por, ky "arsyetim" nuk qëndron.

Nga plagët e krizës po vuajnë sot vendet kapitaliste e revizioniste, por jo edhe të gjitha vendet, siç u pëlqen revizionistëve të na e mbushin mendjen. Nuk mund të mos e dinë ata se në Shqipëri, ku ndërtohet socializmi i vërtetë, nuk ka krizë, inflacion, ngritje çmimesh, kurbet e plagë të tjera si këto.

Krizat në Jugosllavi dhe në vendet e tjera kapitaliste e revizioniste, nuk janë dhe nuk mund të jenë rezultat i ndikimit të jashtëm. Ato janë pasojë e natyrshme dhe e pashmangshme e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim. Këtë të vërtetë, që tani po mundohen ta fshehin, revizionistët titistë e kanë pranuar edhe vetë në raste të ndryshme. "Arsyetimin për ecuritë e pavolitshme inflatore, u theksua në mbledhjen e Këshillit për marrëdhënie ekonomike të botës, nuk mund ta kërkojmë më në inflacionin e importuar e në veprimin e çmimeve të jashtme më të larta se të brendshmet, sepse analizat kanë treguar se, p.sh. vitin e kaluar, në rritjen e përgjithshme të çmimeve, shtrenjtimi i importuar ka ndikuar vetëm 11%, kurse 89% të rritjeve të tjera të çmimeve, janë rezultat i ecurive tona të brendshme ekonomike" ("Politika", 21. V. 1980)

Rendja pas fitimeve, që është karakteristikë e ekonomive kapitaliste, kohëve të fundit e ka ashpërsuar edhe më shumë konkurrencën dhe luftën për tregje në mes firmave kapitaliste jugosllave. Kjo ka çuar në një mbyllje të tillë monopoliste të ekonomive të republikave jugosllave, sa që sot pothuajse nuk mund të flitet për një ekonomi unike jugosllave. Ashtu si në të gjitha vendet kapitaliste, në Jugosllavinë revizioniste gjithçka kryhet sipas ligjeve të xhunglës. Peshku i madh e ha të voglin...

Kjo dukuri, e cila ka kohë që e shqetëson udhëheqjen jugosllave, ishte një nga çështjet rreth të cilave u bë shumë poterë edhe në Kongres. Pothuajse të gjithë e dënuan të ashtuquajturin "nacionalizëm ekonomik", i cili, siç u tha, është bazë për lindjen e nacionalizmave të tjera, por, në diskutimet rreth masave që duhet ndërmarrë, ashtu si edhe më parë, dolën në shesh dy tendenca të kundërta. Deri sa njëra palë, në emër të unitetit të tregut dhe të gjithë ekonomisë jugosllave, theksonin nevojën e një centralizimi më të madh të ekonomisë, të politikës së çmimeve dhe të sistemit monetar e devizor, pala tjetër i kundërvihej kësaj dhe e vinte theksin në nevojën e decentralizimit të mëtejshëm dhe të veprimit të lirë të ligjeve të tregut.

Secila nga palët mundohet të paraqitet si mbrojtëse e socializmit, por në të vërtetë, në këtë mes asgjë nuk ka të bëjë me socializmin e vërtetë. Kjo luftë është vazhdim i kontradiktës në mes të dy tendencave të ndryshme kapitaliste, që rivalizojnë kaherë në udhëheqjen revizioniste jugosllave: të centralizmit burokratik, që mbrohet nga borgjezia unitariste serbomadhe, dhe të liberalizmit borgjez perëndimor, të klanit kroato-slloven. Lufta në mes këtyre dy rrugëve është edhe shprehje e rivalitetit të ashpër, që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik zhvillojnë rreth Jugosllavisë dhe, siç po dëshmojnë edhe ngjarjet e fundit në Kosovë dhe masat e ndryshme centralizuese që u ndërmorën këto kohët e fundit, situatën gjithnjë e më shumë po e marrin në dorë klani serbomadh dhe aleatët e tij, socialimperialistët sovjetikë.

Ka kohë që në Jugosllavi flitet e shkruhet me të madhe për të ashtuquajturën "punë e bashkuar" dhe ligjin e saj, për "pozitën dominuese të punëtorëve në të", për "ndarjen sipas punës" etj. Se çfarë është gjendja e vërtetë në këtë fushë, tregon më së miri gjendja e vështirë dhe gjithnjë më e padurueshme, në të cilën ndodhen masat punonjëse; tregon edhe ajo që u tha në Kongres. Edhe vetë Mika Shpilaku, që paraqiti referatin kryesor, u detyrua të pranojë se "në dekadën e shkuar... tjetërsimi i të ardhurës nga punëtorët edhe më tej ka ngelur dominues", kurse shumë delegatë punëtorë theksuan hapur se puna e mundi i tyre po shfrytëzohet në mënyra të ndryshme, të hapura e të fshehta.

Revizionistët titistë kanë ndërtuar një sistem të tillë burokratik, me organe, organizata e institucione të panumërta, që, me anë të obligimeve e tatimeve të ndryshme, kontributeve e "vetëkontributeve" të shumta, me anë të "marrëveshjeve" e "ujdive" të ashtuquajtura "vetëqeverisëse" u thithin punëtorëve e fshatarëve edhe pikën e fundit të djersës e të gjakut. "Në kohën kur në shumë ndërmarrje punëtorët nuk merrnin për muaj të tërë kurrfarë pagash, mjetet e bashkësive shoqërore politike (pa federatën), organet dhe organizatat e niveleve të ndryshme, kah gjysma e vitit 1979, siç shkruante revista NIN, arrinin rreth 40 miliardë dinarë, që është gati sa gjithë akumulimi i ekonomisë së vitit 1978, kurse të ashtuquajturat BVI, vetëm si teprica, gllabëronin gjithnjë akumulimin e industrisë jugosllave. Sipas të dhënave të Institutit të Shkencave Shoqërore në Beograd, gjatë vitit të kaluar të ardhurat personale në ekonomi ranë në nivelin 35,6 % të të ardhurës së realizuar. "Ky nivel, konstaton Instituti, është deri tash niveli më i ulët, dhe kjo është dukshëm nën proporcionet që janë të domosdoshme për riprodhimin normal të ekonomisë".

Mjaftojnë këto fakte për të parë se kush është zot i "punës së bashkuar", se kush e zotëron riprodhimin shoqëror.

Kjo plaçkitje e madhe që i bëhet ekonomisë nga burokracia shtetërore, është shfrytëzimi më i madh që u bëhet punëtorëve, por jo edhe i vetmi. E keqja do të kish qenë shumë më e vogël sikur edhe ai "kulaç" i vogël që i mbetet ekonomisë të ndahej në mënyrë të drejtë, por, kjo, siç theksuan shumë diskutues, nuk bëhet pothuajse askund. Diferenca në mes të ardhurave të realizuara në degët e ndryshme të ekonomisë, e kalon edhe shkallën 3 me 1, e kjo sigurisht nuk mund të varet nga puna që bëhet. Siç u detyrua të pranojë edhe referuesi tjetër në këtë kongres, D. Bogdanov, "ndikim dominant kanë ende faktorët e jashtëm, gjë që shumë organizata të punës së bashkuar i sjellin në pozitë të pabarabartë... pozita e disa degëve dhe grupacioneve nuk varet në rend të parë nga rezultatet e arritura dhe nga produktiviteti i punës".

Akoma më të mëdha janë diferencat mes pagave së njejtës organizatë. Ato jo vetëm që janë më të mëdha se diferencat e pagave në vende të tjera kapitaliste, por edhe kanë tendencë të vazhdueshme rritjeje. Një shef i "Pankomercit" të Novin Sadit, p.sh. gjatë dhjetorit të vitit 1978, siç shkruante gazeta "Politika", mori të ardhura në shumë prej 89 677 dinarësh, kurse të ardhurat e një punëtori të së njëjtës organizatë, mezi arrijnë në 3 454 dinarë, pra, rreth 30 herë më pak! Ky shembull nuk është ndonjë përjashtim dhe as rast ekstrem. Shefa e "buxhovanë" që marrin si ai i "Pankomercit", e madje edhe më shumë, ka sa të duash në Jugosllavinë "vetadministruese" të Titos, kurse numri i punëtorëve me paga më të vogla se 4000 dinarë, siç shkruante revista NIN, arrin në mbi 670 mijë vetë.

Në kushtet e një realiteti të tillë, që vështirë mund të krahasohet me ndonjë vend tjetër, në kushtet kur, siç u detyrua të pranojë edhe vetë Mika Shpilaku, "një nga qëndrimet qenësore kushtetuese – e drejta për punë me mjete shoqërore shpesh ndërrohet në të drejtë për vend të punës, i cili garanton sigurimin social, kurse punëtorët ekzistencën e vet e kërkojnë në punën plotësuese, jashtë organizatës së tyre themelore", tingëllojnë qesharake dhe cinike dërdëllisjet revizioniste rreth "vetadministrimit punëtor", "mbizotërimit të punëtorëve mbi punën e bashkuar", "ndarjes së të ardhurave sipas rezultateve të punës" etj.

Gjendja e mjeruar dhepozita skllavëruese e klasës punëtore, fshatarësisë dhe masave të tjera popullore, rënia e vazhdueshme e standardit të tyre të jetesës dhe, njëkohësisht, të pagave që marrin, rritja e mëtejshme e armatave milionëshe të të papunëve e të kurbetçinjve etj., flasin më së miri edhe për absurditetin që bëjnë

revizionistët titistë rreth gjoja "demokracisë së madhe" që ekzistoka në Jugosllavi dhe të sistemit të tyre të ashtuquajtur "të delegimit".

Edhe vetë Stane Dolanci, në referatin që paraqiti, u detyrua të pranojë se sistemi i delegimit, "marrë në tërësi, nuk ka arritur rezultate të kënaqshme dhe ka pasur ngecje në punën e tij", kurse delegatë të shumtë, në diskutimet e tyre, folën edhe për hapur për "mosfunksionimit e sistemit të delegimit", për "pjesëmarrjen formale e simbolike dhe hapësirat e ngushtuara për vendosjen e punëtorëve", për "mungesën e çdo kontrolli punëtor dhe pamundësinë që punëtori të thotë fjalën vet dhe të ndikojë në vendosjen e çështjeve më të rëndësishme", për "disproporcionin e madh në mes asaj që thuhet e asaj që bëhet, në mes të normatives dhe reales", për faktin se "për çështjet kryesore vendosin organet ekzekutive të bankave, kurse delegatë kryesisht janë anëtarët e këshillave punëdrejtuese" etj. Është domethënës fakti që edhe në këtë kongres gjoja të punëtorëve shumica dërmuese e delegatëve ishin jo punëtorë, por burokratë e funksionarë të rangjeve të ndryshme.

Masat punonjëse në Jugosllavi po e kuptojnë se ç'është në të vërtetë "demokracia revizioniste", prandaj edhe po ngriten kundër saj gjithnjë e më shumë. Sipas të dhënave të vetë revizionistëve, vetëm gjatë vitit të kaluar në Jugosllavi janë bërë rreth 250 greva të punëtorëve, e këtë vit numri i tyre me siguri që do të jetë akoma më i madh. Por më mirë se kushdo tjetër, këtë "demokraci" fashiste e njeh populli i robëruar i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare, i cili, jo vetëm që është lënë në errësirë, skamje e mjerim të madh, jo vetëm që i ekspozohet një shtypjeje e shfrytëzimi të egër dhe të shumëfishtë kolonial kapitalist, por është bërë edhe objekt i një dhune, terrori e gjenocidi të pashembullt. Në emër të kësaj "demokracie", ai po vritet e gjakoset, po burgoset, po rrahet e poshtërohet si kurrë ndonjëherë më parë, vetëm e vetëm pse ngriti zërin, e kërkoi në rrugë paqësore një të drejtë të tij të ligjshme, të cilën kushtetuta jugosllave u njeh popujve të tjerë në Jugosllavi. Në emër të kësaj "demokracie", atij po i mohohet e sulmohet historia, kultura, letërsia, arti e deri edhe këngët e simbolet e tij kombëtare. Prandaj ai, më parë se çdokush, edhe po e kupton natyrën e vërtetë fashiste të kësaj "demokracie të mitralozave" dhe karakterin e vërtetë kapitalist të sistemit tashmë të diskreditуar të "vetadministrimit" titist. Prandaj ai më pak se çdo kush tjetër mashtrohet nga zhurma që bëjnë armiqtë e tij revizionistë dhe nga kongreset që organizojnë ata.

Kongresi i "vetadministruesve" nuk ishte "dëshmi e vitalitetit të sistemit të vetadministrimit", siç e quajtën atë revizionistët, po përkundrazi, ai ishte dëshmi e kalbëzimit dhe e diskreditimit të tij të mëtejshëm. Kriza e thellë e këtij sistemi, e cila ashtu siç u theksua edhe në kongres, "është e pranishme që nga organizata themelore, e deri në federatë", nuk mund të shërohet e as të mbulohet me farsa të tilla qesharake. Ai nuk do t'i sjellë asnjë të mirë proletariatit dhe masave të tjera punonjëse të Jugosllavisë, ashtu siç nuk u sollën asgjë kongreset e mëparshme. Gjendja e rëndë në të cilën ndodhet Jugosllavia titiste, është pasojë e pashmangshme e sistemit kapitalist të "vetadministrimit", prandaj ajo nuk mund të përmirësohet me kurrfarë lustrimi dhe arnimi të këtij sistemi të kalbur e të falimentuar. Rrugën për të dalë nga kjo gjendje e tregon vetëm marksizëm-leninzmi, dhe këtë rrugë shpëtimi me siguri do ta gjejë edhe proletariati dhe popujt e Jugosllavisë. (LIRIA, gusht 1981, faqe 15-16)

4-5-7. THELLOHET KRIZA EKONOMIKE NË KOSOVË

Nga Nezir Myrtaj

Vetëm gjatë tre muajve të parë të këtij viti, në Kosovë u regjistruan mbi 1,4 miliardë dinarë humbje më shumë se gjatë gjithë vitit të mëparshëm.

Në krahasim me një vit më parë, në maj të këtij viti çmimet u rritën 52,6 %, kurse kostoja e jetesës 53,4%. Gjatë pesë vjetëve të ardhshëm punë do të kërkojnë rreth 180 mijë të papunë të rinj.

Po zhvillohet "më shpejtë" apo po ngec edhe shumë Kosovë?

Në fushatën e egjër propagandistike që po bëjnë revizionistët jugosllavë rreth demonstratave të Kosovës, po flitet me të madhe edhe për gjoja sukseset që qenkan arritur në ekonominë e Kosovës gjatë muajve të parë të këtij viti, e sidomos gjatë kohës së demonstratave të mëdha që u bënë! Në këtë mënyrë, revizionistët duan të thonë se klasa punëtore, jo vetëm që nuk mori pjesë në këto greva e demonstrata, po përkundrazi ajo i dënoi ato dhe u mobilizua që të punojë edhe më tepër, bile ta tejkalojë planin e prodhimit!

Revizionistët e niveleve të ndryshme në Kosovë e Jugosllavi po mundohen t'i fshehin plagët e rënda të ekonomisë së Kosovës dhe të krijojnë përshtypjen sikur gjendja e saj po përmirësohet. Por, pavarësisht nga deklaratat e tyre demagogjike gjendja e vërtetë në të cilën ndodhet ekonomia e Kosovës, është shumë e rëndë, e atë nuk mund ta mbulojë propaganda revizioniste.

Gjatë katër muajve të parë të këtij viti, prodhimi industrial, sipas të dhënave që japin revizionistët, ishin rreth 3% nën shkallën e planifikuar. Në shumë degë të rëndësishme të ekonomisë e në ndërmarrje të mëdha si "Trepça", "Kosova" etj. nuk po arrihen as për së afërmi rezultatet e parashikuara.

Veçanërisht të rëndë e bëjnë gjendjen në ekonominë kosovare humbjet e mëdha financiare, të cilat, siç shkruante "Rilindja", vetëm për 3 muajt e parë të këtij viti, u shtuan për jo më pak se 1,4 miliardë dinarë, e që janë më të mëdha se të gjitha humbjet që u regjistruan gjatë vitit të mëparshëm, shumica dërmuese e të cilave janë akoma të pambuluara. Pjesa më e madhe e këtyre humbjeve, ashtu si edhe më parë, shënohet në degët kryesore të ekonomisë, në industri, xehtari, ndërtimtari etj.

Nga propaganda revizioniste po bëhet një zhurmë e madhe edhe rreth të ashtuquajturit "nacionalizëm ekonomik", i cili, sipas asaj, qenka prezent edhe në Kosovë. Mirëpo, faktet tregojnë se ekonomia e Kosovës, më pak se çdo ekonomi tjetër në Jugosllavi, është e mbyllur në vetvete. Mallrat e firmave jugosllave bëjnë gara konkurrence në tregjet e Kosovës, në një kohë që mallrave kosovare u kufizohet plasimi në tregjet e tjera, dhe, si pasojë e kësaj, depot e ndërmarrjeve kosovare mbushen me stoqe të shumta. Firma e ndërmarrje të të gjitha republikave të Jugosllavisë, kanë hapur anë e kënd Kosovës qindra njësi të tyre tregtare, kurse ndërmarrjet kosovare detyrohen t'i mbyllin shitoret e tyre edhe në Kosovë.

Vështirësi të shumta i dalin Kosovës edhe për plasimin e mallit të saj në tregjet e jashtme. Shumë mallra kosovare, që do të mund të eksportoheshin në tregje të jashtme, grabiten me çmime fare të ulëta nga borgjezia jugosllave, e cila pastaj nxjerr prej tyre fitime të mëdha. Dihet nga të gjithë se prodhimet e "Trepçës", firmat jugosllave i marrin me çmime shumë të ulëta që s'u afrohen çmimeve reale në tregun botëror, kurse energjinë elektrike, që prodhohet në Kosovë, ne kosovarët e paguajmë më shtrenjtë sesa e paguajnë atë republikat jugosllave. Për sigurimin e lëndëve të para dhe të teknologjisë nga jashtë, Kosovës i japin fare pak leje e deviza, kurse vështirësi e pengesa të shumta administrative

i nxirren asaj edhe në fushën e eksportit. Në kushte të këtilla, nuk është çudi që vetëm gjatë katër muajve të parë të vitit deficit tregtar të arrijë në mbi 1,6 miliardë dinarë.

Në gjendje më të mirë nuk është as tregu i brendshëm i Kosovës, i cili ka kohë që është boshatisur. Para demonstratave ishte vështirë të gjeje edhe artikujt më të domosdoshëm për jetesë si miellin, kripën, sheqerin, deterxhentet etj. Gjatë kohës sa zgjatën demonstratat dhe menjëherë pas tyre, furnizimi i tregut sikur u përmirësua. Pse ndodhi kështu? Nuk u ndie më mungesa e mallrave, u thye ajo krizë, apo ato ditë u punua "me vullnet të pathyeshëm" dhe u prodhua më tepër që të ketë edhe për Kosovën? Pati tepricë mallrash, apo borgjezia jugosllave u tregua e "arsyeshme" për furnizimin më të mirë të tregut edhe në Kosovë. Jo. Ndodhi kështu jo për tjetër, por pse borgjezia jugosllave dhe krerët e saj u gjendën në pozitë të rëndë dhe mungesat në treg e rëndonin edhe më shumë gjendjen në Kosovë. Këtë e dëshmon më së miri ajo që ndodhi më pas. Tani që lufta sikur u qetësua pak, dollapet e shitoreve u zbrazën përsëri, anarkia e kaosi në treg po vazhdon. Populli i Kosovës nuk gjen sheqer as sa për ilaç, në kohën kur sheqeri i tij eksportohet jashtë Jugosllavisë apo dërgohet nëpër republikat jugosllave. Vetëm në dhjetor të vitit 1980 nga Fabrika e Sheqerit në Pejë u dërguan në Itali jo më pak se 1533 tonë sheqer. Kështu veprohet edhe me miellin, vajin e produkte të tjera.

Një rritje të paparë gjatë muajve të parë të këtij viti shënuan edhe çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të ndryshme. Në fund të majit të këtij viti ato ishin 52,6 % më të larta se në majin e vitit të mëparshëm. Si pasojë e kësaj, edhe kostoja e jetesës u shtua si asnjëherë më parë duke e bërë edhe më të padurueshme jetën e masave punonjëse. Në krahasim me dhjetorin e vitit 1980, në maj të këtij viti ajo u shtrenjtua për 23,8 %, kurse në krahasim me një vit më parë – 53,4%.

Përballë kësaj krize të thellë e të gjithanshme, pozita materiale e punëtorit kosovarë po keqësohet çdo ditë e më tepër. Paga reale, edhe ashtu e vogël, po ulet vazhdimisht. Në vitin e kaluar, ajo ra për 5% kurse gjatë këtij viti me siguri që do të bjerë akoma më shumë. (Në Jugosllavi, gjatë tre muajve të parë të këtij viti, ajo ra për 11%). Punëtori kosovarë nuk trajtohet njëlloj as me punëtorët jugosllavë. Për të njëjtën punë ai merr më se 30% më pak se mesatarja e asaj që marrin punëtorët në Jugosllavi. Për të qenë e keqja edhe më e madhe, ndodh shumë shpesh që punëtorëve kosovarë të mos u paguhen për muaj të tërë edhe ato paga të vogla, ose që ato t'u jepen të përgjysmuara. Mirëpo, kur revizionistët jugosllavë e shohin të ngritur grushtin e fuqishëm të punëtorëve, ata dinë të bëjnë edhe lëshime. Në shumë ndërmarrje, ku punëtorët ngritën zërin e protestës kundër shtypjes e shfrytëzimit të egër që u bëhet, ata u nxituan t'u rrisin pagat punëtorëve, t'u paguajnë regrese dhe t'u plotësojnë kërkesa të tjera. Vetëm në këtë mënyrë mund t'i fitojnë punëtorët tanë të drejtat e tyre të mohuara dhe jo me përralla të mërzitshme për "vetëqeverisjen", "punën e bashkuar" etj.

Gjatë muajve të parë të këtij viti me të madhe u shtua edhe ushtria e të papunëve. Numri i atyre që kërkojnë punë në të ashtuquajturat "bashkësi të punës", kalon në mbi 72 mijë, kurse numri i vërtetë i të papunëve, siç detyrohen të pranojnë edhe vetë revizionistët, është mbi 200 mijë vetë. Në këtë pesëvjeçar jo vetëm që nuk do të zvogëlohet numri i të papunëve, por ai do të rritet edhe më shumë. Sipas të dhënave që japin vetë revizionistët në vitin 1985, vetëm numri i të papunëve që do të kërkojnë punë në "bashkësi", do të arrijë rreth 180 mijë vetë, kurse, edhe sikur të realizoheshin parashikimet lidhur me hapjen e vendeve të reja të punës, prapëseprapë, më shumë se 110 mijë të evidentuar do të mbeten në rrugë, pa përmendur këtu ata që nuk paraqiten fare në këto farë bashkësish. Gjendja në këtë fushë bëhet edhe më e rëndë nga fakti se mbi 70% të të papunëve janë të rinj nën 30 vjeç, e rreth 43% janë me kualifikime profesionale, me shkolla të mesme, të larta e fakultete të kryera.

Në gjendje jo të mirë janë edhe veprimtaritë shoqërore. Kushtet për punë në institucionet arsimore, kulturore, shëndetësore etj. janë shumë të papërshtatshme. Numri i godinave shkollore jo vetëm që nuk shtohet, por edhe ato ekzistuese janë të papërshtatshme për punë e mësim. Në vitin 1975 p.sh. një nxënësi i takonin 0,67 m katrorë lokal shkollor, në këtë vit atij i takojnë më pak 0,03 metra katrorë. Në kohën kur në Kosovë po ndërtohen institucione të shumta fetare, burgje e stacione policie, revizionistët jugosllavë dhe veglat e tyre në Kosovë morën vendimin që një numri të shkollave të larta t'u vihet dryri. Në këtë mënyrë, një numër i madh nxënësish e studentësh do të mbeten jashtë bankave të shkollave e fakulteteve.

Për shkak të vështirësive financiare, mungesës së mjeteve investuese etj., zhvillimi i këtyre veprimtarive kaloi në plan të dytë. Në një mbledhje të Odës ekonomike të Kosovës u vendos që në këtë vit të hiqet dorë nga investimet në këto veprimtari.

Për t'u treguar "zemërgjerë" e "solidarë" me popullin tonë revizionistët jugosllavë flasin shpesh edhe për zhvillimin e "shpejtuar" të Kosovës. Mirëpo vetë gjendja e rëndë në të cilën ndodhet Kosova, pozita e saj koloniale dhe shfrytëzimi i egër i pasurive të saj, tregojnë se çfarë "zhvillimi" dëshirojnë ata për Kosovën.

Se sa është zhvilluar "më shpejt" Kosova, tregon edhe fakti se më 1978 pjesëmarrja e Kosovës në popullsinë e përgjithshme të Jugosllavisë ishte rreth 7%, kurse pjesëmarrja e saj në të ardhurat kombëtare të Jugosllavisë, vetëm 1,9%. Ndërsa në vitin 1953 prodhimi shoqëror i Kosovës për një banor ishte 46,1% nën mesataren jugosllave, më 1979 ai ra në gjithsej 28%, kurse gjatë dy vjetëve të fundit, ai ka rënë edhe më shumë. Gjatë pesëvjeçarit që shkoi, ekonomia e Kosovës jo vetëm që nuk u zhvillua 60% më shpejt se mesatarja jugosllave, siç planifikohej, por, përkundrazi, ajo mbeti për 50% nën këtë mesatare.

Revizionistët jugosllavë mundohen ta paraqesin si shembull të "kujdesit" e "ndihmës" së bashkësisë jugosllave për Krahinën e Kosovës ndarjen e ndonjë kredie të brendshme, apo garantimin për ndonjë borxh të jashtëm. Por, këto "ndihma" jepen jo për ta zhvilluar Kosovën, por për ta skllavëruar atë akoma më shumë. Republikat jugosllave nuk investojnë në zhvillimin e atyre degëve që i duhen Kosovës, por kryesisht në kapacitete nxjerrëse të lëndëve të para, prej të cilave ato nxjerrin fitime të mëdha.

Kohëve të fundit Kosovën e vizituan funksionarë e grupe të ndryshme punuese nga Serbia e Jugosllavia. Të gjithë ata i "preokupoi" gjendja e vështirë në të cilën ndodhet ekonomia e Kosovës dhe u angazhuan për "zhvillimin e saj më të shpejtë"! Por, se çka i preokuponte ata në të vërtetë, se çfarë zhvillimi të Kosovës dëshironin ata, tregon më së miri potencimi nga të gjithë ata i nevojës së intensifikimit të eksploatimit të mëtejshëm të thëngjillit dhe pasurive tona të tjera. Ja, kështu duan ta "zhvillojnë më shpejt" revizionistët Kosovën tonë të pasur dhe njëkohësisht të varfër.

Gjendjen edhe ashtu të rëndë të ekonomisë së Kosovës, po e rëndon edhe më tepër përballimi i shpenzimeve për policinë, UDB-në dhe ushtrinë fashiste, që u dyndën në Kosovë pas demonstratave.

Në një kohë që dhjetëra mijëra të papunë bredhin rrugëve, kur mijëra familje nuk mund të sigurojnë as kafshatën e gojës, kur mësimi mbahet nëpër shtëpi private kur qindra fshatra janë të paelektrifikuara ende, kur studentët tanë teren nëpër bodrumet e borgjezisë, pa bursë e kredi, pa tekste e veshmbathje, regjimi titist, që të forcojë aparatin e tij të dhunës, po hap vende të reja të punës për forcat policore. Këto ditë nga Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme u shpall konkursi për pranimin brenda një kohe të shkurtër të mijëra policëve e spiunëve. Pagat që u jepen atyre dhe kushtet e tjera që u krijohen, janë nga më të mirat, mjafton që ata të tregohen të zellshëm për të vrarë e torturuar popullin.

Prapambetjen e thellimin e krizës në Kosovë, revizionistët jugosllavë dhe tradhtarët shqiptarë, mundohen ta shpjegojnë me prapambetjen shekullore të popullit tonë, me dobësitë subjektive në këto kohët e fundit edhe me "dëmet" që gjoja i kanë shkaktuar grevat e demonstratat që u bënë në Kosovë. Mirëpo, as njëri, dhe as arsyetimi tjetër, nuk mund ta mashtrojnë kënd. Populli ynë nuk u ngrit në luftë për të shkaktuar thellimin e kësaj krize, por pikërisht pse nga kriza e rëndë jeta e tij qe bërë e padurueshme.

Nuk janë "liria e tepërt", "bollëku i madh" dhe as dëshira për të mos qeverisur veten, ato që e detyruan popullin tonë të ngritet në këmbë, por gjendja e padurueshme, në të cilën ndodhet, shtypja dhe shfrytëzimi i egër që ushtrohet mbi të.

Lufta revolucionare e klasës punëtore dhe e gjithë popullit tonë për të drejta dhe liri, jo vetëm që nuk e vështirëson gjendjen në Kosovë, por ajo është e vetmja rrugë për përmirësimin e saj, e vetmja rrugë për ta nxjerrë Kosovën tonë nga kriza dhe prapambetja e madhe, e vetmja rrugë që të mos ketë ngritje çmimesh, mungesë mallrash, papunësi e kurbet, skamje dhe mjerim, e vetmja rrugë që njerëzit të jetojnë të lirë, të lumtur dhe zotër të punës dhe të tokës së tyre. (LIRIA, gusht 1981, faqe 16-18)

4-5-8. SUKSESE DHE PERSPEKTIVA MADHËSHTORE

Nga Kadri Zeka

Para sa kohe në Tiranë zhvilloi punimet Plenumi i 10-të i KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili bëri bilancin e sukseseve madhështore të arritura gjatë pesëvjeçarit të kaluar dhe miratoi Projektdirektivat për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës gjetë planit të shtatë pesëvjeçar, të cilat do t'i paraqiten për aprovim Kongresit të 8-të në nëntor të këtij viti.

Megjithë rrethimin e egër kapitalisto-revizionist, Shqipëria socialiste po marshon e sigurt dhe me hapa kilometër drejt majave më të larta të socializmit. Në kohën që bota borgjezo-revizioniste po lëngon nga plagët e pashërueshme të krizës së rëndë e të përgjithshme, Shqipërinë socialiste çdo vit e pesëvjeçar e gjen në lartësi të reja dhe me fitore të mëdha në të gjitha fushat.

Nën udhëheqjen e pagabueshme e largpamëse të Partisë, klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse në Shqipëri, megjithë vështirësitë e shkaktuara nga revizionistët kinez, arritën të realizojnë me sukses detyrat kryesore të planit të gjashtë pesëvjeçar.

Gjatë periudhës 1975-1980 produkti shoqëror u rrit rreth 25% që është rreth dy herë më shumë se shtimi i popullsisë, kurse prodhimi i përgjithshëm industrial, për çdo vit, u rrit mesatarisht për 6,1%. Vetëm gjatë dy vjetëve të fundit të pesëvjeçarit, megjithë ndërprerjen e ndihmave e kredive nga revizionistët kinezë, produkti shoqëror u rrit rreth 10%, kurse ritmi mesatar vjetor i prodhimit të përgjithshëm industrial ishte 17% më i lartë se gjatë dy vjetëve të para. Në krahasim me vitin 1975, nxjerrja e qymyrgurit në vitin 1980 u shtua për 63%, kurse prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet për jo më pak se tri herë. Industria metalike arriti të realizojë detyrën për plotësimin e 95% të nevojave të ekonomisë për pjesë ndërrimi, kurse prodhimi i maqinerive dhe pajisjeve më 1980 ishte për 57,7% më i madh se në vitin 1975. Si rezultat i zhvillimit të shpejt të industrisë së lehtë dhe asaj ushqimore, prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë ishte për 6,5 herë më i lartë se shtimi i mesatares së popullsisë.

Suksese të mëdha u arritën edhe në prodhimin bujqësor, i cili në krahasim me atë të pesëvjeçarit, u rrit për 21,4%. Sipërfaqja tokësore e ujitshme u shtua edhe për afro 40 mijë hektarë, e prodhimi i plehrave kimike u rrit për jo më pak se 50%.

Vëllimi i investimeve gjatë pesëvjeçarit të gjashtë ishte për 15% më i madh se gjatë pesëvjeçarit të mëparshëm, ndërsa vëllimi i transportit të mallrave u rrit për rreth 30%.

Rezultate të mëdha, ashtu si në çdo fushë tjetër, u arritën edhe në fushën e arsimit e të kulturës. Gjatë pesëvjeçarit u përgatitën 20 mijë kuadro të specialiteteve të ndryshme, që është 27% më shumë se në pesëvjeçarin e mëparshëm.

Këto suksese madhështore dëshmojnë më së miri për vitalitetin e sistemit socialist dhe epërsinë e tij ndaj sistemit të kalbur kapitalisto-revizionist. Ato hedhin poshtë më së miri edhe shpifjet e trillimet e propagandës borgjezo-revizioniste kundër socializmit fitimtar që po lulëzon në Shqipëri.

Le të lehin sa të duan revizionistët titistë kundër Shqipërisë. Gënjeshtrat, shpifjet e trillimet nuk mund ta mbulojnë të vërtetën. Shqipëria e kuqe e Enver Hoxhës, është sot i vetmi vend i vërtetë socialist, e vetmi vend që nuk njeh krizë e inflacion, ngritje çmimesh, kurbet e papunësi, i vetmi vend ku populli nuk paguan asgjë për shkollim dhe shërbimin mjekësor, i vetmi vend ku njerëzit jetojnë me të vërtetë të lirë dhe të lumtur.

Madhështore janë sukseset që ka arritur Shqipëria gjatë planeve të kaluara pesëvjeçare, por edhe më madhështore do të jenë fitoret që do të arrihen në të ardhmen. Projektdirektivat e Partisë për Planin e shtatë pesëvjeçar i hapin perspektiva të reja e të sigurta marshimit të pandalshëm të Shqipërisë socialiste.

Duke u mbështetur krejtësisht në forcat e brendshme njerëzore, materiale e financiare, Shqipëria socialiste do të arrijë suksese të reja, akoma më të mëdha, në të gjitha fushat e jetës. Në krahasim me vitin 1980, sipas direktivave të Partisë, në vitin 1985, shtimi i prodhimtarisë dhe i të ardhurave në RPS të Shqipërisë do të duket si në tabelën vijuese:

Produkti i përgjithshëm shoqëror	32 – 34 për qind
Produkti i përgjithshëm industrial	34 – 36 për qind
Produkti i përgjithshëm bujqësor	31 – 33 për qind
Investimet themelore	23 – 25 për qind
Transporti i mallrave	36 – 38 për qind
Rendimenti i punës	12 – 16 për qind
Të ardhurat kombëtare	33 – 35 për qind
Të ardhurat reale	8 – 10 për qind
Të ardhurat e përgjithshme financiare	34 – 36 për qind

Gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm parashikohet një zhvillim me ritme të shpejta i industrisë dhe i të gjitha degëve të saj. Ashtu si edhe më parë, një kujdes i veçantë do t'i kushtohet shtimit të prodhimit të mjeteve të prodhimit. Në vitin 1980 ky grup përbënte 64% të prodhimit të përgjithshëm industrial, kurse gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm është parashikuar që prodhimi në të rritet 38-39%.

Në krahasim me vitin 1980 nxjerrja e naftës në vitin 1985 parashikohet të rritet 56-58%, ajo e qymyrgurit rreth 48%, e bakrit 52% etj. Rritje të dukshme do të shënojë edhe prodhimi i çeliqeve të petëzuara, i cili më 1985 do të jetë 67% më i madh se në 1980 kurse ai i ferokromit karbonik, edhe më i madh – 80%.

Rritje të dukshme gjatë këtij pesëvjeçari do të ketë edhe industria mekanike, procesi i së cilës do të rritet për 38-40%,ripërtrirja e pjesëve të ndërrimit - 54% deri 56%, kurse prodhimi i makinerive për pajisje do të rritet 51%.

Një rëndësi e madhe gjatë viteve të ardhshme do të t'i kushtohet edhe zhvillimit të industrisë kimike, prodhimi i së cilës do të rritet për jo më pak se 60-63%.

Në zhvillimin e bujqësisë socialiste, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet rritjes së rendimentit të prodhimit nga i cili do të sigurohet rreth 90% e shtimit të përgjithshëm bujqësor. Krahas kësaj, do të hapen edhe 26 mijë hektarë tokë të re, kurse tokës së ujitshme do t'i shtohen edhe 45 mijë hektarë. Një punë e madhe do të bëhet gjatë Pesëvjeçarit të 7-të edhe për drenazhimin e përhershëm nëntokësor, sipërfaqja e të cilit do të arrijë në 85 mijë hektarë. Të gjitha këto do të bëjnë të mundshme që prodhimi i drithërave të bukës gjatë Pesëvjeçarit të rritet rreth 20%, rendimenti mesatar vjetor i misrit rreth 26%, kurse prodhimi mesatar vjetor i pangjarsheqerit do të jetë 42-45% më i madh se gjatë pesëvjeçarit të mëparshëm, ai i luledielli t 56-58%, i pambukut 56-59% e ai i duhanit 46-49% etj.

Me kujdesin që do t'i kushtohet përmirësimit racor të të gjitha llojeve të kafshëve, gjatë viteve të Pesëvjeçarit, do të arrihet një ngritje cilësore e sasiore e prodhimit të mishit dhe prodhimeve blegtorale. Në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, prodhimi i mishit do të rritet 53-55 për qind, i qumështit 29-31%, i vezëve 50-52% dhe i leshit 34-36%.

Rezultate të mëdha gjatë Pesëvjeçarit të 7-të do të arrihen edhe në zhvillimin e pemëtarisë. Prodhimi i frutave, gjatë këtij Pesëvjeçari, do të jetë 35-37% më i madh se ai i planit të mëparshëm, i rrushit 40-43%, i agrumeve 48-51%, i ullirit 66-70%.

Në projektdirektivat për Planin e 7-të pesëvjeçar, është paraparë që fondi i akumulimit të rritet 67-69%, kurse norma e akumulimit për pesë vjet të marrë së bashku 31-33%. Vëllimi i investimeve do të rritet 23-25%, kurse 75% e vëllimit të tyre të përgjithshëm do të përdoret për zhvillimin e industrisë e të bujqësisë.

Një zhvillim të hovshëm do të ketë edhe transporti e telekomunikacioni. Do të hapen linja të reja hekurudhore, do të përmirësohet më tej rrjeti automobilistik, do të shtohet komunikacioni ujor dhe ai me teleferik. Në krahasim me vitin 1980, vëllimi i përgjithshëm i transportit të mallrave, më 1985 do të rritet 36-38%, kurse ai i transportit të mallrave në hekurudhë për jo më pak se 80-84%.

Një rritje të shpejtë gjatë viteve 1981-1985 do të shënojë edhe tregtia e jashtme e Shqipërisë. Vëllimi i përgjithshëm i eksportit do të rritet për 56-58% kurse shumicën e tij dërmuese do ta përbëjnë mallrat e përpunuara në vend. Ashtu si deri më tash, eksporti do ta mbulojë importin, e do t'u sigurojë vendin edhe rezervave valutore.

Zhvillimi i hovshëm dhe i gjithanshëm që është arritur në Shqipëri, bën të mundshme ngritjen e mëtejshme të mirëqenies materiale e kulturore të masave punonjëse. Të ardhurat reale të punonjësve do të kenë ngritje të vazhdueshme, ndërsa qarkullimi i mallrave me pakicë do të rritet 22-24%. Ashti si deri më tani, në Shqipëri nuk do të ketë ngritje çmimesh, rënie pagash, mungesë mallrash e plagë të tjera si këto që po e brejnë sot botën kapitalisto-revizioniste.

Gjatë Pesëvjeçarit të 7-të parashihet që me mjete financiare të shtetit dhe me kontribut vullnetar, të ndërtohen rreth 50 mijë apartmente banimi, si dhe do të sigurohet material ndërtimor për ndërtimin e 31 mijë banesave nga vetë fshatarësia koperativiste. Shërbimet, riparimet, meremetimet dhe punimet me porosi për popullin nga ndërmarrjet komunale do të rriten 45-47%, kurse ato në koperativat bujqësore deri në 84%.

Rezultate të mëdha do të arrihen gjatë këtij pesëvjeçari edhe në zhvillimin e arsimit, kulturës, artit, letërsisë, shëndetësisë, kulturës fizike dhe sportit. Numri i studentëve në shkolla të larta në vitin 1985 do të jetë 24% më i madh se më 1980, kurse ai i nxënësve në shkolla të mesme me shkëputje nga puna – rreth 44%. Mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist dhe të politikës së Partisë një zhvillim të mëtejshëm do të shënojë revolucioni tekniko-shkencor në të gjitha fushat e ekonomisë dhe të kulturës.

Detyrat që shtrohen në projekt, direktivat e Kongresit të 8-të janë vërtetë të mëdha, por klasa punëtore, fshatarësia koperativiste dhe i gjithë populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës e shokut Enver Hoxha, me siguri që do t'i realizojnë ato me sukses, duke i treguar në këtë mënyrë botës se ç'është në gjendje të bëjë një popull, qoftë ai edhe i vogël në numër, kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste. Ashtu si edhe deri më tani, Shqipëria e kuqe e Enver Hoxhës do të vazhdojë të qëndrojë kështjellë e pamposhtur e socializmit, fener ndriçues për të gjithë botën. (LIRIA, gusht 1981, faqe 19-20)

4-5-9. ZEMRA SPECIALE

Nga Hydajet Hyseni

Në dy anë të barrikadës
Qëndrojnë grushti e bajoneta
Në njërën anë yje,
Në tjetrën hemeta.

Breshër bombash seç na hidhte
Polici e zezë, "speciale",
Po me gjokset të shpalosur
Hidhet Djalëria kosovare.

"Shpërndahuni", çirren helmetëzinjtë,
"Është e kotë qëndresa juaj;
Rrobat tona s'i shpon plumbi,
Pa le më gurët tuaj..."

Armë, çelik – e dimë – ju keni,
Keni tanke e avionë,
Po grushti ynë i bashkuar
Është më i fortë se çdo atom.

Jelekë specialë mund të keni,
Ju, ujq të zinj të Serbisë,
Porse ne veshur kemi lindur
Me xhamadana të trimërisë.

Rrobat e hekurta sa ju bëjnë punë,
Pasi nuk keni ideale;
Ne kemi rroba të zakonshme,
Po zemrat i kemi speciale!

4-5-10. Të gjithë shqiptarët – Mic Sokola

Nga Hydajet Hyseni

Kam parë trimin e Kosovës
Tankut para si i doli,
Para grykës hapi gjoksin,

Sokëllin si Mic Sokoli...

Kam parë djemtë e Kosovës
Si nga sytë nxirrnin shkëndija,
Vërsulen mbi mitraloza,
Si dikur Selam Salaria.

Përmbi tanke i kam parë
Sikur Vojo Partizani,
Pionierët mbi mitraloza
Si dikur Çelo Sinani.

Kam parë vajzat e Kosovës,
Kam parë nëna shamizeza,
Qëndronin përballë dushmanit
Si Shotë Galica e Mine Peza...

E kam parë xhamadanin
Që e veshi gjithë Kosova,
Dhe në të – me gjak – të shkruar:
"Të gjithë shqiptarët – Mic Sokola"!
(LIRIA, gusht 1981, faqe 20)

4-5-11. ATENTAT KUNDËR PERANDORIT

NASHO JORGAQI

Në prill të vitit 1939, Italia fashiste pushtoi Shqipërinë, duke kryer një aksion barbar kundër vendit tonë. Me këtë akt ajo synonte të realizonte ambiciet e saj imperialiste për ta kthyer Shqipërinë në një koloni të saj të përhershme.

Për të vënë në jetë planet e tyre aneksioniste, në maj të vitit 1941, fashistët organizuan me pompozitet të madh vizitën në Shqipëri të Viktor Emanuelit të III-të, të mbiquajtur edhe "mbret i Shqipërisë e perandor i Etiopisë".

Në atë kohë rezistenca e popullit shqiptar kundër zaptonjësve fashistë ishte në rritje. Anëtarët e grupeve komuniste ishin hedhur në veprime konkrete, çetat e para kryengritëse po organizoheshin në krahina të ndryshme të vendit; kurse patriotët – punëtorë, fshatarë e intelektualë përparimtarë zhvillonin një rezistencë gjithnjë në rritje kundër masave kolonizuese e çkombëtarizuese që kishin ndërmarrë fashistët në të gjitha fushat e jetës. Në këtë situatë shumë të rëndë, doli nga radhët e tyre, si shprehës i aspiratave liridashëse të gjithë patriotëve e të masave të gjera, i riu punëtor 21 vjeçar Vasil Laçi, biri i një familje të varfër nga katundi Piqeras i Bregdetit të Sarandës, i cili shtiu me revolver kundër perandorit fashist në Tiranë, ndërsa po largohej nga Shqipëria.

Vasili e kreu atentatin në mes të një turme oficerësh fashistë dhe ndodhi që në çastin më nevraligjik të veprimit, njëri prej fashistëve, në përpjekje për t'i kapur dorën, u ndërroi drejtimin goditjeve. Megjithatë vullneti i popullit shqiptar nëpërmjet dorës së Vasilit ishte shprehur, urrejtja kundër mbretit pushtues ishte shpallur botërisht. Fasada e butaforisë e pompoziteti i pritjes fashiste të perandorit ishin rrëzuar për tokë. Megjithëse perandori nuk u vra, politikisht atentati i Vasil Laçit ishte një mohim i guximshëm i perandorit dhe i zaptonjësve që ai përfaqësonte, ishte shprehje e dëshirës dhe pasqyrë e

gjallë e rritjes së rezistencës së popullit tonë. Në këtë mënyrë akti i Vasil Laçit hynte "në historinë e Shqipërisë – siç e ka cilësuar shoku Enver Hoxha – si simbol i guximit e i trimërisë", "si fillim i kryengritjes së armatosur", duke i treguar me shembullin e tij "popullit shqiptar që duhej luftuar njëkohësisht si kundër mbretit ashtu edhe kundër okupatorit që ai përfaqësonte".

Kërkimet dhe gjurmimet në jetën e Vasil Laçit nxjerrin para studjuesve fakte dhe hollësi që hedhin dritë mbi figurën e heroit. Kështu, duke e "rindërtuar" sot jetën e tij të shpërndarë në kujtesën e popullit dhe nëpër dokumente arkivale, duke i lidhur faktet me logjikën e tyre të pakundërshtueshme, duke e vendosur figurën e heroit në shtratin e historisë, duke e parë atë nga lartësia e kohës sonë, kuptojmë edhe më mirë madhështinë e gjestit historik të tij.

Vasili ishte punëtor, njeri i vuajtur, që kishte provuar skamjen dhe shtypjen; ai i jetonte shpirtërisht përpjekjet e komunistëve për klasën e tij, merrte pjesë në demonstratat antifashiste që mbushnin aso kohe sheshet dhe rrugët e Tiranës, ai lexonte literaturë komuniste e njihej drejtpërdrejt me komunist të grupeve revolucionare.

Të gjitha këto i hapin sytë punëtorit patriot, i ndiznin zemrën flakë, i mbrunin urrejtjen, e hidhnin në mendime serioze për fatin e atdheut të robëruar. Pikërisht në këtë kohë ai zuri të shkruante dhe vargje e vjersha patriotike.

Ata që e njohën nga afër Vasilin, tregojnë se nën ndikimin e faktorëve të rinjë revolucionarë që po hynin në jetën e popullit tonë, ndodhi tek ai një zgjim i shpejtë i ndërgjegjes politike, nisi procesi i formimit të tij si luftëtar kundër pushtuesve fashistë.

Në ditët që erdhi në Shqipëri Viktor Emanueli i III-të, Vasili e kuptoi se me emrin e tij lidheshin tërë pushtimet dhe luftrat grabitqare të imperializmit italian. Ushtria e Perandorit fashist kishte pushtuar jo vetëm tokat e Shqipërisë, por edhe ato të Libisë, të Etiopisë dhe të Somalisë. Mbi të gjitha ky mbret kishte firmuar dy herë aktin e turpshëm të pushtimit të Shqipërisë, më 1920 dhe më 1939. Mbreti dhe pushtimet e Italisë fashiste ishin për Vasilin sinonime të njëri tjetrit.

Kjo shpjegon atë ndjenjë të fuqishme patriotike që u zgjua te Vasili e që u rrit gjatë javës që mbreti udhëtonte nëpër Shqipëri. Ai i ndoqi me kujdes lëvizjet e "korteut" mbretëror, duke mposhtur në heshtje zemërimin e përgatitej shpirtërisht për aktin e tij heroik.

Me hetimin dhe përgatitjen e gjyqit të Vasilit u morën jo vetëm organet më të larta të administratës mbretërore, por u krijuan edhe grupe hetuese të veçanta, si nga monarkistët ashtu edhe nga fashistët, jo vetëm për shkak të mosbesimit reciprok dhe të divergjencave që ekzistonin ndërmjet tyre, por edhe që të mposhtnin moralisht heroin, të bënin që të mohonte aktin e tij. Por më kot. Vasili mbajti qëndrim burrëror përpara torturave të fashistëve dhe e përbuzi vdekjen me krenari. Stuhisë së pyetjeve, presioneve e torturave ai iu përgjigj me fjalët e thjeshta "E bëra nga dashuria për Shqipërinë".

Atentati i Vasil Laçit pati jehonë të madhe në Shqipëri e në arenën ndërkombëtare. Akti i tij u bë shembull frymëzimi në luftën e madhe Antifashiste të popullit tonë, e cila me themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare, në nëntor 1941, u shndërrua në luftë të organizuar revolucionare që shpuri në çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe e bëri populli zot të plotëfuqishëm të fateve të tij.

Vasil Lacit i është dhënë titulli i lartë "Hero i Popullit". Shtëpia e tij në vendlindje është bërë muze, ku vizitorët e ndryshëm njihen me jetën e tij revolucionare. Në vendin ku ai kreu atentatin, në një rrugë të Tiranës, është vendosur një skulpturë që e tregon heroin duke qëlluar me revolver. (LIRIA, gusht 1981, faqe 21)

4-5-12. LETËR E HAPUR PUNËTORËVE KOSOVARË NË MËRGIM

Nga Kadri Zeka

Të dashur vëllezër,

Një mjet i rëndësishëm në duart e armiqve tanë shovinistë për sllavizimin e tokave shqiptare, ka qenë dhe mbetet shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e veta shekullore.. Titistët, këta armiq të përbetuar të popullit tonë, si erdhën në fuqi, kurdisën plane të reja për ta ngritur në sistem këtë politikë. Atyre nuk u mjaftuan marrëveshjet e kontraktuara të Jugosllavisë Monarkiste me Turqinë për dëbimin e shqiptarëve dhe vendosjen e tyre në shkretëtirat e Anadollit, por arritën marrëveshje të reja me reaksionin turk për dërgimin në Turqi të kontigjenteve të reja të shqiptarëve.

Sipas statistikave që japin vetë revizionistët, del se regjimi antipopullor i Titos dëboi me dhunë e presione qindra mijëra shqiptarë në shkretëtirat e Anadollit e gjetkë. Më vonë, kur shovinistët serbomëdhenj iu bë e pamundur një formë e tillë, e vrazhdët e shpërnguljes së shqiptarëve, ata shpikën një formë të re, më të rafinuar, atë të emigrimit ekonomik, që në fakt nuk ndryshon nga e para.

Skamja dhe mjerimi i madh, papunësia e presionet që ushtron pushteti, kushtëzuan që kurbeti për popullin tonë të bëhet një fenomen masiv. Sot janë të pakta ato familje që nuk kanë së paku një anëtar të mërguar, Kështu njerëzit tanë u detyruan të shiten tek kapitalistët e huaj, të shkojnë e të mëkëmbin ekonominë e revanshistëve gjermanë, që na vranë e na prenë gjatë luftës së fundit.

Revizionistëve e tradhtarëve, jo vetëm që nuk u vjen keq për këtë tregti të poshtër me njerëz, por mburren dhe mundohen ta paraqesin kurbetin si diçka të mirë, si një meritë të tyre të jashtëzakonshme, si shprehje të "lirisë" dhe "demokracisë", që ekzistoka në Jugosllavi. Këta të fantaksur s'ngurojnë të na i servirin edhe poshtërsitë më të mëdha si virtyte të sigurta, duke shitur dhallën për gjalpë, sado që bota e shquan dhallën dhallë e gjalpin gjalpë. Sikur kurbeti të kish qenë shprehje e lirisë dhe demokracisë, atëherë liria e demokracia do ta kishin burimin te Spanja fashiste, te Turqia anarkiste, te Portugalia e Italia dhe, natyrisht, te Jugosllavia, që dallohen për eksportin më të madh në botë – të krahut punëtor. Popullit tonë do t'i bëhej shumë qejfi po t'ia merrnin këtë "liri" e "demokraci" dhe t'u siguronin bijve të tij punë në atdhe.

Kurbeti është një plagë e vjetër e popullit tonë. Për të tregohen rrëfimet më rrënqethëse e këndohen këngët më të trishtuara. Ne, vëllezërit e motrat tuaja në Kosovë, jemi të vetëdijshëm për gjendjen tuaj të vështirë e jetën e rëndë që bëni. E dimë sa rëndë është për ju kur e shihni veten të shtypur e të përbuzur si mos më keq, kur ju mungon fjala e njerëzishme dhe ju jepet me bollëk vrazhdësia e përbuzja. Kur i huaji të çirret, të shan e të poshtëron për asgjë. E rëndë është kjo jetë, por ç'të bëjmë. Rëndë është të kalohen dhjetëra vite, një rini e tërë, në kthina barakash, të cilat vendasit nuk i bëjnë kabull as për kafshët e tyre. Rëndë kur kthehesh nga puna, i lodhur e i këputur dhe s'ke pranë njeri nga të tut të familjes sate të dashur, të krijuar me shpirt ndër dhëmbë e të ngritur me treqind mundime skamnore. Në vend që të rish me njerëzit e tu, të gëzohesh duke u çmallur, ti detyrohesh të përgatisësh darkën që të vjen e hidhur pelin. E rëndë është të lësh rininë nëpër metropolet e Evropës, të mplakesh e thinjesh larg njerëzve të tu, të sosësh ditët në dhe të huaj, të biesh e të çohesh me fotografinë e fëmijëve në gji, por edhe më rëndë kur shkon për pushim në atdhe e atje s'të njeh më fëmija yt, se e ke lënë foshnjë e tash që ka zënë të shquajë njerëzit e shtëpisë, ty të quan të huaj, se s'të ka parë asnjëherë. Ose, të thërrasë: dajë, fëmija yt! E rëndë dhe e ftohtë është gjithçka në kurbetin e mallkuar. Por,

tjetër shteg s'u la regjimi titist njerëzve tanë. Ose në shtëpi e pa bukën e gojës për fëmijët, ose në kurbet, duke shitur krahët dhe rininë, e për t'u siguruar një kafshatë goje fëmijëve që – të të thërresin dajë!

Për çdo ditë bijtë e Kosovës marrin valixhet në duar, përshëndeten me njerëzit e vet me lot në sy e me dhembje të thellë, përshëndeten me prindërit, që, ndoshta, nuk do t'i shohin kurrë më të gjallë, me gratë që pranë burrave mbeten të veja, me fëmijët që mbeten jetimë, ndonëse me babën gjallë. Përshëndeten me vatrën e tyre të dashur, me tokën e lumin, me malin e fushën, e cila nuk bleron për ta, me burimet pranë të cilave kanë kaluar ditët e bardha të fëmijërisë, përshëndeten me varret e të parëve, përshëndeten, se është punë që nuk i dihet. Rruga që marrin është e gjatë, rrugë e zezë dhe kthimi – kurrë i sigurt. Shumë u nisën në këtë rrugë të trishtueshme dhe s'u kthyen kurrë.

Një ndarje e vetme e kurbetçarit me njerëzit dhe vendin e vet, do të duhej ta pikëllonte botën. Kurse kurbetçarët tanë s'janë një e dy, po me dhjetëra mijëra. Dhembja e ndarjes bëhet kështu më e madhe. Dhe te ne, kjo është bërë një dhembje e gjithë popullit.

Të gjithë punëtorët në kapitalizëm janë të shtypur, të shfrytëzuar , të përbuzur e të poshtëruar. Por, punëtorët e huaj dhe në mes të tyre sidomos shqiptarët, janë më të shfrytëzuarit ndër të shfrytëzuar. Ata i ke në punët më të vështira , e me rreziqe, të diskriminuar me paga simbolike, e shumë prej tyre edhe pa asnjë mbrojtje sociale. Për të siguruar bukën e fëmijëve, punëtorët tanë në mërgim duhet të hanë bukën thatë. Edhe ato pak të holla që kursejnë, regjimi titist ua rrëmben nga duart akoma pa i dërguar në shtëpi.

Njëri pas tjetrit vijnë përfaqësuesit e bankave për të mashtruar sa më shumë punëtorë që të mbushin me deviza arkat e shtetit të tyre të falimentuar. Vijnë gjithfarë emisarësh të shtetit, me gënjeshtra e premtime se gjoja do të hapin vende të reja pune për punëtorët tanë të mërguar. Vijnë si korba për t'i bindur të marrin pjesë në të ashtuquajturat vetëkontribute që duhet të japin punëtorët gjoja për ndërtimin e rrugëve, shkollave e ambulancave. Llafazanë e demagogë të tjerë vijnë njeri pas tjetrit e u flasin punëtorëve për gjoja "parajsën" titiste, për "zhvillimin e përparimin" e Kosovës, për "bashkim-vëllazërimin" titist që gjoja ekzistoka kudo në Jugosllavi, e sidomos në Kosovë.

Gjakpirësit titistë nuk harrojnë të organizojnë edhe "pritje" për punëtorët e mërguar kur këta vijnë për pushime. Në këto farë "pritjesh", udbashët e shumtë i kërcënojnë punëtorët të mos shoqërohen me punëtorët e vendeve ku punojnë, të mos solidarizohen me ta e të mos organizohen në sindikata, të mos lexojnë ndonjë revistë shqiptare e të mos dëgjojnë radion socialiste të Tiranës etj. Për të gjitha këto raste, kërcënohen udbashët, ne do t'ju burgosim e t'ju marrim pasaportat. Në vend që, sipas "lirive" e "demokracisë" së madhe, të interesohen për kushtet e rënda të jetës e të punës së punëtorëve tanë të mërguar, titistët kujdesen që punëtorët tanë të prishen e të degjenerohen më shumë, të humbin çdo ndjenjë kombëtare e progresive. Për këtë qëllim, titistët kanë ngritur si kërpudhat pas shiut, klubet e ashtuquajtura të punëtorëve, ku shfaqin filma pornografikë, që i sjellin nga Jugosllavia, organizojnë në këto klube koncerte me hipitë Made in Jugoslavia, shpërndajnë revista e gazeta të degjeneruara, që titizmi i ka me bollëk.

Me veprimet e "këshillat" e veta, titistët u thonë punëtorëve se mund të bëjnë ç'të duan, se janë të lirë të bëhen rrugaqë e pijanecë, aventurierë e kaubojë, mund të vjedhin e bile edhe të vrasin edhe njëri-tjetrin. Ne s'kemi gjë kundër, thonë ata, burgut mund t'i shpëtoni duke dhënë disa mijëra marka e franga ryshfet. Mund të bëni gjithçka, vetëm me politikë nuk guxoni të merreni, pra nuk guxoni të mendoni për gjendjen tuaj të mjeruar, për ardhmërinë tuaj dhe të fëmijëve tuaj. Për këto mendojnë kokat e "mëdha" e të

“ndritura”, zotërinjtë Miniç, Kolishevski e Deva me shokë. Ai që guxon të mendojë e të veprojë ndryshe, do të hidhet në pranga.

Çfarë nuk bëjnë titistët për të mashtruar e përçarë punëtorët tanë. Agjentura e UDB-së jashtë është e përhapur kudo. Ajo vepron kudo, mundohet t’i gënjejë e mashtrojë punëtorët, t’i përçajë ata, duke vënë njërin kundër tjetrit, bën lojën e premtimeve të rrejshme, kompromenton me të holla ndonjë element të dobët e mendjelehtë. Disa të tjerë i kërcënon. E çfarë nuk bëjnë udbashët e përfaqësive diplomatike dhe të tjerët që vijnë nga Jugosllavia.

Por ju, punëtorët tanë trima e atdhetarë, e keni kuptuar mirë kush janë titistët, e keni kuptuar me çfarë armiqsh keni të bëni. Fytyrën e vërtetë prej xhelati të titistëve e patë më së miri kohën e fundit, me terrorin e pashpirt që ushtrojnë ata në Kosovë. E patë atëherë kur, shumë prej jush, morët telegrame, me të cilat ju ftonin e ju njoftonin te shtëpia për vrasjen e të afërmve tuaj në demonstrata, kurse xhandarët fashistë të Titos ju ndalën në kufi dhe nuk ju lejuan të vini e të varrosni vëllezërit e motrat tuaja.

Bashkatdhetarë të shtrenjtë,

Atdheu ynë i përbashkët, Kosova jonë e dashur, po përjeton momente shumë të vështira. Çetnikët serbë u vërsulën me tërbim drejt Kosovës. U dyndën këtu dhjetëra mijëra policë e ushtarë të rinj. Ata shuan me gjak demonstratat paqësore të popullit tonë, e kthyen në kasaphanë të tmerrshme Kosovën tonë të dashur, shtinë me tanke e mitraloza mbi vëllezërit e motrat tona të pambrojtura, vranë e plagosën shumë bija e bij nga më të mirët të popullit, burgosën e arrestuan me mijëra të tjerë dhe po ushtrojnë tortura shtazarake mbi ta. Masa të shumta antishqiptare po ndërmirren në çdo fushë. Shovinistët jugosllavë kanë ndërmarrë një fushatë të gjerë shpifjesh e akuzash kundër popullit tonë dhe historisë së tij të lavdishme. Po sulmohen e po fyhen heronjtë dhe simbolet tona kombëtare, kultura e traditat tona, po bëhen përpjekje për të na rrëmbyer edhe ato pak të drejta që i kishim fituar me gjak pas vitit 1968.

Këtë vit u mbyll para kohe Universiteti i Kosovës e po kurdisen plane edhe për shkapërderdhjen e tij të plotë. U anuluan të gjitha marrëveshjet me Shqipërinë në fushën e artit, shkencës, kulturës dhe arsimit. Është vendosur të ndryshohen e sakatohen tekstet shkollore të historisë e të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Shqiptarët rrahen e dënohen vetëm pse mbajnë një distiktiv a një plis të bardhë. Në të ashtuquajturin “proces të diferencimit”, janë larguar nga puna shumë profesorë të Universitetit e shumë mësimdhënës të shkollave të mesme dhe atyre fillore. Janë hedhur në rrugë qindra punëtorë të ndërmarrjeve pse kanë marrë pjesë në greva e demonstrata, apo pse nuk i kanë dënuar ato.

Të gjitha këto masa të tipit fashist nuk e ligështojnë ose nënshtrojnë popullin tonë po përkundrazi e kanë forcuar atë edhe më shumë. I bashkuar si kurrë më parë, ai po qëndron kryelartë para xhelatëve titistë dhe është i vendosur e këmbëngulës në realizimin e kërkesave të veta e të drejta. Në mbledhjet që po organizon armiku për të dënuar demonstruesit, populli po e shpreh revoltën e urrejtjen e tij të papërmbajtur kundër këtyre dënimeve dhe pushtetit antipopullor. Kjo rezistencë e mrekullueshme e ky unitet i paparë i popullit tonë, jo vetëm që po shprehet në tubimet e kolektivave punonjëse dhe të atyre të lagjeve, por ka dalë sheshit edhe në ato organizata që kanë qenë leva të titizmit, duke filluar që nga organizata e Lidhjes së “komunistëve”, ku janë përjashtuar qindra anëtarë e janë shpërndarë dhjetëra organizata bazë, e deri te organizata e rinisë dhe ajo e Lidhjes Socialiste. Armiku është detyruar ta pohojë me gojën e vet se i kanë dalë telashe serioze edhe në organizatën e oficerëve rezervë dhe në atë të Lidhjes së Luftëtarëve, nga radhët e të cilave janë përjashtuar dhjetëra anëtarë. Bile, rezistencë po bëhet edhe në radhët e policisë kosovare.

Vëllezër punëtorë në mërgim,

Sot që i gjithë populli ynë heroik është ngritur në këmbë si një trup i vetëm dhe po kërkon të drejtat e veta të ligjshme, edhe juve, si bijë besnikë të këtij populli, ju dalin përpara detyra të shumta e të rëndësishme. Ne, marksistë-leninistët dhe revolucionarët e Kosovës, kemi besim të plotë te ju dhe jemi të sigurt se, ndonëse larg atdheut edhe ju do të qëndroni të patundur me kërkesat e drejta të popullit tonë dhe të ngreni lart e më lart zërin kundër shtypësve gjakatarë titistë e t'i tregoni botës dhe armikut se edhe ju jeni bij besnikë të kësaj toke e të këtij populli. Ju punoni në ato vende ku vepruan dhe luftuan patriotë e komunistë të shquar shqiptarë si Ali Kelmendi, Avni Rustemi, Halim Xhelo, e shumë të tjerë. Shembulli i tyre i ndritur duhet të jetë frymëzim edhe për ju.

Sa gëzim e krenari ndiejmë, kur dëgjojmë për protestat e demonstratat tuaja të fuqishme dhe për përpjekjet tuaja prej patriotësh zemërzjarrtë. Ju ngritët zërin e grushtin tuaj të fuqishëm kundër padrejtësive që i bëhen popullit tonë të shumëvuajtur. Ju mbrojtët vëllezërit e motrat tuaja në Kosovë. Ju u ngritët ashtu si gjithë populli ynë në mbrojtje të nderit të motrave, nënave e vatrave tona të shtrenjta, që u përpoqën ta marrin nëpër këmbë çetnikët e Rankoviçit e të Drazha Markoviçit.

Populli ynë, sot, para së gjithash kërkon që të mos i cënohen ato pak të drejta të fituara me gjak në demonstratat e vitit 1968. Kërkon që Kosovës t'i njihet patjetër statusi i republikës së federuar.

Amaneti e porosia e gjithë atyre heronjve që dhanë jetën në lulen e rinisë për të drejtat dhe lirinë e popullit, amaneti i atyre që janë duke lënguar nga plagët e rënda dhe i atyre mijëra trimave që po dergjen nëpër burgjet fashiste jugosllave, si për gjithë popullin, ashtu edhe për ju, ka qenë dhe mbetet:

-Të luftoni pareshtur e me të gjitha forcat deri sa të realizoni të gjitha të drejtat e popullit tonë,

-të kundërshtoni me forcë dhunën e terrorin e pashoq që po ushtron regjimi mbi popullin dhe rininë tonë.

-të forconi pareshtur unitetin luftarak të radhëve tuaja,

-të përkrahni e të ndihmoni me të gjitha mundësitë bashkatdhetarët që keni në Kosovë,

-të zbuloni dhe demaskoni pa mëshirë ata elementë të shitur që bëjnë punën e armikut, që mbjellin panik e konfuzion në radhët tuaja, që bëjnë punën e agjentëve të fëlliqur, duke ju denoncuar juve te armiku.

-të kërkoni me këmbëngulje që t'ju sigurohet puna në vendlindje,

-të sabotoni ato të ashtuquajtura "klube jugosllave të punëtorëve", që janë shndërruar në çerdhe të rrezikshme antishqiptare, e në vend të tyre të forconi klubet dhe shoqëritë tuaja të pavarura kulturore e artistike dhe sportive,

-të mos mashtroheni nga demagogjia e premtimet boshe të armikut, të mos u besoni shpifjeve e trillimeve të shumta të tij,

-mos lejoni që të humbni gjuhën, kulturën e traditat tona të mira.

Demonstratat e grevat masive që kanë përfshirë mbarë Kosovën, armiku po mundohet t'i paraqesë në sy të botës si vepër të "nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë". Në fakt, ato janë vepër e popullit dhe rezultojnë drejtpërdrejtë nga politika antishqiptare që ka ndjekur regjimi për 40 vjet me radhë. Ato janë rezultat i shtypjes dhe shfrytëzimit të egër të masave punonjëse, i pozitës koloniale të Kosovës dhe i vendosjes së marrëdhënieve kapitaliste në të gjitha fushat e jetës. Ato janë rezultat i ashpërsisë në kulm të të gjitha kontradiktave dhe i skamjes e mjerimit të papërshkrueshëm, në të cilin e kanë katandisur titistët popullin tonë. Përvoja e gjatë historike e luftarake e kanë mësuar

popullin tonë se të drejtat e liritë nuk t'i fal kush, por ato fitohen vetëm në rrugën revolucionare. Prandaj dolën të bashkuar, rrugëve punëtorët, studentët e fshatarët, gjithë populli ynë trim e patriot për të kërkuar të drejtat e veta, duke qenë të ndërgjegjshëm edhe për sakrificat që duhet bërë. Populli nuk doli me pahir në demonstrata. Ai e dinte se titistët nuk do t'i duartrokasin kërkesat e tij të ligjshme, kurse policia e ushtria fashiste jugosllave, nuk do t'i priste me lule demonstruesit tanë.

Shumë armiq janë munduar ta robërojnë e zhdukin popullin tonë. Por, të gjithë janë mbuluar vetëm me turp, kurse populli ynë ka mbetur gjithnjë i lavdishëm e heroik në luftën e tij për liri. Prandaj sot populli ynë është më i vendosur e më i bashkuar se kurrë në luftën e tij të drejtë dhe e ka bindjen e plotë se edhe ky rrebesh i shovinistëve do të kalojë si shumë furtuna titiste që u egërsuan në Kosovë. Demonstratat më të reja që shpërthyen këto ditë në Gjakovë e Prishtinë, i treguan qartë armikut se populli ynë nuk e ka ndër mend të gjunjëzohet as para dënimeve fashiste që po u bëhen njerëzve tanë në gjyqet titiste në proceset e shumta të kurdisura nga udbashët e Herleviçit.

Përpjekjet e shovinistëve serbë dhe të këlyshëve të tyre në Kosovë janë përpjekje të një bote të perënduar dhe përpëlitje të një të sëmuri rëndë, që është shtrirë në shtratin e vdekjes, po, para se të ngordhë, egërsohet si një bishë me fuqi të shumëfishuar. Fuqia e titizmit jugosllav, siç po dihet tashmë, pa dyshim, është fryma e fundme e të dëshpëruarit, të cilit, hë tash hë tevona, do t'i shklasë këmba dhe ai do të bjerë në humnerën që ua ka hapur të tjerëve. (LIRIA, gusht 1981, faqe 21-23)

4-5-13. SHQIPJA BËN EDHE PA GJËMË, I MJAFTON LAVDIA

Nga Jusuf Gërvalla

Shovinistët serb, të tërbuar si kurrë më parë kundër popullit tonë, më 13 maj të këtij viti dërguan reparte të tëra policësh në Prekazin e Ulët, për të rrethuar shtëpinë e Nebih dhe Tahir Mehajt, fshatarë të ndershëm e patriotë të dëgjuar. Babë e bir, me të dëgjuar përçartjen e xhandarëve serbë dhe vringëllimën e tankeve, zunë vend te frengjitë e kullës dhe vendosën të qëndrojnë të papërkulur deri në fund, të përtrijnë epopenë e patriotit të shquar Ahmeti Delia. Regjimi, për të thyer qëndresën heroike të këtyre dy patriotëve, u detyrua të dërgoj njësi të tëra tankesh e të mbulojë qiellin e Prekazit me helikopterë ushtarakë. Pas shumë orë luftimesh, gjatë të cilave armiku la me dhjetëra të vrarë e të plagosur, policia hyri dhe i bëri rrafsh me tokë muret e oborrit dhe kullën e familjes Mehaj. Në betejën e pabarabartë ranë, më në fund, heroikisht edhe Nebihu e Tahiri. Ata e dhanë jetën për nderin e familjes, për nderin e Prekazit famëmadh, ranë si burra e lanë pas vetes një shembull të ndritur. Populli ynë do t'i kujtojë gjithmonë me nderimet më të mëdha. Tashmë, mbi varret e tyre mëngjes për mëngjes po gdhijnë kurora lulesh, që po ua dërgon dora e dashur e popullit, kurse qëndrimit heroik të Tahir e Nebih Mehajt poeti anonim i ka kushtuar këngën që po e botojmë këtu.

1.
Fshati ruante të kaluarën,
Fshati donte ardhmërinë,

Pa pranga ta shihte Kosovën,
Në liri t'ia ndiejë dashurinë,

Këngët për Azemin rriteshin,
Shtrëngoheshin armët në gji,
Në kulla historia shpalosej,
Në zemra gufonte liri!

Dhe bashkë me atë madhërim armësh,
Kumbonte ëmbël çiftelia,
Në kujtimin e gjallë të Shotës me trimat,
Rritej në Shpresë e tërë Drenica,

Këndej erdhën e thyen qafën panumër ushtri,
Turpin e tyre e namin tonë lanë pas,
Lindjet përherë më të dashura bëheshin,
E flamuri valonte në Prekaz,.

2.
Por në prag të një stuhie,
Në gardh të fshatit vuri putrat,
Ujku i vjetër prej Serbie,
Hallakati të gjitha kullat,

Në gjëmë u mblodh fshati atë natë,
Qeni serb në rrugë u shçir,.
Na rrethuan, babë Nebih!
Na rrethuan, bir Tahir!

Dhe hungroi zë' i tradhtarit
E i lëndoi trimat në zemër:
"Dorëzohi, se s'ka tjetër"
U tha, e i thirri vrazhdë në emër,

"Qërou, shpirt i shitur, ik!"
Që nga kulla plaku tha:
" Le të vijnë milicët serbë,
Kemi punë vetëm me ta."

"Me këto duar do t'ju lidh"
Po i nxehte fjalët tradhtari,
"Gjithmonë preja i takon,
Atij që e zë i pari."

Shkrepi flakë pushk' e Tahirit
Merr tradhtarin në lule të ballit

“ Vafsh në pleh, qen i mallkuar,
O qelb e plagë e shqiptarit!”

Sakaq dhe fshati me milicë,
Si korba të zeza, u resh i tëri,
Por, a tunden muret e kullës?
A dridhet në dorë të trimit, maliheri?

Një ditë e gjatë, pa fund, luftimesh,
U ngrys e kafshuar nga pabarazia.
Njëri tabor – dy pushkë te frengjia,
Tabori tjetër – me tanke ordia!

3.

Kot qëllonin tanket murin,
Kot murtaja rrahte çatinë,
Këndej qëndresa më e fortë bëhet,
Andej fashistët një pas një bien

Mbahu Prekaz, ti kullë graniti,
E tërë Serbia të ka marrë në thumb!
Është po ai serb prej shovinisti,
Që me ty lufta i shkoi në lumë.

“Të fortë e kemi kullën!”
Te frengjia i qeshi buza plakut
Të fortë e kemi Kosovën.
Ne po biem, po kush na e merr hakun.”

Në atë çast mbi kullë gjëmoi,
Një i paudhë helikopter,
Dhe plaku ra, po në dorë të Tahirit,
Këpuste breshërima njai maliher,

Prite Prekazin, o bishë e ndytë,
Në pancir e veshur e me tankun shok!
S’më le vend tjetër të të qëlloj, pos sytë,
Dhe më kapardisesh si një maçok

S’të thanë, kur u nise, në Beograd,
Se dhe njëherë këtu, në Drenicë,
Kur u vërsulën çetnikët e tu,
Mes vetullave i qëlloi Murseli* sakicë?

Dhe vazhdoi lufta, e gjatë e rreptë.
Dhe u drodh trimi, pa të shtrirë plakun
“Duhet të tërhiqem, të çaj rrethimin,
Shumëfish t’ia marr Prekazit hakun.”

Po drit’e hënës e tradhëtoi,

Mbi maliherin kur i ra,
Nga mitrolozat në duar barbare
U shtri skaj prozhmit, Tahiri, u vra.

4.
Dhe s'lanë t'u bëhej as gjëma trimave,
Të vrarët e vet vajtonte Serbia.
Ndër mote, pra, atyre le t'u mbetet gjëma,
Shqipja bën edhe pa gjëmë, i mbetet lavdia

Këndej erdhën e thyen qafën panumër ushtri,
Turpin e tyre e namin tonë lanë pas,
Dhe lindjet përherë më të dashura na bëhen,
Dhe shqiponja e lirë në Prekaz.

* Mursel Ahmeti, i biri i Ahmet Delisë, bashkëluftëtarit të Azem Galicës, i cili u vra po në Prekaz nga hordhitë çetnike, por vetëm pasi shpartalloi me të virin e me shokë, një çetë të tërë serbomëdhenjsh.

("LIRIA" , nr. 4-5; gusht 1981, faqe 23)

4-5-14. NDIHMA PËR KOSOVËN

Nga Kadri Zeka

Të dashur vëllezër e motra!

Sot populli shqiptar në Jugosllavi ndodhet në një gjendje të vajtueshme. Regjimi fashist i klikës titiste e katandisi atë në një skamje e mjerim të papërshkruar. Por, fatkeqësitë e popullit tonë janë shtuar pa masë këta muajtë e fundit, pasi rinia, punëtorët e fshatarët tanë u sulmuar me tanke dhe avionë, me policë e ushtarë nga mbarë Jugosllavia. Në demonstrata na u vranë e plagosën shumë vëllezër e motra. Shumë nga familjet e tyre, në skamjen dhe mjerimin ku i ka katandisur shovinizmi serbomadh, e kanë vështirë të mbulojnë qoftë edhe shërbimet e varrimit të bijve të tyre, të mos flasim për sigurimin e barërave e të mjekëve për të plagosurit, që nuk guxojnë të shtrihen nëpër spitale, se atje i presin kthetrat e milicisë fashiste serbe dhe burgu i rëndë. Përveç kësaj, përditë po burgosen me qindra shqiptarë dhe po marrin dënime të rënda me burgim. Prej tyre ka edhe njerëz që ishin përgjegjës në familje dhe ekzistenca e të afërmeve të tyre varet kryesisht nga të ardhurat që siguronin ata.

Një numër mjaft i madh i shqiptarëve janë larguar nga puna, pse morën pjesë në demonstrata ose i përkrahën ato, dhe tash armiku ynë i ka hedhur në mes të rrugës. Ka familje të tëra të ndershme, që janë pa strehë mbi kokë dhe u mungon edhe kafshata e gojës.

Me veprimet e tij barbare, armiku ka për qëllim të na shtyp me dhunë e terror, e njëherit të na nënshtrojë edhe me armën e urisë. Ai përpiqet të lërë pa shkolluar fëmijët e njerëzve tanë që po kalben burgjeve, e të demoralizojë familjet e tyre, që këto t'i mallkojnë bijtë e vet.

Dhe ne, me qëllim që të shkatërrojmë planet djallëzore të armikut dhe të pakësojmë fatkeqësinë e vëllezërve dhe motrave tona, kemi një detyrë patriotike dhe të ngutshme: t'i ndihmojnë edhe materialisht, me të gjitha mundësitë që kemi. Ndihmat mund t'i drejtoni në këtë xhiro-llogari:

25-45475
HILFE FUR KOSOVA
BIEL
SUISSE

Dhënia e ndihmave për Kosovën nuk duhet të bëhet në formë fushate. Ndihmat duhet të jenë të vazhdueshme dhe me afat të gjatë, se edhe nevojat tash për tash janë të tilla. Duke ndihmuar vëllezërit tanë, ne ndihmojmë çështjen tonë: i japim një grusht të fortë armikut, çojmë luftën tonë përpara dhe njëherit forcojmë solidaritetin e unitetin tonë të pathyeshëm. (LIRIA, gusht 1981, faqe 24)

4-5-15. Njoftim

Nga Kadri Zeka

Njoftojmë bashkatdhetarët tanë që ndodhen në punë të përkohshme në Perëndim se literatura shqiptare mund të sigurohet në këto librari. Në Zvicër: BADHAUS STR. 35, BIEL-BIENE. Kjo është një librari shumë e pasur me libra, revista e gazeta shqiptare. Përveç librarisë së përmendur, në Zvicër dhe në Gjermaninë Federale, libri dhe shtypi shqiptar mund të gjenden edhe në libraritë përkatëse të shoqatave të miqësisë Zvicër-Shqipëri dhe Gjermani-Shqipëri, të cilat nuk do ta keni të vështirë t'i gjeni në qytetet ose në afërsi të qyteteve ku punoni.

Natyrisht, libri e shtypi shqiptar mund të porositen edhe drejtpërsëdrejti edhe nga Shqipëria. Në këtë rast porosia mund të bëhet në adresën: NDËRMARRJA E LIBRIT, TIRANË, ALBANIEN. (LIRIA, gusht 1981, faqe 24)

==========

(Shënim: Trakti i mëposhtëm i Jusuf Gërvallës u përgatit dhe doli nga shtypi, në Shtutgart menjëherë pas botimit të numrit 4-5 të lirisë, në gusht 1981 me qëllim që t'i bëjë jehonë sa më të madhe xhiro-llogarisë: 25-45475, HILFE FUR KOSOVA, BIEL, SUISSE.)

TË MBLIDHEMI RRETH FLAMURIT FITIMTAR TË POPULLIT TONË TË BASHKUAR

Nga Jusuf Gërvalla

"KUSH NUK DERDH NJE PIKE GJAKU PER TOKE TE VET, KUSH NUK JEP ASNJE QINDAR PER TE, AI S'KA TE DREJTE AS TE VARROSET NE TE."
Sami Frashëri

Sot zbresin pa pushim në Kosovë ministra e funksionarë të lartë republikanë e federativë, japin udhëzime për shtypje e represalje dhe kthehen me ngut në Beograd, për të kurdisur plane të reja antishqiptare. Gjithë aparati propagandistik jugosllav, ai i Lidhjes

Komuniste., i Lidhjes Socialiste, i Lidhjes së Rinisë, mjete të shumta informimi në Jugosllavi e Kosovë shpifin e bërtasin kundër shqiptaiëve, shajnë popullin e Kosovës dhe tokën e Kosovës si „tokë të mallkuar", shajnë nënën shqiptare pse lindi aq shumë trima...

Frenat e qeverisë e të luftës kundër shqiptarëve i kanë marrë në dorë shovinistët më të tërbuar jugosllavë, të cilët po përdorin pa kursim të gjitha mjetet e dhunës dhe terrorit për të gjunjëzuar popullin shqiptar, për të njollosur luftën e tij të drejtë dhe për të diskreditуar bijtë e tij të vërtetë marksistë-leninistët dhe revolucionarët e patriotët shqiptarë, që po qëndrojnë me heroizëm të rrallë përballë masave të egra ndëshkuese të gjakpirësve jugosllavë.

Populli ynë u ka dhënë një grusht vdekjeprurës forcave të errëta shoviniste të Jugosllavisë. Të bashkuar e të vendosur deri në fund për luftën e vet të drejtë, shqiptarët e Kosovës, me demonstrata e greva,me aksione të njëpasnjëshme, po edhe me rezistencë pasive, e kanë shtjerrë deri në pikë të fundit qetësinë dhe urtinë e qeverisë shoviniste të Beogradit. Asnjë aksion i serbomëdhenjve në pushtet, pa marrë parasysh kahjen e qëllimin, nuk po mun të realizohet, edhe rise organeve u janë vënë në dispozicion forca e mjete të shumta. Kjo ka bërë që tërbimi shovinist të rritet jo vetëm nga dita në ditë, por edhe nga çasti në çast.

Të hutuar përballë qëndresës së pashoqe shqiptare, shovinistët e kanë humbur fare kokën dhe gjithë punën e kanë çuar në një qorrsokak nga i cili e kanë vështirë të dalin. Çdo masë që po ndërmarrin ata kundër shqiptarëve të revoltuar, në vend që ta qetësojë e frikësojë, po e pezmaton dhe po e trimëron edhe më shumë popullin tonë të robëruar. Tani edhe vetë jugosllavët janë të bindur se, ose do të duhet t'ua plotësojnë të gjitha kërkesat shqiptarëve, ose do të detyrohen ta mbajnë vazhdimisht në Kosovë, në gjendje gatishmërie, milicinë dhe ushtrinë e shumtë jugosllave. Mirëpo tërbimi ua ka errur sytë dhe ata sot nuk po janë në gjendje të zbatojnë mjetet e urtisë e të gjakftohtësisë së domosdoshme, po vetëm forcën e armës dhe të demagogjisë.

Ndërkohë, duke hetuar shembjen e truallit nën këmbë, shovinistët serbomëdhenj kanë bërë përpjekje të ethshme për ta pushtuar kalanë për së brendi, për të thyer unitetin e shqiptarëve, duke aktivizuar në mënyrë të paparë rrjetin e gjerë të spiunëve dhe të agjentëve, me përpjekje për një zgjerim të mëtejshëm të tij me njerëz frikacakë, të pavetëdijshëm e të mashtruar.

Tani, me anën e këtij mjeti të stërnjohur të përçarjes, të cilin e kanë përdorur edhe më parë shovinistët serbomëdhenj po përpiqen mëkot të arrijnë ato rezultate në nënshtrimin dhe gjunjëzimin e shqiptarëve, të cilat nuk i arritën dot me tanke e aeroplan, me automatik e kërbaç; as me burgun e zi. 30 000 forca të reja ushtarake e policore kanë zbritur nga Beogradi në Kosovë për ta bërë zap popullsinë e këtushme, qëkur shpërthyen demonstratat e marsit.

Në prezencën e nën kërcënimin e këtyre forcave po përpiqet borgjezia serbomadhe të detyrojë popullin për t'u deklaruar kundër dembnstratave. Por për popullin tonë është bërë e qartë se demonstratat ishin zëri i të drejtave dhe lirive të shkelura, kurse demonstrantët bijtë e vërtetë të popullit, që vendosën të thyejnë prangat e robërisë e të mjerimit. Kështu rinia, punëtorët, fshatarët dhe inteligjencia popullore tashmë janë bërë mur i pakapërcyeshëm për pushtuesin dhe po e vrasin atë me heshtje shkëmbi, pikërisht kur ky klith i lebetitur: "Dëno demonstratat!" Profesorët e universitetit Kosova janë bërë bllok dhe armiku s'ua nxjerr dot një fjalë, minatorët, punëtorët në fabrika e ndërmarrje gjithashtu. Madje, armiku i tërbuar po detyrohet të -spërndajë organizata të të tëra të LK në fshatra, ndërmarrje e institucione të ndryshme që po tregohen të pabindura. Kaq thellë që ka depërtuar ndjenja e lirisë e kaq shumë që ëhtë brumosur bashkimi i popullit.

Një gjë që e krenon shumë situatën aktuale në Kosovën tonë kreshnike është ilaçi që i doli papritmas një dukurie shumë të dëmshme në jetën e shqiptarëve të robëruar nga Jugosllavia: hakmarrjes dhe vëllavrasjes. Ky ilaç u përfitua nga qëndresa e pashembullt e popullit tonë karshi zullumeve të padurueshme që po sheh ky pupull nga shovinistët serbomëdhenj që nuk ngurruan as të shkelin me tanke e të grijnë me mitraloza edhe fëmijët shtatë vjeç.

Siç e dimë, vëllavrasja mes shqiptarëve, e kushtëzuar nga rrethanat politko-shoqërore nën regjimin e egër titist dhe e stimuluar në shumë mënyra si mjet efikas për përçarjen e popullit tonë të shumëvuajtur, vazhdimisht rrinte varur si një kërcënim i madh mbi kokën e çdo shqiptari.

Por, shpërthyen demonstratat e marsit dhe të prillit. Studentët, rinia, inteligjencia popullore, punëtorët dhe fshatarët, me një fjalë mbarë populli ynë, u çuan në këmbë dhe kërkuan të drejtat e ligjshme, të mohuara nga regjimi jugosllav për më se 40 vjet. Mirëpo, kërkesave tona për bukë për më shumë të drejta e liri, qeveria e Bogradit u tregua shumë e gatshme t'u përgjigjet me gjuhën e çelikut dhe të barotit. Populli shqiptar e pa se me çfarë lehtësie e papërgjegjësie shkelte tanku serb mbi trupat e fëmijëve, pleqve dhe të të rinjve shqiptarë. Dhe, duke u gjendur përballë tërbimit të këtij përbindëshi, populli ynë duarthatë e i pambrojtur, por në rrugën e drejtë të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirisë, e kuptoi menjëherë se arma e tij e vetme po më e fuqishmja, është bashkimi. E kuptoi se vëllavrasjes dhe hakmarrjes duhet t'i shkelet menjëherë koka si gjarpërit.

Prandaj, si në kushtet karakteristike të luftës, kur pushojnë së vepruari shumë ligje e dukuri shoqërore që kanë vepruar dendur në kohë paqeje, ashtu te populli ynë pushuan së vepruari shumë ligje e dukuri shoqërore. Dje, të hasmuar, kishin kërkuar t'i pinin gjakun njëri-tjetrit, sot po merren ngrykë me njëri-tjetrin. „Hasmin" e deridjeshëm po e quajnë me emrin e vërtetë - vëlla. Ata falën gjaqet e kusuret dhe u lidhën vëllazërisht,sepse kuptuan që koha kërkonte tjetër luftë, luftë me armikun e vërtetë.

Kjo gjë i dha një dimension të ri, revolucionar e shumë human, luftës sonë nacionalçlirmtare.

Përveç kësaj, në rrethanat e egra kur pushteti kërkon nga fshatarët që të bojkotojnë e të leçitin familjet e pjesëmarrësve në demonstrata dhe në ngjarjet e tjera të kësaj pranvere, populli po ia kthen mbrapsht porositë, kërkesat dhe urdhërat armikut të tërbuar. Fshatarët tanë të ndershën, të pezmatuar sa s'ka më, në vend që të leçitin familjet e pjesëmarrësve në demonstrata, ashtu si kërkon prej tyre pushteti, po leçitin gjithë atë njeri dhe gjithë atë familje që provon ta çojë në vend urdhrin dhe porosinë e tillë të egër të UDB-së.

Këto dhe dkuri të tjera, të cilat janë pasqyrë e gjallë e unitetit të pathyeshëm që është arritur sot te masat tona punonjëse dhe te mbarë populli ynë flasin qartë se lufta jonë dita ditës po i afrohet me hapa të mëdhenj fitores së sigurt.

Duke parë se me popullin në Kosovë e ka humbur davanë, qeveria e Beogradit, nëpërmjet përfaqësive të saj diplomatike që janë çerdhe agjenturore të Jugosllavisë në botën e jashtme, po rropatet të fusë frikë, konfuzion e përçarje së paku në mesin e punetorëve kosovarë në mërgim. Këtë qëllim shovinistët serbomëdhenj po duan ta realizojnë me frikësime e shantazhe. Bie fjala, për të vazhduar pasaportin, punëtori kosovar i mërguar detyrohet të tregojë shokët që kanë marrë pjesë në deonstratat e punëtorëve të zhvilluara këto kohët e fundit në botën e jashtme. Përpjekje për t'i kërcënuar ata me marrjen e pasaportit ka bërë UDB-ja me punëtorët tanë të mërguar që kanë shkuar në shtëpi për pushime. Bile, një pjesë të tyre e ka hedhur edhe në burg, tok me ata dhjetëra mijëra shqiptarë të tjerë që përgjigjen pse kanë marrë guxim të kërkojnë me zë të lartë të drejtat më të ligjshme.

Përveç kësaj UDB-ja ka bërë përpjekje të etshme që, nga radhët e disa shqiptarëve të pavetëdijshëm, të ligj a të mashtruar, të rekrutojë spiunë e agjentë. Këta kishin për detyrë të bojkotonin e të provokonin demonstratat e punëtorëvë shqiptarë në mërgim marrjen e klubeve në duart e punëtorëve dhe dëbimin e përfaqësuesve diplomatikë jugosllavë nga këto klube.

Por, asgjë nuk i ndal më punëtorët tanë në rrugën e tyre të drejtë. Ata janë pjesë përbërëse e popullit shqiptar që po shtypet nga çizmja e ushtarit dhe nga kërbaçi i xhandarit fashist jugosllav. Ata ndjekin hap pas hapi zërin e popullit e të Atdheut dhe përditë e më shumë ata i gjen të gatshëm t'i dalin zot popullit qoftë me demonstrata, me marrjen e klubeve në duart e veta apo me mënyra të tjera që i lyp koha e nevoja.

Fatkeqësisht janë disa punëtor të mërguar që, duke pasur një vetëdije fare të ulët shoqërore e kombëtare duke qenë përveç kësaj edhe të lig kanë pranuar urdhrat e porositë e UDB-së fashiste dhe ia kanë kthye shpinën popullit e atdheut të vet. Por është gjithashtu e vërtetë se punëtorët tanë në mërgim kanë arritur t'i izolojnë e neutralizojnë në mënyra ndryshme këta spiunë e agjentë të fëlliqur. Ata i njeh mirë punëtori ynë dhe e di si do t'i qërojë hesapet me ta kur të vijë momenti i duhur.

Marksistë-leninist e Kosovës, të tubuar rreth organit "Liria", duke pasur parasysh interesat klasore e kombëtare të popullit shqiptar që vuan nën zgjedhën e rëndë fashiste jugosilave, duke pasur parasysh unitetin e pashembullt që është arritur te populli ynë në Kosovë, të gjithë ata njerëz të mashtruar e të frikësuar po që ende nuk janë zhytur në krime ndaj popullit, i fton të braktisin rrugën e tyre të pakrye, të kthejnë mbrapsht me trimërinë e njohur shqiptare urdhrat e UDB-së e të përfaqësive diplomatike jugosllave në Perëndim. Le t'i kthehen sa më parë nevojës së atdheut e të popullit që i lindi dhe i rriti me njëqind mundime.

Ndryshe, kur të fillojë me goditje dora hakmarrëse e popullit, do të jetë i humbur gjithë ai shqiptar që ka braktisur interesat e popullit, gjithë ai shqiptar që, për interesa të imta e të fëlliqura, vazhdon t'i shërbei armikut të egër shovinist edhe pas ngjarjeve tragjike të kësaj pranvere në Kosovë. Populli ynë do t'u marrë gjak në vetull. Atdheu do t'i lërë pa nam e nishan. Varret e tyre dot'i shpupurishin qentë nëpër varreza të huaja rrugëve të shkreta të botës. Sepse, siç thotë patrioti dhe dijetari ynë i madh, Sami Frashëri atdheu nuk duhet t'i japë as varr atij që nuk e ka dhënë për atdhe pikën e djersës apo të gjakut kur ka qenë nevoja.

Rroftë uniteti i popullit ne realizimin etë drejtave dhe aspiratave të tij shekullore!
Rroftë Republika Socialiste e Kosovës!
Poshtë politika dhe terrori i egër fashist i qeverisë nacionalsoviniste tt Beogradit!
Poshtë agjentët dhe spiunët që vënë në shërbim të gjaksorit!

==========

TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

I

Kriza e rëndë që ka mbërthyer Jugosllavinë revizioniste, i ka sjellë masat punonjëse kudo në Jugosllavi në një gjendje shumë të vështirë. Por, veçanërisht e rëndë dhe e padurueshme është kjo gjendje në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, ku mbi masat punonjëse po ushtrohet një shtypje e shfrytëzim i egër e i shumëfishtë kolonial e kapitalist.

Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi ka luftuar në shekuj për lirinë, të cilën nuk e fitoi kurrë. Megjithë gjakun e shumtë që derdhi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai nuk fitoi të drejtën e tij të ligjshme dhe të premtuar që të vendosë vetë për fatin e tij. Këtë të drejtë, që më parë e kishin proklamuar vetë shovinistët e rinj jugosllavë, pas përfundimit të luftës, e mbytën me gjak. Me anë të forcës e të tradhtisë, ata bënë që Kosova dhe tokat e tjera shqiptare, që fuqitë e mëdha i kishin shkëputur padrejtësisht nga shteti shqiptar, të pushtohen përsëri dhe të copëtohen në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Mali të ZI. Populli i robëruar shqiptar u bë objekt i një politike të egër shoviniste të shtypjes e shfrytëzimit të pamëshirshëm, objekt i dhunës dhe terrorit, shkombëtarizimit dhe gjenocidit të paparë. Çështja kombëtare e popullit tonë mbeti një problem i pazgjidhur, një plagë që kërkon shërim. Popullit shqiptar në Jugosllavi dhe sidomos atij në Maqedoni e Mal të Zi i janë mohuar e shkelur të drejtat më elementare kombëtare.

Përveç marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, gjendjen e masave punonjëse dhe të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi e rëndon edhe shfrytëzimi i egër kolonial që ushtrohet mbi të. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi janë shndërruar në koloni të vërteta të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në burim të tyre, thjesht të lëndëve të para dhe të krahut të lirë të punës. Mbi supet e klasës sonë punëtore dhe masave të tjera punonjëse po hidhen jo vetëm pasojat e krizës që ka mbërthyer ekonominë kosovare, por edhe ato të krizës së ekonomisë të të gjithë Jugosllavisë. Kjo ka bërë, që megjithë pasuritë e shumta që kanë Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi jo vetëm të jenë pjesa më e pazhvilluar në Jugosllavi, por që edhe prapambetja e tyre në krahasim me viset e tjera të Jugosllavisë të shtohet vazhdimisht. Kjo ka bërë që Kosova jonë e begatshme të mbetet " shtëpia e varfër e Evropës ", vendi i prapambetjes, papunësisë, kurbetit, analfabetizmit, errësirës, sëmundjeve, skamjes dhe mjerimit

I I

Populli ynë heroik ka luftuar në shekuj për lirinë dhe të drejtat e tij. Ashtu si dhe më parë, ai nuk u pajtua kurrë me zgjedhën e re të robërisë revizioniste. Luftën e pandërprerë të popullit tonë kundër zaptuesve të rinj shovinistë nuk kanë mundur ta shuajnë as gjenocidi, dhuna e terrori i egër fashist dhe as premtimet, demagogjia, feja, shthurja e degjenerimi. Krahas ngritjes së vazhdueshme të ndërgjegjes kombëtare e klasore të popullit tonë të robëruar, u rrit dhe u intensifikua edhe lufta e tij për të drejta e liri.

Lëvizja revolucionare e pranverës së këtij vitit është vazhdim i drejtpërdrejtë i luftës së pandërprerë të popullit tonë për liri, dëshmi e ngritjes së saj në një shkallë akoma më të lartë.

Grevat dhe demonstratat e mëdha të pranverës nuk kishin aspak karakter shovinist, irredentist, reaksionar e kundërrevolucionar, siç po për piqet t'i paraqesë ato propaganda jugosllave. Ato ishin pasojë e gjendjes së padurueshme, në të cilën ndodhet populli ynë, e shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kolonial e kapitalist që ushtrohet mbi

masat tona punonjëse. Me anë të këtyre demonstratave dhe grevave, populli ynë kërkoi kushte më të mira jetese, kërkoi lirinë dhe të drejtat e mohuara kombëtare e demokratike; dhe në mënyrë të veçantë kërkoi që Krahinës Autonome të Kosovës t'i jepet statusi i Republikës brenda Federatës Jugosllave. Këto kërkesa qenë paqësore; të përgjakshme ato i bënë shovinistët serbomëdhenj dhe tradhtarët shqiptarë, që urdhëruan shuarjen e tyre me armë dhe me gjak, me milici speciale, tanke dhe ushtri. Ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh në këto demonstrata popullore dhe për të gjitha dëmet që u shkaktuan.

Suksesi i demonstratave dhe grevave të këtij viti është i jashtëzakonshëm.

* U arrit një politizim, mobilizim dhe bashkim i paparë i popullit tonë.

* U ngrit në një shkallë akoma më të lartë fryma e tij, luftarake, patriotike e klasore, u shtua edhe më shumë besimi i tij në forcat e veta të pashtershme.

* Politika antipopullore e udhëheqjes shoviniste të Jugosllavisë u demaskua e u diskreditua edhe më shumë jo vetëm në sytë e popullit tonë, por edhe në sytë e popujve jugosllavë dhe të atyre të botës. Doli në shesh jo vetëm politika e shovinistëve serbomëdhenj për fashistizimin dhe rankoviçizimin e mëtejshëm të Jugosllavisë, por edhe plani i rrezikshëm që ata po kurdisin në bashkëpunim me socialimperialistët sovjetikë – kundër popujve të Jugosllavisë dhe të Ballkanit.

* Çështja e Kosovës u popullarizua edhe më shumë në të gjithë botën. Lufta jonë e drejtë fitoi simpatinë dhe përkrahjen e të gjitha forcave përparimtare në të gjithë botën...

I I I

Të tmerruar nga goditjet dërmuese që morën nga grushti i ngritur i popullit, shovinistët serbomëdhenj kanë shpërthyer tani një fushatë të tërbuar antishqiptare. Ata po përdorin të gjitha mjetet dhe metodat, me qëllim që të shkatërrojnë lëvizjen komuniste e patriotike, që po rritet e forcohet vazhdimisht, ta nënshtrojnë popullin tonë të pamposhtur, ta mbysin luftën e tij çlirimtare, e madje edhe të na i rrëmbejnë ato pak liri e të drejta që i kemi fituar me gjak e sakrifica. Por, siç ka treguar historia jonë e lavdishme dhe siç po e tregon edhe lufta e gjithnjë në rritje që po bën populli ynë edhe në këto kushte, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtë popullin tonë të paepur, që të ndalë marshimin e tij të pandalshëm drejt lirisë e socializmit.

* Në këto kushte, para gjithë lëvizjes komuniste, patriotike e revolucionare në Kosovë del detyrë e ngutshme bashkimi dhe organizimi më i mirë i gjithë popullit tonë dhe luftës së tij të drejtë.

* Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës mendon se në kushtet e tanishme kjo mund të arrihet më së miri duke organizuar FRONTIN POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.

I V

* Qëllimi i Frontit për Republikën e Kosovës është që Krahina e Kosovës të çlirohet nga sundimi i Serbisë dhe të fitojë statusin e republikës brenda federatës jugosllave

* Kërkesa për Republikën e Kosovës është e drejtë dhe përkrahet nga i gjithë populli shqiptar

* Populli i Kosovës kurrë nuk ka vendosur për fatin e vet. Tokat e tij janë pushtuar me forcë, janë copëtuar dhe në kundërshtim me vullnetin e tij, i janë aneksuar Serbisë. Në mbledhjen e AVNOJ –it ku u vunë themelet e pushtetit të sotëm jugosllav, nuk u fol fare për çështjen e popullit shqiptar në Jugosllavi dhe më të nuk morri pjesë asnjë delegat shqiptar.

* Populli shqiptar jeton në tokën e tij, ku ka jetuar brez pas brezi.

* Populli shqiptar në Kosovë i ka të gjitha karakteristikat që përbëjnë një popull dhe një komb. Ai nuk është" pakicë kombëtare", nuk është" kombësi" dhe as "popullsi" ("

narodnost"), siç e kanë cilësuar shovinistët jugosllavë. Ai përbën mbi 80 për qind të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

* Për nga numri i banorëve, Krahina e Kosovës është rreth tri herë më e madhe se Mali i Zi, që ka republikën e vet.

* Republika e Kosovës do ta bëjë të mundshëm zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik dhe kulturor të Kosovës si dhe afirmimin e mëtejshëm kombëtar të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi.

* Republika e Kosovës do të jetë fitore e madhe edhe për popullin shqiptar në Maqedoni, në "Serbinë e ngushtë" dhe në Mal të Zi, prandaj edhe përkrahet prej tij.

* Republika e Kosovës nuk u sjell asnjë të keqe popujve jugosllavë dhe federatës së tyre; përkundrazi ajo është dhe në interes të tyre dhe e forcon Federatën jugosllave.

* Kërkesa për Republikën e Kosovës është një e drejtë që buron edhe nga Kushtetuta e Jugosllavisë, një e drejtë që e gëzojnë të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi. Dënimet që u jepen përkrahësve të kërkesës për Republikën janë të paligjshme.

* Kërkesa për Republikën e Kosovës nuk është kërkesë për ndryshimin e kufijve në Jugosllavi e Ballkan. Ajo nuk është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara as me vendimin e Helsinkit dhe nuk sjell kurrfarë rreziku për paqen në Ballkan.

V

* Për t'ia arritur këtij qëllimi, Fronti duhet të bashkojë në luftë për Republikën të gjitha masat popullore, punëtorët, fshatarët, zejtarët, rininë, gratë, inteligjencën revolucionare dhe elementë përparimtarë nga radhët e borgjezisë; të gjithë komunistët, patriotët dhe revolucionarët e vërtetë, pavarësisht nga bindjet politike e nga dallimet klasore, fetare e krahinore.

* Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë e sipër; jo qëllim në vete, por një levë e rëndësishme për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e masave popullore në luftë për të drejta e liri

* Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë.

* Në Frontin për Republikën do të bëjnë pjesë të gjitha organizatat dhe grupet ilegale komuniste, patriotike e revolucionare, pavarësisht nëse janë ose jo për socializmin e vërtetë. Republika e Kosovës është në interes të të gjithë popullit të Kosovës, në interes të të sotmes dhe të së ardhmes së tij, prandaj në Front duhet të bëjnë pjesë të gjithë ata që janë për lirinë e Kosovës, për Republikën e saj.

* Në Frontin për Republikën mund të bëjnë pjesë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë Kosovës, në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, në viset e tjera të Jugosllavisë apo kudo në botë. Fronti do të luftojë për lirinë dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi.

* Republika e Kosovës është në interes edhe të popujve joshqiptarë në Kosovë, prandaj edhe ata duhet ta përkrahin kërkesën për Republikë dhe të përfshihen në radhët e Frontit.

* Fronti Popullor për Republikën e Kosovës nuk do të ketë asgjë të përbashkët, por do të jetë kundër LKJ-së dhe organizatave tradhtare të masave si LSPP, LRS, LS, KKASHG etj., që janë vegla të shovinizmit serbomadh. Fronti do të luftojë për demaskimin dhe izolimin e udhëheqjeve të tyre tradhtare dhe për tërheqjen në anën e tij të masave të mashtruara e të manipuluara prej tyre.

* Në Frontin për Republikën nuk mund të bëjnë pjesë gjithashtu as grupet e organizatat fashiste e terroriste dhe agjenturat e ndryshme, që organizon reaksioni i jashtëm apo i brendshëm.

V I

* Krahas luftës për Republikën, Fronti do të punojë edhe për organizimin e luftës në çdo ndërmarrje, fshat, shkollë e fakultet, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, politike, ekonomike e shoqërore të klasës punëtore, fshatarësisë, rinisë, gruas, inteligjencës etj., për organizimin e rezistencës kundër plaçkitjes së pasurive të Kosovës, të luftës për mbrojtjen e kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë etj.

* Për realizimin e qëllimeve të tij, Fronti do të përdorë të gjitha format e luftës dhe organizimit, do t'i kombinojë e zëvendësojë ato në përputhje me kërkesat e situatës dhe të strategjisë së tij.

* Në veprimtarinë e tij, Fronti do t'i japë përparësi organizimit dhe luftës ilegale, por krahas kësaj ai do t'i shfrytëzojë gjerësisht edhe të gjitha format e mundshme legale.

* Fronti është kundër reformizmit dhe legalizmit borgjez dhe, nga ana tjetër, lufton kundër pikëpamjeve dhe metodave anarkiste e terroriste të luftës, të cilat e dëmtojnë rëndë dhe e kompromet ojnë luftën tonë të drejtë.

* Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për përçarjen e popullit tonë me anë të fesë, hakmarrjes, vëllavrasjes etj.

* Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për armiqësimin e popullit shqiptar në Jugosllavi me Shqipërinë socialiste. Ai do t'i popullarizojë sukseset madhështore që po arrin në të gjitha fushat Shqipëria socialiste nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver Hoxha. Fronti do të përpiqet për zhvillimin e marrëdhënieve sa më të ngushta e të gjithanshme mes popullit shqiptar në Jugosllavi dhe atij në Shqipëri.

* Fronti Popullor për Republikën e Kosovës do të luftojë gjithashtu edhe kundër përpjekjeve të shovinistëve serbomëdhenj për ta armiqësuar popullin shqiptar me popujt jugosllavë në Kosovë dhe në Jugosllavi. Fronti nuk i ngatërron popujt jugosllavë me krerët e tyre shovinistë. Luftën e tij ai jo vetëm që nuk e drejton kundër proletariatit dhe popujve jugosllavë, por përkundrazi, ai i konsideron ata si aleatë të tij në luftën për të drejta e liri.

* Duke ndjekur një politikë konsekuente internacionaliste, Fronti do ta lidhë luftën e tij me luftën që bëjnë popujt dhe proletariati i të gjithë botës për liri e socializëm dhe do të luftojë kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër fashizmit dhe reaksionit të të gjitha ngjyrave.

* * *

Këto janë tezat kryesore që Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës i propozon si bazë për organizimin e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Gjatë diskutimit ato me siguri që do të plotësohen, të përsosen e kristalizohen më tej dhe mbi këtë bazë do të përcaktohet vija politike, ideologjike e organizative e Frontit.

Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës u bën thirrje të gjithë komunistëve, patriotëve e revolucionarëve të organizuar e të paorganizuar që t'i përgjigjen ashtu si duhet thirrjes së Atdheut për bashkimin e Frontit të përbashkët të luftës për të drejtat dhe lirinë tonë – për Republikën tonë.

Forca jonë qëndron në unitetin tonë. Sa herë që populli ynë ka bashkuar armët dhe zemrat në një front të vetëm, ai ka arritur të mposhtë dhe të mbulojë me turp armiq shumë më të mëdhenj e më të armatosur. Këtë e dëshmojnë luftërat legjendare të Skënderbeut, e dëshmon lufta e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e dëshmon epopeja e lavdishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e dëshmojnë edhe grevat e demonstratat tona heroike.

Në luftë për të drejtat tona, ne, gjatë kësaj pranvere, pavarësisht se cilës organizate i takonim, u lidhëm sup më sup dhe, si shokë e vëllezër të vërtetë, luftuam, u përleshëm

e u gjakosëm me armiqtë dhe tradhtarët e urryer të popullit tonë. Tani para nesh shtrohen detyra që këtë bashkim të paparë që arritëm në luftën tonë, ta ruajmë e forcojmë më te, ta bëjmë të organizuar, të qëndrueshëm, të pathyeshëm, të përjetshëm. Bashkimi bën fuqinë. Bashkimi është imperativ i kohës. Të bashkuar e të lidhur si vëllau me vëllanë, ne jemi më të fuqishëm se të gjithë armiqtë tanë, të bashkuar ne jemi të pamposhtur. Vetëm të bashkuar si grusht i vetëm në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës, ne do të arrijmë fitoren tonë, lirinë tonë.

Rroftë Fronti Popullor për Republikën e Kosovës

Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës" (Teksti i Tezave, është marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 208-213)

==========

QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM

1. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
2. ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR
3. QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM
4. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË
5. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E TYRE!
6. KËTË MENDIM E KANË PLOTËSISHT EDHE SHPENDI DHE BESNIKU

1. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit

Jusuf Gërvalla: ***"Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.***

Ka disa muaj që unë po fluturoja nga gëzimi, në pritje të bashkimit të forcave tona revolucionare, që isha bërë gati ta quaja bashkim historik. Më herët të kisha dërguar një letër dhe të kisha thënë se këtë bashkim unë vetë nuk e shoh çështje aq të thjeshtë. ***Ka probleme parimore për të cilat duhen marrëveshje serioze, siç është ai se a duhet të kemi fare parti k.m.- l., (komuniste marksiste-leniniste - shën i Xh. D.) apo ajo parti është e domosdoshme për t'i dalë në ballë popullit tonë në drejtim të luftës dhe të fitores. Ky ishte për mendimin tim problemi kyç.*** *Meqë me Organizatën e shokëve të "Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare dhe të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka. Për veten time, në shërbim të kësaj çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e shokut me shokun, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa besë dhe me grushtin të bashkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-274)

2. ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR

Jusuf Gërvalla*: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.*

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka-shën im)" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

3. QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, **por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët**. Kam dëshirë të madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.*

***Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim**. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim e satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

4. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË

Jusuf Gërvalla: ***"**Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën. **Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

5. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E TYRE!

Jusuf Gërvalla*: "(**Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre**, kur nuk dhanë asnjë shenjë! Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)*

*Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. **Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

6. KËTË MENDIM E KANË PLOTËSISHT EDHE SHPENDI DHE BESNIKU

Jusuf Gërvalla*: "Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi (Xhafer Durmishi - shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla - shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 275)

==========

LIRIA

Nr 6, Dhjetor 1981

6-1. DENIMET E RENDA NUK MUND TA FRIKESOJNE POPULLIN TONE
6-2. LETRA E TË BURGOSURIT
6-3. JETËN E JAPIM - FLAMURIN SE JAPIM!
6-4. PËRLESHJE NË MES POLICISË SERBE DHE QYTETARËVE NË PODUJEVË
6-5. LAVDI O JU TRIMA, QË RATË PËR ATDHE
6-6. KONGRESI I FITOREVE
6-7. SHOKU ENVER HOXHA PËR KOSOVËN
6-8. EDHE NJË AKT I POSHTËR SHOVINIST
6-9. I MBYTURI KAPET EDHE PËR FEJE
6-10. POET I MADH REVOLUCIONAR
6-11. SHQIPJA E FURTUNËS
6-12. RINIA IME
6-13. DY YJEVE TË PASHUARA
6-14. KOSOVË
6-15. KOSOVARË DHE KOSOVARE
6-16. Demagogjia nuk mund ta mbuloj dhunën dhe terrorin
6-17. ASNJË PËLLËMBË TË TOKËS SHQIPTARE NUK E L'SHOJMË PËR PA DALË FARE
6-18. LETËR KOSOVËS
6-19. LAMTUMIRË VENDLINDJA E DASHUR KOSOVË
6-20. AMANET MOJ NËNË
6-21. RROFTË KOSOVA, REPUBLIKË!
6-22. KOSOVË E KUQE
6-23. KJO TOKË TË RRITI
6-24. TEKSTE PËR KËNGË REVOLUCIONARE DHE PATRIOTIKE
6-25. SHKOLLA SHQIPE NË SHËNJESTËR TË SHOVINIZMIT MAQEDON
6-26. EDHE RRENA KA NJË KUFI

6-1. DENIMET E RENDA NUK MUND TA FRIKESOJNE POPULLIN TONE

Nga Nezir Myrtaj

Një valë e egër dhune e terrori ka shpërthyer kudo në Kosovë, pas demonstratave dhe grevave të këtij viti. Çetnikët e Beogradit e këlyshët e tyre tradhtarë, nuk u mjaftuan vetëm me vrasjen e dhjetëra bijve e bijave të popullit por vazhduan valën e masave të egra ndaj popullit e rinisë sonë të kuqe me pushime nga puna, largime nga shkollat e fakultetet, burgosje e dënime të rënda.

Me të drejtë opinioni botëror, po i vlerëson këto masa drakoniane si të papara, pas Luftës së Dytë Botërore. Masa të tilla të egra populli ynë nuk mban mend as në kohën e kraljve të Jugosllavisë, as gjatë pushtimit nazifashist dhe as gjatë kohës së zezë të xhelatit Rankoviç. Për më shumë se një muaj mjetet jugosllave të informimit dhanë njohtime të përditshme për proceset e shumta gjyqësore që u zhvilluan.

U dënuan punëtorë, fshatarë, studentë, nxënës, intelektualë, policë e ushtarë. Numri i të gjithë të dënuarve është vështirë të dihet, meqenëse shtypi jugosllav, nuk i publikoi një numër të konsiderueshëm të proceseve gjyqësore. Megjithatë, edhe numri i publikuar dhe i zvogëluar del më i madh se sa numri që jepnin në deklaratat e tyre krerët revizionistë në Kosovë e Jugosllavi, për të gjithë demonstruesit. Sipas vetë shtypit jugosllav, gjatë më shumë se 30 proceseve gjyqësore që i zhvilluan, u dënuan me burgime të rënda gjer në 15 vjet jo më pak se 245 veta. Mesatarja e dënimeve të shqiptuara arrin në më shumë se 8 vjet, kurse po të merren së bashku, del se vetëm të dënuarve të publikuar iu dhanë më shumë se 2 mijë vjet burg të rëndë. Kur t'i shtohet kësaj edhe numri (sigurisht i zvogëluar) prej 600 vetave të dënuar gjoja për kundërvajtje dhe numri i madh i atyre që presin të dalin para gjykatave të zeza të shovinistëve, atëherë mund të shihen përmasat e vërteta të kësaj fushate të egër e të paparë.

Edhe gjatë proceseve gjyqësore, në shënjestër të shovinistëve u vu në mënyrë të veçantë intelegjenca jonë revolucionare dhe sidomos arsimtarët e gjuhës shqipe, historisë, marksizmit e të lëndëve tjera shoqërore. Ata u akuzuan dhe po akuzohen, se gjoja paskan nxitur romantizmin nacional, se i paskan indoktrinuar nxënësit me nacionalizëm e dogmatizëm, se i kanë edukuar ata, me ideologji të huaj për "vetëqeverisjen" etj., etj. Shovinistët serbomëdhenj nuk u ngopën me masat që ndërmorën kundër intelegjencies sonë. Sipas tyre nuk mund të qetësohet gjendja, derisa nëpër shkolla e fakultete të japin mësim ata arsimtarë, nxënësit e të cilëve kanë dalë në demonstrata, pra po kërkohet hapur që të largohen e dënohen të gjithë arsimtarët e ndershëm e patriotë.

Në shumë shkrime të shtypit jugosllav thuhej vazhdimisht se klasa punëtore dhe fshatarësia nuk mori pjesë në demonstrata dhe i dënoi ato. Mirëpo fakti se në mesin e të dënuarve, ishin jo pak por dhjetëra punëtorë e fshatarë, tregon se demonstratat e pranverës, nuk ishin demonstrata vetëm të nxënësve e studentëve dhe dëshmon për pjesëmarrjen e punëtorëve e të fshatarëve, në lëvizjen e këtij viti dhe për rolin e rëndësishëm që patën ata.

Se sa e egër dhe e poshtër është kjo fushatë shoviniste, tregon qartë edhe mbushja e burgjeve me vajza e djem të rinj, që ende nuk e kanë filluar mirë jetën dhe dënimet e rënda që po iu shqiptohen atyre. Vetëm në vendet më fashiste, mund të dënohet një i mitur, me dhjetë e më shumë vjet burg, vetëm pse ka shkruar një parullë apo një vjershë ose pse ka kërkuar kushte më të mira jetese, liri e të drejta që garantohen edhe me kushtetutë. Për të fshehur fytyrën e tyre të vërtetë para opinionit jugosllav nuk e publikuan fare dënimin e një numri të madh të të miturve. Vetëm në grupin që u dënuan për çarmatosjen e njësisë speciale të policisë së Beogradit u dënuan dhe nuk u publikuan fare jo më pak se 16 nxënës.

Të gjitha proceset gjyqësore u mbajtën me dyer të mbyllura, pa praninë as të familjeve të të akuzuarve, kurse Tanjugu, që ishte i vetmi burim informatash, nga këto farsa nuk e njohtonte fare opinionin me deklaratat e të dënuarve. Shumë nga gjykimet u bënë natën dhe të dielave, kurse trupat gjykues ishin krejtësisht anonim. Ndërtesat e gjykatave i rrethuan nga një numër i madh i policësh të armatosur gjer në dhëmbë, të cilët bllokonin edhe rrugët për rreth.

Shovinistët rankoviçistë, shpifën e trilluan gjithçka të keqe kundër motrave e vëllezërve tanë të dënuar, i quajtën "nacionalistë", "shovinistë", reaksionarë e kundërrevolucionarë, njerëz që i duan të keqen vetë popullit shqiptar, që dënohen nga ai etj., etj. Në këtë mënyrë, ata duan të mashtrojnë opinionin e painformuar në Jugosllavi e botë, por ata vetë e dinë se populli ynë, jo vetëm nuk i dënon bijat e bijtë e tij trima e besnikë, por i përkrah dhe i mbështetë ata me të gjitha forcat. Kjo është arsyeja e vërtetë pse gjykimet u bënë me dyer të mbyllura dhe jo aspak mungesë e sallave të mëdha, mungesa e karrigave e "arsye" të tilla qesharake.

Edhe përkundër dënimeve të shumta që u bënë dhe masave të egra që u ndërmorën ndaj popullit tonë, në qarqet e ndryshme shoviniste, çdo ditë po ngriten zëra të tërbuar të atyre që janë ende të pangopur me atë që u bë. Me anë të të ashtuquajturit "diferencim", ata po orvaten të ruajnë vazhdimin e fushatës së dhunës dhe terrorit.

Për të justifikuar masat e tyre të egra shovinistët jugosllavë, i kualifikuan demonstratat si armiqësore, madje edhe si përpjekje për kundërrevolucion dhe shpikë lloj-lloj parullash e kërkesash të cilat as që janë përmendur në demonstrata. Sipas asaj që thonë revizionistët, del se populli ynë paska dashur të përmbysë pushtetin, duke qenë i "armatosur" me gurë, shkopinjë e çekanë. Me "fakte" të tilla, ata duan të akuzojnë popullin tonë për "kundërrevolucion", por akuzat e tyre janë jo vetëm naive, por edhe qesharake. Çdo njeri i logjikshëm e di se me gurë e shkopinjë, nuk përmbyset një pushtet që mbrohet, me ushtri e polici të armatosur gjer në dhëmbë. Nga ana tjetër, në gjakimet që u zhvilluan, doli se në demonstratat që u bënë, pati parulla për kushte më të mira të jetesës, për lirimin e të burgosurve, për heqjen e policisë së huaj e për shndërrimin e Kosovës në Republikë, parulla kundër plaçkitjes së pamëshirshme të pasurive tona, kundër diskriminimit të gjithanshëm, ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi, etj., por jo parulla e kërkesa për Kosovën e pastër etnike e Shqipërinë e Madhe, kundër popujve jugosllavë e për dëbimin e tyre nga Kosova, e parulla tjera të trilluara nga vetë shovinistët, me qëllim që t'i japin tjetër karakter demonstratave dhe luftës sonë. Mbi parulla të tilla të fabrikuara është mbështetur edhe kualifikimi që i kanë bërë demonstratave udhëheqja jugosllave, prandaj ai edhe është krejtësisht i pabazë.

Me dënimet e shumta dhe me masat tjera represive shovinistët serbomëdhenj dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë, menduan se do ta frikësojnë e do ta mposhtin popullin tonë heroik dhe bijat e bijtë e tij trima. Mirëpo ata u bindën dhe çdo ditë po binden se në këtë mënyrë ata po i bëjnë varrin vetes. Me qëndresën e tyre burrërore, shokët tanë të burgosur, u kallën tmerrin armiqve edhe duke qenë të lidhur në pranga e zinxhirë, kurse populli po e vazhdon luftën e filluar me vendosmëri edhe më të madhe.

Këtë të vërtetë po detyrohen ta pranojnë edhe vetë autoritetet revizioniste. Në një mbledhje të udhëheqjes kosovare, u theksua se gjyqet që po organizohen po quhen gjyqe tradhtare, kurse aktiviteti, me gjithë masat e marra po vazhdon me forcë akoma më të madhe. Nga ana e tij njëri nga udhëheqësit jugosllav theksoi se duke u dhënë dënime të rënda të rinjve, ne po i bëjmë ata heronj para rinisë dhe popullit, kurse në Kuvendin e Kosovës u ngritën zëra dhe kundërshtuan hapur dënimet e rënda që iu dhanë pjesëmarrësve të demonstratave.

Dënimet drakoniane që iu shqiptuan motrave dhe vëllezërve tanë, nuk tregojnë forcën as trimërinë e udhëheqjes jugosllave, por frikën e madhe që i ka kapluar ata,

tregojnë dobësinë dhe kalbëzimin e regjimit të tyre gjakatarë. Ato nuk e kanë frikësuar dhe nuk do ta frikësojnë kurrë popullin tonë të pamposhtur. Ai do të luftojë me vendosmëri, për realizimin e kërkesave të tij të drejta dhe krahas kësaj ai do të luftoj edhe për lirimin e bijve dhe bijave të tij të dënuara padrejtësisht. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 1-2)

6-2. LETRA E TË BURGOSURIT

Nga Hydajet Hyseni

Unë nuk ndjej vetmi
Në terrin e qelisë;
Mua më shoqërojnë
Këngët e lirisë.

S'më mposhtin torturat,
armiq e tradhtarë;
Marksist-leninist, jam,
revolucionar.

Unë nuk njoh përulje,
para pranoj të vdes;
Por shokët nuk i jap,
Atdheun nuk e shes.

Një mijë herë po të bie,
Do të ngritem përsëri,
Prap do të hidhem
Në luftë për liri.

Lart flamuri i kuq!
Poshtë shovinizmi!
Përpara shokë!
Rroftë komunizmi! (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 2)

6-3. JETËN E JAPIM - FLAMURIN SE JAPIM!

Nga Hydajet Hyseni

Në revanin e tyre të çmendur antishqiptar, shovinistët jugosllavë, kanë zgjatur kthetrat e tyre të përgjakur edhe drejt flamurit tonë të lavdishëm. Njëri pas tjetrit, ngrihen ujqërit shovinistë dhe duke kërcëlluar dhëmbët ulurijnë kundër flamurit tonë kuq e zi. Herë nga Nishi, herë nga Cetina, herë nga Shkupi, herë nga Prishtina, dëgjohen britmat histerike “Flamuri shqiptar është shovinist e irredentist”, “Ai është flamur i Shqipërisë e i Enver Hoxhës”, “ai po indoktrinon shqiptarët me nacionalizëm e dogmatizëm…” t’ua ndryshojmë shqiptarëve flamurin kuq e zi!” “T’ua ndalojmë fare atë flamur të mallkuar me shqiponjë!”,” flamuri i tyre duhet të jetë flamuri trengjyrësh i Serbisë “etj., etj.

Britmat e këtilla rrënqethëse të shovinistëve e zemërojnë dhe e pezmatojnë pa masë çdo shqiptar, por ato nuk e çudisin dhe befasojnë askënd. Ne jemi mësuar me egërsinë dhe ligësinë e armiqëve tanë. Këto ulërima të egra, populli ynë i ka dëgjuar gjatë gjithë historisë së tij shumëshekullore. Armiq të shumtë e të egër, që ne rrugë për theqafje këndejpari i ranë, njeri pas tjetrit zgjaten kthetrat e tyre të zeza për ta ulur dhe zhdukur flamurin tonë të kuq me shqiponjë dhe për të ngritur në vend të tij, flamujt e tyre pushtues. Armiq të shumtë e vunë në shenjestër flamurin tonë, por ai nuk u zhduk. Flamuri ynë feniks, zbriti shumë shpesh në beteja të përgjakshme, priu në ballë të shqiponjave të lirisë, u skuq përsëri me gjakun e tyre të pastër dhe u ngrit edhe më i kuq, më madhështor, në tokën e pamposhtur të shqipeve. Më kot janë munduar armiqtë që të hedhin baltë mbi flamurin tonë, ta njollosin e nxijnë atë. Ai u fitua me gjak, u mbrojt me gjak dhe mbeti i kuq dhe i pastër si gjaku që u derdh për të.

Çetnikëve të rinj shovenë të Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi, edhe më parë ua ka vrarë sytë flamuri ynë i kuq, por tani ata po mendojnë se u ka ardhur rasti për t'u vërsulur, përsëri kundër tij, ashtu siç bënë menjëherë pas Luftës. Nën flamurin kuq e zi, partizanët shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, luftuan dhe u vranë gjatë epopesë së lavdishme të Luftës antifashiste Nacionalçlirimtare, të bindur se pas përfundimit të saj, do të fitonin edhe ata lirinë e ëndërruar në shekuj. Por shovinistët e rinj jugosllavë për ta shpërblyer, për kontributin e madh që dha në luftë, e pushtuan përsëri popullin tonë martir, e ndanë dhe e copëtuan siç deshën ata, e vranë e rrahën dhe e masakruan përsëri, ia ndaluan edhe flamurin. U desh përsëri shumë luftë dhe gjak, shumë vjet burgje, vuajtje e tortura, që në tokën e Kosovës, të valonte përsëri flamuri ynë kuq e zi. Dhe ja tani, pas sa vitesh, lugetërit rankoviçistë, po zgjasin përsëri duart e tyre, të përgjakura drejt flamurit tonë.

Shovinistët po e quajnë "shovinistë" flamurin tonë të lavdishëm, por gjithkush në botë e dinte se flamuri ynë, nuk ka qenë kurrë flamur pushtues, kurrë nuk u ka bërë hije të tjerëve. Shovinistët mund të lehin sa të duan, por popujt jugosllavë e dinë, dhe nuk mund të harrojnë, se me këtë flamur në ballë, partizanët heroikë shqiptarë, luftuan krah për krah me partizanët jugosllavë, kundër nazistëve gjermanë dhe forcave çetnike edhe në Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë e Serbi, edhe në Srem të Trieshte. Ndoshta është pikërisht ky fakt që i bënë çetnikët revizionistë të Beogradit të kenë gjithë atë urrejtje, kundër flamurit tonë gjithmonë fitimtar.

Duke shpresuar se kështu do ta ndalojmë më lehtë, shovinistët po e quajnë flamurin tonë, flamur të Enver Hoxhës e të Partisë së Punës, por edhe ata e dinë mirë se me këtë flamur kanë luftuar stërgjyshërit tanë dhe të Enver Hoxhës, jo më pak por 5-6 shekuj më parë. Partia e Punës dhe shoku Enver Hoxha, nuk bënë tjetër veçse e shpëtuan flamurin e Skënderbeut, e Ismail Qemalit, e mbrojtën atë me heroizëm, ia shtuan atij yllin e kuq të komunizmit, ia shtuan lavdinë, nderin e krenarinë, e bënë atë flamur të dashur e të respektuar, për popujt, proletarët dhe komunistët e vërtetë të të gjithë botës.

Me qëllim që ta justifikojnë disi këtë ndërmarrje të pashembullt shoviniste, shovinistët jugosllavë po detyrohen dhe po e përdorin edhe ndonjë krimb të fëlliqur shqiptar që të kërkojnë me gojën e tij të qelbur, ndalimin e flamurit tonë. Po këtë kërkesë të poshtër, përmbajnë edhe letrat e shumta që boton shtypi jugosllav, të nënshkruara nga emra të trilluar shqiptar e që ,siç është vërtetuar më se një herë, janë të shkruara nga vetë shovinistët serbomëdhenj. Ja deri ku mund të shkojë ligësia dhe poshtërsia e logjikës shoviniste, duan ta bindin opinionin jugosllav dhe atë botëror se kërkesa për heqjen e flamurit shqiptar na qenka "kërkesë" dhe "dëshirë" e vetë shqiptarëve! Po kush është ai naiv që mund të besojë marifete të tilla, sa të poshtra, aq edhe naive e qesharake. Kundër

makinacioneve të këtilla po ngriten zëra edhe në vetë shtypin revizionist jugosllav, po ngriten edhe autoritetet tradhtare të Kosovës.

Nuk ka populll në botë, që do ta dëshironte e kërkonte t'i hiqej e ndalohej flamuri i tij, simboli i qenjes së tij. Jo. Këtë nuk mund ta bëjë askush dhe sidomos nuk mund ta bëjë kurrë shqiptari që flamurin kuq e zi e ka gjenë më të shenjtë e më të shtrenjtë, shqiptari që nëpër shekuj, siç thotë kënga "vritej e pritej për flamur, armiqtë hiq e ai vur".

Legjendat thonë se flamuri i të parëve tanë dikur ishte i bardhë, siç ishin të bardha edhe veshjet, plisat dhe zemrat e tyre. Erdhën bajlozët e zinj dhe deshën ta shkelin flamurin e arbërit, që simbolizonte bardhësi, paqe e çiltërsi… dhe në vend të tij, të ngrinin në kështjellat tona flamujt e tyre të zinj, pushtues. Që flamuri arbëror të mos binte në kthetrat e zeza të armiqve zaptues, luftëtari arbëror, gjatë një beteje e çau gjoksin e tij dhe e futi aty flamurin arbëror. Pas betejës, dy shqiponja të maleve tona e nxorën flamurin e arbrit prej gjoksit të luftëtarit trim dhe duke e mbajtur në dy skaje fluturuan lartë në qiellin arbëror. Bijtë e shqipeve e panë flamurin e tyre, që ishte skuqur nga gjaku i luftëtarit, i panë shqiponjat që e valvitën krenarë atë flamur të përgjakur dhe këtë pamje i dhanë flamurit të tyre…

"Legjenda, mite, romantizëm nacional.. mund të gërthasin shovinistët. Dhe vërtetë shumë legjenda madhështore ka populli ynë legjendarë. Legjenda është legjendë, por, me këtë rast, ajo shpreh një të vërtetë të madhe e të pamohueshme , të vërtetën se flamuri është fituar dhe është mbrojtur me gjakun e atyre bijve të këtij trualli, të cilët në furtunat e stuhishme që kalonte Atdheu, e mbanin atë në gjokset e tyre të zjarrtë, aty pranë zemrës. Sa gjak shqiptari është derdhur për këtë flamur, sa luftëra e beteja të përgjakshme janë bërë nën këtë flamur. Sa trima luftëtarë janë betuar para këtij flamuri, të skuqur me gjakun e të parëve të tyre, sa bija të populllit janë kalbur dhe po kalben edhe sot për këtë flamur! Flamuri ynë i kuq me shqiponjën dykrenare, është përjetësuar me këngët më të bukura të populllit, është kënduar në vargjet më të zjarrta të poetëve tanë, është qëndisur me qëndismat më të bukura të vajzave e nuseve shqiptare, është gdhendur në dru, është skalitur në hekur e gur…, flamuri ynë është gdhendur e skalitur thellë në zemrat tona, prandaj edhe nuk mund të hiqet kurrë, për pa i skuqur zemrat tona.

Po këtë përgjigje ka populli ynë flamurdashës edhe për thirrjen tjetër hiç më pak të poshtër e antishqiptare, për të ndryshuar flamurin tonë dhe për t'i shtuar si shtesë atij ndonjë simbol jugosllav. Populli ynë i ka të qarta qëllimet e errëta dhe tepër të rrezikshme që fshihen pas kësaj kërkese shoviniste, sado që në pamje të parë ajo paraqitet si çështje jo edhe aq e madhe.

Duke e cilësuar flamurin tonë, si flamur të RPS të Shqipërisë, pra të shtetit të sotëm shqiptar dhe jo edhe të gjysmës tjetër të populllit shqiptar, që padrejtësisht është lënë jashtë kufijve të tij, shovinistët jugosllavë, duan që fillimisht të sajojnë ndryshime të paqena në mes nesh dhe vëllezërve tanë të një gjuhe dhe të një gjaku në Shqipërinë socialiste, në mënyrë që më vonë, të na mohojnë krejtësisht përkatësinë tonë kombëtare shqiptare.

Flamuri kuq e zi nuk është vetëm flamur i shqiptarëve brenda RPS të Shqipërisë, por flamur i të gjithë populllit e kombit shqiptar, i çdo shqiptari kudo që ndodhet. Flamuri ynë i kuq me shqipen dykrenare ka valuar në tokën arbërore, shumë kohë para copëtimit të Atdheut tonë nga fuqitë imperialiste e qarqet shoviniste fqinje. Këtë flamur e valëviti Dedë Gjo Luli me trimat e tij në malet e Deçiçit (që sot është në Malin e Zi), këtë flamur e puthi në Vlorë, në Vlorë me sy të përlotur, fatosi ynë Isa Boletini, nën këtë flamur luftoi dhe ra heroikisht trimi i maleve, Bajram Curri, me këtë flamur në dorë luftuan Azem Bejtja e Shotë Galica, me këtë flamur në ballë luftuan dhe shkruan epopenë e tyre të

lavdishme shqiponjat partizane. Për këtë flamur të shtrenjtë tretën rininë e tyre nëpër burgje e qeli bijtë më të mirë të popullit tonë. Nën këtë flamur populli ynë vërshoi në demonstratat e vitit 1968, në këtë flamur në ballë, gjatë pranverës së përgjakshme të këtij viti, bijtë dhe bijat e Kosovës heroike u dolën përpara dhe u hapën gjoksin tankeve e mitralozëve të armikut, u përleshën me ta duke kërkuar lirinë dhe të drejtat tona, duke mbrojtur flamurin tonë.

Në flamurin tonë është gjaku, që kanë derdhur brezat në altarin e lirisë, është amaneti i tyre i shenjtë, është fati i brezave që do të vijnë, prandaj nuk lejojmë kurrfarë loje me të. Ashtu siç i bëri copë-copë sëpatat e Liktorit që fashistët italianë u munduan t'ia shtijnë flamurit tonë, populli ynë nuk do të lejojë askënd t'ia prishë flamurin e tij të lavdishëm, nuk do të lejojë kurrfarë arnimi të flamurit të tij, kurrfarë shenja tjetër në fushën e flamurit përveç shqiponjës dykrenare dhe yllit të kuq vezullues. Flamuri ynë nuk është dhe nuk do të jetë kurrë flamur i larëm. Flamuri shqiptar ka qenë dhe do të mbetet për jetë kuq e zi.

Flamurin tonë e kemi fituar me gjakun tonë, e kemi mbrojtur me gjakun tone dhë po të jetë nevoja, jemi gati ta mbrojmë përsëri me gjakun tonë. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 3-4)

6-4. PËRLESHJE NË MES POLICISË SERBE DHE QYTETARËVE NË PODUJEVË

Nga Nezir Myrtaj

Policia serbe e cila po qëndron në Kosovë, që prej fillimit të pranverës së këtij viti, përveç sjelljeve të saja banditeske ndaj popullit tonë të pafajshëm po bënë në mënyrë të vazhdueshme provokime të shumta, bile duke sulmuar atë edhe fizikisht. Përveç disa rasteve që njihen në të cilat kjo polici, sulmoi familje dhe individ të ndershëm, siç ndodhi në Prekaz, në Prishtinë, Gjakovë etj. Para një kohe u shkaktuan edhe përleshje në mes pjesëtarëve të kësaj policie dhe një familjeje në Podujevë.

Shefki Hasani, punëtor në Shtëpinë e Kulturës në Podujevë, duke pushuar në Motelin "Besiana", papritur iu ekspozua provokimeve të disa policëve, të cilët poashtu ndodheshin aty. Policët serb tentuan ta rrahin dhe ta arrestojnë Shefkiun, mirëpo ai me shkathtësi dhe forcë i goditi ata dhe arriti që për një kohë t'i shpëtojë arrestimit.

Të alarmuar nga ky aksident, patrullat e policëve, të armatosur gjer në dhëmbë filluan rrugën për në shtëpinë e Shefkiut, në mënyrë që të marrin "hakun". Me këto njësi shkuan edhe vetë komandanti dhe inspektori i policisë. Një lagje e tërë në Podujevë u rrethua nga policët serb, kurse disa prej tyre hynë në shtëpinë e Shefkiut. U ngrit në këmbë e gjithë familja: dy vëllezërit, nëna dhe motra e Shefkiut. Në përleshje e sipër midis policisë së armatosur dhe familjes duarthatë u lënduan shumë policë e veçanërisht komandanti i tyre i cili u godit për vdekje. Pas gjithë kësaj drame që shkaktuan korbat serbë, familja Hasani u arrestua e tëra. Ky akt i ulët i revoltoi pa masë gjithë qytetarët e Podujevës e mbarë Kosovës por njëherit ishte edhe një mësim i mirë, për të gjithë ata që mësyjnë t'i poshtërojnë e robërojnë vatrat shqiptare. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 4)

6-5. LAVDI O JU TRIMA, QË RATË PËR ATDHE

Nga Berat Luzha

Ishte fillimi i pranverës së këtij viti, blerimi sapo kishte filluar të mbulojë e hijeshojë natyrën tonë të bukur. Manushaqet e lulëkuqet i kishin hapur kurorat e para të luleve kundërmonjëse e bilbli këndoi këngën e parë kushtuar stinës së re që po vinte. Dukej se acarit të dimrit të fortë po i vinte fundi e zemrat tona të ngroheshin me rrezet e ngrohta të diellit pranveror.

Në këtë prag pranvere, djelmëria kosovare, tok me popullin, ngriti zërin dhe grushtin e vet rinor për të kërkuar e fituar të drejta e liri. Dhe, kush mund ta ndalonte rininë tonë të ngrihet dhe ta tund "malin që s'bëzante"? Kush mund ta ndalonte vrullin revolucionar të rinisë sonë që të marshonte para bajonetave e mitralozave, para tankeve e nën kërcënimin e avionëve gjuajtës luftarak, të marshonte qyteteve e fshatrave tona? Askush! Aq sa mund të ndalohej pranvera e sivjeme të mos vijë, aq mund të ndalohej rinia jonë që të mos defilojë në realizimin e kërkesave të veta të drejta dhe të shpreh revoltën që i vlon në gji.

Mbi rininë dhe popullin tonë u përplasën dallgë të egra shoviniste, u ngritë një fërfëllazë e fortë e cila solli dhjetëra mijëra policë e ushtarë të huaj të armatosur deri në dhëmbë, solli mijëra tanke e avionë. Kjo fërfëllëzë deshi të shkatërrojë çdo gjë shqiptare, para së gjithash shpirtin dhe zemrat e zjarrta patriote e revolucionare të rinisë sonë.

Rinia e kuqe e Kosovës kreshnike ia hapi gjoksin furtunës shoviniste, dallgëve e zjarreve që ngritën katilët e Beogradit, Nishit, Kralevës, Shkupit e Titogradit... Ajo u hodhë e para në kërkesa dhe në revoltë, ajo u hodhë e para dhe në zjarrin e luftës për mbrojtjen e vatrave të veta.

Rinia revolucionare e Kosovës edhe kësaj radhe nuk i duroi hordhitë shoviniste, të marrin nëpër këmbë nderin dhe dinjitetin kombëtar, të shkelin në vatrat tona dhe të ç'nderojnë motrat dhe nënat tona. Ajo u prek në sedër nga veprimi i poshtër dhe i pabesë i çetnikëve të Beogradit në konviktet e studenteve më 26 mars. Ajo u përlesh fytfyt me komandosët specialë të policisë së huaj, të ardhur këtu për të shfryrë dufin prej shovinistëve të pashiqëve, mihajlloviqëve e herleviqëve mbi popullin tonë të pafajshëm. Nga kjo përleshje me hienat shoviniste të cilët bënë terror të zi, masakrim e persekutim në masë, u plagosën, u vranë e u burgosën mijëra të rinj kosovarë, lulja e rinisë sonë heroike.

Nga terrori i zi vdiqët ju, o trima. Ju që dhatë jetën për të drejta e liri, populli nuk do t'ju harroj kurrë. Ju nuk e gëzuat edhe këtë pranverë të mbushur me plot ngjarje e me plot vlime revolucionare.

Ju, dëshmorë ratë në fushën e nderit, aty ku ju ftoi atdheu. Ju ratë duke u përleshur me policë të shumtë, me bajonetat, bombat helmuese e automatikët e tyre. Ju ratë duke u përleshur me ushtarë të huaj, me tanksat e mitralozët e tyre.

Ju, o trima, ishit të parët që i dolët zot vatrave shqiptare, motrave e nënave shqiptare. Ju, me guxim e vetëmohim të pashoq luftuat që qizmja e rëndë shoviniste kurrë të mos shkel mbi nderin tonë, që zingjirët e ulurimat të mos hyjnë kurrë që t'i shkelin zemrat tona, shpirtin tonë.

Ju, vëllezër e motra të rënë, ishit të ndërgjegjshëm për sakrificën që bëtë, dhe ia falët atdheut jetën tuaj të re. Për atdheun e popullin ju flijuat jetën tuaj ende të pashijuar, trupin tuaj ende të njomë. Dhe populli kurrë nuk do të ju harrojë. Ai, për ju do të thurë këngë, do të ju ngrejë lavdi.

Ju, shqiponja të lirisë, nuk keni vdekur. Në shpirtin dhe zemrën e popullit tonë martir do të qëndroni përgjithmonë.

Ju, trima të vatanit do të radhiteni, në listën e gjatë të dëshmorëve të popullit, duke gëzuar kështu kurdoherë respektin e thellë të këtij populli që ju lindi e rriti. Populli ynë kurrë nuk do të shkelë mbi gjakun tuaj të shtrenjtë. Ai mbi gjakun tuaj do të ndërtojë kalanë e madhe të lirisë. Gjakun tuaj të shtrenjtë do ta marrë populli, hakun tuaj do ta paguaj shtrenjtë armiku gjakatar dhe i pabesë. Mbi gjakun tuaj tani po shkel vetëm një grusht i vogël tradhtarësh e shërbëtorësh të të huajve, të cilëve ndër deje u rrjedh gjak i fëlliqur dhe qelb tradhtari. Qelbanikët janë ata që do të marrin mallkimin e popullit e të atdheut, janë ata të cilëve populli u falë vetëm një gjë – plumbin.

Është turp i madh përpara popullit e atdheut, të jesh tradhtar!

Ju, martirët e lirisë, na mësuat si jetohet e si vdiset. Na mësuat si mbrohet atdheu, si mbrohet nderi dhe dinjiteti kombëtar. Ju ngjallët epopetë e lavdishme të Mic Sokolit, Selam Salarisë, Mujo Ulqinakut, Vasil Laçit, Koci Bakos, Mine Pezës, Vojo Kushit e të shumë dëshmorëve të tjerë, të cilët u përleshën me milicët e ushtarët e huaj fyt më fyt, e kapën topin nga gryka e u gjuajtën mbi tankset armike...

Ju sokolat e atdheut, u frymëzuat nga heroizmi i dëshmorëve e heronjve të popullit, u frymëzuat nga Teuta, Skenderbeu, Abdyl Frashëri, Ismail Qemali, Idriz Seferi, Avni Rrustemi, Bajram Curri, Asim Vokshi, Ibe Palikuqi, Bardhok BIba e të tjerë, të cilët ju mësuan të rroni por edhe të vdisni me nder, kur këtë e kërkon atdheu; sepse siç thotë edhe kënga popullore: "se shqiptari dy gëzime ka: një kur lind, një në luftë me ra".

Ju o trima i treguat edhe një herë armikut, sa e fortë është fuqia e popullit. Se sado të veshur e të pajisur me armatime të jenë armiqtë, para fuqisë së popullit nuk janë gjë tjetër, pos hijena të destinuara për dështim të turpshëm. Populli, armikut e tradhtarit i kërkon lulen e ballit, i jep plumbin kokës. Kështu ndodhi në Prekaz të Drenicës, ku u ngjallë epopeja e Azem e Shote Galicës, e Ahmet Delisë e Qorr Ilazit. Kriminelët e Beogradit, me tërë ato tanke e helikopterë, me mitraloza e veshje speciale u kthyen me turp nga ofenziva e tyre "madhështore" kundër një familje të ndershme e patriote. Dhjetëra policë, prej mëse 700 sish, nuk u kthyen më kurrë në kampet e tyre, që kohëve të fundit kanë mbirë në Kosovë kudo, si këpurdhat pas shiut.

Po, djemtë e Vatanit edhe këtë here u treguan armiqve se shqiptari, nuk duron t'i merret nëpër këmbë nderi dhe dinjiteti. Ju, i treguat qetnikëve se shqiptari duron shumë, por kur zemërohet shqiptari, merr flakë e zjarr edhe stralli.

Edhe ju o vëllezër kurbetgjinj, nuk qëndruat indiferentë ndaj ngjarjeve të Kosovës. Ju kërkuat të ktheheni në familjet tuaja, t'u qëndroni familjeve pranë në ato ditë të stuhishme. Ju erdhët nga kurbeti, dhe kur erdhët te pragu i shtëpisë, hienat fashiste ju urdhëruan të ktheheshit prapa, ju qëndruat me ditë të tëra nëpër stacionet e policisë, nëpër stacionet e autobusëve e të hekurudhave. Në ditët e netët e gjata, kur Kosovën e kishte përfshirë gjëma e kur armiku kishte vënë orën policore, ju nuk kishit se si t'i bindeshit urdhërit "stoj" të shovinistëve. Në pragun e shtëpive tuaja, ju gjetët vdekjen pa i parë edhe njëherë voglushët, të cilët si zogjtë e shqiponjës në çerdhe, kërkonin mbrojtje nga gjarpri helmues. Mbi ju ranë breshëri automatikësh, mbi ju, ra helmi i gjarprit shovinist serbomadh.

Rrugët e qyteteve e të fshatrave tona u skuqën edhe një herë me gjakun e bijve më të mirë të kësaj toke, u vaditën me gjakun e bijve më të shtrenjtë, me gjakun më të ri.

Gjaku juaj i pastër o shokë dëshmor, siç thotë kënga popullore, "ra në tokë me mbi përsëri".

O shokë, mbi varret tuaja ende të shkriftë, këto ditë ra bora e parë. Varret tuaja i mbuloi kjo borë, por nuk do t'i harrojë kurrë populli. Varret tuaja do të mbushen me lule. Pranë tyre me grushtin lartë, rinia dhe populli ynë do të betohen "ja vdekje, ja liri". Varret

tuaja si edhe deri më tani, bashkë me gjelbërimin e borën do t'i mbuloi edhe kujtimi i përhershëm i popullit.

Pushoni, o shokë, pushoni të qetë, se ratë me nderë. Pushoni të qetë se hakun do t'ua marrë populli. Çështja për të cilën ratë, ju shokë të dashur është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë. Rrugën që filluat ju ne do ta vazhdojmë. Prandaj pushoni, se nuk keni vdekur, në zemrat tona do të jeni gjithmonë.

Lavdi more trima, që ratë për atdhe! (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 5)

6-6. KONGRESI I FITOREVE

Nga Mehmet Hajrizi

Në një atmosferë të zjarrtë revolucionare e festive, nga 1 gjer më 7 nëntor, në Tiranë, zhvilloi punimet me sukses të plotë Kongresi i 8-të i Partisë së Punës të Shqipërisë. Ky Kongres u mbajt në jubileun e lavdishëm të 40 vjetorit të lindjes së Partisë dhe bashkë me të përbëjnë dy ngjarje të mëdha historike, për popullin shqiptar dhe për Partinë e saj heroike të Punës.

Dyzet vjet jete të PPSH janë dyzet vjet luftërash e fitoresh të parreshtura të Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë dhe shokut Enver Hoxha, në luftën Nacionalçlirimtare, në revolucionin socialist, ndërtimin e një jete të lumtur socialiste, në mbrojtjen e pashembullt të marksizëm-leninizmit fitimtar nga sulmet e poshtra që i që i kanë bërë e i bëjnë atij forcat e errëta imperialiste e revizioniste në botë dhe në forcimin e vazhdueshëm të pavarësisë e të Sovranitetit të Shqipërisë socialiste dhe aftësive të saj mbrojtëse.

Raportet që ka mbajtur në tetë Kongreset udhëheqësi i lavdishëm i Partisë dhe i popullit shqiptar, shoku Enver Hoxha janë një sintezë e gjallë shkencore marksiste-leniniste e gjithë këtyre luftërave heroike dhe e fitoreve madhështore që gëzon sot Shqipëria socialiste.

Në Kongresin e 8-të të Partisë dhe në jubileun e saj të madh, klasa punëtore në Shqipëri, fshatarësia kooperativiste, intelegjence dhe gjithë punonjësit, erdhën duarplotë dhe ballë lartë, me fitore të reja madhështore në të gjitha fushat. Megjithë vështirësitë e papritura që shkaktoi tërmeti i 15 prillit 1979 megjithë bllokadën e egër imperialisto-revizioniste dhe krizën e paparë ekonomike që e ka mbërthyer botën përreth saj, Shqipëria socialiste me forcat e veta materiale e njerëzore realizoi plotësisht objektivat themelore, të përcaktuara në kongresin e 7-të historik të PPSH për zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës.

Raporti që mbajti Sekretari i Parë i KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha në Kongres përbën një sintezë dhe bilans të fitoreve të arritura në Shqipëri dhe njëkohësisht një program madhështor pune e lufte, për të ardhmen akoma më të lumtur të Shqipërisë socialiste.

Në kohën kur gjithë botën kapitalisto-revizioniste e ka mbërthyer kriza e gjithanshme ekonomike e politike e manifestuar me plagë të pashërueshme, që janë bërë bashkudhtare të paevitueshme të sistemit kapitalisto-revizionist gjer në vdekje, Shqipëria socialiste e Enver Hoxhës marshon e sigurt nga fitorja në fitore drejt majave më të larta në rrugën socialiste; me një ekonomi stabile dhe të fortë, komplekse pa kriza, pa rënie prodhimi, pa borxhe të jashtme e të brendshme, pa ngritje çmimesh e papunësi, me një kulturë kombëtare e të pastër e të pasur dhe me një gjendje të shëndoshë politike. Në

unitet më të fuqishëm se kurrë rreth Partisë dhe KQ të saj me shokun Enver Hoxha në krye, masat punonjëse janë gati të realizojnë një për një të gjitha objektivat, që përcaktoi Kongresi i 8-të, si për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës ashtu edhe në përgaditjen e gadishmërinë e vazhdueshme për t'i derdhur plumba në gojë, kujtdo që guxon të prek sadopak Shqipërinë e kuqe të Partisë së lavdishme të punës e të popullit ushtar.

Direktivat që miratoi Kongresi për planin e 7-të pesëvjecar, të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, përbëjnë një program të madh lufte e pune për gjithë masat punonjëse në Shqipëri i cili do të çojë akoma më lartë Shqipërinë, kësaj radhe të mbështetur plotësisht dhe vetëm në forcat e veta, pa asnjë ndihmë e kredi nga jashtë. Garanci e sigurtë e këtij plani pesëvjeçar, e realizimit të tij, i cili bënë sa katër pesëvjeçar të marrë së bashku (1951-1971) është vija e drejtë marksiste-leniniste, baza materiale e teknike që ka sot Shqipëria, mobilizmi revolucionar dhe vendosmëria e tyre për t'i bërë realitet patjetër këto objektiva.

Në raportin e KQ dhe në diskutimet që u zhvilluan në Kongres, iu bë një analizë politikës së jashtme që ka zbatuar Partia dhe shteti shqiptar si dhe u përcaktua ajo për periudhën e ardhshme.

Shqipëria Socialiste ndjek një politikë të jashtme e të brendshme parimore, pa luhatje dhe thellësisht marksiste-leniniste. Shqipëria nuk është, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë e izoluar nga bota, siç mundohen të trillojnë armiqtë e saj, armiqtë e socializmit e të marksizëm-leninizmit. Shqipëria sot ka lidhje diplomatike, tregtare e kulturore me afro 100 vende të botës. Shqipëria Socialiste ka sot miq të shumtë në të gjitha kontinentet e rruzullit tokësor dhe numri i tyre po shtohet vazhdimisht. Prestigji i saj sot është më i lartë se kurrë më parë dhe është në ngjitje të vazhdueshme. Shqipërinë e duan dhe e respektojnë të gjitha vendet dhe shtetet përparimtare, proletariati ndërkombëtar dhe popujt e botës, partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe njerëzit përparimtar e revolucionar kudo në botë.

Kongresi i 8-të i Partisë, ka edhe një rëndësi të madhe ndërkombëtare për zhvillimin e lëvizjes marksiste-leninste dhe forcimin e unitetit të saj internacionalist. E izoluar, siç ka thënë shoku Enver Hoxha: "me vetëdije Shqipëria është vetëm nga imperialistë, fashist e revizionistë që bëjnë çdo përpjekje për ta mbytur zërin e saj, për ta zhdukur edhe socializmin e vërtetë".

Në Kongres u tha edhe një herë qartë se Shqipëria dëshiron të ketë lidhje e marrëdhënie të mira, me të gjitha ato vende që ia duan të mirën asaj dhe kanë një qëndrim korrekt në këto marrëdhënie. Nga këto parime Shqipëria është udhëhequr edhe në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Por udhëheqja jugosllave siç po duket e shtrënguar nga klani serbomadh, që shumë nga frenjt e qerres udhëheqëse jugosllave, i ka futur në dorë, në përpjekje për të gjetur një fajtor të paqenë, jashtë Jugosllavisë, për gjendjen serioze të krijuar në Kosovë, akuzuan Shqipërinë për gjoja ndërhyrje në punë të mbrendshme të Jugosllavisë, për nxitjen e demonstratave masive në Kosovë etj., etj. Shqipëria dhe Partia e Punës në fakt, në rrugë marksiste-leniniste dhe në përputhje me normat ndërkombëtare, si në të kaluarën edhe sot mbrojnë të drejtat e ligjshme të popullit shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, të cilat na janë mohuar e mbytur në gjak nga udhëheqja jugosllave në përgjithësi dhe nga krerët serbomëdhenj në veçanti. Qëndrimi në Kongres i problemit të Kosovës dhe veçanërisht fjala e shokut Enver Hoxha, patën jehonë në çdo vatër shqiptare në Jugosllavi dhe erdhi si një valë e ngrohtë, në këtë acar terrori fashist të vendosur mbi popullin tonë martir. Nga ana tjetër klika serbomadhe e Beogradit, në shqetësim të ethshëm vuri në lëvizje forcat fashiste dhe u ngut ta quaj të "papranueshëm" këtë qëndrim e të vazhdojë avazin e vjetër të akuzave kundër Shqipërisë, gati sa s'po fajësohet vetë Enver Hoxha për organizimin e protestës që u bë këto ditë në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

Kongresi i 8-të i PPSH, analizoi situatën ndërkombëtare dhe zhvillimin e sotëm botëror, luftën e imperializmit e të socialimperializmit për sundim botëror, të borgjezisë, revizionizmit e të reaksionit ndërkombëtar, për të mbajtur në shtypje e shfrytëzim proletariatin dhe popujt dhe nga ana tjetër e proletariatit ndërkombëtar dhe partive të tij marksiste-leniniste si dhe popujve për çlirimi kombëtar e shoqëror nga shtypësit e egër. PPSH duke i mbetur besnike gjithmonë parimeve marksiste-leniniste përcaktoi në këtë Kongres detyrat e saj dhe të RPS të Shqipërisë në luftën konsekuente kundër imperializmit me atë amerikan në krye, socialimperializmit sovjetik, kundër shtypjes kombëtare e racizmit si dhe në luftën e pamëshirshme për demaskimin e të gjitha varianteve të revizionizmit.

Si Raporti që mbajti shoku Enver Hoxha ashtu edhe të gjitha dokumentet tjera të Kongresit, shprehin vazhdimin konsekuent të vijës marksiste-leniniste të PPSH në kushtet aktuale të mbrendshme e të jashtme. Kongresi vërtetoi edhe një herë vendosmërinë e PPSH për t'i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar pa marrë parasysh as shantazhet e presionet dhe as lajkat e buzëqeshjet hipokrite të imperializmit e të socialimperializmit. Populli shqiptar, i madh e i vogël, nën udhëheqjen e Partisë së tij të lavdishme, në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, ndërton e sigurtë shoqërinë e re socialiste dhe gjithnjë me vigjilencë është i gatshëm t'i mbrojë nga çdo sulm, ngado që t'i vijë, fitoret e tij, atdheun e tij të dashur socialist. Partia heroike e Punës e Shqipërisë, asnjëherë nuk është përulur para asnjë force dhe kurrë, nuk do të përulet e nënshtrohet para askujt.

Kongresi i 8-të i PPSH ishte një manifestim i unitetit që ekziston në radhët e Partisë dhe të të gjithë popullit rreth saj. Shprehje konkrete e këtij uniteti dhe entuziazmi e atmosferës që përshkoi sallën gjatë gjithë Kongresit, është mobilizmi i klasës punëtore, i fshatarësisë kooperativiste dhe intelegjencies popullore si dhe gjithë popullit, të cilët janë të gatshëm, që me guxim dhe heroizëm revolucionarë, të bëjnë realitet me forcat dhe mundësitë e veta, gjithë objektivat që parashtroi Kongresi historik i Partisë sokoleshë të Punës, të çojë përpara zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë socialiste. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 6)

6-7. SHOKU ENVER HOXHA PËR KOSOVËN

PJESË NGA FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E 8-të TË PPSH

Në marrëdhëniet tona me Jugosllavinë ne jemi nisur e nisemi nga fakti se popujt tanë jetojnë prej shekujsh njëri pranë tjetrit, se fatet historike shpesh kanë qenë të përbashkëta, se kur pushtuesit e huaj kanë sulmuar njërin nuk e kanë kursyer as tjetrin. Këto na kanë bërë e na bëjnë që me Jugosllavinë, pavarësisht nga kontradiktat ideologjike e politike që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë ndërmjet dy vendeve e që tashmë janë të njohura botërisht, pavarësisht nga polemika ideologjike që është zhvilluar e zhvillohet nga të dy palët, të kërkojmë gjithnjë të rrojmë në paqe e në fqinjësi të mirë, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe duke respektuar të drejtat e secilit.

Politika e Shqipërisë socialiste ndaj Jugosllavisë ka qenë kurdoherë konstante, e pandryshuar në bazat dhe në parimet e saj. Në qoftë se në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ka pasur ulje e ngritje, përmirësime e acarime, kjo ka ndodhur jo për fajin tonë, por për fajin e qarqeve drejtuese jugosllave. Edhe keqësimi i tanishëm në marrëdhëniet midis RPS të Shqipërisë dhe RSF të Jugosllavisë është pasojë e veprimeve shoviniste të autoriteteve të Beogradit ndaj popullsisë së Kosovës dhe e nxitjes nga ana e tyre të një fushate të re armiqësore kundër vendit tonë.

Për sa i përket Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë qëndrimet dhe sjellja e jugosllavëve ndaj saj nuk do ta lëkundin atë nga parimet, nuk do ta bëjnë të ndryshojë rrugë. Ajo dëshiron që marrëdhëniet shtetërore në fusha të ndryshme ndërmjet dy vendeve të zhvillohen normalisht. Por kjo do të varet nga qëndrimi i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë socialiste dhe nga trajtimi që do t'u bëhet shqiptarëve të Kosovës e të viseve të tjera në Jugosllavi.

Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi, nuk është problem i një «minoriteti», i ardhur apo i vendosur diku në një zonë «vakuum» si emigracion ekonomik, as i shkaktuar nga dyndja e Perandorisë Osmane dhe as nga rritja e natyrshme demografike e shqiptarëve që shqetëson Maltusët e rinj serbomëdhenj. Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton, të cilin, siç dihet, e copëtuan dhe e shkëputën nga mëmëdheu i vet fuqitë e mëdha imperialiste dhe ia aneksuan Jugosllavisë. Këtë askush nuk mund ta fshehë. Çdo interpretim tjetër është arbitrar, është një falsifikim i rëndë e i dëmshëm i historisë.

Mëmëdheun e etnisë shqiptare populli shqiptar nuk ua la as pushtuesve fashistë, as kurrkujt tjetër që ta përcaktonte. Shqiptarët kanë luftuar pa pushim e në shekuj kundër armiqve të egër e shumë më të mëdhenj në numër për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe vetë ekzistencën e tyre. Në të gjitha këto luftëra, si në humbje dhe në fitore, në vitet e gjata të robërisë, në tërë historinë e tij, populli shqiptar nuk i humbi asnjëherë vetëqenien dhe vetëdijen e tij kombëtare, kompaktësinë dhe unitetin e tij. Në çdo rrethanë ai i ka manifestuar ato me një vitalitet të jashtëzakonshëm e shembullor.

Perandoritë dhe fuqitë e mëdha nuk e zhdukën dot etninë kompakte të shqiptarëve, as nuk mundën ta asimilonin, t'i ndërronin kulturën, gjuhën, , doket dhe zakonet. Këtë e vërteton vetë ekzistenca e popullit shqiptar. Historia tregon se, pa asnjë përkrahje nga fuqi të huaja, të cilat i ka pasur kurdoherë kundër, ai ka luftuar me sukses për lirinë e kombit dhe për kompaktësinë e tij, për mbrojtjen e pavarësisë si shtet sovran, të kulturës së tij dhe të të drejtave të veta të natyrshme e të ligjshme. Kurdoherë vetëm lufta dhe gjaku i tij i derdhur kanë bërë që të arrihej fitorja.

Në Luftën e Dytë Botërore populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë luftuan së toku e në aleancë të ngushtë armësh kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë. Edhe shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, luftuan me heroizëm tok me ne dhe me të gjithë popujt e Jugosllavisë kundër të njëjtëve armiq. Jo vetëm luftuan së toku, por Ushtria jonë Nacionalçlirimtare u shkoi në ndihmë partizanëve jugosllavë e vëllezërve kosovarë dhe në tokat e tyre derdhi gjakun e bijve e të bijave të popullit shqiptar. Ne vepruam siç na mësonte Partia Komuniste Shqipërisë, me ndërgjegje e me frymë të lartë internacionaliste. Ne mendonim se kështu do të fitohej liria nga popujt e të dy vendeve tona, do të zhdukej robëria dhe do të ndreqeshin gabimet tragjike të historisë së kaluar. Ne besonim se pas fitores çdo gjë do të zgjidhej në rrugën marksiste-leniniste. Garanci për këtë ishin partitë komuniste që udhëhiqnin Luftën Nacionalçlirimtare në të dy vendet. Por bindja jonë te "komunizmi dhe internacionalizmi" i udhëheqësve jugosllavë, besimi te fjalët e tyre nuk u vërtetuan. Në fakt, udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë nuk shikoi kurrë drejt e në rrugë marksiste-leniniste çështjen e së ardhmes së shqiptarëve në Jugosllavi, prandaj edhe do ta zgjidhte, siç e zgjidhi gabim e shtrembër, në rrugë nacionaliste e shoviniste, plotësisht antimarksiste.

Zgjidhja e gabuar e kësaj çështjeje të madhe parimore filloi që në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, mbajtur në Jajce në nëntor të vitit 1943, ku viset shqiptare në Jugosllavi u përdorën si një mjet për të rregulluar përmasat tokësore e të popullsisë së republikave të Federatës, veçanërisht të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. E ardhmja e shqiptarëve të Jugosllavisë u vendos a priori

nga lart, pa aprovimin dhe vetëvendosjen e popullit shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe pa as më të voglin konsultim me aleaten e popujve të Jugosllavisë, e interesuar drejtpërsëdrejti në këtë çështje, Shqipërinë popullore. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në kundërshtim me «politikën e barazisë nacionale» të shpallur në mbledhjen e dytë të AVNOJ-it, shkeli pa të drejtë vullnetin e shqiptarëve në Jugosllavi, të shprehur në mbledhjen themelvënëse të Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Metohinë, mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944, që ishte në përputhje të plotë me të drejtën e «vetëvendosjes deri në shkëputje» të popujve që përbënin Jugosllavinë dhe që ishte përcaktuar në dokumentet themelore të Partisë Komuniste e të Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave.

Për sa i përket konsultimit me Shqipërinë popullore për zgjidhjen e këtij problemi historik, udhëheqja jugosllave e quante a priori të panevojshëm. Ajo ishte kundër një konsultimi të tillë, pse e dinte që një diskutim parimor, marksist-leninist e miqësor ndërmjet udhëheqjeve të të dy vendeve tona, duke marrë parasysh edhe vullnetin e lirë të shqiptarëve që banonin në trojet e tyre në Jugosllavi, do të çonte në një zgjidhje të drejtë dhe jo shovinisto-arbitrare e nacionaliste, si ajo që ndërmori udhëheqja jugosllave.

Pas luftës, në vitin 1946, një delegacion i vendit tonë, që kryesoja unë, bëri vizitën e parë zyrtare në Jugosllavi. Në bisedimet që u zhvilluan me këtë rast me Titon, ky kërkoi të dinte se ç'mendoja unë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Unë i shpreha mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen kësaj. Shqiptarët luftuan që të ketë një Shqipëri të lirë e sovrane, së cilës tani duhet t'i bashkohen edhe viset shqiptare të Jugosllavisë. Presidenti Tito u përgjigj: «Jam dakord me pikëpamjen tuaj, por tash për tash nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë, sepse serbët nuk do të na kuptojnë». Ky premtim zyrtar i Titos për këtë problem të madh e parimor nuk u shoqërua me asnjë veprim të mëtejshëm nga ana e jugosllavëve. Çdo gjë ishte mashtrim nga ana e tyre.

Në zgjidhjen e gabuar në Jajce, në copëtimin e tokave shqiptare dhe në mohimin e shprehjes së vullnetit të lirë të shqiptarëve qëndron gabimi themelor, me karakter nacionalist e shovinist, i udhëheqjes jugosllave që u pasua nga gabime të tjera po aq të rënda në lidhje me të drejtat e ligjshme e të natyrshme të shqiptarëve, të cilët akuzohen tani nga serbomëdhenjtë si «shovinistë», «nacionalistë» e «irredentistë». Në këtë zgjidhje shumë të gabuar dhe antilenineste të çështjes nacionale në Jugosllavi dhe sidomos të entitetit shqiptar prej afro 2 milionë banorësh, gati sa gjithë popullsia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e kanë burimin ngjarjet e kohëve të fundit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi.

Shovinizmi serb, malazez e ai maqedonas, që në fillim ndoqi ndaj shqiptarëve një politikë nacionaliste të egër, shtypëse e diskriminuese, në të gjitha drejtimet, në arsim, në kulturë, në ekonomi etj.

Edhe në periudhën kur ndërmjet vendit tonë e Jugosllavisë dhe të dy partive kishte marrëdhënie të mira, problemi i shqiptarëve në Jugosllavi ishte një «gjyle hekuri» në këmbët e jugosllavëve. Kërkesat e pakënaqësitë e shqiptarëve as nuk shqyrtoheshin, as nuk zgjidheshin politikisht në rrugën e mirëkuptimit, por me dhunë, me masa të egra administrative. Shqiptarët akuzoheshin për nacionalizëm dhe kjo bëhej për të fshehur shovinizmin dhe nacionalizmin serb. Asgjë nuk mund t'i mbulojë e t'i justifikojë raprezaljet e përgjakshme kundër shqiptarëve më 1945, më 1968 e përsëri më 1981, diskriminimin e tyre, lënien në varfëri, shtypjen nacionale, mohimet e dallimet e mëdha në fushën e arsimit dhe të kulturës. Rënia në fatkeqësi e grupit serbomadh të Rankoviçit, në vitin 1966, e më vonë e grupit tjetër serbomadh të Nikeziçit, shënojnë periudhën e demagogjisë politike të titistëve ndaj Kosovës dhe kosovarëve. Nevoja për balancimin e

forcave të ndryshme brenda Federatës, çoi në njëfarë rishikimi formal të statusit të Kosovës, e cila nga krahinë e thjeshtë e Serbisë, u emërtua krahinë «autonome» e saj.

Me dashje ose pa dashje të serbëve, kjo situatë e re u dha mundësi shqiptarëve në Jugosllavi, dhe sidomos kosovarëve, të zgjeronin arsimin, të ngrinin Universitetin e Prishtinës, të zhvillonin kulturën, të mësonin historinë e popullit të tyre, të vendosnin kontakte dhe marrëdhënie arsimore-kulturore dhe ekonomike me Shqipërinë, në bazë të ligjeve të Federatës dhe të marrëveshjeve zyrtare midis RPSSH dhe RFSJ. Por baza ekonomike e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës mbeti përsëri shumë e dobët, u la pas dore. Pasuritë e saj përsëri u shfrytëzuan pa skrupull nga republikat e tjera të Federatës, sidomos nga Serbia. Të gjitha «zgjidhjet» që u paraqitën me bujë të madhe gjatë kësaj periudhe ishin të shpëlara, koniunkturale e të dobishme për Beogradin dhe Shkupin. Sipas rastit, pa u thënë haptazi, ato konsideroheshin ose si "lëshime oportuniste të Titos", siç ndodhte me serbët, ose si "fitore të arritura në sajë të Titos", siç trumbetoheshin nga udhëheqës shqiptarë të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës. Ndërsa masat e shqiptarëve nuk patën shumë iluzione, pasi ajo çka u jepej ishte një gjë fare e vogël përpara të drejtave të mëdha që u ishin mohuar e rrëmbyer.

Ngjarjet që kanë ndodhur pas vdekjes së Titos, kanë treguar se sa gabim e në ç'rrugë antimarksiste ishte zgjidhur çështja nacionale në Jugosllavi dhe veçanërisht çështja e shqiptarëve. Kërkesave të tyre të ligjshme brenda Kushtetutës iu dha një grusht i rëndë dhe i përgjakshëm nga ana e udhëheqjes shoviniste serbe dhe e të gjithë udhëheqjes jugosllave pas demonstratave që u bënë në Kosovë, në mars e prill të këtij viti. Tani, më shumë se kurdoherë tjetër, mbi kosovarët dhe mbi gjithë shqiptarët në Jugosllavi përveç gjendjes ekonomike të mjeruar, rëndon edhe shtypja e egër nacionale. Mbi ta është vendosur ligji i terrorit, është derdhur policia dhe ushtria serbe, burgjet janë mbushur plot me të rinj e të reja. Masat që janë marrë e po merren, shkojnë jo vetëm drejt zhdukjes së çdo të drejte të ligjshme e të atyre pak përfitimeve që u dukën në zhvillimin e arsimit e të kulturës, por edhe drejt shkombëtarizimit të shqiptarëve në Jugosllavi. Dhe kjo bëhet nga ata që pretendojnë se respektojnë dokumentet e Konferencës së Helsinkit mbi liritë e të drejtat e njeriut. Opinioni botëror duhet të mos qëndrojë indiferent, por të alarmohet për këtë gjendje dramatike të popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Ç'kërkuan, në fund të fundit, shqiptarët në demonstratat masive që u zhvilluan në qytete e fshatra të ndryshme në Kosovë?

Shqiptarët në Jugosllavi më se një herë, me demonstrata paqësore dhe pa demonstrata, kanë, kërkuar që gjendja e tyre kushtetuese, ekonomike dhe social-kulturore të ndreqej, të vihej në rrugë të drejtë brenda ligjeve të Federatës, ata kërkuan të kenë statusin e Republikës brenda RFSJ. Ata, nuk kërkuan as shkëputjen nga Federata, as bashkimin me Shqipërinë. Por kërkesave të drejta e të ligjshme të studentëve, punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve kosovarë as ua vuri veshin kush. Jo vetëm kaq, por ata, si edhe herë të tjera kur. kanë paraqitur kërkesa të tilla të ligjshme e të drejta, u cilësuan si nacionalistë, u persekutuan dhe u mbytën në gjak.

Por a mund të zgjidhen kështu këto probleme në kohën tonë? Kurrsesi. Është e pamundur të mbahet në varfëri e në mjerim një popull, toka e të cilit është e begatë dhe grabitet nga të tjerët. Është e pamundur të mbash nën frikën e tankeve e të bajonetave një popull trim si shqiptarët. Është e pamundur ta shtrembërosh ose ta zhdukësh historinë dhe kulturën e tij të lashtë. Është e pamundur t'ia zhdukësh ndjenjën patriotike dhe dashurinë për mëmëdheun.

Po të ecet në rrugën që ka zgjedhur dhe po ndjek udhëheqja e sotme jugosllave, kundërshtimet e shqiptarëve do të vazhdojnë, do të rriten dhe do të acarohen akoma më shumë. Vetëm një zgjidhje e menduar mirë e çështjes nacionale, pa pasione nga të dy palët, një zgjidhje që të pranohet e të aprovohet nga populli i Kosovës, e likuidon këtë

situatë shumë të ndërlikuar, të cilën e kanë krijuar jo kosovarët, por shovinizmi serbomadh. Kosovarët dhanë zgjidhjen më të drejtë e më të përshtatshme në këto situata të vështira për Jugosllavinë dhe për veten e tyre. Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës brenda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk e cenon ekzistencën e Federatës. Krerët serbë e jugosllavë, në vend që të arsyetonin, dërguan tanket, gjakosën popullin dhe tash po zhvillojnë në shkallë të gjerë të famshmin diferencim, domethënë hetimin policor: kush ishte pro e kush kundër demonstratave. Kjo mënyrë veprimi, më parë me terror, pastaj gjoja me «diferencim», do të thotë të përpiqesh të frikësosh masat, që nuk frikësohen, të zhdukësh patriotizmin, që nuk zhduket, të kesh iluzionin se ke qetësuar gjendjen, por ngjallur mërinë dhe zemërimin, të mendosh se ke sjellë «njerëz të besuar» në pushtet, të cilin e ke spastruar nga «nacionalistët» etj., por ke hedhur të gjithë popullin në rezistencë të heshtur, që nesër më me forcë do ta ngrejë zërin kundër mizorive që po i bëhen. Këtë situatë s'duan ta kuptojnë udhëheqësit jugosllavë.

Pse ne i themi hapur këto të vërteta dhe kërkojmë që problemi i Kosovës dhe i gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, i zgjidhur gabim, të ristudiohet me gjakftohtësi dhe të mos shkohet në dhunë e në terror, pse kërkojmë t'u jepet fund persekutimeve dhe të lirohen nga burgjet djemtë e vajzat kosovare, RPSSH e akuzojnë se ndërhyn në punët e brendshme të Jugosllavisë, bile atë e akuzojnë se nxit turbullirat në Kosovë e gjetkë! Dhe si i nxit ajo këto turbullira? Nëpërmjet marrëdhënieve arsimore e kulturore zyrtare. Shkohet deri atje sa të thuhet se RPSSH bën kauzë të përbashkët me reaksionin politik shqiptar në mërgim, të cilin ne e kemi luftuar dhe e luftojmë me të gjitha forcat tona.

Asnjëherë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë. E kundërta ka ndodhur. Revizionistët jugosllavë komplotuan për likuidimin e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe për inkuadrimin e Shqipërisë në Federatën jugosllave si republikë e shtatë e saj, duke menduar që me këtë zgjidhnin një herë e mirë dhe në rrugë aneksioniste e imperialiste problemin e gjithë kombit shqiptar. Por këto komplote as u realizuan, as do të realizohen ndonjëherë. Shqipëria s'është e s'do të bëhet kurrë një mjet rregullimi për të qetësuar konfliktet e kontradiktat midis klaneve jugosllave. Ajo ka zot popullin e saj, një popull plot vitalitet, trim dhe atdhedashës, që s'ka frikë nga askush.

Shqipëria nuk ka bërë ndonjëherë rivendikime tokësore ndaj Jugosllavisë, asnjë kërkesë për rektifikim kufijsh nuk gjen në dokumentet e saj. Por, duke mbajtur këtë qëndrim, ne s'kemi mohuar dhe as do të mohojmë kurrë faktin se në Jugosllavi rron një pjesë e madhe e kombit dhe e popullit shqiptar. Ne kemi mbrojtur dhe do të mbrojmë edhe në të ardhmen, me të gjitha forcat e në rrugë marksiste-leniniste, të drejtat e ligjshme të vëllezërve tanë shqiptarë matanë kufirit dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është e drejta jonë e pamohueshme.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Autoritetet jugosllave duhet të pushojnë terrorin dhe persekutimet ndaj shqiptarëve, të likuidojnë shtypjen nacionale dhe t'u njohin atyre të gjitha të drejtat që u takojnë. Për zgjidhjen me drejtësi të problemeve ata duhet të bisedojnë qetësisht, me gjakftohtësi dhe në barazi me popullsinë shqiptare në Jugosllavi. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 7-9)

6-8. EDHE NJË AKT I POSHTËR SHOVINIST

Nga Kadri Zeka

Vargut të masave të egra që shovinistët serbomedhenj po ushtrojnë ndaj popullit tonë, iu shtua edhe një akti i poshtër: në shumë pjesë të Kosovës, u pengua përcjellja e

emisioneve të Radios dhe të Televizionit shqiptar. U vu kështu në jetë kërkesa që kishte bërë para sa muajsh shovinisti me damkë, Dushan Ristiç dhe antishqiptarët e tjerë të tërbuar si ai.

Shqipëria Socialiste është bërë sot, ylli ndriçues në natën e zezë borgjezo-revizioniste. Ajo është bërë sot e dashur dhe e respektuar për të gjithë popujt dhe proletarët e botës. Zëri i Shqipërisë është bërë zëri i së vërtetës, zë që ngroh zemrat e të shtypurve dhe tmerron armiqtë e popujve dhe të socializmit. Nëpërmjet emisioneve të Radiotelevizionit shqiptar, populli ynë njihte realitetin e shkëlqyer të Shqipërisë socialiste, fitoret madhështore që arrijnë vëllezërit tanë, jetën e lirë dhe të lumtur që bëjnë ata. Ato u bënë shkollë e madhe për edukimin e tij patriotik e komunist. Radiotelevizioni shqiptar, për një kohë të shkurtër, hyri në shumicën e shtëpive kosovare, u bë i dashur për të gjithë njerëzit e të gjitha profesioneve dhe moshave. Edhe ato familje që nuk kishin kushte për të blerë aparat televiziv, bënë ç'bënë de siguruan disi mundësinë që të shohin Televizionin shqiptar, siguruan dritaren, nga e cila shikonin botën e madhe të lirisë e socializmit...

Krerë të ndryshëm shovinistë e tradhtarë, dikur deklaronin plotë fodëlluk se nuk kanë nevojë t'i pengojnë emisionet e Radiotelevizionit shqiptar dhe as që t'i pengojnë njerëzit që ta njohin realitetin shqiptar, të cilin e quanin të mjerueshëm, e aq më pak flisnin kundër këtij realiteti, pasi siç thoshin ata, ai nuk mund të ndikonte fare në opinionin në Jugosllavi. Më vonë ata u detyrua të shpërthenin fushatë të paparë shpifjesh e trillimesh kundër Shqipërisë dhe kur e panë që as kjo nuk u mjafton, se kështu i nxirrrnin sytë e vetëvetes, ata u detyruan që në këto momente të vështira krize që po kalojnë, të hargjojnë miliarda, për të blerë instalimet, me të cilat do t'i pengonin emisionet e Radiotelevizionit shqiptar. Në kanalin e valëve të Televizionit shqiptar, shovinistët vendosën perden e zezë, në mënyrë që njerëzit tanë të mos mund ta shohin diellin e lirisë, kurse në vend të tingujve gazmorë të çiftelisë e gërnetës që i penguan ata, lëshuan një zhurmë të bezdishme, që të ngjan në kuisjen e një bishe që po jep shpirt.

Në këtë mënyrë, shovinistët duan ta ndajnë e izolojnë krejtësisht popullin tonë nga bota që e rrethon dhe sidomos nga Shqipëria Socialiste dhe kështu të mbyllur brenda kafazit të tyre shovinist ta përpunojnë atë, ta zhveshin nga çdo frymë patriotike e kombëtare, ta shthurin e degjenerojnë plotësisht.

Por shovinistët serbomëdhenj, edhe në këtë rast i kanë bërë gabim llogaritjet e tyre. Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, nuk do të bëhet kurrë siç duan ata. Ai e ka kuptuar të vërtetën, e ka gjetur rrugën e tij dhe nuk ka forcë në botë që mund ta ndalë në rrugën e lirisë dhe përparimit. Asnjë perde nuk mund ta pengoj rrezatimin e diellit të lirisë, asnjë zhurmë e kuisje pre bishe nuk mund ta pengoj zërin e Atdheut. Populli ynë thotë: "Dielli me shoshë nuk mund të mbulohet." (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 9)

6-9. I MBYTURI KAPET EDHE PËR FEJE

Nga Hydajet Hyseni

Për qëllimet e tyre të errëta antishqiptare, shovinistët jugosllavë dhe tradhtarët, po mundohen të shfrytëzojnë gjithnjë e më shumë edhe fenë. Për këtë qëllim, kohët e fundit, krerët më të lartë të Serbisë, Kosovës e Maqedonisë, organizuan takime me personalitetet më të larta fetare dhe u munduan t'i fusin edhe ata në fushatën antishqiptare. Në këtë

mënyrë ata duan t'i mashtrojnë besimtarët e ndershëm dhe ta përçajnë popullin tonë që është bashkuar si më parë, pa dallim feje e bindjeje politike, në luftë për të drejta e liri.

Një fjalë e urtë thotë: "I mbyturi kapet edhe për një fije kashte"..., kurse sot mund të thuhet: I mbyturi kapet edhe për feje. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 9)

6-10. POET I MADH REVOLUCIONAR

NË 70-VJETORIN E LINDJES SË MIGJENIT

Nga Berat Luzha

Migjeni është njëri ndër shkrimtarët tanë kombëtar, i cili me krijimtarinë e tij letraro-artistike ka tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe zgjon kurreshtjen për njohjen gjithnjë e më të mirë të veprës së tij, për njohjen e rrethanave politiko-shoqërore e ekonomike, në të cilat jetoi e veproi poeti.

Shqipëria e viteve 30-ta ishte mbytur në një krizë të thellë ekonomike e shoqërore. Ajo pak ekonomi e varfër po shkatërrohej vazhdimisht si pasojë e politikës antipopullore e antikombëtare të regjimit satrap zogist dhe të depërtimit gjithnjë e më shumë të kapitalit të huaj. Një varfëri e paparë deri atëherë e përfshiu tërë vendin, gjendja në vend ishte kudo e nderë. Bejlerët, agallarët, kleri, fajdegjinjtë, borgjezia, tregtarët e shtresat tjera të privilegjuara, shtypnin dhe shfrytëzonin masat e varfra të qytetit e të fshatit. Mbi masat rëndonte edhe rendi i egër policor, i cili ndëshkonte e dënonte elementin përparimtar demokratik, që herë pas here ngrinte zërin kundër këtij regjimi të urryer. Derisa regjimi në fuqi po kalbej gjithnjë e më tepër, ishte Italia fashiste ajo që zinte pozita kyçe në ekonominë shqiptare, në arsimin e kulturën, duke përgatitur kështu terrenin për pushtimin e plotë të Shqipërisë. Ideologjia fashiste si një gjarpër i zi, mundohej të shtrihej në Shqipëri dhe të helmonte shpirtrat e njerëzve.

Ndaj sistemit të egër shtypës e shfrytëzues zogist ziente pakënaqësia e masave, grumbullohej urrejtja e revolta si llavë vullkani. Në këto kushte lindi dhe u gjallërua lëvizja antizogiste, antiimperialiste, lindi lëvizja demokratike e punëtore. Në vitin 1935 shpërtheu Kryengritja e Fierit, e cila nga regjimi u shtyp me zjarr e me hekur. Në vitin 1936 u zhvillua greva e punëtorëve të naftës në Kuçovë (sot qyteti Stalin), demonstrata e bukës në Korçë, etj. Në Shkodër kishin nisur të përhapeshin idetë socialiste, u formuan celulat e para komuniste e në vitin 1936 u krijua grupi komunist i Shkodrës. Në Korçë kishte disa vite që vepronte Grupi Komunist i këtij qarku, i cili filloi botimin e gazetës "Bota e re". Jashtë vendit formohet Fronti Demokratik Nacional, filluan të botohen edhe organe përparimtare, demokratike e antizogiste brenda dhe jashtë vendit. Të rinjtë komunist i vunë vetes detyrë të largonin rininë nga ndikimi i regjimit dhe i propagandës shurdhuese të tij si dhe obskurantizmit fetar, të zhvillonin aktivitete masive kulturore-artistike, të përhapnin ndër ta idetë socialiste, etj. Mjaftë komunistë dhe patriotë vullnetar shkuan në Spanjë, ku u radhitën në brigadat internacionale për të mbrojtur Republikën Demokratike të Spanjës dhe për të luftuar fashizmin, që si një lugat po përgaditej të sulmonte popujt e Evropës dhe jashtë saj.

Në rrethana të shtypjes e shfrytëzimit nga njëra anë dhe të urrejtjes e revoltës nga ana tjetër, në Shqipëri në vitet e 30-ta, u zhvillua një letërsi përparimtare. Kjo letërsi, duke mbajtur anën e popullit, sulmonte e demaskonte herë hapur, herë me simbolikë, sistemin zogistë me të gjitha strukturat sunduese dhe makinerinë shtypëse. Përfaqësuesi më në zë i kësaj letërsie ishte padyshim Millosh Gjergj Nikolla–Migjeni. Ky shkrimtar, më së miri

i përjetoi rrethanat e vështira ekonomiko-shoqërore qëpo kalonte populli, u njoh mirë dhe u lidh me masat e gjera dhe krijimtarinë e tij në poezi e prozë ia dedikoi atyre. Migjenin e preokupuan problemet shoqërore, i mbronte të drejtat njerëzore, shquhej për një pasion të zjarrtë, për zgjidhjen e tyre.

Sa ishte nxënës në Manastir, ai mori anën e rretheve revolucionare të rinisë. Nëpërmjet këtyre rretheve dhe nëpërmjet letërsisë përparimtare që ai lexonte vazhdimisht, i riu Millosh erdhi në kontakt me vepra të njohura letrare dhe me idetë e tyre, me vepra të realizmit socialist, me shtetin e Leninit e Stalinit.

Sa qe mësues, Migjeni njohu jetën e zymtë dhe revoltuese të masave të qytetit e fshatit, kåeshtu që veprimtaria e tij letrare pasqyron kushtet e jetës dhe gjendjen e vështirë të popullit. Migjenin pothuajse asnjëherë nuk e ka mbërthyer pesimizmi, por pezmatimi për masat që shtypen e shfrytëzohen. Ai dallon qartë ndarjen klasore, dallon "të dobëtit" pa pushtet nga "të fuqishmit" me pushtet, i venë këto klasë përballë njëra-tjetrës.

Dalja e Migjenit në arenën letrare, qe ngjarje me rëndësi për letërsinë demokratike të kohës që i kundërvihej letërsisë dekadente dhe asaj klerikale. Në kundërshtim me rrymat letrare të deriatëhershme, që idealizonin të kaluarën apo idilizonin jetën e mjerueshme të popullit, Migjeni përqafoi metodën e realizmit, si drejtim më të përshtatshëm të kohës, për të pasqyruar jetën e popullit, për të mbrojtur masat e gjëra, për të shprehur brengat, revoltën dhe aspiratat e tyre demokratike.

Në përgjithësi vepra e Migjenit kishte karakter luftarak për kushtet që kalonte vendi. Arti sipas tij, ishte një mjet për pasqyrimin e jetës e të shoqërisë, si një nga format e shoqërisë njerëzore Arti – thotë Migjeni, ka karakter shoqëror dhe i shërben një klase të caktuar në shoqërinë e ndarë me klasa.

Realiteti i zymtë feudalo-borgjez ishte një burg për poetin revolucionar. Migjeni nuk e ndjente veten të lirë të shprehte atë që i vlonte në shpirt. Ai ishte realist edhe për rrezikun që do t'i sillte krijimtaria revolucionare dhe këtë e shfaqte duke thënë se: "dy armiq konkurronin t'i afronin qefinin e vdekjes", qeveria zogiste dhe tuberkulozi. Sepse jeta dhe veprimtaria e Migjenit lidheshin ngushtë me lëvizjen antizogiste dhe antiimperialiste në Shqipëri, veçanërisht me lëvizjen punëtore e komuniste.

Të rinjtë përparimtar e njihnin Migjenin përmes shkrimeve të tij dhe përmes shokëve, ndonjëri prej të cilëve, ishte inkuadruar në celulat e porsaformuara komuniste. Migjeni nuk hyri në ndonjë celulë, as më vonë në grupet komuniste, por me komunistët mbajti lidhje të ngushta. Ai me komunistë shkëmbente literaturë revolucionare ilegale, kështu që në këtë kohë, ai lexoi disa broshura që qarkullonin nëpër këto celula. Migjeni u shoqërua me shokë, që ishin të dalluar, për çështjen e atdheut e të popullit. Kështu, ai pos të tjerëve, u shoqërua me komunistët Vojo Kushi e Jordan Misja (sot heronj të popullit), pastaj me mësuesit revolucionar Teufik Gjyli e Skënder Luarasi, me militantin revolucionar Selim Shpuza e të tjerë.

Në qendër të veprës poetike të Migjenit është tema e mjerimit, e atij mjerimi që vështirë përshkruhet. Duke shfryrë dhembjen që i shkakton mjerimi poetit, ai vizaton pamje rrënqethëse, jep portrete njerëzish të mbërthyer nga një trishtim i rëndë. Poetin e rëndonte hendeku i pabarazisë shoqërore në rendin ekzistues, kontrasti i luksit të të pasurve dhe mjerimit të të varfërve.

Krahas viktimave të tjera të padrejtësisë njerëzore, është me interes paraqitja e figurës së punëtorit, i cili, "punon, punon ditë e natë, tue i vlue djersa në gjoks dhe në ballë" dhe në fund si shpërblim merr "vetëm lekë tre-katër dhe marsh".

Tema e klasës punëtore do ta tërheq Migjenin në shumë krijime në poezi e prozë. Punëtori i Migjenit endet rrugëve të qytetit të tij pa punë, "porsi kolegët e tij në Berlin e në London" dhe është gati për të shpërthyer si një "revolucion në miniaturë".

Në botën e protagonistëve të Migjenit, i cili me besnikëri na jep tablonë e shoqërisë në sistemin zogist, na ipet figura e beut feudal, e agait fajdexhi, xhandarit e klerit hipokrit e injorant. Kjo kategori njerëzish përbënin përfaqësuesit e shtresave e të klasave të privilegjuara e sunduese, ndërsa në anën tjetër na ipet kategoria e njerëzve të shtypur e të shfrytëzuar që qonin një jetë të varfët, në errësirë e pasiguri për të nesërmen, siç janë: punëtori i papunë, lypësit, qirakët, fshatarët e robëruar nga regjimi, kleri dhe zakonet konzervatore etj. Punëtorët në ato pak fabrika e punishte që ekzistonin, punonin edhe nga 12 orë në ditë, me një pagë fare të vogël e me kushte të mjerueshme të punës. Si pasojë e rrënimit të ekonomisë fshatare u përhap zia e bukës. Gra e burra, fëmijë e pleq grumbulloheshin të uritur para dyerve të institucioneve shtetërore për të kërkuar punë dhe misër. Të uriturit dhe lypësit e ndeshin rrugëve, duke shtrirë dorën për një lekë apo një kafshatë bukë. Zuri të shfaqej hapur plaga e zezë dhe e shëmtuar e prostitucionit. Fshatarët rendnin në qytet për të shitur krahun e punës, apo prodhimin e paktë të tyre me çmim fare të ulët. Varfëria kishte prekur edhe disa shtresa shoqërore, siç ishin zanatçinjtë, tregtarët e vegjël dhe nëpunësit e kategorisë së ulët.

Migjeni nuk arriti që krahas demaskimit të botës së vjetër, çjerrjes së maskës shoqërisë feudalo-borgjeze, të shprehte pohimin e botës së re, të botës socialiste. Veçse, këtë botë ai e ndjeu në qenjen e tij dhe besoi se ajo do të vinte edhe në atdheun e tij. Migjeni besonte se do të vinte "një ditë më e lumnueme" kur "këngët e pakëndueme" do të shpërthenin "pa frigë e pa zori". Me diellin alegorik poeti aludonte në idetë e Revolucionit Socialist të Tetorit, të cilat po përhapeshin gjithnjë e më tepër edhe në Shqipërinë e tij.

Migjeni nuk ishte formuar plotësisht në botëkuptimin e tij materialist e shkencor, ndërsa në Shqipëri klasa punëtore nuk ishte ngritur në nivelin e duhur nga ana ideologjike e organizative. Kësaj klase i mungonte partia, i mungonte pararoja revolucionare, e cila do të themelohej vetëm pak vjet më vonë, pasi vdiq poeti. Mirëpo, poeti nuk gjëmonte nga dhembja për të mjerët, nuk i ankohej regjimit në fuqi, por shpërthente fuqishëm në revoltë e urrejtje.

Bllokimi i "Vargjeve të lira" nga cenzura e qeverisë, nuk bëri që autori i kësaj përmbledhje të revoltohet, e as që vepra e tij të mos njihej nga populli. Admiruesit e veprës së Migjenit, që ishin të shumtë, i mblodhën shkrimet e tij në poezi e në prozë që ishin të botuara në organet e shtypit, i daktilografuan e i shumëzuan në kopje të reja dhe i shpërndanë dorë më dorë. Një shpërndarje të gjerë patën veçanërisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, kur u bënë material i çmuar propagandistik ilegal. Në fillim të vitit 1944, dual një përmbledhje e poezive të poetit, por ajo u cenzurua nga autoritetet gjermane dhe kështu bëri që ajo të mos ketë një shpërndarje të gjerë.

Vetëm me çlirimin e Shqipërisë dhe me ardhjen në fuqi të pushtetit popullor, vepra e Migjenit, gjeti tretmanin e merituar, në ballë të letërsisë shqipe. Ndërkaq, interesimi i masave të çliruara për figurën dhe veprën e poetit ishte i madh.

Me kujdesin e Partisë e të pushtetit popullor, në vitin 1956 u sollën në Atdhe eshtrat e MIllosh Gjergj Nikollës, u nderuan ato dhe u vendosën në varrezat e dëshmorëve të popullit, në qytetin e tij të lindjes.

Për merita të jashtëzakonshme në edukimin e gjeneratave, Migjeni u nderua me titullin e lartë "Mësues i popullit" dhe me "Urdhërin e lirisë" të shkallës së parë. Në qytetin e Shkodrës u hap shtëpia e tij, ku u vendos material i çmuar nga jeta dhe krijimtaria e poetit. Me emrin e tij u emëruan shkolla, ndërmarrje, institucione kulturore, rrugë, pastaj grupe amatore e profesionale letrare e artistike etj. Poetët i kushtuan vargje, kompozitorët këngë, piktorët e skulptorët bënë portrete, buste e përmendore të tij. Herë pas here, e sidomos në raste jubilare, mbi varrin e tij bëhen homazhe me lule të freskëta, organizohen

mbrëmje letrare e konferenca përkujtimore, sesione shkencore dhe dalin botime me vepra të tij apo rreth krijimtarisë së tij. Në Shqipëri për çdo vjet organizohen manifestime të tilla, e ndërsa në Kosovë nuk organizohet asnjë lloj manifestimi për Migjenin, e as për ndonjë poet shqiptar.

Migjeni për ne ka mbetur kurdoherë i ri. Ai siç ka thënë prof. Vehbi Bala: "nuk kërkoi lavdinë, por lavdia e ndoqi pas".

Migjeni mbetet një poet revolucionar i shquar, dhe mësues përparimtar që talentin e tij, e vuri në shërbim të popullit, të demokracisë e përparimit shoqëror. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 10-11)

6-11. SHQIPJA E FURTUNËS

Nga Ismail Syla

Ti e deshe jetën, tokën, njerëzit, pranverën
Ëndrrat t'i skuqi dielli i zjarrtë jugor,
Tufë rrezesh të arta, miliona margaritarë
Shëndriste në syrin tënd ylli mëngjesor.

Udha e dritës vinte thellësive shekullore,
Shtrihej kalldrëmave të eshtrave të gjakut,
Mëngjeset e ndritura i zinte nata mejgullore,
Terri i zi, kuqedra, sfidë i bënin agut.

Atë ditë hidhej vallja fluturim shqiponjash,
Nën qiellin e egërsuar, nga erërat e të ftohtit veri.
Mes tyre vallen e hodhe sup më sup si malet
Krenar i patundur si lisi në stuhi.

Veriu mes prillit derdhte suferinë,
Akull e breshër mbi lulet e njoma,
Që toka e shqipeve të mos ketë tjetër stinë
Që të thahet blerimi, të zhduket aroma.

Vallja e shqiponjave e rëndë atë ditë hidhej
Zemra strall shkreptinte vetëtimë
Përflakej horizonti, qielli i turbullt ndizej,
Marshimi i shqipeve gjëmonte bubullimë.

Në çdo rrebesh ka fluturim shqiponjash
Dhe fluturimet hapin, shtigjet e lirisë
Varganit i shkëputet një shqipe, bie,
Edhe një gurë kështjellës, një emër pavdekësie.

Në çdo sitnë moj shqipe ëndërra të mbeti një,
Sa vjeshta, sa dimra të argasën rininë,
Ta thyen buzëqeshjen, endrrën ta trazuan
Dhe për pranverën, ta rritën dashurinë.

Jashtë kuiste veriu, zemra merrte plagë,

Pranvera, ëndërr, vegim i bukur ishte,
Dallëndyshet fluturonin, kudo dritë e ag,
Ti ëndërroje në dimër, ëndrra e re kishte.

Buzëqeshja jote-lule, karafil,
Zbukurues i kësaj toke me zjarre
Në ballin flamur-plagë trëndafil,
Ti pishtar i ndezur në netët kosovare.

Dhe tokës sate që aq shumë e deshe
Me strall, plisa të bardhë, shqipe e zë bilbili
Në male, legjenda, krisma, rrebeshe,
Një gurrë gjaku i fale atë ditë prilli.

Shumë heret rinia t'u thye o vëlla,
Dhe ike mbi krah shqiponjash fluturim,
Qiellit të përskuqur, stuhi vetëtimash,
Vezullim yjesh, lulëkuqe, shkëmbi, dritë, agim.
(LIRIA, dhjetor 1981, faqe 11)

6-12. RINIA IME

Nga Ismail Syla

Rinia ime ngjyrë bozhuri,
Rini e kuqe si flamuri.

Rinia ime zemër-zjarrta
E pamposhtur në barrikada.

Rinia ime lule e rrallë,
Lule e bukur me yll në ballë.

Rinia ime heroikja
Është e jotja Republika.

6-13. DY YJEVE TË PASHUARA
(Bule Naipit dhe Persefoni Kokëdhimës)

Nga Tueta Hadri

Çelët si lule behari,
O ju bija, shqiptari,
O ju yje të pashuara,
Motrat tona të paharruara.

Luftuat siç ju kish hije
O shqiponja Shqipërie,
Ishit lule, mbetët lule,

Lule Perso, lule Bule.

Sot për ju këndojmë,
Emrat tuaj lartë i çojmë,
O trime guximtare,
O shqiponja, shqiptare.

Shembulli juaj na frymëzon
Na rrit zemrat, na forcon,
Edhe ju jeni në luftën tonë,
Rruga juaj, është rruga jonë.

6-14. KOSOVË

Kosovë, fole shqiponjash
Në pranga e lidhur,
Kështjellë e trimave
Nëpër luftëra e rritur.

Kosovë, me shekuj në robëri
Me shekuj rënkim,
Sulme, shfarosje, beteja,
Por jo kurrë nënshtrim.

Lumja ti, moj nënë Kosovë,
Lumja ti për ata trima,
Lum për Shota e Azema
Lum për Isa Boletina.

Lumja ti, për Bacë Bajramin,
Për Eminin e Ganimeten,
Lum për yjet e kësaj pranvere
Që ty o nënë, ta falën jetën.

Lumja ti moj nënë Kosovë
Për djem e vajza që ti ke,
Lum për lulet tua të kuqe
Që luftojnë për një ditë të re.

Eja moj pranverë e kuqe,
Që të lulëzoj Kosova ime,
Eja ditë e ëndërruar me shekuj,
Falë të qoftë, rinia ime.

6-15. KOSOVARË DHE KOSOVARE

(Tekst për këngë)
Nga Hydajet Hyseni

Kosovarë dhe kosovare,

Të ngritemi ne për liri,
Të lidhemi me besë shqiptare
Pranë flamurit kuq e zi.
T'i ngremë grushtat përsëri;
Më mirë vdekje se robëri
Poshtë robëria, shovinizmi!
Rroftë liria e komunizmi!

Kosovarë dhe kosovare
Punëtorë, studentë fshatarë
Pranë flamurit proletar!
Ja fitojmë në liri,
Ja se bëhemi shkrumb e hi.
Poshtë robëria e shovinizmi!
Rroftë liria e komunizmi! ((LIRIA, dhjetor 1981, faqe 11)

6-16. Demagogjia nuk mund ta mbuloj dhunën dhe terrorin

Nga Nezir Myrtaj

Këto kohët e fundit në shtyp, radio, televizion u shkrua dhe u fol me të madhe për "aksionet e shumta punuese" që u organizuan me pjesëmarrjen e njësive të armatës dhe policisë së ardhur në Kosovë, nga vise të ndryshme të Jugosllavisë. Artikuj, shënime e reportazhe të shumtë, ngritën në qiell rëndësinë e madhe të këtyre "aksioneve" për forcimin e dashurisë dhe unitetit në mes rinisë sonë dhe njësive të ushtrisë e policisë, për farkëtimin e harmonisë dhe bashkëjetesës në mes tyre, për forcimin e bashkimit në mes tyre etj., etj. Gati sa nuk thuhet se këto njësi nuk kanë ardhur këtu për tjetër, por për të ndërtuar rrugë dhe ura, për të hapur kanale e për të ndërtuar ujësjellsa, për të rregulluar oborret e shkollave e fabrikave tona, për të pyllëzuar malet tona...

Me anën e këtyre rasteve qesharake, shovinistët serbomëdhenj po mundohen ta gënjejnë e mashtrojnë opinionin në Kosovë dhe jashtë saj. Edhe me këtë rast shovinistët, po mashtrojnë vetveten, kur po mendojnë se njerëzit janë aq naiv sa të gënjehen aq kollaj dhe të hanë gjellën bajate që u servir kuzhina propagandistike e serbomëdhenjve. Se cili është misioni dhe qëllimi i vërtetë i njësive të huaja policore e ushtarake, tani e dinë mirë edhe njerëzit jashtë Kosovës, dhe e dimë mirë sidomos ne, kosovarët, që për muaj të tërë po i ekspozohemi dhunës dhe terrorit të tyre fashist.

Populli ynë ia ka parë me sytë e tij hijenat e Beogradit si i masakruan, rrahën, poshtëruan e plaçkitën studentët tanë të pambrojtur, si qëlluan me bomba, snajper e automatikë mbi trupat e njomë të motrave e vëllezërve tanë, si i ngritën kapakët e tankseve dhe qëlluan mbi fëmijët tanë, si i qëlluan dhe i torturuan edhe të plagosurit, si rrahën dhe poshtëruan njerëzit e pafajshëm, vetëm e vetëm pse ishin shqiptar... Ai ka parë këta kriminelë, si lëvronin varrezat me tanke, si i sulmonin njerëzit në shtëpitë e tyre me tanke e helikopterë, si qëlluan popullin me automatikë në mes të qytetit të tyre, i ka parë ata të shkelin edhe atje ku nuk durohet, në nderin dhe dinjitetin tonë...

Gjatë këtyre muajve të rëndë dhe gjatë gjithë historisë së tij, populli ynë ka parë shumë, prandaj ai nuk nënshtrohet kurrë. Ai nuk gënjehet nga demagogjija dhe hipokrizia e atyre që natën lyejnë duartë me gjakun më të mirë të bijve të popullit, kurse ditën organizojnë "aksione të përbashkëta vullnetare" me të rinjtë tanë, atyre që hapën gjithë ato varre të reja dhe tani dashkan ta nderojnë e zbukurojnë vendin tonë, të vëllazërohen

me ne... Jo, vëllazërim me vrasësit e tij gjakatarë, populli ynë nuk ka pasur e nuk do të ketë kurrë. Për ta populli ynë ka vetëm urrejtje. Se cili është qëllimi i vërtetë i tij për njësitë e huaja pushtuese, tregon ajo që ndodhi në Prekaz, e tregon përleshja në Gjakovë dhe varrimi madhështor i të riut Nesim Dana, që u vra mizorisht nga këto njësi, tregon përleshja në Podujevë, protesta në Qendrën e studentëve, e tregon urrejtja që lexohet në sytë e çdo kosovari, tregojnë parullat që po shkruhen anë e kënd Kosovës me kërkesën e njëzëshme: POLICË TË HUAJ, SHKONI NË SHTËPINË TUAJ! (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 12)

6-17. ASNJË PËLLËMBË TË TOKËS SHQIPTARE NUK E L'SHOJMË PËR PA DALË FARE

Nga Kadri Zeka

Viti që shkoi u karakterizua nga vlimet revolucionare që përfshinë mbarë Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi. I gjithë populli ynë dhe rinia e tij e kuqe u ngritën në këmbë për të kërkuar të drejtat dhe liritë e mohuara për të kërkuar Republikën e Kosovës. Kërkesat e drejta të popullit tonë, u përkrahën dhe u mbështetën fuqimisht edhe nga punëtorët kosovarë në mërgim, të cilët gjatë gjithë vitit zhvilluan një aktivitet të dendur patriotik e luftarak. Ata qëndruan të patundur në përkrahje të studentëve, punëtorëve e fshatarëve, në mbështetje të mbarë popullit të Kosovës. Kjo e tërboi si UDB ashtu edhe përfaqësitë diplomatike në perëndim, të cilët nuk lanë mjet pa përdorur e gurë pa lëvizur për t'i shmangur punëtorët nga rruga e tyre e drejtë. Por përpjekjet e tyre shkuan huq. Punëtorët as nuk u përqanë as nuk u trembën, nga presionet.

Tani kur punëtorët kanë filluar të vijnë për pushime në vendlindje, pranë familjeve të tyre, udbashët e Herleviqit nuk po organizojnë "takime" me punëtorë (pasi e dinë se nuk shkonë kush në to, e edhe po të shkojnë, punëtorët kërkojnë llogari, si viteve tjera) por kanë ndërmarrë një fushatë të paparë burgosjesh e arrestimesh. Shumë punëtorë janë arrestuar ende pa arritur në shtëpi, kurse qindra të tjerëve u është rrethuar shtëpia, pa u çmallur mirë me njerëzit e familjes dhe janë flakur qelive. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i punëtorëve, çdo ditë po merren në pyetje me kërcënime e presione të shumta. Aq larg kanë shkuar shovinistët serbë dhe veglat e tyre në Kosovë sa t'i akuzojnë punëtorët për vepër penale, pse janë anëtarësuar në klubet e punëtorëve shqiptarë në mërgim.

Masa të jashtëzakonshme po ndërmirren edhe në vendkalimet kufitare, ku punëtorët shqiptarë maltretohen, kontrollohen imtësisht dhe mbahen në burgim kufitar, pa asnjë faj me ditë e javë të tëra.

Gjatë këtyre ditëve që punëtorët ndodhen në Kosovë, po shohin për së afërmi dhunën dhe terrorin e pashoq që po ushtron regjimi mbi rininë e popullin tonë, po shohin edhe masat e shumta antishqiptare, që po ndërmirren me qëllim që t'ia zënë frymën popullit tonë, ta nënshtrojnë e shkombëtarizojnë atë.

Të gjitha këto, bashkë me brutalitetin policor si dhe situatat e vështira e të ndërlikuara që po kalon Kosova, çdo ditë e më tepër po i kalitin punëtorët tanë mërgimtarë, që t'i përballojnë vështirësitë e sulmet e gjithanshme të armiqve. Kjo po shprehet qartë në qëndresën e vendosur, të shumicës dërmuese të punëtorëve, që u dënuan dhe atyre që janë në hetime e në presione.

Një nga synimet kryesore të serbomëdhenjve (të cilën mërgimtarët dhe populli ynë i kanë kuptuar me kohë) është që përmes masave represive e presioneve të detyrojnë njerëzit tanë (sidomos rininë) të marrë rrugët e botës, për të mos u kthyer kurrë më në

Kosovë. Situata kritike që po kalon tani Kosova, nuk është e para në historinë e popullit tonë. Gjyshërit dhe baballarët tanë u lidhën fort me njëri tjetrin dhe të bashkuar qëndruan të papërkulur, në tokat shqiptare, të trashëguara e të lara me gjak nga të parët tanë. Ata me trimëri të rrallë i bënë ballë epërsisë anadollake, i bënë ballë masakrave e brutalitetit të kralëve serbë dhe terrorit të fashistëve italianë e gjermanë. Më vonë po me të njëjtën qëndresë përballuan gjenocidin titist dhe krimet e UDB-së e Rankoviqit. Shembulli i tyre duhet të jetë një frymëzim i madh për çdo shqiptar. Prandaj, sot për çdo shqiptar të ndershëm e patriot, vehet si detyrë e dorës së parë, që të ngulitet fortë në vendlindjen e vet dhe pa marrë parasysh vuajtjet e sakrificat të mos largohet e t'ia kthejë shpinën Kosovës. Në këtë mënyrë, ne do të shkatërrojmë një plan të rrezikshëm e djallëzor të armiqve. Sot më shumë se kurrë, Kosova jonë e dashur, ka nevojë për bijtë e vet. Në këto situata, të braktisësh atdheun (qoftë edhe me pretekstin se do ta ndihmojë luftën edhe nga jashtë) është barazi, me atë që quhet sabotim i luftës.
Të ikësh sot nga Kosova është njësoj sikur t'i çosh duart nga istikami, kur armiku kërkon dorëzimin tënd. Në përgjithësi këtë të vërtetë e kanë kuptuar punëtorët tanë në mërgim, prandaj janë aq shumë të lidhur me vendlindjen dhe fatet e Atdheut.

Me siguri në të ardhmen edhe qëndresa e përpjekjet e tyre, do të forcohen e konsolidohen edhe më tepër. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 13)

6-18. LETËR KOSOVËS

(PJESË NGA FJALA E NJË PUNËTORI KOSOVAR, MBAJTUR NË MBRËMJEN FESTIVE TË 28 NËNTORIT, TË ORGANIZUAR NGA PUNËTORËT SHQIPTAR NË R. F. GJERMANE)

Nga Ismet Rashiti

MIRËMBRËMA KOSOVA JONË HEROIKE!

Ne bijtë e tu mërgimtarë, bijtë e tu të ndershëm, jemi tubuar në këtë natë, të festojmë 28 Nëntorin, ditën e flamurit tonë të lavdishëm dhe ditën e çlirimit të nënës sonë Shqipëri.

Nëna jonë e dashur Kosovë, gjendemi larg gjirit tënd dhe të njerëzve tanë, por gjithmonë marrim frymë së bashku me ty. Të kujtojmë nëna jonë e dashur në ëndërr e në zhgëndërr dhe sa herë që mendojmë për ty na rrjedhin lotët rrëke faqeve tona të zbehura. Ne vërtetë jemi larg atdheut por nuk harrojmë amanetin e vëllezërve dhe motrave tona, djemve dhe vajzave, nënave dhe baballarëve tanë, që na porositën të qëndrojmë besnik ty nënë Kosovë. Kjo porosi sidomos tani është bërë kushtrim për ne, kur shovinistët serbomëdhenj kanë vu një peshë të rëndë mbi trupin tënd plot plagë.

Nëna jonë e dashur Kosovë, muzgu po afrohet e gjithnjë e më shumë errësohet natyra. Ne bijtë e tu jemi tubuar këtu dhe mendojmë për ty, për hallet tua dhe bukuritë e shumta që ke dhe zemrat na kallen flakë, mendojmë për epopetë tua të lavdishme dhe flamurin tonë ngadhënjimtar. Sot mbi ty Kosova jonë e shtrenjtë, mbretëron acar, lulet kanë zënë të vyshken, pullazet e shtëpive janë të mbuluara me mjegull, e mbi kalldremet e rrugëve tua manovrojnë kërcënueshëm tanket jugosllave. Djemtë dhe vajzat tua më të bukura janë mbyllur burgjeve që të shpëtojnë ty nëna jonë Kosovë, nga kuçedra serbomadhe. Nga gjiri yt janë grabitur pasuri të shumta, tani në raftet tua po nxirren qindra libra e tekste shkollore, u është vënë dryri shumë institucioneve arsimore, vogëlushëve tu të njomë në vend të çantës me libra krahëve u rrjedhin lotët papra për të afërmit e vrarë e

të burgosur, janë larguar nga puna e shkolla mijëra shqiptar të ndershëm, po sulmohet çdo gjë e vlefshme që ke.

Jemi tubuar sonte bijtë e tu besnik dhe çdonjërit i shihen rrudhat e ballit për ty Kosova jonë hallemadhe. Në këtë natë, na kujtohet çdo gjë që po ndodh në trupin tënd të bukur, na kujtohen torturat e shumta që bënë milicia speciale e Beogradit dhe kriminelët e UDB-së mbi vëllezërit tanë, mbi motrat tona të ndershme, mbi bijtë tu revolucionarë dhe me lot në faqe nderojmë heroizmin e tyre dhe qëndresën tënde.

Ne mërgimtarët tu me kohë të jemi betuar se kurdoherë na ke me vete. Për ty nuk do të kursejmë as pikën e fundit të gjakut. Luftën tonë të drejtë do ta çojmë deri në fund, peshën e rëndë që ke ti o nënë Kosovë, motoja e përgjithshme në marshim tonë ngadhënjimtar është: JA VDEKJE – JA LIRI!

RROFTË POPULLI YNË HEROIK!

RROFTË KOSOVA JONË KRESHNIKE!

RROFTË 28 NËNTORI – DITA E FLAMURIT! (LIRIA, dhjetor 1981, f. 13)

6-19. LAMTUMIRË VENDLINDJA E DASHUR KOSOVË

Nga Kadri Zeka

TË DASHUR LEXUES,

Demonstratat paqësore që i zhvilloi në mars e në prill të këtij viti populli ynë, shovinistët serbomëdhenj i shtypën me zjarr e hekur. Njësitë e policisë speciale shtin pa pushim mbi demonstruesit e pa armatosur dhe vranë qindra vëllezër e motra tona. Vala e dhunës dhe terrorit policor nuk u ndalë as pas demonstratave masive dhe po vazhdon me tërbim të papërmbajtur. Qeveritarët e Beogradit dhe telallët e tyre në Kosovë, ngulën këmbë se në të gjitha demonstratat që u zhvilluan në Krahinë, nga dora e policisë u vranë vetëm nëntë veta. Por e vërteta e hidhur nuk mund të mbulohet me asnjë gënjeshtër. Por populli që ishte autor dhe dëshmitar i këtyre ngjarjeve tragjike dhe të lavdishme, tërhoqi nga thonjët e çetnikëve me dhjetëra kufoma gjatë demonstratave. Shumë shqiptarë tjerë të pafajshëm, u rrëmbyen dhe u zhdukën nga patrullat policore që kishin zënë çdo rrugë e skutë, që edhe sot e kësaj dite nuk dinë kush për fatin e tyre.

Populli thotë: "dardha e ka bishtin prapa". Kriminelët titistë, tani pas sa muajsh, kanë filluar t'i kthejnë kufomat e shumë viktimave që deri më tani i "ruajtën" nëpër frigorifere, duke trilluar rreth vdekjes së tyre. Kështu ndodhi edhe me një të ri patriotë, nga një fshat i Komunës së Vuçiternës. Ishin ato ditë heroike kur i gjithë populli ynë ishte ngritur në këmbë dhe kishte dalur në demonstrata, për të kërkuar të drejtat e veta. I ndjeri drejtohet për në spital, që të dërgonte një të afërm të plagosur në demonstratë. Posa hynë në oborrin e spitalit, njësitë e policisë serbe, që pritnin "gjahun" u turrën me rrëmbim drejtë tyre. I plagosuri duke parë gjendjen kritike, arrinë të fshihet e të shpëtojë nga kthetrat e tyre, ndërsa shoqëruesi i tij kapet nga duartë e milicëve gjakatarë. Që nga ajo ditë kaluan muaj të tërë, familja Ademi nuk diti gjë për birin e vetë që e rriti dhe e shkolloi me njëqind mundime. Para pak ditësh Aliu, vëllau i tij, muar telegramin e kobshëm nga Zagrebi, ku thuhej: –" Të vini të merrni kufomën, që ka vdekur në fatkeqësi komunikacioni", dhe asnjë shpjegim tjetër nuk ipej rreth tij. Në të vërtetë i ndjeri u rrëmbye dhe u torturua për vdekje nga udbashët kriminelë. Këtë e vërteton letra e shkruar nga vetë dora e tij, para se ta linin forcat e fundit.

Letra që po botojmë në origjinal këtu i drejtohet nënës së tij. Ajo tregon qartë për moralin e lartë të tij edhe në ato çaste kritike, për dashurinë e pakufishme ndaj Kosovës

së dashur, flet për qëndresën heroike dhe idealet e larta, të njërit nga shumë yjet e pashuara, që ranë kësaj pranvere për lirinë e popullit dhe atdheut.

(LIRIA, dhjetor 1981, faqe 14)

Letër Nënës,

Nga Teuta Hadri

N'vend të panjoshëm jam qëlluar,
plagë të rënda m'kan rrokë mua,
Dora më punon një letër me shkruar,
Se përndryshe jeta më është shkurtuar!
N'paqin mundësi, vëllezërit kufomën
në shtëpi me ma pru
Dil përpara dhe pritëm mua,
Hiq pa lot fytyrës tuj lotuar.
Se për vëllezërit shqiptar, jetën e kam ndrru!
Për vëllezërit Shqiptar, Kosovë Republikë!
Për të drejtat e popullit që barbarët
i kanë grabitë.
Qoftë dhe Rroftë populli Shqiptar Martir!
Trashëgues i Aspiratave gjer në fitoren përfundimtare
Janë përshëndetjet e mia të fundit,
Që mbeten përgjithmon.

Lamtumirë Nëna ime krenare,
Lamtumirë vendlindja e dashur Kosovë!

6-20. AMANET MOJ NËNË

Nga Teuta Hadri

Kudo që të vdesë mojë nënë
dua trupin të ma kërkosh,
dua lot të mos derdhësh
me flamur kur t'më mbulosh.

Kur flamuri të më mbulojë,
Ti, mos qaj, moj nëna ime,
I qetë në varr unë do të pushoj.
Paskam rënë për tokën tima.

6-21. RROFTË KOSOVA, REPUBLIKË!

Nga Hydajet Hyseni

U ngrit biri i Kosovës

Mitralozit iu hodh në grykë,
Ngriti zërin para botës:
Rroftë Kosova, Republikë!

Ballë për ballë u doli tankeve
Duke thirrur s'kemi frigë,
U tundi grushtin aeroplanëve:
Rroftë Kosova, Republikë!

E burgosën e torturuan,
I thanë kurrë s'do të shohësh dritë
Dhe prej tij këto fjalë dëgjuan:
Rroftë Kosova, Republikë!

I bëjnë lajka e dredhi,
I ofrojnë para e pozitë;
Ai thirri përsëri:
Rroftë Kosova, Republikë!

Dhe sikur gjoksin e dërmuar
Në dy copa t'ia ndajnë me thikë,
Në zemër të tij do të gjejnë të shkruar,
Rroftë Kosova, Republikë!

6-22. KOSOVË E KUQE

E kuqe gjithmonë
Në shekuj për liri,
Kreshnikja Kosovë
E kuqe në Histori.

Deshën të të nxijnë
Korbat gjakatarë;
Ti, e kuqe mbete
Nga gjaku i patharë.

Sërish në këtë pranverë
Të skuqi rinia
Dhe prap ti do të skuqesh
Gjersa të vijë liria.

6-23. KJO TOKË TË RRITI

Nga Teuta Hadri

Kjo tokë të lindi o bir,
Me bukë të saj ti u rrite,
Ujë të pastër nga kjo tokë ke pirë,

Dhe me gjak ti e ujite.

Nga gjaku yt lulëkuqe do të çelin,
Aromë të këndshme do të lëshojnë,
Në zemrat tona trimërinë mbjellin
Dhe ato për ty do të këndojnë. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 14)

6-24. TEKSTE PËR KËNGË REVOLUCIONARE DHE PATRIOTIKE

BESA BESË

(e përshtatur)

Nga Nezir Myrtaj

Besa besë një besë kemi dhënë
Ty Kosovë ne të kemi nënë;
Të kemi dhënë besë e të kemi dhënë fjalë
Shpirt e zemër të kemi falë.

Besa besë një besë kemi dhënë
Tokë të huajit mos me i lënë,
Është e jona, të parët na e kanë lënë
Kush mos t'na e prek se vdesim t'tanë.

Besa besë një besë kemi dhënë
Të gjithë do të vdesim për ty o nënë.
Jemi shqiptar me besë të madhe,
vdesim me nder s'jetojmë me marre.

Besa besë një besë kemi dhënë
Ty Kosovë të lirë do të bëjmë
Do të lajm prap me gjak
Se erdhi koha të marrim hak. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 15)

USHTON TOKA E KOSOVËS

Nga Hydajet Hyseni

Ushton toka e Kosovës
Armiqtë dridhen e tradhtarët
Përballë tankeve t' Beogradit
Tundin grushtat o kosovarët
Hej moj Kosovë o shkëmbë e gurë
Vritesh e pritesh-o për flamur
Me armikun o grykë për grykë,
Për liri o për Republikë.

U ngrit në këmbë o e gjithë Prishtina,
Ferizaji dhe Gjakova
Podujeva e Mitrovica...
N'këmbë u ngrit o e tërë Kosovë
Hej moj Kosovë o shkëmb e gurë
Vritesh e pritesh o për flamurë etj.

Më ngadalë bish e Beogradit
Se kjo tokë është e jona;
Për lirinë e vatanit
Të gjithë jemi o Mic Sokola
Hej moj Kosovë o shkëmb etj.

Vajza shqipe e djem sokola
Mbi tanke hidhen, mbi mitraloza.
Po çuditet o e gjithë bota
Çfarë rinie paska Kosova
Hej moj Kosovë o shkëmb etj

MOJ KOSOVË O MOJ MALËSORE

Nga Hydajet Hyseni

Moj Kosovë o moj malësore,
Pak na u duke e shumë na dole

Pak na u duke e shumë na dole,
Tankut para gjoksin i nxorre.

Tankut para gjoksin i nxorre,
Me grusht lartë armikut i fole:

"Herleviç o krye lopa
S'na frikëson me tanke me topa.

As me topa, as me aviona,
Jem shqiptar o e jem shqiponja.

Jem shqiptar o e jem shqiponja,
Të gjithë jemi i Mic Sokola.

Jem shqiptar o e jem shqiponja,
Se kjo tokë o bre është e jona.

Se kjo tokë është e jona.
Ne luftojmë për të drejtat tona.

Ne luftojmë e s'kemi frikë,
Për liri o për Republikë.

O TRIMA LUFTËTARË
(e përshtatur)

Nga Hydajet Hyseni

O trima luftëtarë,
O bijtë e Skënderbeut,
Kërkoni shqiptarë,
Lirinë e mëmëdheut.

Se mjaftë më mojë Kosovë
Në vuajtje, robëri!
O djem shtrëngoni grushtatë,
Ja vdekje, ja liri.

Sot lipset me flamur
Të ngritemi për liri
Se nuk e lëmë jo kurrë,
Kosovën nën Sërbi!

Se mjaft më moj Kosovë,
Në vuajtje, robëri!
O djem shtrëngoni grushtatë
Ja vdekje, ja liri!

O trima luftëtarë
Të luftojmë ne natë e ditë,
Ta bëjmë ne kosovarët,
Kosovën Republikë!

Se mjaft më moj Kosovë,
Në vuajtje, robëri!
O djem shtrëngoni grushtatë,
Ja vdekje, ja liri!

KAM QËNDISUR NJË SHAMI

Nga Saime Isufi

Kam qëndisur një shami
Me shqiponjë kuq e zi.

Mbi shqiponjë kam shkruar pa frikë,
Rroftë Kosova, Republikë.

Këtë shami t'kuqe si zjarri,
S'mund të ma grisë dorë serbomadhi.

Se Kosova ka shumë shqipe e Marigo,
Që e skuqin me flamuj atdheun kudo.

Dhe së shpejti ty o nënë do të vijë koha një ditë,
Kur e lirë të valoj shqipja dhe KOSOVA, REPUBLIKË!

RATË JU PËR KOSOVË!

Nga Hydajet Hyseni

Kosova martire
Me gjak gjithmonë e larë
U la përsëri Me gjak të dlirë shqiptar.
U skuq toka jonë
Me gjakun rinor,
O motra dhe vëllezër
Që ratë dëshmorë.
Ratë ju për Kosovën
Ratë ju për liri,
Lavdi ju qoftë o lule
Lavdi për jetë, lavdi!

Nuk duronit jo
Zgjedhë e robëri.
Ndaj e ngritët ju
Grushtin për liri.
Nën tanke armike
Po rënkonte trolli
Ju hapët xhamadanin
Sikur Mic Sokoli.
Ratë ju për Kosovën
Ratë ju për liri,
Lavdi ju qoftë o lule
Lavdi për jetë, lavdi!

Ratë ju për Kosovën
Për të mos vdekur kurrë,
Gjakun tuaj në luftë, ne,
Do ta kem flamur.
Ne do ta vazhdojmë
Amanetin tuaj
Në vend do ta qojmë.
Ratë ju për Kosovën
Ratë ju për liri,
Lavdi ju qoftë o lule
Lavdi për jetë, lavdi!

Gjak na pikojnë zemrat
Por ne nuk mbajmë zi;
Nuk qajmë për dëshmorët
Që bien për liri.
Nuk ju harrojmë kurrë
Por, gjithmonë ju kujtojmë,
Këngët më të bukura
Për ju do të këndojmë.
Ratë ju për Kosovën
Ratë ju për liri,
Lavdi ju qoftë o lule
Lavdi për jetë, lavdi! (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 15)

6-25. SHKOLLA SHQIPE NË SHËNJESTËR TË SHOVINIZMIT MAQEDON

Udhëheqja titiste, që krijoi prej leckash Federatën jugosllave, pasi ripushtoi tokat shqiptare, filloi të vejë në zbatim bile edhe më me vendosmëri, politikën asimiluese dhe shkombëtarizuese ndaj popullit tonë të filluar që nga krajlët serbë. Natyrisht, në këtë kuadër Titoja me shokë u kujdes që edhe klikës shoviniste të Kolishevskit, t'i mbetej pjesa "e vëllaut të vogël" në tokat shqiptare. Kështu pa pyetur vullnetin e popullit tonë dhe as gjakun e tij të derdhur, për të jetuar i lirë e i bashkuar u lanë territore të tëra shqiptare nën mëshirën e shovinistëve të tërbuar maqedon. Për këtë nuk pati kundërshtim as klika shoviniste serbe e Rankoviçit, pasi ishte e bindur se miku i zemrës Kolishevski me shokë, do të tregohej edhe më i papërmbajtur se edhe vetë ai në shkombëtarizimin e sllavizimin e tokave shqiptare. Dhe me të vërtetë ashtu ngjau. Historia dyzet vjeçare e popullit tonë në Maqedoni, është nga më të trishtueshmet. Mbi popullin tonë në Maqedoni u bënë masakra masive dhe u ushtrua terror i vazhdueshëm policor, me mijëra shqiptarë të pafajshëm, u dënuan dhe u kalbën në burgun famëkeq të Idrizovës e në kapidane të tjera. Në nivel republikan u formuan institucione e shtabe të veçanta me qëllim që të përjetojnë pushtetin maqedon në tokat shqiptare.

Në shërbim të këtij plani, u shpërngulën me dhunë dhjetëra, mijëra shqiptarë dhe në vend të tyre po sillen elementë sllavë, nga Greqia e vende të tjera. Masa të jashtëzakonshme janë ndërmarrë e po ndërmirren kundër kulturës e shkollës shqipe. Dhe po të flasim me gjuhën e fakteve, del se mbi 23 mijë fëmijë shqiptarë, mësojnë në gjuhën maqedone dhe kjo përbën gjysmën e numrit të përgjithshëm të nxënësve shqiptarë, kurse gjysma tjetër mësimin e ndjekin në të dy gjuhët dhe vetëm një pjesë e vogël (kryesisht nxënësit e viseve malore, kanë të gjitha lëndët në gjuhë shqipe). Për absurditet, këtë gjendje, Sekretariati Republikan për shkencë e arsim të Maqedonisë, përpiqet t'a shpjegojë me "dëshirën e nxënësve dhe prindërve të tyre, që mësimin ta ndjekin në gjuhën maqedone". Për habi nuk dihet deri më tani ndonjë rast, që fëmiu maqedonas, të ketë shprehur dëshirën të mësojë gjuhën shqipe apo ndonjë gjuhë tjetër. Në këtë drejtim gjendja paraqitet më kritike në shkollat e mesme e të larta, ku shovinistët maqedon në pretekstin e "mungesës së kuadrit", të "vëllazërimit e bashkimit", "patriotizmit jugosllav", etj., pjesën dërmuese të nxënësve e studentëve shqiptarë i kanë detyruar të mësojnë në gjuhën maqedone. Shembull tipik për këtë është Universiteti i Shkupit, në të

cilin studjojnë 2365 shqiptar. Nga të gjitha fakultetet e degët që i ka ky universitet vetëm në Akademinë Pedagogjike, dega e Gjuhës shqipe, për studentët shqiptarë mësimi është organizuar në gjuhën amtare. Për këtë arësye si dhe për diskriminimin e gjithanshëm që iu bëhet studentëve shqiptarë, para pak kohe u organizua një protestë e fuqishme nga studentët shqiptarë. Gjithashtu edhe standarti jetësor i tyre është shumë i ulët në krahasim me mesataren e studentëve të Republikës. Nga numri i përgjitshëm i shqiptarëve në këtë universitet, vetëm 489 veta shfrytëzojnë bursë ose kredi, kurse në shtëpitë e studentëve (barakat e mbetura që nga tërmeti i vitit 1963), banojnë 430 studentë shqiptarë, prandaj protestat e tyre, nuk përmbanin vetëm kërkesën që mësimi të zhvillohet në gjuhën shqipe por në vetvete ngërthenin shumë kërkesa të tjera. Ata gjithashtu shprehnin përkrahje e solidaritet me vëllezërit e tyre në Prishtinë.

Pas ngjarjeve të Kosovës, shovinistët maqedon, të alarmuar e në panik, nga protestat e fuqishme të popullit, sulmuan formalisht jo vetëm shkollat shqipe në Maqedoni, por edhe historinë, simbolet e figurat tona kombëtare. Goditje të rënda ka pësuar sidomos edhe pak ai arsim shqip që ishte në Maqedoni. Janë ndryshuar pothuajse rrënjësisht të gjitha planprogramet e shkollave shqipe, po ndryshohen shumë libra e tekste mësimore e disa prej tyre janë ndaluar krejtësisht. Aq shumë i është errësuar logjika shovinistëve maqedon sa t'i ndalojnë edhe përdorimin e shumë librave shqipe që botohen në Kosovë. Kështu ka ndodhur me librin e historisë të Ali Hadrit, për të cilën janë përgjegjur penalisht, arsimtarët që janë shërbyer me të. Të gjitha tekstet e ndryshuara e të ndaluara është vendosur të zëvendësohen me tekste të përkthyera nga maqedonishtja.

Në mungesë të librave (sidomos të gjuhës shqipe, historisë e gjeografisë) nxënësit po detyrohen të mësojnë përmes shënimeve.

Në Maqedoni, që nga lufta e këtej janë ndërmarrë masa represive kundër mësimdhënësve shqiptarë dhe inteligjencies përparimtare. Vlerësohet se që nga viti 1946 e deri në prag të demonstratave, në Maqedoni janë burgosur e përjashtuar nga puna mbi 500 arsimtarë shqiptarë. Kurse sivjet ky është bërë një aksion që ka marrë tiparet e një fushate të organizuar shtetërore. Deri më tani, janë arrestuar e larguar nga puna mbi 100 arsimtarë shqiptarë. Vetëm në komunën e Tetovës, në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, u larguan nga puna 18 mësimdhënës, në këtë komunë ky proces po vazhdon edhe tani me intensitet të shtuar. Në fshatin STREC u dënuan me burgim 7 arsimtarë, pse gjatë vitit të kaluar shkollor kishin regjistruar mbiemrat e nxënësve në përputhje me normat e drejtshkrimit shqip, pa prapashtesën maqedone "ski". Represione ndaj arsimtarëve shqiptarë janë ndërmarrë edhe në komunën e Dibrës, Kumanovës, Strugës etj.

Me pretekstin "e lirisë së besimit fetar" me të madhe shovinistët, po inkurajojnë e përhapin religjionin. Kjo ka bërë që një përqindje e madhe e fëmijëve shqiptarë të ndjekin shkollat (mejtepet) fetare me të cilat është angazhuar një ushtri e tërë priftërinjsh. Duket paradoksale por në Maqedoninë Perëndimore në këto farë shkolla fetare, janë përfshirë rreth 25 mijë fëmijë.

Goditjet e shovinistëve maqedon ndaj shkollës shqipe, në të ardhmen do të intensifikohen edhe më shumë. Kjo del qartë nga shumë materiale të Sekretariatit Republikan për Shkencë e Arsim si dhe nga deklaratat nervoze të krerëve republikanë, të cilët kërcënojnë për masa të reja dhe shajnë e shpifin për popullin tonë. Por populli ynë as nuk frikësohet e as nuk mashtrohet nga armiqtë e tij. Populli shqiptar në Maqedoni, me një guxim të rrallë u ka përballuar shumë stuhive e rrebesheve shoviniste dhe ka një traditë të shkëlqyer në luftën për të drejta e liri. Ai njeh mirë shovinistët maqedon e planet e tyre djallëzore dhe do të dijë t'i mbrojë të drejtat e veta.

(LIRIA, dhjetor 1981, faqe 16)

6-26. EDHE RRENA KA NJË KUFI

Nga Kadri Zeka

Gënjeshtrat trillimet e udhëheqësve jugosllav, tani më janë bërë një ushqim i përditshëm e bajat për qytetarët e zakonshëm e sidomos për kosovarët. Kështu ngjau edhe me mbledhjen e Komitetit Qendror të LKJ që u mblodh më 18 tetor për të shqyrtuar e miratuar të ashtuquajturën "platformën politike të LKJ për Kosovën". Në këtë farë maskarade u ngritën njëri pas tjetrit krerët titist në garën, se cili po shanë e shpif më shumë popullin tonë.

Me një pompozitet të neveritshëm e muarr fjalën edhe prosovjetiku e intriganti i mbaruar, Millosh Miniq. Që në fillim ai lajmëroi pjesëmarrësit se në fjalën e tij do të përpiqet t'i bënë një rëndësie të veçantë dhe nuk mund të iu lihet as historianëve. Pasi sakaton në mënyrë të palejueshme (ai gënjen se shoku Enver i quan kosovarët shqiptarë jugosllavë) disa citate të shokut Enver në Kongresin e 8-të, fillon interpretimin e tyre sipas dëshirës dhe mendjes së tij të turbulluar nga shovinizmi serbomadh. Ai në qendër të vemendjes për "demaskim" vë deklaratën e shokut Enver në Kongres, lidhur me bisedën e tij që pati me Titon në vitin 1946 rreth fatit të popullit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi.

Sipas tij, ajo që thotë shoku Enver lidhur me këto bisedime nuk është e vërtetë, pasi kështu ka shkruar njëfarë Josip Gjergja që paska qenë pjesëmarrës në këto bisedime. Por theksin kryesor Miniqi e vë në atë se "Enver Hoxha mendon se Tito s' është më që të mohojë ate..." Çfarë t'i thuhet kësaj pos një gënjeshtër me bisht. Dihet botërisht se ajo që u tha në Kongres për këtë takim është thënë pikë për pikë në librin e shokut Enver "Me Stalinin" që u botua në dhjetor të vitit 1979. Aty thuhet "Titoja më pyeti se ç'mendoja unë për Kosovën. KOSOVA dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi, i thash unë, janë toka shqiptare që fuqitë e mëdha padrejtësisht ia shkëputën Shqipërisë; ato i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë. Tani që ne jemi dy vende socialiste është koha që ky problem të zgjidhet drejtë. Titoja më tha: "Jam dakord, ne e dëshirojmë këtë, por tash për tash nuk mund të bëjmë gjë, sepse nuk e kuptojnë serbët një gjë të tillë." Pra ky pohim i shokut Enver u publikua qysh gjatë vitit 1979, kur Titoja ishte gjallë e shëndosh "si molla", bënte udhëtime e priste delegacione (ai vdiq në maj të 1980-tës). Atëherë nuk mbetet tjetër pos të pyesim? Pse Titoja nuk e demantoi këtë e zotit minik i themi. Edhe rrena ka një kufi. (LIRIA, dhjetor 1981, faqe 16)

==========

THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA

Më 7 dhjetor 1981, me postë, paradite, ka ardhur tek Jusufi një zarf postal me dy dokumente në te. Njëri ka qenë ftesa personale (me sa më kujtohet), individuale apo familjare për Jusufin, për dasmë dhe tjetri ka qenë një dokument me titull "Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", që në bazë kishte të pavërtetën, pra ishte një lloj testimi se mos këtë të pavërtetë e këtë manovrim po e përbinë edhe Jusufi. Jusufi po atë ditë, në praninë time i shkruan këtë përgjigje Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla: "*Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

MOS U HABITNI NËSE NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E TË PAVËRTETAVE

Jusuf Gërvalla: *"Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se* ***keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha, me manovrime nga ana juaj.***

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave. (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

KJO MË BRENGOSË EDHE MË SHUMË PËR RRUGËN E TYRE

1. Terrori komunist ishte shumë diskret
2. Regjimi socialist po luftohej me socializëm
3. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste
4. Nuk janë të afërta as të pranueshme
5. DIKTATI I KEQ DHE HEGJEMONIA E MIRË
6. Iu kemi kundervu ideologjisë komuniste
7. KRIMET E KUQE
8. Kurrë nuk kanë qenë komunistë
9. Një fantazmë sillet nëpër Evropë
10. Vrasja e tyre kishte këtë qëllim të mbrapshtë
11. Janë përpjekur t'i vrasin për së gjalli idetë e tij nacionaliste
12. Kjo më brengosë edhe më shumë për rrugën e tyre

1. Terrori komunist ishte shumë diskret

Ismail Kadare: "*Terrori i përditshëm, sistematik, monoton ishte shumë më i keq se dhuna spektakolare. Ishte dispozita e veçantë e komunizmit. I krahasuar, për shembull, me terrorin fashist, terrori komunist ishte shumë më diskret, i fshehtë, i heshtur dhe i maskuar".*

"Nëse dënimi ishte kërkuar nga lart dhe nëse mbledhja ishte publike, mbrojtja ishte e pamundur, ndoshta fatale për viktimën. Mbrojtja haptazi merrej si sfidë haptazi ndaj partisë". ("La Republica", www.balkanforum.info, nëntor 2009)

Ismail Kadare: "*Është hipokrizi, është dyfytyrësi të thuash se ne jemi evropianë, por mos na pyesni më shumë për të kaluarën. Prandaj diskutimi duhet të bëhet. Nëse kemi këtë dilemë, ne e vëmë veten në skizofreni morale, që është gjëja më e pamoralshme e një kombi" -ka thënë ai. "Ka gjëra që për arsye të ndryshme munden që për një kohë t'i refuzohen publikut, çdo shoqëri e ka këtë, ka arkiva që nuk hapen për vjet të caktuara për arsye të ndryshme, por shoqëritë demokratike duhet të shpjegojnë ato që ndodhin në strategji të zhvillimit të shtetit, në politikë, në ekonomi, në të gjitha."* (http://lajme.dervina.com, nëntor 2009)

2. Regjimi socialist po luftohej me socializëm

*"**Apostol Duka**: Thatë se e ndërruat emrin e Grupit tuaj Revolucionar. Më lejoni t'ju pyes: E ndërruat sepse bindjet tuaja ideologjike ishin marksiste-leniniste, e ndërruat sepse duhej ndërruar, apo e bëtë këtë gjë për të qenë të ngjashëm me veprimtarinë politike e ideologjike të shtetit-amë?*

Mehmet Hajrizi*: E kuptoj këtë pyetje me ngut. Sot, pas kaq vitesh, duhen sqaruar këto emërtime të Organizatës, që për brezin **aktual duken demode** dhe të largëta, edhe pse nuk e cënojnë aspak karakterin nacionalçlirimtar dhe rëndësinë historike të saj... Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste **që ishte në modë atëherë**, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim.*

...Po të shikohen dokumentet e Organizatës, bëhet e qartë si drita e diellit se veprimtarët e Lëvizjes së Kosovës, pavarësisht emërtimeve dhe literaturës që lexonin, luftonin për të drejtat dhe çlirimin e popullit shqiptar dhe jo për triumfin e ndonjë ideologjie në atdheun e tyre apo në botë.

*...**M. Hajrizi**: Ndikimi nuk mund të mohohet, por ne fokusoheshim tek shkelja nga udhëheqja jugosllave e parimit të vetëvendosjes së popujve, e cila ishte pjesë përbërëse e doktrinës leniniste dhe premtim demagogjik i Titos e partisë së tij komuniste.*

...Së katërti regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm edhe për një arsye që e diktonin rrethanat historike.

...Apostol Duka: Ky është trajtimi dhe shpjegimi më i plotë që kam dëgjuar deri tani dhe juve jo më kot paskeni qenë udhëheqësi i asaj organizate. (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, f.163-167)

3. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste

"*Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-**socialiste** në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e 'Grupit Revolucionar" që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata **Marksiste-Leniniste** e Kosovës.*" (Citat i

përdorur nga Mehmet Hajrizi, Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 316)

4. Nuk janë të afërta as të pranueshme

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"
"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto **emërtime** të Organizatës, që për brezin aktual **nuk janë të afërta as të pranueshme**."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

Mehmet Hajrizi: *"Filozofia politike, mendimi i ri politik, analizat e thella të gjendjes dhe të situatave, **qartësia e perspektivës**, ndërtimi i strategjisë dhe taktikave në shërbim të saj, ishin shprehje e një pjekurie dhe kulture të lartë politike e kombëtare të radhëve të Organizatës (Marksiste Leniniste të Kosovës -shën. ynë)."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 318)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

5. DIKTATI I KEQ DHE HEGJEMONIA E MIRË

Mehmet Hajrizi: "*Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste, që ishte në **modë** atëherë, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim, prandaj pjesëtarët e saj nuk duhen ngatërruar me pushtetarët që e përdornin apo keqpërdornin për diktat dhe sundim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 98)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të **ruante rolin hegjemon**."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

6. Iu kemi kundervu ideologjisë komuniste

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

*...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik ...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

7. KRIMET E KUQE

Prof. Abdyl Kadolli: "*Lëvizja kombëtare shqiptare kurrë nuk ka pasur karakter ideologjik. Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e*

bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. Një Rezolutë e miratuar nga Kuvendi i Kosovës do t'i përkufizonte mirë këto krime antikombëtare e antinjerëzore, ndërsa një ligj nuk do të lejonte më në pushtet personat e kompromentuar.

Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave.

Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës...

Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët.

Janë të tmerrshme krimet komuniste të periudhës së pasluftës, kur gjatë Kryengritjes shqiptare u masakruan e ekzekutuan rreth 50 mijë shqiptarë." (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

8. Kurrë nuk kanë qenë komunistë

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë*." (Bota Sot, 14 shtator 2009)

Kovosaprees: "*Në punimet e sotme të Konventës së VI-të të PDK-së është diskutuar edhe rreth profilit të partisë, me ç'rast delegatët janë përcaktuar për profilizimin si parti e qendrës së djathtë*." (PDK profilizohet si parti e qendrës së djathtë, wwww.kosovapress.com, 27 janar 2013)

9. Një fantazmë sillet nëpër Evropë

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE, i Karl Marksit dhe Fridrih Engelsit fillion me fjalinë: "Një fantazmë sillet nëpër Evropë –"

Fjalët e mëposhtme flasin për shpirtin e sakrficës dhe luftën për t'u takuar me figurën e vërtetë të udhëhqësit të Partisë Komuniste.

Xhafer Shatri: *"Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhtuam me mija kilometra për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasoja të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të udhëtojmë 5000 kilometra, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative."* (Qarkore, qershor 1983)

10. Vrasja e tyre kishte këtë qëllim të mbrapshtë

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej* ***'Liria'****. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte*

*me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e **Frontit**, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

11. Janë përpjekur t'i vrasin për së gjalli idetë e tij nacionaliste

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!**" Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

12. Kjo më brengosë edhe më shumë për rrugën e tyre

Jusuf Gërvalla: "*Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim e satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes. Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën. Veçse, një mësim duhet nxjerrë : sinqeriteti - për shokët e sinqertë. (Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre, kur nuk dhanë asnjë shenjë! **Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)***

Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku."
(Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012

07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Korrik 2013-Shkurt 2026